

**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP**

**STUDIME
ALBANOLOGJIKE**

5

Shkup, 2012

*Kryeredaktor
Prof. Dr. Qemal Murati*

*Redaksia
Prof. Dr. Qemal Murati
Dr. Bukurije Mustafa
Dr. Izaim Murtezani
Dr. Naim Halimi
Mr. Besnik Emini*

*Sekretar i redaksisë
Mr. Besnik Emini*

*Adresa e redaksisë:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
Kutia Postare nr. 171
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë*

*Adresa elektronike:
studimealbanologjike@yahoo.com
studimealbanologjike@itsh.edu.mk*

ISSN 1857-6958UDK 930.85
COBISS.MK-ID 82595850

PËRMBAJTJA

PËRVJETORË

Laureta PETOSHATI

KUSH ISHTE ISMAIL BEJ VLORA? Në vigjilje të 100-vjetorit të Shtetit Shqiptar.....9

STUDIME DHE ARTIKUJ

Eqrem ÇABEJ

ILIRISHTJA DHE SHQIPJA.....19

Aleksandër STIPÇEVIQ

ETNOGJENEZA E SHQIPTARËVE NGA ILIRËT.....31

Lavdosha AHMETAJ

MBI SHTETFORMIMIN E HERSHËM ILIR.....43

Qemal MURATI

ALBANËSIA E “PROVINCAVE ONOMASTIKE” NË AREALIN E MAQEDONISË – DËSHMI E AUTOKTONISË SË SHQIPTARËVE NË KËTO VISE QË NGA PERIODA ANTIKE E DERI SOT.....49

Skender ASANI

AUTOKTONËSIA SHQIPTARE E SHKUPIT NË DOKUMENTE AUTENTIKE.....65

Besnik EMINI

MAQEDONIA NË SHKRIMET E GAZETËS “SHKUPI”.....69

Zunun ZUNUNI

Silvana JOVÇESKA

SHPËRNGULJA E POPULLSISË NGA RAJONI I MAVROVËS DHE ROSTUSHËS PËR NË TURQI.....77

Izaim MURTEZANI

KAH HERMENEUTIKA E DISA LOJËRAVE POPULLORE ME PRAPAVIJË TEATRORE.....85

<i>Bukurije MUSTAFA</i> VËZHGIME MBI LEKSIKUN E TË FOLMEVE SHQIPE TË MAQEDONISË.....	99
<i>Nazmi BEQIRI</i> QASJE E SHKURTËR MBI TË FOLMEN E KUMANOVËS.....	107
<i>Fatmir SULEJMANI</i> TAGRI I NJË VEPRIMTARIE TË PAZAKONTË ATDHETARE.....	121
<i>Zejnepe ALILI – REXHEPI</i> POEZIA E MESAZHIT UNIVERSAL NË “VARGJET E LIRA”.....	129
<i>Naim HALIMI</i> KONTRIBUTI I SHQIPTARËVE TË KARADAKUT NË ÇLIRIMIN E SHKUPIT DHE NË SHPALLJEN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË NË VITIN 1912.....	139
<i>Zeqirja IDRIZI</i> <i>Fahredin SHABANI</i> KONTRIBUTI I TAJAR BEJ TETOVËS PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE SHQIPTARE.....	151
<i>Qerim DALIPI</i> KONSOLIDIMI DHE ZGJERIMI TERRITORIAL I SHTETIT TË BALSHAJVE (1360-1385).....	161
<i>Fauzi SKENDERI</i> DISA VEÇORI GJEOGRAFIKE TË VENDBANIMEVE RURALE NË TREVAT SHQIPTARE NË MAQEDONI.....	175
<i>Sadik KRASNIQI</i> ZHVILLIMI I MUZELOGJISË NË KOSOVË.....	185
<i>IDENTITETE BALLKANIKE</i>	
<i>Monika SHOSHORI STAFA</i> “GJUHA E TJETRIT” SI KRITER MENDËSIE.....	197
<i>Eda DERHEMI</i> ZAMAN, DERMAN, BALLKAN, MOR AMAN!.....	201

RECENSIONE

NJË VEPËR STUDIMORE ME VLERA PËR GJUHËN E XOXËS
(Dr. Bukurie Mustafa, Gjuha e romanit “LUMI I VDEKUR” të Jakov
Xoxës, Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në
Shkup, 2011) (Qemal Murati).....**207**

MARRËDHËNIET SHQIPTARE-MAQEDONASE - KONTEKSTI I
ENCIKLOPEDIË (Enciklopedia e ndarjes - *Kumtesa të Tribunës
shkencore të organizuar nga Instituti Albshkenca, mbajtur në Prishtinë, më
7. 10. 2009.* Botoi Instituti Alb-shkenca, Prishtinë, 2010, f. 124) (Begzad
Baliu)**210**

Përvjetorë

LAURETA PETOSHATI

KUSH ISHTE ISMAIL BEJ VLORA?

Në vigjilje të 100-vjetorit të Shtetit Shqiptar

Atij i erdhi mbrapa historia, sepse ai la mbrapa një vepër të madhe. Kënga: “Cili je ti more burrë” këndohet sot e kësaj dite. Po kush ishte ky burrë që nuk la pallat e kancelari për dymbëdhjetë vjet me radhë pa shkelur për të arritur një shtet shqiptar?! Ai nuk vinte nga asgjëja. I dinte mirë rrënjët e veta. Ai kishte në rremba direkt gjakun e Arianitëve, ishte pjesë e asaj familjeje që kishte pasur krushqi me Komnenët, familje perandorake, ku Gjergj Arianit Komneni do të mbetej në histori jo vetëm për luftërat e vazhdueshme mbi çerekshekulli kundër pushtuesve osmanë, por edhe për martesën e famshme që bëri të bashkohej jugu dhe veriu i popullit shqiptar, toskët dhe gegët. Vajza e tij Donika që e kishte pasur me gruan e parë Maria Muzakën, më 21 prill të vitit 1451, do të lidhte kurorë me Gjergj Kastriot Skënderbeun, të cilit i vjehri i dha jo vetëm vajzën, por edhe një pajë të jashtëzakonshme. Ai e pat njohur mirë adashin e tij. Të dy kishin qenë dikur peng te sulltani. Ndaj, kur ai doli i bëri thirrjen që të kthehej prej andej. Kastrioti u kthye, e mbajti fjalën. Kjo është arsyeja që në pajën e vajzës Gjergj Arianit Komneni, fisniku me dy kështjella, i dha Skënderbeut edhe flamurin e Arianitasve, shqiponjën me dy krerë në ngjyrë ari me fushë të kaltër, e cila ishte futur te emblema e Arianitasve nga lidhjet e gjakut me Engjëll Komnenin. Pastaj fusha kaloi e kuqe, shqiponja e zezë, sepse Gjergj Kastrioti i futi ngjyrat e emblemës së familjes së tij. Ky ishte ai bashkim që u duhej shqiptarëve. Ky bashkim i shërbeu dhe Evropës, që do ta quante Skënderbeun Atleti i Krishtit “I shenjtë si Shën Luigji, diplomat si Talleyrand, trim si Aleksandri i madh.” Dhe ai, luftoi si askush tjetër. Erdhi një çast që edhe Skënderbeu do të plakej, por dhe Europa, djepi i kompromiseve, kërkonte të merrte frymë. Më 27 prill të vitit 1463, në marrëveshjen që bën Skënderbeu me Sulltanin Mehmet II, kërkohet që një nga djemtë e princit Gjergj Arianit Komneni të shërbente në ushtrinë e Perandorisë Osmane. Më 25 shtator 1463 Këshilli i Lartë i Venedikut miraton kërkesën e

Skënderbeut për ta bërë të birin Gjonin, pjesëtar të fisnikërisë venedikase dhe më 13 maj të vitit 1464, ky këshill u dha djemve të Gjergj Aranit Komnenit me gruan e tij të dytë, venedikasen Petrina Francone, e bija e baronit të Turizianos titullin e fisnikërisë: *Thomas Comnino, Constantinus et Areniti fratres, domini in patribus Albanie, filij quondam Magnifici et potentis domini Areniti.* (Vëllezërit Thoma Komnino, Kostantini dhe Araniti zotërinj të një pjese të Shqipërisë, djemtë e të shkëlqyerit dhe të plotfuqishmit Araniti.) Edhe pse të bijtë e princit Gjergj Arianit Komneni, u morën në mbrojtje nga Venetiku, përsëri, diplomacia kërkonte që marrëveshja të plotësohej. Dhe i vogli i vëllezërve, do të pësonte fatin e të atit, por dhe atë të Skënderbeut, do të merrej peng dhe do të quhej Aranit Mehmet, do të bëhej sanxhakbej, pastaj myteselim i kazasë së Himarës dhe sanxhakbej i Vlorës. Ai do të vritej nga himarjotët pse ndërroi fenë dhe u bë renegat. Por mbrapa do të linte tre fëmijë. Njëri nga këta do të ishte Ali Gazi Sinan Hadim, i cili do të ishte sanxhakbej i Vlorës, sanxhakbej i Prizrenit, do të qeveriste bregdetin shqiptar nga Arta deri në Korfuz, do të ishte ministër i thesarit, guvernator ne Anadoll dhe vezir i madh i Bajazitit të Dytë, i cili do t'i jepte grua të bijën e vet Adije Sulltanën, e cila ishte kushërirë e dytë e Aliu Gazi Sinan. Ai do të vritej në një betejë detare dhe do të varrosej në xhaminë e ndërtuar mbi një manastir në Kaninë më 1501. Fëmijët e tij do të bëheshin të famshëm për betejën e Lepantos dhe Kara Sinan Ahmet Pasha u bë sanxhakbej i Vlorës. Mbiemri mbeti Vlora. Të gjithë varroseshin në Kalanë e Kaninës. Në Vlorë prej disa shekujsh ekzistonte një shprehje: “Po u prish Vlora, Kanina e ndërton prapë, po u prish Kanina, Vlora nuk e bën dot.” Njerëzit kanë menduar për ndërtimet, por në fakt fjala ka qenë gjetkë. Kanina nënkuptonte shumë më shumë. Kanina nënkuptonte Arianitët, farën e tyre: trimërinë, zgjuarsinë, diplomacinë dhe largpamësinë.

Do të ishte përsëri kjo familje që hera-herës do të ngrihej kundër Sulltanëve edhe pse u lidh me ta për shkak të sundimit të gjatë. Madje edhe Ali Pasha që bëri përpjekje për një shtet shqiptar kishte lidhje krushqie me këtë familje të madhe. Mbas vrasjes së Ali Pashë Tepelenës, përpjekjet për bashkimin e Shqipërisë dhe shpalljen e pavarësisë vazhduan. Pikërisht më 8 nëntor 1828 në Velabisht, u formua Besëlidhja Shqiptare e Beratit dhe shtabi për drejtimin kryengritjes antiosmane kryesohej nga Ismail Bej Vlora i Parë, të cilit më vonë iu pre koka nga Porta e Lartë, gjoja gjatë diskutimit me një komandant turk gjatë rrethimit të Janinës. Por flaka e saj u shtri në të gjithë Shqipërinë: në Leskovik më 1831, në Shkodër 1835, Dibër, Gjakovë më 1844 dhe që paralajmërim i kryengritjes së vitit 1847. Ndërkaq gjaku shqiptar po zgjohej. Por si për fat, atë vit që fqinjët tanë po përgatiteshin të kafshonin me plane afatgjata trojet tona, pikërisht më 1844, lindi ai, që do të dinte të nxirrte në dritë gjithë përpjekjet e të parëve të tij. Babai i Ismail Bej Vlorës, Mahmut Bej Vlora në bashkëpunim me shumë patriotë nga Lumi i Vlorës, Kanina dhe Krahina e Dukatit, bëri përpjekje për të ngritur një çetë luftarake mbrojtëse kundër kërcënimeve të gjeneralit grek Griva në vitet 1850-1854. Ismaili do të merrte në dorë stafetën e paraardhësve, të cilët kishin dhënë gjatë historisë po kaq shumë. Madje, në atë kohë familja Vlora filloi lidhjet e shpeshta me familjen Frashëri, shtoi më tepër lidhjet që kishte pasur i afërmi i tyre Mustafa Pashë Vlora, i cili ishte një nga krerët e Lëvizjes Kombëtare dhe Kryetar i Lidhjes Shqiptare të

Prizrenit për Vlorën, me Sami Frashërin, me të cilin shkruan memorandume kundër Traktatit të Shën Stefanit. Ismail Qemali në heshtje filloi të shihte gjithçka dhe të ndërgjegjësohej se duhet të bënte diçka për Shqipërinë.

Kush është vërtetë fisnik

Ai do të ishte shumë i vogël kur të atin dhe xhaxhanë e tij, së bashku me familjen do ta internonin në Selanik, pasi kishin sjellë turbullira duke u bërë nxitës të disa kryengritjeve. Aty, ai bëri shkollën fillore dhe mësoi gjuhën turke. Kur u rikthyen në Vlorë, ata që dikur i kishin blerë plaçkat e familjes së nxjerrë në ankand nga qeveria, nxituan t'ua çonin prapë në shtëpi. Ishte një dashuri që populli i Vlorës e shfaqte hapur ndaj tyre. Në Vlorë mësoi italishten, por edhe frëngjisht dhe më vonë niset në Zosimea, ku do të merrte një kulturë të gjerë. Në Stamboll, ai do të shkelte për herë të parë në maj të vitit 1860. Aty u prit nga një kushëri i nënës së tij Hedijes nga Gjirokastra, i cili e futi përkthyes në Ministrinë e Jashtme dhe njëkohësisht vazhdonte studimet në Fakultetin e Drejtësisë. Në Stamboll ai nje reformatorin turk Mit'hat Pasha, me të cilin do të punonte shumë dhe do të lidhte një miqësi të madhe. Këtu filloi dhe karriera politike e Ismail Bej Vlorës, i cili shumë i ri pranoi detyrën e parë të rëndësishme si guvernator i Varnës, por refuzoi titullin e pashait. Në arkivin e familjes Vlora në Itali, ruhen gjashtë fermanë të firmosur nga Sulltani Abdyl Hamiti II, nga 1885 deri më 1900, ku për Ismail Bej Vlorën flitet me një konsideratë jashtëzakonisht të lartë si për kryerjen e detyrës, por edhe për cilësitë e larta morale. Madje atij i vendoset titulli "Qemal", që do të thotë i zgjuar. Por ai më shumë se fisnik, më shumë se i zgjuar ishte një humanist i madh. Ismail Bej Vlora sa shkoi në Varnë, jo vetëm që ndihmoi në ngritjen e shkollave, por shpëtoi nga skllavëria pesë mijë çerkezë me shpërblim që u pagua nga bankat bujqësore dhe që u dha tokë ish skllavëve dhe gjithçka u pagua dalëngadalë nga ish skllavërit. Kur e pyetën përse e bëtë këtë, ai u përgjigj: "Çerkezët janë racë me vitalitet dhe energji të jashtëzakonshme." Ai u përpoq të vendoste atje edhe 100 mijë gjermanë që jetonin në Rusi dhe keqtrajtoheshin nga cari, por qeveria osmane nuk e lejoi. Një mbrojtje të shkëlqyer ai u ka bërë edhe hebrenjve kur këta diskriminoheshin. Ai i kishte njohur ata në Vlorë dhe në Selanik, i respektonte që ishin punëtorë dhe studiues të mëdhenj, ndaj hebrenjtë e ikur nga Rumania ai i strehoi në të djathtë të Danubit. Edhe kur ishte në Rumani, në Kostancë, ai atje çoi një ujësjellës, madje bëri shumë ankesa për keqtrajtimin e hebrenjve duke thënë se ishte e papranueshme të gjykosh të tjerët nga prejardhja dhe nga raca. Madje Ismail Bej Vlora, diti të pajtojë interesat e grupeve të ndryshme etnike. Idetë e tij liberale dhe përparimtare me ndjenjën e drejtësisë dhe me elasticitetin diplomatik bëri që të zbuste kundërshtitë fetare që po e gërryenin Jerusalemin, të paqësonte druzët me etnitë e tjera që keqtrajtoheshin në Liban e Siri kur ai ishte guvernator i përgjithshëm. Atij i dhimbeshin të tjerët, ashtu siç i dhimbsej dhe populli i tij që po vuante nën një zgjedhë sunduese për një kohë të gjatë. Ai nuk ishte një nacionalist fanatik dhe me ego, por i bashkohej konceptit të tij mbi lirinë, që për një komb është e natyrshme, por duke respektuar dhe liritë e të tjerëve.

Trim i mirë me shokë shumë

Ai kishte filluar të kristalizonte miqësitë e të parëve të tij, por dhe të njihete në rrugën e jetës shumë shqiptarë patriotë. Iu desh që në prill të vitit 1874 të nxirrte nga burgu Hoxha Tahsinin, i cili ishte arrestuar në Delvinë dhe ishte shpënë në Stamboll se po përgatiste një alfabet shqip me shkronja latine. Ai nuk mund ta linte një ish rektor të Universitetit të Stambollit në duart e xhahilëve injorantë. Më tej, prania në Parlamentin Osman, njohja me shumë bashkatdhetarë të tjerë bënë që të mendonte se ç'duhej bërë për Shqipërisë, por Traktati i Shën Stefanit, po ia vinte vulën mendimit se Turqia po kalbej dhe siç thotë vetë Ismail Bej Vlora se “Traktati i Shën Stefanit, u konsiderua në të gjithë Turqinë si një dënim me vdekje i dhënë kundër Turqisë.” Ndihma që ai i dha shumë shqiptarëve dhe lidhjet e tij me Mustafa Pashë Vlorën, që ishte një eksponent i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit bënë që Ismail Bej Vlorën ta syrgjynosnin në Qytahi, ku ai ndenji rreth shtatë vjet, por u ndihmua ekonomikisht nga Aqif Pashë Tetova, i cili kishte një çiflig të madh atje. Mbasi u lirua prej andej e çojnë në Galipoli, pastaj në Bejrut si qeveritar, ku takohet me Pashko Vasën, që siç thotë vetë “ u takova me bashkatdhetarin tim.. që tani ishte qeveritar i Libanit dhe e kalonte dimrin në Bejrut.” Ndërsa po endej ca andej-këndej perandorisë, duke njohur administrimin, ndërsa u shoqërua me një nga mendjet më të mëdha liberale të Turqisë, Mit’hat Pashain, që iu pre koka nga Sulltani, ai e kuptoi se asgjë nuk do të bëhej tërhiq e mos këput. Ai i kishte thënë disa herë edhe vetë Sulltanit se perandoria duhej të decentralizohej, duke u dhënë autonomi popujve, të dilte nga errësira mesjetare dhe të merrte frymë nga Europa. Por Sulltani dhe gjithë aradhja e tij nuk ia vunë veshin. Në vitin 1899, Ismail Bej Vlorës i bie në dorë libri i Sami Bej Frashërit “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet.” Ai kishte të njëjtin mendim me të: “Si një i sëmurë, që s’bën ç’i thonë shëronjësit ei vë krusmënë trupit të tij, ashtu dhe kjo mbretëri po bën gjith ç’i duhetë për të shkurtuar ditët e saj... Në Evropë jetën e ka fort të shkurtër... Me të rënë të kësaj stihije të madhe do të bjerë edhe Shqipëria e do të shtypet nën gërmadha të rënda t’asajë.” Njohja e tyre dhe lidhja që kanë mbajtur ka qenë e fshehtë. Kjo si pasojë e lidhjeve të familjeve të tyre në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Faktet janë shumë të qarta për këtë: Konsulli austro-hungarez në Vlorë, Calzavara, në tetor të vitit 1878 shkruan relacione për qeveritë e tij duke thënë se Abdyl Bej Frashëri ndodhej në Vlorë dhe “se bisedoi me parësinë për një autonomi shqiptare dhe të gjithë e pranuan propozimin e tij.” Përsëri konsulli austro-hungarez mbas dy vjetësh më 15 maj 1880, në relacionin e tij Nr 24 shkruan se “Syrja Bej Vlora, Xhafer Bej Vlora dhe anëtarë të tjerë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i japin ndihma financiare të dërguarit të Ali Pashë Gucisë dhe e përcjellin atë me vaporin Llojd për në Shëngjin.” Pra si Sami Bej Frashëri dhe Ismail Bej Vlora kishin këtë pikëpamje se koha nuk priste. Koha ishte gjithçka. Dikush duhet të merrte hapin e madh. Librat vërtiteshin rreth Robert Koleh, ku Naim Frashëri studentëve shqiptarë u dërgonte vjershat e tij. Më 1900, kur vdiq Naimi, dikush u kishte thënë studentëve se duhet të takoheshin me Ismail Qemalin. Atë kohë midis shqiptarëve endej një dëshirë, por nuk shqiptohej fort, aq sa që atëherë ka dalë shprehja: “Të

gjithë në zemër e kemi / Njëri tjetrit dot s'ia themi.” Atë vit Ismail Bej Vlora bëri shkëputjen e madhe. Nga osmanët ai nuk pat mbartur vetëm nofkën “I zgjuari”, por edhe një proverb që në shqip i thonë: “Kur s'ka në shtëpi, harrëm në xhami.”

Pasuria e tij vetëm Atdheu

Arratisja e Ismail Bej Vlorës, i cili quhej autonomist, bëri një zulmë të jashtëzakonshme. Gjithë kancelaritë evropiane, sidomos ajo gjermane dhe ajo austro-hungareze nuk ndenjën pa bërë relacione. Përfaqësuesi i Rajhut gjerman shkruante nga Athina më 7 maj 1900, se “Ai me burrëri i ka shprehur bindjet e veta dhe se ai ku sepse mbështeste gjallërisht synimet autonomiste të Shqipërisë.” Ndërsa konsulli austro-hungarez, Petroviç nga Vlora shkruante më 4 maj se “shqiptarët kanë gjetur tek Ismail Qemali mbrojtësin e tyre të fortë. Ky më të vërtetë ka bërë çmos për atdhetarët e vetë, pasi ai asnjëherë nuk ka qenë i udhëhequr nga interesat materiale dhe me gjithë postet e larta nuk ka pasuri.” Ndërsa gazeta “Volkszeitung” e konsideronte Ismail Qemalin “një udhëheqës mjaft serioz.” Ndryshe ishte për otomanët dhe për të gjithë ata që për postet e paratë e perandorisë kishin shitur dhe shpirtin. Ata sajuan të bëra dhe të pabëra për atë që po bënte ç'është e mundur për atdheun e vet. Madje edhe vizitën që bëri në Greqi, që e zhvilloi me qëllimin siç e thotë edhe vetë se “tani rreziku sllav i afronte grekët dhe shqiptarët,” e përdorën për qëllime të mbrapshta për të hedhur baltë mbi atë që sipas tyre meqë kërkonte ndarjen e Shqipërisë nga Turqia po kryente një akt tradhtie. Po kë takoi Ismail Qemali atje? Ja si e përshkruan ai se si e pritën burrat me gjak shqiptar që ngritën themelet e Greqisë; “Unë isha krenar dhe i lumtur të vija re se ndjenja e kombësisë ishte kaq fort e rrënjësuar te shqiptarët, pavarësisht nga shekujt dhe ndryshimet në kushtet politike dhe shoqërore. Ishte për mua një kënaqësi e madhe të shëtisja nën qiellin e mrekullueshëm të Atikës dhe të dëgjoja gjuhën time të mëmës, që flitej prej shqiptarëve nëpër rrugët dhe në treg.” Madje marrëveshja e miqësisë shqiptaro – greke midis Jorgo Theotoqis dhe Ismail Qemalit në vitin 1906 kishte në themel mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të dy vendeve kundër propagandave të huaja në Ballkan. Në këtë pretekst, me inatin se me gjakun e kapëdanëve shqiptarë ishte çliruar Greqia, Porta e Lartë filloi një fushatë shpifjesh kundër Ismail Bej Vlorës, madje i internoi dhe dy djemtë, ku të madhin Nedimin e mbajtën tetë vjet të izoluar. Në vitin 1901, Ismail Bej Vlora një intervistë të dhënë në gazetën londineze “Morning Star” kishte thënë se në kufijtë që kërkonte ishte Çamëria, bregdeti jonian deri në Prevezë. Po Ismail Bej Vlora e kish parashikuar mbi një shekull më parë se shteti grek dhe ai bullgar kishin një luftë të paparë për punën e Maqedonisë dhe çetat e tyre po mbyteshin në gjak, ndaj ai kërkonte një aleat kundër pansllavizmit që siç thoshte ai “kërcënon shqiptarët në të ardhmen.” Ismail Qemali më 1903 shkoi dhe në Itali tek arbëreshët dhe pikërisht në Sicili në fshatin Sheshi i Arbëreshëve, ku u prit me bandë muzikore dhe me flamurin e Skënderbeut ku të gjitha gratë dhe fëmijët i hidhnin lule nga ballkonet. Aty ai u prit nga një pinjoll i një familjeje po aq të madhe të Muzakajve, Francesco Muzaki, i cili ishte kryetar i Lidhjes Kombëtare Shqiptare. Ja si e përshkruan Ismail Bej Vlora këtë vizitë: “Qe një skenë shumë mallëngjyese, kur pothuajse të gjitha

gratë dhe fëmijët të veshur me kostume kombëtare shqiptare dhe të shoqëruara nga bandat muzikore, erdhën me vrap drejt nesh për të prekur rrobat tona, sikur ato të ishin një pjesëz e të dashurës vendlindje, saqë shoku im Xhaferi nuk mundi t'i mbajë lotët." Ismail Bej Vlora, takoi shumë shqiptarë nëpër Europë. Punët nuk po shkonin siç mund të ishte menduar për autonominë. Më 2 dhjetor 1903, patrioti Dervish Hima, i shkruante mikut të tij Ibrahim Temo një letër ku i thoshte se "pardje erdhi tek unë Ismail Beu. Është partizan i kryengritjes. Më tha: të gjejmë të holla e t'i tregojmë rrugën popullit me forcë, s'ka tjetër mënyrë." Dhe rruga e tij ishte e gjatë. Në fillim, kur iku nga perandoria më 1900, hodhi thirrjen drejtuar shqiptarëve: "O me shkolla e qytetërim, o pa shkolla e në errësirë... Është e pamundur që një popull të përmirësojë gjendjen e tij pa shkolla dhe pa arsim. Njeriu duhet të jetë fare i verbër që të mos ndjejë nevojën e shkollës kombëtare, duhet të jetë tradhtar që të dëshirojë lënien pas dore të arsimit në gjuhën shqipe. Ata që duan të rrojnë në errësirë e padituri, pa gjuhën dhe kombësinë e tyre, dëshirojnë t'i përgatisin Shqipërisë një vdekje të turpshme." Mbas zgjimit të ndërgjegjes kombëtare, duheshin hedhur hapa të sigurve dhe të bashkënduar. Ai për tetë vjet u end Evropës, mbajti lidhje edhe me kolonitë shqiptare për dërgimin e librave dhe mbledhjen e të hollave për armë. Më 1908 nga amnistia e përgjithshme që bëri Sulltani, ai u fal dhe erdhi në Vlorë ku e pritën në mol si hero, madje e mbajtën në krahë që nga vapori Llojd e deri në tokë. Aty iu lexua një vjershë dhe e quajtën Uashington të Shqipërisë. Shkuarja përsëri në Parlamentin Osman si deputet i krahinës së tij dhe lidhja e tij me Hasan Prishtinën e Luigj Gurakuqin do të bënin që gjërat të ecnin më tej. Ismail Bej Vlora do të ishte nismëtar i Memorandumit të Gërçes dhe do të mundësonte armë për patriotët e veriut. Dhe pavarësia do të bëhej e koordinuar edhe me Isa Boletinin. Ajo do ta vinte Europën përpara faktit të kryer. Dhe nuk kishte se si të ndodhte ndryshe. Flamuri kuq e zi u ngrit në sarajet e familjes së Vlorajve, pikërisht të Xhemil Bej Vlorës ku ishin 47 delegatë nga të gjitha trojet shqiptare. Ja se si e përshkruan Mit'hat Bej Frashëri, delegat në Kuvendin e Vlorës më 28 Nëntor 1912: *"Ismail Qemali u zgjidh kryetar i kuvendit dhe mbajti një fjalim të shkurtër për gjendjen e luftës, për hallin e veçantë të Shqipërisë të rrezikuar nga mësymjet e fqinjëve dhe mbi nevojën e një vendimi kombëtar për të shpallur mëvehtësinë e Shqipërisë...Trokitje duarsh i prenë në mes fjalën që donte të thoshte kryetari dhe populli që ishte mbledhur në kopshtin e shtëpisë, kishte buçitur jashtë në rrugë, përsëri me duartrokitjet dhe thirrjet e gëzimit. Në atë kohë një Flamur Shqiptar po ngrihej mbi portën e kopshtit dhe rrëfente shqiponjën kombiare mbi qiellin e kuq të saj. Kjo orë historike ishte afër perëndimit të diellit; ishte një kohë e vrenjtur dhe një vesë e hollë po rigonte nga retë, një vesë bekimi si lot gëzimi. Turma e njerëzisë, për të festuar këto orë me flamur në dorë dhe me këngë bëri një qarkim në rrugët e qytetit, duke qëndruar përpara konsullatave të Austrisë dhe të Italisë, si një shenjë miqësie dhe falënderjeje për mirësinë dhe mbështetjen që shpallej nga të dy këto pushtete." Ai e shpalli pavarësinë. Diplomati Renzo Falaschi shkruan: "Doli edhe njëherë gjenia diplomatike e Ismail Qemalit, i cili pa asnjë "monedhë këmbimi", me një vend krejtësisht të pushtuar e të shkatërruar, mundi falë aftësisë së jashtëzakonshme bindëse, të mbajë gjallë konceptin e shtetit shqiptar, ndonëse të privuar nga më pak*

se gjysma e trojeve dhe e popullsisë së tij. Në të vërtetë Austro-Hungaria dhe Italia ishin të interesuara për ekzistencën e një institucioni shtetëror që do të mbulonte organikisht kombin shqiptar, i vetmi që mund të bëhej barrikadë për ekspansionin serb e grek. Por Rusia, si gjithmonë mbështeste frymën pansllaviste të Serbisë, të cilës ia dëshironte shtrirjen deri në Adriatik. Në planet e saj ajo mbështetej nga Franca dhe Britania e Madhe, aleate të ngushta të saj dhe të tria në favor të forcimit të Greqisë.” Ismail Bej Vlora punoi për Shqipërinë deri sa mbylli sytë me dhimbjen e sakatosjes së trojeve shqiptare. Kur më 1918 shqiptarët me banim në Amerikë i besuan atij mandatin për t’i përfaqësuar në Konferencën e Paqes, Parisi, i cili kënaqte interesat e Serbisë e detyroi të transferohej në Spanjë. Qeveria italiane e tërhoqi atje e bindur se shpëtimi i Shqipërisë kërkonte ndërhyrjen e tij. Natyrisht edhe ata mendonin se do të merrnin ndonjë copë. Më 22 Janar 1919, dy ditë para se të mbyllte sytë, ai do të shkruante: “Sot është dita vendimtare për Shqipërinë: do të rilindim ose do të vdesim.” Ai u kthye në atdheun e tij nën një arkivol të mbuluar me flamurin që ngriti i rrethuar nga bajonetat e ushtrisë italiane. U varros në Kaninë, më vonë u soll në Vlorë tek lulishtja që dikur ishte pronë e familjes Vlora. Atje ku është shtiza e flamurit ka qenë ballkoni ku ai u valëvit krenar mbas 5 shekujsh. Ka dhe një monument të madh gjithëpërfshirës. Por nuk ka një shtatore për të ashtu siç e ka lënë amanet Luigj Gurakuqi. Vlorën ai e ktheu në shenjtërore. Ai pati mbiemrin Vlora, ndaj nuk dihet se kush ia dha emrin njëri-tjetrit. Ndaj sot e kësaj dite, njerëzit këndojnë një këngë labe: “Moj Vlorë e bukur në gropë/Skelë e parë në Europë/ Të rri Kanina mbi kokë.” Kanina ngjizi jugun dhe veriun pesë shekuj më parë dhe nga kjo ngjizje do të rilindë përsëri Shqipëria, ashtu siç e tha vetë i madhi Ismail Bej Vlora se “dëshira e shqiptarëve ka qenë dhe është të mbrojnë atdheun e tyre duke shpëtuar trojet dhe kombësinë.” Në këtë amanet, ai duket sikur thotë: “Shpëtoni trojet! Kujdes Mitrovicën e Isa Boletinit!”

Studime dhe artikuj

EQREM ÇABEJ**ILIRISHTJA DHE SHQIPJA**

Në shekullin e kaluar (19-të) dhe në dhjetëvjetët e parë të këtij shekulli (20-të) shqiptarët janë konsideruar përgjithësisht pasardhësit e ilirëve dhe gjuha shqipe është konsideruar vazhdimi i njërit nga dialektet e vjetra ilire. Kjo teori, e mbrojtur nga një varg historianësh e gjuhëtarësh, me formulimin më sipër sidomos nga Gustav Majeri (1), aty nga fillimi i këtij shekulli u zëvendësua te një pjesë e mirë e dijetarëve me tezën e dalë kryesisht nga fusha e gjuhësisë, sipas së cilës shqiptarët janë stërnipër trakasish të ardhur prej visesh më lindore në brigjet e Adriatikut, dhe shqipja është bija e trakishtes, ose edhe një “dialekt trak i ilirizuar”(2). Ka pasur edhe një sintezë të të dy teorive, e përfaqësuar me Norbert Joklin, sipas së cilës shqipja është ngushtësisht e afërt dhe me ilirishten dhe me trakishten. Këtë teori e kanë ndjekur mjaft dijetarë.

Në këtë fushe kërkimesh sot zotëron shumëkund një skepticizëm shpeshherë i tepruar dhe diku edhe një agnosticizëm. Kanë dalë edhe teza të reja, të përfutuara për një pjesë të mirë nga prirja për të gjetur medoemos rrugë të reja, për të thënë diçka të re, e për të vërtetuar atë që është dashur nga ana e tyre të vërtetohet. Karakteristika kryesore e këtyre tezave në punë të metodës është kjo, që përfaqësuesit e tyre shpeshherë nisen çuditërisht nga një tabula rasa, nuk marrin parasysh rezultatet e punës kërkimore të mëparme dhe aq më pak mbajnë qëndrim ndaj tyre. Përveç kësaj disa nga këta dijetarë shquhen për një qëndrim hiperkritik ndaj tezave të të tjerëve bashkuar me një besim të tepruar ndaj mendimeve të veta. Duhet pranuar që si në shumë fusha të dijes, edhe në atë të kërkimeve gjuhësore, e aty edhe në studimin e historisë së Shqipërisë, ka progres dhe regrese, ka përparime e ka një shkuarje mbrapa.

Çështja se çfarë marrëdhëniesh ka midis shqipes dhe ilirishtes, a ka një afëri (parenté) midis këtyre dy gjuhëve, dhe, në qoftë se ka, a kemi aty një raport filiacioni (birërie) apo jo, kjo çështje komplekse përbën një problem shkencor. Për të krahasuar dy madhësi duhet t'i njohim. Në rasën tonë konkrete ne dimë vetëm njërin nga këto, shqipen. Ilirishten e njohim pak a aspak; sidomos jemi krejt në errësirë në punë të strukturës së saj gramatikore, dhe mezi po arrijmë ta rindërtojmë

gjer diku atë gjuhë me anën e thërrimeve që mund të thuhet se na kanë mbetur prej saj. Përveç kësaj, distanca kohësore që nga ekzistenca e nga zhdukja e dialekteve ilire gjer te dokumentimi i parë i shqipes si gjuhë më vete është bukur e madhe. Për sa i përket konceptit etnografik “iliret” dhe lidhur me të edhe koncepti gjuhësor “ilirishtja” do thënë se këto koncepte kanë pësuar ndryshime gjatë këtij brezi të fundit. Ndërsa një brez më parë ky koncept ishte zgjeruar me tepri në pikëpamje të shtrirjes gjeografike, aq sa dha shkas dhe për lindjen e termit “panilirizem”(3), si reaksion ndaj kësaj rryme u kalua në skajin tjetër, erdhi e u zhvillua një koncept i ri i një skepticizmi përtej masës. Kjo ka pasur një pasojë që tani ka ardhur koha të shtrohet përsëri në tryezë çështja se ç’duhet të kuptohet me ilirë dhe ilirishte. Sidomos ka zënë rrënjë një atomizëm i theksuar si metodë pune në lëmin e studimeve ilire, mendimi se nuk ka pasur një popull të madh e të vetëm të ilirëve në Evropën antike. Prandaj shtrohet pyetja: a njësi a shumësi etnike? A një popull ilir me fise të ndryshme, një gjuhë ilire me dialektet e saj, apo popuj të ndryshëm që mbajnë këtë emër me më shumë a më pak të drejtë? Burimet antike nuk na japin një përgjigje të prerë në këtë punë, po nuk mund të lihet pa thënë që edhe trajtimi kritik i tyre i ka lënë vend një interpretimi shumë herë arbitrar e të njëanshëm.

Në këtë çështje nuk mund të shkohet përpara pa i kushtuar vëmendjen e duhur terminologjisë etnografike në botën e vjetër. Do pasur parasysh cilat kanë qenë kriteret e emërimit të popujve, të fiseve e të kombësive të popujt e vjetër vetë, e te gjeografët, historianët, udhëtarët, politikanët, ushtarakët etj. të grekëve e të romakëve. Në këtë fushë ka sot mendime shpeshherë të tryezës së dijetarit e larg realitetit historik e shoqëror. Tendenca për diferencime etnike ka shkuar këtu te disa dijetarë me larg se në gjykimin p.sh. të rrethanave trake, italike etj. Asnjëri nuk mund të thotë që me emrin “ilir” të mos jenë përfshirë popuj të ndryshëm e me gjuhë të ndryshme. Vetëm një gjë mbetet e sigurt këtu: një shoshitje objektive e tezave që përpiqen të vërtetojnë një shumësi popujsh në trevën ilire të kohës antike, tregon se ato teza nuk arrijnë në shkallën e një argumenti shkencor. Për të dhënë vetëm një shembull, teza që në zonë ilire të ketë pasur treva me sisteme të ndryshme në emra personash, “*provinca onomastike*” me “*vatra*” e me “*krahina rrezatimesh*”, një fushë ku janë dhënë më fort gjykime me një karakter të përkohshëm edhe ku ende nuk është dhënë fjala e fundit, kjo tezë për ne mbetet problematike. Por edhe sikur të vërtetohej drejtësia e saj, kjo nuk do të përbënte aspak një dëshmi se kemi të bëjmë aty me popuj të ndryshëm. Mjafton të përmendim në këtë mes faktin që në një njësi etnike e gjuhësore aq të përcaktuar e të kufizuar si nga numri si nga koha, dhe të shfaqur në dritën e plotë të historisë siç është popullsia ostrogote në shek. IV të erës sonë, ekzistojnë pranë e pranë sisteme emërtimi të ndryshme në punë të emrave vetjakë. Një gjë e tillë vihet re dhe në territoret e gjuhëve të sotme të Evropës përbrenda një gjuhe të vetme. Ndërkaq antroponimia ilire nuk mund të thuhet se është më e shumëllojshme se antroponimia kelte, gjermanike etj. Përkundrazi një vështrim objektiv e pa parakuptime (prekoncepte) i kësaj lënde vë re karakterin specifik të këtyre emrave për territorin ilir, ekzistencën e disa tipareve të përbashkëta, konstaton elementet e një njësie përbrenda ndryshmeve territoriale, hyjnë ato emra të tillë si *Andes* në Burnum (Kroaci), *Andius* në Prizren, *Bardius Bardyllis*, *Bato* (Dardani, Dalmaci,

Panoni etj.) me *Batena Batuna* etj.; *Bersaniues Bersant*, *Bilisa Bilena*, *Boicus*, *Buzo*, *Busio*, *Dasius Dazas Dasant*, *Epicadus*, *Gentius Grabeos Graboi*, *Lavius*, *Mytilius Mutelios*, *Peuk – Peukestis Peucetii*, *Pinnes*, *Plateor Plaetorius*, *Plator*, *Raecius*, *Surus Sura*, *Sutta Suttis*, *Tata Tataia*, *Teuta me Teutaia*, *Teutana Trieteuta* etj., *Turus Turelius Turelia*, *Verzi* e ndonjë tjetër. Rrethana që në këto emra merr pjesë dhe Shqipëria antike, e përtej detit dhe popullsia mesapeve e japigëve në Italinë Jugore, na duket me rëndësi për të gjykuar drejt këtë sistem emrash në pikëpamje historike e gjuhësore. Dëshmitarë më të fortë në punën e caktimit të përkatësisë etnike janë për ne emrat e viseve, sepse këto, sa kohë që formohen me lëndë vendi, nuk i shtrohen ndikimit të importimit nga jashtë që pësojnë emrat e personave. Edhe këtu nuk mungon lokalizimi në territorin ilir dhe përhapja në krahina mjaft të largëta të këtij territori. Khs. ndër të tjera *Aleta*, *Amantia Amantini*, *Arb – në Arba Arbanon Arbon Arbatias*, *Bant Brendesion*, *Bul – në Bulinoi Bulliones Bulentum*, *Dalm – Delm – në Dalmion Dalmate Delmenium*, *Gen – në Genusus Genysios*, *Lam – në Lamatis Lametus*, *Mal – në Dimallum Malontun Maleventum*, *Malontina*, *Met – në Metulon Meturbarbis*, *Parth – në Parthini Parthos*, *Sal – në Salona Salluntum Sallentini*, *Skard – në Skardon Skardona*, *Tar – në Tara Taras Tarentum*, *Terg – trag – në Tergeste Opitergium Tergolape Tragarium*, *ulk – në Ulkion Ulcirus Ulcisia castra*, *Ulkaia hele* etj. Si kudo në arsyetimet logjike, edhe në çështjen a popuj ilirë apo fise (popullsi) të një etnosi ilir, ka vlerë ligja që gjykimi jepet në bazë të krahasimit. Rrethanat ilire gjykohen më drejt kur të vështrohen në lidhje me mënyrën si vështrohen rrethanat e popujve të tjerë të Evropës antike. Dhe pyetja aty shtrohet jo vetëm për kriteret pas të cilave emetoheshin popujt e vjetër, po edhe për ato me të cilat i dallonin njërin nga tjetri. Aty mbase më shpesh se gjuha merreshin parasysh disa tipare etnografike të tjera, si vetitë e karakterit, veshja e frizura, mënyra e jetesës dhe e luftës, besimi e ndonjë element tjetër.

Në këto kushte edhe pyetja e shpeshtë e disa dijetarëve a kemi të bëjmë te Iliria e ilirët me një koncept etnik apo gjeografik, kjo pyetje shtrohet barabar edhe për shumë të tjerë popuj të Evropës së periodës antike. Kështu kjo çështje në pikëpamje metodologjike humb mjaft nga rëndësia që i jepet. Te këta popuj duan parë entitete gjeografike dhe etnografike, duke mbizotëruar herë njëri koncept, herë tjetri në rrethanat e ndryshme të zhvillimit historik e politik të tyre. Në këtë mënyrë edhe të vënë e kufijve të prerë midis Ilirisë si koncept etnogjeografik e si koncept politik-administrativ, pra si dy koncepte qenësisht të ndryshme, edhe kjo është mjaft larg nga realiteti historik, ashtu si mund të vihet re për epokat e ndryshme të historisë politike. Caktimi i kufijve administrativë në një provincë të madhe të një perandorie bëhet zakonisht përmbi bazën e njëjësive territoriale-etnike dhe përfshirja e ndonjë krahine aloglote në këto nuk ka cenuar ndonjëherë karakterin e njësishtëm të këtyre. Kështu në caktimin e provincës Illyricium, te romaket nuk kanë zotëruar kriteret shumë të ndryshme nga ato që janë zbatuar në caktimin e provincave të tjera, si Hispania, Gallia, Germania, Thracia. Ashtu ka ngjarë dhe me emërtime të mëpastajme, si Polonia në mesjetën e vonë, *Arnavutluk* në Perandorinë Osmane, etj.

Në lidhje me këto do pasur parasysh se tjetër gjë do kuptuar me konceptimin dhe emrin “ilirë” e me “ilirishte” të shek. VI p.e.s. e tjetër gjë me “ilirë” e “ilirishte” p.sh. të epokës së perandorisë romake të shek. II e III te e.s. Khs. p.sh. gjermanët e kohës së Tacitit dhe gjermanët e kohës së shtegtimt të popujve. Ky është zhvillimi normal në historinë e popujve e të gjuhëve, zhvillim që e ndeshim te të gjithë popujt e moçëm të Evropës, me gjithë ndryshimet që vihen re në procesin e formimit të tyre. Mospërmendja e ilirëve në burimet egjiptiane, hetite e mikene edhe në epet homerike, shfaqja e dardanëve a e peoneve në këto të fundit, dhe dalja më vonë e ilirëve te Herodoti e te Pseudoskilaksi, këto janë indice që dëshmojnë për etapat e ndryshme të formimit të një populli. Prapa këtyre fshihen inkursione, shtegtime e shpërngulje fisesh e popullsish, përzjerje e shkrirje etnike, integrim me anë asimilimesh, luftime për troje e për tokë buke, përpjekje për hegjemoni politike e ushtarake, ndikime kulturore, procese divergjimi e konvergjimi, shkëputjesh e bashkimesh etnike, përhapja e një emri etnik përmbi të tjerët për arsye të pozitës gjeografike e të një mbizotërimi politik-shoqëror, lindja e vetëdijes së një burimi të përbashkët. Kështu, për të dhënë ndonjë shembull, në burimet që përmendin së pari fiset e ilirëve, nuk zihen ngojë ardianët, të cilët luajtën një rol në historinë e mëpastajme; autariatët përmenden në perioda të ndryshme në krahina të largëta njëra nga tjetra, gjë që flet për një shtegtim e një shpërnguljeje të tyre. Edhe te fqinjët jugorë të ilirëve në Gadishullin Ballkanik, te grekët, me parë dalin në skenë të historisë popullsi ose fise të veçanta, si akeasit, danaët, jonasit, pastaj shfaqet e përgjithësohet emri i helenëve dhe ai i grekëve, graes graikoi, lat. Graeci. Ndryshime të tilla emrash nuk mund të shërbejnë si argument për të menduar se kemi të bëjmë me popuj të ndryshëm.

Problemi i raportit të shqipes ndaj ilirishtes është një problem historik e gjuhësor. Prandaj dhe rrugët e mjetet për t’ju afruar zgjidhjes shkencore të tij nuk mund të jenë vetëm gjuhësore, ato duan rrokur në tërësinë komplekse të tyre. Aty ekzistojnë disa kriteret, të cilat duan zbatuar në këtë fushë kërkimesh. Së pari është kriteri gjeografik-territorial, rrethana që populli shqiptar banon në një trevë që bënte pjesë në vendbanimet e popullive të ilirëve jugorë. Së dyti është fakti historik që në asnjë nga burimet historike të mëvona nuk flitet për ndonjë ardhje të shqiptarëve nga vise të tjera në atdheun e tyre të sotmin: heshtje që do të ishte e vetme dhe paradoksale, po të kemi parasysh afërsinë e pandërmjetme të Shqipërisë me botën romake e romane e greke-bizantine. Për ne është dëshmi e një metode shkencore të padrejtë kur shumica e dijetarëve të sotëm problemit të burimit të popullit shqiptar e gjuhës së tij i afrohen vetëm me mjete linguistike dhe lënë pas dore kriteret gjeografike-historike të shtruara prej J. Tunmanit sot gati dy shekuj më parë. Këtyre vjen e u shtohet së treti kjo rrethanë që në disa stacione prehistorike të Shqipërisë vihet re një vazhdimësi kulture, e cila me mjaft gjasë dëshmon për një vazhdimësi popullsie (4), dhe në çdo rasë përforcon të dhënat territoriale e historike.

Duke kaluar tani te dëshmitë gjuhësore të krahasimit, aty ne shohim dy rrugë për të hetuar çështjen e lidhjeve historike iliro-shqiptare. Njëra nisat nga të dhënat e shqipes, tjetra nga të dhënat e pakta e shumë herë të pasigurta të ilirishtes. Rruga e parë paraqitet më e lehtë, dhe shkencërisht më e mbarë, meqë nisat nga një

madhësi që dihet, pra merr shkas nga e njohura për të kërkuar të panjohurën. Këtu detyra e parë na duket se është zotërimi praktik dhe shkencor i gjuhës shqipe. Kjo gjë sjell me vete pasojën që ata që merren me këto probleme pa përmbushur kushtin e mësipërm, nevojisht notojnë në ujë të cekët, ngaqë nuk u kushtojnë vëmendjen e duhur ligjeve të brendshme të kësaj gjuhe.

Pamja e përgjithshme e shqipes na paraqitet e këtillë, që karakteri dhe pozita e saj gjuhësore janë të ditura tashmë me tiparet e tyre relativisht të përcaktuara mirë, po që për proceset dhe kushtet historike që kanë sjellë këtë situatë gjendemi mjaft në të errët. Megjithatë me anën e metodës së rindërtimit mund të arrihet të shihen dhe këtu disa nga fjetet që lidhin të kaluarën me të tashmen.

Nga fusha e toponomastikës historike, duke u nisur me rrugën metodikisht të drejtë prej rrethanave të brendshme të shqipes, ne konstatojmë se emrat e atyre qyteteve, lumenjve, maleve etj. të trevës nga Raguzë gjer në Çamëri, nga Shtipi, Nishi, Shari e Shkupi e gjer në brigjet e Adriatikut e të detit Jonik, të cilat dihen që nga koha antike, me trajtën që kanë sot në gjuhën shqipe dëshmojnë për një vazhdimësi, për një kontinuitet në këtë truall. Këto emra në pjesën më të madhe paraqesin një zhvillim gjuhësor nga trajta e lashtë në të renë në pajtim me ligjet fonetike të shqipes, dhe në një mënyrë që trajta e tyre e sotmja nuk mund të shpjegohet veçse me mjetet e saj, duke mos gjetur shpjegim me anë të ndonjë gjuhe tjetër të Gadishullit Ballkanik: *Ragusium: Rush, Scodra: Shkodër, Astibus: Shtip, Naissus: Nish, Scradus mons: Shar, Scupi: Shkup, Drivastum: Drisht, Pirustae: Qafa e Prushit, Lissus: Lesh (si lat. Spissus: shpesh), Candavia: Kunavlja, Dyrrachion: Durrës, Isamnus: Ishëm, Scampinus: Shkumbini, Aulon: Vlonë Vlorë, Thyamis: Çam* – . Kjo është një nga provat më shtrënguese për autoktoninë e popullit shqiptar. Përprjekjet e disa dijetarëve për ta mënjeluar ose minimizuar këtë, janë caktuar apriori të dështojnë, sepse këtu ndeshin arsytetime përgjithësuese në arsytetime të mbështetura në fakte. Në këtë mes nuk mund të jetë një gjë e rastit kjo, që emri i albanoivët antikë të Shqipërisë qendro-veriore rron edhe sot, si emër nacional i vjetri i popullit e i vendit (*arbën, arbër*), në truall të shqipes e në ngulimet shqiptare të Italisë e të Greqisë. Këtyre vjen e u shtohet dhe rrethana, që nga emrat e viseve të zonës ilire nuk janë të paktë ata që gjejnë përgjegjësit e tyre në leksikon e shqipes ose në toponiminë e saj, e gjithësesi vetëm në këtë gjuhë. Khs. *Bigeste: bigë* “mal me dy maja”, majë mali (?), *Brindia Brundisium: bri brini, Dardania: dardhë, Dalmatia: delme, Lamatis: lamë lëmë, Molontum: mal, Mathis: mat* “buzë lumi, breg deti”, *Meturbarbis: mjet, Pelagonia: pellg* më e vjetër *pellëg, Ragusium: Rush rrush, Sason* emri i ishullit te *Sazanit: thaj*, te thatë “tokë, sterë, terë”, *Tara Tarentum: ter* “thaj një gjë të lagur, në erë, në diell, në zjarr”, *Tergeste* etj.: *treg, Ulkinion: ulk, Vendum: vend* etj. Duke kaluar tek emrat e personave, do të themi se me gjithë ndryshimet e mëdha që ka pësuar antroponimia, si kudo, edhe ne Evropën juglindore e në Shqipëri, sidomos me përhapjen e krishterimit nuk mungojnë analogjitë. Është vënë re se disa emra personash të ilirëve, si *Bardus, Bardyllis, Bato, Dasas, Das(s)ius, Dida, Licaus, Licca, Marica*, ose janë të gjallë edhe sot në Shqipëri, ose gjejnë përgjegjëset e tyre në gjuhën shqipe, ose shpjegohen me mjetet e saj(5). Në ato do të përfshihen tani edhe *Bardibalus*, emër burri gjetur me kohë në Serbi perëndimore, të cilit mendojmë se nga fusha e

shqipes i përgjigjet kompozita me dy sinonime *balbardhë*, që ndryshon nga ai vetëm në topikën e dy elementeve përkatëse të tij(6). Hyn aty dhe emri i një gruaje *Lydra* gjetur në vjetet e fundit në Durres(7). Ky emër i cili mund të lexohet edhe Lunda, për ne, si “e pastër, e dliër”, i përket etimologjikisht e morfologjikisht grupit gr. Lutron “banjë” lat. Latus “i larë; i pastër” gal. Lautro “banjë botore”; afrohet edhe me shq. i dliër, gjë që tregon se edhe i lirë nuk rrjedh me rrugë të drejtpërdrejtë prej lat. Liber, po duket të jetë përzier me një fjalë vendi të shqipes, të afër me Lydra. Te Skerdialidas, emri i njohur i dy princave ardianë, ndërsa te pjesa e parë mund të kemi të bëjmë, në pajtim të H. Krahen(8), me ilir. skerd – = lit. skerdzius “bariu”, sllav. e vjetër kishtarë creda “radhë, tufë”, ind. e vj. çardhas “tufë, çetë”, shq. çerdhe, te – laidas më fort se një fjalë të afërt me gr. laidros “i leshurar, i pacipë”, kemi analogjinë ilire të angl. leader, gjerm. Leiter “prijës, udhëheqës”, gjermanike e përbashkët laidian; kështu që ky emër ilir del me kuptimin “prijës çetash” (fjalë për fjalë “çeteprijës”), e jo (me Krahen) “ai që lëshon tufën”.

Nuk mund të lihet mënjanë këtu edhe ekzistenca e një terminologjie detare mjaft e pasur të shqipes, si në lidhje me florën e faunën e detit, si dhe ç’i përket lundrimit e peshkatarisë. Edhe kjo dëshmi që shqipja është formuar lashtësisht në brigjet detare të krahut perëndimor të Ballkanit(9). Në kritikën që u bëhen këtyre argumenteve nga disa dijetarë, nuk shohim të shtrohet ndonjë gjë e re. Ato në pjesën më të madhe janë një paraqitje skemash të vjetra me një petk të ri, një përsëritje disi e modifikuar e tezave të ditura e më të shumtat të vjetruara të G. Vajgandit, pa u shtuar atyre ndonjë gjë qenësore e pa i çuar më tej në ndonjë drejtim rezultatet e tyre.

Lidhur me toponomastikën historike, në tezën e Ivan Popoviçit(10) se shqiptarët paskan zënë vend në Shqipëri Veriore në kohën pas dyndjes së sllavëve në ato anë injorohet ky fakt, që një pjesë e mirë e toponimeve shqiptare e sllave të asaj krahine që ai sjell si argument për këtë tezë, në gjuhën shqipe janë apelative. Kjo gjë, e cila nuk është vënë re gjer më sot, dëshmon që sllavët i kanë marrë ato nga goja e shqiptarëve, e jo anasjelltas. Aty hyjnë ndër të tjera Fundina në Kuç të Malit të Zi (midis Hotit e Triepshit): fundëna, shumësi i fund-it, formim topik si Bishtna, Lisma, Ndërfandna; Buenë Bunë, në shek. XV S. Benedicti de Buena, serbokr. Bojana: shq. buenë boenë “të dalët e lumit jashtë shtratit, vërshim”; Lim shqip e serbokroatisht: lym (nëpër dialektet e Veriut edhe lim) “baltë e lumit, tokë që ka sjellë lumi me vete” (N. Jokli); Dêjë edhe në Mat: dêjë në Vau i Dêjes, roman. Dagno, serb. e vj. danjo nga serbokroatishtja dan “dogane”; shq. dêjë “vendi ku është ulur bora, ku ka shkrirë bora; vendi ku ujët është i cekët, cekët”: dêja e ujit: Dêjë edhe në Mat: dêjë një postverbal i dêhet bora “shkrin bora vende-vende: ulen ujerat e lumenjve”: Mati, serb. e vj. Mat, pas Payly-Wissowas prej ilir. mat – “buzë lumi a deti”: shq. mat “buzë lumi, breg deti”, Bulgër emër vendi në Mirditë e në Shestan jo “bullgar”, po = bulgër bujqër” “Quercus macedonica, lloj lisi”. Mendimi i këtij dijetari “sigurisht” me anë të sllavishtes (Svac, Drac, Vojusa, Lab-) dhe që Ulqin, Pult, Drisht, Lesh “thjesht teorikisht” mund të kenë hyrë me anë të sllav. Lcin, Pilot, Drivost, Lesb, në këtë situatë gjuhësore as që diskutohet. Në lidhje me argumentin që terminologjia detare e shqipes me fjalë të lashta e të

trashëguar që ka, dëshmon për praninë e elementin shqiptar qëmoti në viset e sotme bregdetare, është ngritur si kunderargument që disa nga këto fjalë si det, vë, mat, valë, shkullm, nuk i përkasin vetëm detit, po edhe ujërave të brendshme; disa të tjera si grykë, anije (:anë, enë), ballë, pëlhurë, shul, lugatë, janë metafora ose rrjedhoja (derivate) fjalësh që në krye të herës nuk kanë pasur lidhje me detin e që në përdorimin detar mund të kenë arritur më vonë e po kështu – thuhet – qëndron puna edhe me disa elemente të faunës, si likurishtë “polip”, ngjalë e ndonjë tjetër(11). Pa mundur të hyjmë në hollësira këtu, për të parë nëse terme të tilla vërtetojnë diçka apo nuk vërtetojnë asgjë, le të këqyrim shkurt si paraqitet gjendja në disa gjuhë të tjera, për të cilat nuk janë shprehur dyshime për një afërsi të moçme me detin. Aty shihet se fjalët e detarisë edhe në këto gjuhë burojnë më të shumtat prej kuptimesh të tjera dhe se vetëm në periodën postetnike të tyre, dhe aty vetëm me kohë, erdhën e hynë në përdorimin detar. Në greqishten fjalëve thalassa “det” dhe ochthe “buzë lumi”, “breg deti”, nuk u dihet burimi; pélagos “det” do të thotë në thelb “sipërfaqe, vend rrafsh”; hals “det” është “kripë”: pontos “det” është “udhë, shteg” dhe afrohet me lat. pons pontis “urë” e me sllav. put “udhe, udhëtim”: kolpos “gji deti” është “gji” përgjithësisht; isthmos “ngushticë deti, istm” do të thotë edhe “qafë” që në thelb duket të ketë pasur kuptimin “kalim, hyrje”: kyma “valë, dallgë” shënon dhe pjellën, embrionin dhe kuptimi detar i saj nuk është i pari, prymne “pjesa e prapme e anijes” është një me prymnos “me i mbrapmi, me i poshtmi”: histos “dyrek, shul i anijes” është më parë “shul i begjve, vegj: pëlhurë” dhe buron prej vegjetarisë. Nga fusha e latinishtes aequor “det” është “sipërfaqe e rrafshët, fushë”; sinus “gji deti” është “palë, prehër, gji skute”: velum “velat” është pëlhurë, perde” dhe në thelb një fjalë vegjarie: alga “leshterik” është më parë diçka si “myk, të ndytë”. Në gjuhët gjermanike gjerm. Schiff “anije” dikur ka pasur dhe kuptimin e enës, po ashtu si it. vascello frgj. vaisseau nga lat. vascellum “enë e vogël”, si dhe shq. anije e cila lidhet me anë, enë, khs. enë e mëdhaja e enët e vogla të Ulqinit(12). Edhe në këto gjuhë terma si gr. kolpos, lat. sinus maritimus, gjerm. Meerbusen “gji deti”, kjo një përkthimi i fjalës latine, nuk janë tjetër veçse metafora. Në të tilla rrethana na duket pak si e ngutur të thuhet se fjalë si det, mat, valë, grykë, anije nuk përbejnë elemente të një leksiku detar të trashëguar të shqipes. Edhe nëse disa sosh ose edhe shumica e tyre u përkasin edhe ujërave të brendshme. Logjikisht prej kësaj nuk mund të nxirret se nuk janë qëmoti edhe të detit. Dhe Mendimi që fjalët e këtij llojit vetëm në një shkallë të mëpastajshme të gjuhës hynë në përdorimin detar, operon me një *argumentum ex silentio*: me dëshmimin e vonë të shqipes si gjuhë askush nuk mund të thotë që këto nuk kanë qenë përdorur qëmoti si shprehje të gjuhës detare.

Huazimet latine të shqipes me karakterin e tyre arkaik tregojnë se kanë depërtuar herët në këtë gjuhë, dhe me depërtimin nga një fazë më e hershme e latinishtes dëshmojnë për praninë e shqipes në viset e sotme të paktën në atë periodë. Të njëjtën dëshmi japin edhe huazimet e shqipes nga greqishtja e vjetër. Karakteri dorik i vërtetueshëm i shumë nga këto huazime na dëfton se të parët e shqiptarëve kanë banuar në brigjet e Adriatikut e të Jonit të paktën që nga koha e pranisë së kolonive greke dorike në këto bregdetë dhe se i kanë marrë këto elemente gjuhësore nga këto koloni ose nga dialektet veriperëndimore të Greqisë së vjetër, të

cilat dihen se afroheshin me dorishten. Mendimi që këto huazime në shumicën e tyre nuk paramendojnë një afërsi gjeografike midis dy popujve përkatës, në atë kohë, po hyjnë në viset e brendshme me anë të tregtarëve doras(13) , për emrin e mokrës dhe të barishteve të kuzhinës nuk mund të qëndrojnë(14). Më shtjelluar do të themi se nuk na duket të jetë afër mendsh që t'i detyrohen transportit tregtar nga bregdeti në hinterlande të largëta fjalë të tilla si fier, presh, trumzë, shkop, shkarpë, mështekën, e aq me pak disa të tjera si qull, shpellë, shtyllë, emra insektesh si kandërr, merimangë, e fjalë detarie si blî (peshk), ankyra “spirance” (hekur, N. Jokl) e ndonjë tjetër. Shumica e këtyre fjalëve, sikundër shihet, nuk janë emra artikujsh të tregtisë, karakteri autokton i popullit shqiptar të paktën që nga koha antike i vërtetuar me mjete gjuhësore, banimi i tij dhe formimi i gjuhës së tij në një territor ku kanë banuar kryesisht fise ose popullsi ilire, flet në të mirë të filiacionit ilir të tij. Argumentimi gjuhësor më i drejtpërdrejt do të ishte një krahasim i gjithanshëm i sistemit të shqipes me atë të ilirishtes, po ky krahasim siç u vu në dukje më lart, për mungesë të dhënash nga ana ilire, nuk mund të kryhet veçse në shumë pak pika, edhe këto shpeshherë më fort me gjasë (probable) se të sigurta. Për të arritur këtu – e jo vetëm këtu, po përgjithësisht në krahasimin e një gjuhe të gjallë me një të vdekur – në një gjykim e një vlerësim objektiv të materialit, na duket me rëndësi të mbahen disa kriteret parimore në punë të metodës: në radhë të parë kronologjia dhe kushtet e kërkesat e saj, gjendja gjuhësore e brendshmja dhe konkordancat specifike. Përpara çdo krahasimi duan marrë elementet e veçanta të sistemit të shqipes, dhe duan vendosur sipas moshës së tyre; duke shikuar cilat mund t'i përkasin periodës antike, cilat periodës mesjetare e cilat periodës së re të saj. Në çdo pikë takimi që mund të dalë midis shqipes e ilirishtes, në fushën fonetike a morfologjike qoftë a në atë të leksikut, do shikuar më parë a ka të ngjarë që të jetë ajo në shqipen e një lashtësie të tillë që të lejojë krahasimin; nuk duhet harruar asnjëherë në këtë mes që kjo gjuhë që në kohë më të para ka pësuar ndryshime mjaft të mëdha. Kjo punë e kronologjisë shtron detyrën e një rishikimi të analogjive të shtruara gjer më sot nga gjuhësia dhe të përjashtimit të atyre që eventualisht kanë të bëjnë me procese të mëpastajme të shqipes e që si të tillë tjetër nuk janë veçse spekulacione të thjeshta. Në lidhje të ngushtë me kronologjinë qëndron puna e gjendjes gjuhësore të brendshme. Nuk mund të merret një formë a një fjalë e shqipes e të barazohet ashtu përnjëherë me një të ilirishtes në bazë të një gjasie që bie në sy me një vështrim të parë. Më parë do hetuar mos është ajo sekondare, histerogjene në gjuhën shqipe, rezultate procesesh të një zhvillimi gjuhësor të brendshëm, gjë që do ta hidhte poshtë barazimin në fjalë, si pjellë arbitrare të një çasti. Në punë të filiacionit çojnë peshë pastaj edhe konkordancat specifike, përkimet e shqipes me një gjuhë jo greke të Ballkanit të lashtë. Nuk është shenjë e një metode solide e shkencërisht korrekte kur merren si dëshmi relevante për një filiacion të caktuar disa barazime trepalëshe, përkime të shqipes me dy a më shumë nga ato gjuhë të vjetra.

Nga struktura fonetike, reflektimi i *o*-së së shkurtër indoevropiane me *a* në shqipen (asht-i: lat, os, ossis, gr. ostéon “asht”) e në ilirishten(15) nuk është një perktim specifik, sa kohë që këtë ndërrim paraqesin dhe gjuhët gjermanike (dikur dhe sllavet), e në Ballkanin e lashtë edhe trakishtja. Megjithatë fakti që mesapishja ka

këtë ndërrim zanoreje, e që më anë tjetër makedonishtja me fjalën akrunoi “male” për mendimin tonë piqet me emrin e qytetit Acruvium në grykat e Katorit dhe qëndron përballë lat. ocris “arx, mons (me o) dhe gr. okris “majë mali, zgrip” pranë akris “majë mali” e akra “majë”, në këtë mes mbase nuk është një gjë gand e rastit. Një rishikim do edhe çështja e divergjencës që është vënë re midis shqipes e ilirishtes në punën e mënyrës së reflektimit të likuideve e nazaleve sonantike (silabike), konkretisht të r-së, kështu te V Borcigu ilir. or, shq. ri. Shembujt që figurojnë për këtë refleks nuk janë në gjendje të vërtetojnë një reflektim të tillë në këtë gjuhë. Më anë tjetër bie në sy pajtimi në zhvillimin fonetik të l-së silabike në të dy gjuhët shq. ulk: ilir. *Ulkinion, Ulcirus mons, Ulcisia castra* në Panoni etj., pajtim që përball formave të tilla si gr. *lykos*; lat. *lupus*, got. *wulfus*; sllav. e vj. kishtarë vl_k_ etj., duhet të quhet specifik. Një vëmendje të veçantë kërkon theksi. H. Krahe ka shprehur mendimin që edhe ilirishtja ka pasur mbase theksin inicial (theksin në ballë të fjalës) ashtu si gjuha protogjermane, gjuhët italike dhe keltishtja(16). Më anë tjetër Jokli që më parë ka konstatuar rregullimin mekanik të theksit të shqipes me ngulitjen në rrokjen parafundore, që në kohën romake. Këto dy dukuri na duket se pajtojnë në mes tyre dhe se plotësojnë njëra-tjetrën. Kalimi i theksit të shqipes, i shikuar historikisht, shpie për ne më tej në këtë, që kjo gjuhë në fjalët origjinalisht terrokëshe, me humbjen e shpeshtë të rrokjes parafundore nga një gjendje me theks inicial, pra ka kaluar nga ritmi daktilik (\bar{I} vv) në ritmin trokaik (\bar{I} v). Ky është një pajtim i shënueshëm me ilirishten, dhe vijën e zhvillimit të tij e paraqesin qartë të tilla rasa prej Shqipërie si *Drivastum, Drisht, Isamnus, Ishëm, Durrachion: Durrës*, të cilat atëherë shihet se duan lexuar *Drivastum, Isamnus, Durrachion*; këtyre nga treva mesapike, si vuri re sëpari P. Kretschmeri(17), u përgjigjen Brundisium sot Brindisi, Hydruntum: Otranto, Tarentum: Taranto etj. Në këto rrethana mendimi i A. Mayerit(18) se rregullimi mekanik i akcentit të gjuhës shqipe ka fshirë këtu gjurmët e lashta, nuk mund të qëndrojë.

Nga fusha e konsonantizmit reflektimi i së paravendues (supozuares) *bh* indoeuropiane me *b* në gjuhën shqipe, përkundrajt *f*-së së latinishtes e *ph*-së së greqishtes (bie, bar, mbar: lat. fero, gr. phéro), si një dukuri e përhapur në mbarë gjuhët e lashta jo greke të Ballkanit e të viseve përreth (mesapisht, ilirisht, makedonisht, trakisht, frigisht etj.) e në një shumicë gjuhësh të vjetra e të reja të Evropës e të Azisë, pra shkurt në shumicën e gjuhëve indoevropiane, nuk përbën ndonjë përkim specifik, shumë-shumë mund të çojë në peshë si një dukuri ndër të tjerat, afërsisht ashtu si o:a që u zu ngoje më sipër. Nga konsonantizmi ndërkaq meriton vëmendje mendimi i N. Joklit për pajtimin e veçantë të shqipes me ilirishten e me trakishten në mënyrën e pasqyrit të labiovelareve indoevropiane me refleks të dalluara përpara zanoreve të çelëta (e,i) dhe zanoreve të mbyllta (a, o, u), pajtim që me përjashtimin e trakishtes nga ky mes që bën V. Cimohovski(19) , paraqitet tani si tezë e re e një konkordance specifike midis ilirishtes dhe shqipes. Divergjencat që janë vënë re midis këtyre dy gjuhëve në fushë të guturaleve, për mendimin tonë kërkojnë të rishikohen. Kështu edhe po të jetë që ilirishtja në trajtimin e palataleve të ketë shkuar me gjuhët indoevropiane perëndimore ose kentum (mendimet, sikundër dihet, janë të ndara këtu), puna që shqipja është një

gjuhë lindore (satem) nga kjo anë, nuk përbën një argument të prerë për të përjashtuar birërinë ilire të saj. Si e kemi shprehur dhe me parë(20), kjo është dhe një çështje kronologjike: në këtë mënyrë – me zhvillimin fonetik të palataleve në gjysmokluzive (afrikate) e pastaj në spirante – nga një gjuhë kentum në rrjedhë të kohëve mund të përftohet një gjuhë satem, karakteri satem i shqipes mund të jetë një dukuri e zhvilluar dhe relativisht e vonë.

Struktura morfologjike është pjesa më e panjohur e sistemit gjuhësor të ilirishtes. Në qoftë se është i drejtë mendimi ynë që në *Scodra* e *Scupi* na shfaqet nyja shquese e mbrapme *-a -i* që përdor shqipja në emrat femërorë e mashkullorë si *ara, mali*(21), atëherë kemi një takim të rëndësishëm të ilirishtes me shqipen në lëmin e fleksionit të emrit.

Mesapishtja bashkë me disa të tjera gjuhë indoevropiane ka pasur gjinoren e mashkulloren njëjës më *-i*; një gjurmë të kësaj ruan edhe shqipja, në *i ati: i t'et*. Me te dukshme janë disa përkime nga fusha e fjalëformimit, duke përfshirë shqipen dhe ilirishten me trevat më të largëta të saj – një rrethanë që përveç kësaj dëshmon edhe për një njësi gjuhësore ilire brenda ndryshimeve territoriale, njësi për të cilën u fol më lart: sufiksi *at* (Demi) shm. Demat, emra vendesh si *Dukat, Filat*: ilir. *-āt-* (*Delmates, Daesitiates, Ulciniatae*, emra vendesh si *Lamatis, Aemate*); shq. *-shtë* (*kopshtë, vëneshtë*): ilir. *-st-* (*Tergeste, Ladesta*); mbase shq. *-inj* (*kërminj, shkëmbinj*): ilir. *-inium* (*Delmanion, Ulkinion*). Nga prefikset khs. ilir. *li-* (*Liburni: Burni*): shq. *lë-* në *lëfynt: fyt, lëmazë: mazë* etj.

Nisja nga madhësia e panjohur e ilirishtes për të krahasuar të dhënat e saj me disa elemente të shqipes, vetvetiu paraqitet shumë më e vështirë. Kësaj i shtohet fakti që materiali ka mbetur po ai që ka qenë. Megjithatë është me rëndësi kjo, që një pjesë e mirë e atyre dëshmive të pakta që na kanë mbetur, gjejnë shpjegimin e tyre me mjetet e shqipes, e vetëm me mjetet e kësaj gjuhe. Hyjnë aty pikësëpari disa elemente të leksikut që nxirren nëpërmjet të toponomastikës, si *brin-, dalm-, delm-, lam-, pelag-, tar-, terg-, trag-, ulk-, vend-*. Në përpjekjen për të hedhur poshtë ç'është fituar këtu me një punë disa brezash, energjia me të cilën bëhet kjo nuk na duket se i përgjigjet fuqisë së argumentimit: Argumentet që sillen nuk na duket se janë në gjendje t'i rezistojnë një kritike objektive. Prandaj kjo përpjekje si e tillë nuk mund të quhet një përparim në fushë të gjuhës e të onomastikës historike. Po kjo gjë vlen edhe për ato mbeturina gjuhësore, të lashta e të sotme, që janë gjetur në truallin e japigëve e mesapëve në Italinë Jugore, për të cilët burimet historike e gjuhësore bashkë me emrat e personave e të viseve dëshmojnë për një shpërngulje nga brigjet e përkundrejta të Ilirise. Hyjnë aty më një anë ndër të tjera mesap. Aran, bilia, Brendisium, enotr. Rhinos "erresire": shq. arë, bile, bije, brî, rê reja m gjithë errët, për mendimin tonë edhe (lat. lama "vendi i ulët, i lagshtë o moçalor": lamë, lëmë. Më anë tjetër disa fjalë dialektore të sotme të asaj ane, si karparo "shtuf, cermo poroz e shumë i fortë, që shërben si lendë ndërtimi": karpë "shkëmb, shkrep", menna minna "gji, sisë": mënd "i jap gji foshnjës; ve qingjin të pijë te një tjetër dele kur i ka ngordhur e ëma" e ndonjë tjetër. Në këto rrethana gjeografike e gjuhësore nuk duket të jetë një takim i rastit fakti që nëpër ligjërimet e sotme të disa trevave alpine, për të cilat Straboni na dëshmon praninë dikur të dy popullsive ilire, ruhen disa fjalë, kryesisht të sferës baritore e të bimësisë, që gjejnë

përgjegjëset e tyre në leksikon e shqipes, si *ber bero* “dash”: *berr*: loba lauba “lope”: lopë: mants, manz “dem, mëzat”: mâtz mëz rum. minz; mus musso “gomar”: mushke: barga “kasolle, kashtore, kolibe prej kashte ose prej zunkthi ku mbajnë barin e thatë ose almiset bujqësore”: bar; savoj. melze frgj. mélèze “Larix”: mëllenjë mëllezë “Ostrya carpinifolia”. Këtyre u shtohen tani ndër të tjera edhe retoroman. (Valtellina) mani “man toke, mjedhër”: man, dak. (Dioskoridi) Mantia “fermanzë”; boradèi shm. “Galanthus nivalis, it. Bucaneve” ne La Valle Agordina (Dolomitet)(22) , e cila mendojmë se gjen shpjegimin e saj në shq. borë. Duke përmbledhur do të themi se analogjitë që vihen re në mes të shqipes dhe të mbeturinave të ilirishtes, kur kundrohen me një mënyrë objektive përbrenda pamjes gjeografike – historike e gjuhësore, dëshmojnë më fort për një raport filiacioni midis këtyre dy gjuhëve. Ajo është më afër mendsh të shikohen si elemente trashëgimie të shqipes sesa si huazime të kësaj gjuhe prej ilirishtes si prej një gjuhe të ndryshme nga ajo. Është gjithashtu metodikisht e gabuar të flitet për një substrat ilir në këtë gjuhë. Sikundër e kemi theksuar edhe herë të tjera, koncepti i substratit është i lidhur me një ndërrim gjuhe. Një ndërrim i tillë nuk dihet të ketë ngjarë në Shqipëri, ashtu si ka ngjarë p.sh. në Rumani në rrjedhim të romanizmit të atij vendi. Në këto kushte, në problemin e burimit të shqipes, detyra e argumentimit u bie më shumë atyre që mohojnë karakterin ilir të saj sesa atyre që e pohojnë. Një studim më i thelluar, më i plotë e më pak i njëanshëm i gjuhës shqipe në të ardhmen, sidomos i strukturës fonetike dhe i trashëgimisë leksikore të saj, duke i caktuar kësaj gjuhe një vend më të qartë e më të qëndrueshëm në fushën e bashkisë indoevropiane, mund të sqarojë mbase më mirë edhe problemin e burimit të saj. Mundësitë e një sqarimi ndërkaq nuk janë të mëdha sa kohë që materiali të mbetet ai që është. Ato do të shtoheshin po të shtoheshin me ndonjë zbulim material i krahasimit.

(Ilirët dhe Gjenezat e Shqiptarëve, Sesion shkencor, Tiranë, 3-4 mars, 1969)

1. Gröberes Grundriss der romanischen Philologie I (1888) 804
2. H. Baric, Albanorumänische Studien I (1919) 125
- 3- Fillimet e një rryme të tillë rrjedhin që nga pjesa e dytë e shekullit të kaluar (XIX). Khs. Vërejtjet e Gustav Majerit ne parathenien e Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe, 1891, f. XIII.
4. D. Mustilli, Rivista d’Albania III (1942) 37 v., St. Alb. II (1965) 56 v., S. Anamali, F. Prendi, Konf. I st. Alb. (1962) 468
5. Per keto emra M. Lambertz, ne IF, 60, 306 vv.
6. Ndryshe për Bardibalus Krahe në “Romanica, Festschrift für Gerhard Rohlfs” (1958), 259 vv.
7. V. Toçi, „Bul. USHT, ser, shk. Shoq“, 2, 1962, f.127, Konf I st.alb. f. 466.
8. Die Sprache der Illyrier I f. 59 v.
9. Sh. Vërejtjet tona në „Hyrje ne historinë e gjuhës shqipe“ (Albanologji, dispensë, 1947) 1960 f. 32 vv., Bul. USHT, ser.shk.shoq. XII (1958) Nr.2 f. 54 vv., XVI (1962) Nr. 1 219 vv. Nr. 4 123 e 147, Atti del VII Congresso Internaz. Di Scienze Onomastiche 161 f. 241 vv., „Revue (roumaine) de linguistique“ VII (1962) 162 v.,

- X (1965) 104 v., „St. fil.“ XX (III) 1966 Nr. 4 147 v., „St. alb. I (1964) Nr. 1 f. 87, IV (1967) Nr. 1 f. 49 v. – W. Cimochowski, „La lingua posnaniensis“ VIII (1960) 133 vv. – A. Rosetti, Istorja limbii române II 4 (1964) vv. – L. Dodbiba, St. alb. III (1960), Nr. 2 f. 63 vv. St. fil. XXI (IV), 1967, Nr. 1 f. 35 vv., - H. Mihaescu, „Revue des études sud-est européennes“ IV (1966) 347 vv.
10. „Zeitschrift für slavische Philologie“ XXVI 301 vv.
11. C. Haebler, „Südost-Forschungen“ XXIII, 1964, 425 v., „Die sprache“ XIII 80. – E. P. Hamp, The position of Albanian në „Ancient indoeuropean Dialects“, 1966, f. 98.
12. Sh. për anije M. E. Scmidtin ne KZ 50, 235, për enët e Ulqinit, Rr Zojzin, „Bul.shk.shoq.“ 41 1955 f. 150.
13. A. Philippide, Origenea Rominilor II 775 shënimi; Haebler, „Südost-Forschungen“ XXIII 426.
14. N. Jokl, IJ XIV VII 169
15. Për ilirishten N. Jokl Reallexion der Vorgeschichte I f. 91; G. Bonfante, Bull.Soc. de Linguistique de Paris XXXVI 142
16. Indogermanische Sprachëissenschaft, 1943 f. 34
17. „Glotta“ XIV 89 v.
18. Die Sprache der alten Illyrier II 161.
19. „Bul. USHT ser. Shk. Shoq.“ 2, 1958 f. 45 v.
20. Po aty 1962, Nr. 4, f. 122, 139.
21. Po aty, 1963, Nr. 3 f. 79, 105.
22. G. B. Rossi, Flora popolare agordina (Contributo allo studio del lessico della Val Cordevole): Con introduzione di G. B. Pellegrini, 1964, f. 96; „La forma di L. V. è isolata e di etimo oscuro“.

ALEKSANDËR STIPÇEVIQ

ETNOGJENEZA E SHQIPTARËVE NGA ILIRËT

Anton Tomazh Linhart duke u mbështetur tek Thunmani shkruan se gjuha ilire jeton edhe sot. Eqrem Çabej, zhvleftësoi shumë argumente me të cilat mohohej lidhja bijësore ndërmjet gjuhës shqipe dhe ilire. Gjuhëtari kroat Radosllav Katiçiq shprehet: Është normale dhe e natyrshme të konsiderohet se gjuha shqipe ka dalë nga ilirishnja. Shën Jeronimi, e njihte mirë situatën e pjesës perëndimore të Ballkanit të antikës sepse edhe vetë ishte i lindur ilir. Kultura e Komanit, etnologjia, kostumografia dhe format muzikore polifone dhe homophone janë karakteristika tipike ilire. Shqiptarët e kanë emrin nga fisi ilir albanoi, “arbanitai” që janë pasardhës të fisit ilir të albanëve - shkruan në kumtesën e ilirologut, arkeologut, ballkanologut e studiuesit arbëresh, Akademik Aleksandër Stipçeviq.

1. Po e filloj me J. E. Thunman

Me historianin gjerman J. E. Thunman, i cili para më se dy qindvjetëshave shkroi për prejardhjen e shqiptarëve në librin e tij, “*Hulumtime rreth historisë së popujve të Europës lindore*”, nis një varg shumë i madh shkencëtarësh, të cilët u morën me këtë çështje jashtëzakonisht të rëndësishme dhe interesante të paleoballkanikës. A janë shqiptarët banuesit e vjetër, sipas kësaj me grekët, populli i vetëm në Ballkan, i cili nga koha parahistorike, jeton në këtë hapësirë të njëjtë, në të cilën edhe sot jeton, ose ata në këtë hapësirë kanë ardhur vonë, në kohën ose edhe pas shpërnguljes së madhe të popujve në mesjetën e hershme? Nëse shqiptarët janë autoktonë, ç’e argumenton këtë autoktoni, dhe nëse janë të ardhur prej nga kanë ardhur?

Thunmani që atëherë duke pasur në dispozicion vetëm burimet historike përfundoi se shqiptarët janë banuesit e lashtë dhe si argument për këtë hipotezë solli dokumentet e shkruara, të ruajtura të Mesjetës, në të cilët nuk hasim gjurmën më të vogël për ndonjë shpërngulje shqiptarësh në vendbanimin e tyre të sotëm. Ky argument edhe sot është i qëndrueshëm dhe në të, me të drejtë, mbështeten të gjithë ata që mbështesin, ose në të kaluarën kanë mbështetur tezën e autoktonisë së

shqiptarëve.

Pas Thunmanit, këtë tezë e mbrojtën shumë historianë, filologë, e shkencëtarë të tjerë. Kështu, historiani dhe shkrimtari slloven Anton Tomazh Linhart, në veprën e tij “Pasqyrë e historisë së Kranjës dhe vendeve tjera sllavo jugore në Austri” duke u mbështetur tek Thunmani shkruan se gjuha ilire jeton edhe sot, edhe pse jo e pastër, në mallet shqiptare, (und noch heute, obwohl nicht mehr rein in den Gebirgen Albanienslebt). Në qindvjetëshin e 19-të, tezën e autoktonisë së shqiptarëve e mbështesin shumë shkencëtarë, ndër ta vend jashtëzakonisht të rëndësishëm zë konsulli austriak dhe njohës shembullor i të kaluarës dhe i kulturës shqiptare, Johan Gerog fon Hahni, me veprën e tij të rëndësishme “*Studime shqiptare I-III*”. Hahni, duke i mbështetur konkludimet e veta në njohjen e thellë të burimeve historike dhe të historisë së gjuhës shqipe, është i pari që tezën e autoktonisë së shqiptarëve e vendosi në baza të shëndosha e solide shkencore. Meritë e tij e veçantë është se tërhoqi vëmendjen e opinionit shkencor kah toponomastika, si lëndë e rëndësishme për studimin e vazhdimësisë iliro-shqiptare. Shpjegimi i tij i disa emërtimeve ilire të vendeve, me ndihmën e gjuhës shqipe, si p.sh. *Dalmacia* nga *delme* = dele, *Ulcinium* nga *ulk* = ujk dhe shumë e shumë të tjerë, edhe deri më sot mbeten në fuqi.

2. Në shekullin XIX vazhdojnë hulumtimet

Teoria e autoktonisë së shqiptarëve dhe e prejardhjes së drejtpërdrejtë nga ilirët që e pranueshme në tërësi deri në fund të shekullit të XIX-të, kur disa gjuhëtarë, njohës të mirë të gjuhëve të vjetra ballkanike, nisën të theksojnë se gjuha shqipe nuk është zhvilluar nga ilirishtja, por nga trakishtja dhe sipas kësaj, as shqiptarët nuk mund të konsiderohen pasardhës të ilirëve, por të trakasve. Përfaqësues kryesorë të kësaj teorie, në fillim, ishin filologët e njohur K. Pauli (1891) dhe H. Hirti (1898), e pas tyre edhe shumë të tjerë. Sipas kësaj teorie, gjuha shqipe nuk ka mundur të zhvillohet në zonën në të cilën ajo flitet sot, por në brendësi të Ballkanit, në zonën në të cilën, në kohën antike jetonin trakasit dhe prej saj del se shqiptarët nga këto treva janë vendosur në trojet ku jetojnë sot. Për mendimet e këtilla si argument sillen ngjashmëritë ndërmjet gjuhës rumune e shqipe.

Nëse është e vërtetë kjo që, sipas kësaj teorie dëshirohet të argumentohet si e tillë, shtrohet pyetja: kur u shpërngulën shqiptarët nga brendia e Ballkanit kah perëndimi? Sipas të parëve (V. Parvan) kjo ngjau ne shekullin III ose IV të erës sonë, pra që në kohën e mbretërisë romake, ndërkaq sipas të dytëve, u vendosën në kohën e dyndjeve të popujve në mesjetën e hershme (K. Jireçeku), dhe sipas të tretëve mendohet se tek kjo dyndje gjithsesi arrihet pas vendosjes së sllavëve në këto anë (A. M. Selishçev, J. Popoviq), ndonjë prapë beson se shqiptarët atje kanë mundur të paraqiten në kohën turke (F. Kordinjano).

Megjithatë, teoria trakase nuk është e vetmja me të cilën përpiqet të pengohet autoktonia e shqiptarëve dhe prejardhja e tyre ilire. Linguisti bullgar Vladimir Georgiev gjeti ngjashmëri ndërmjet gjuhës shqipe dhe asaj dako-mizike, andaj përfundon se shqiptarët janë shpërngulur nga vendbanimet e Dacisë antike. Të tjerët prapë, gjithnjë duke u nisur nga studimet gjuhësore, arrijnë në përfundimin se

shqiptarët rrjedhin nga simbioza gjuhësore iliro-trakase, sipas kësaj edhe i simbiozës etnike (N. Jokli), të tjerët tek shqiptarët shohin pasardhësit e trakasve të ilirizuar, etj.

3. Eqrem Çabej argumenton lidhjen e gjuhës iliro-shqiptare

Mirëpo, duke studiuar këtë çështje, shumë përfundime në të cilat arrijnë gjuhëtarët e së kaluarës i mbështesin në hulumtimet e pamjaftueshme të gjuhës shqipe, sidomos të historisë së saj. Hulumtimet intensive që kohën e fundit i ndërmorën gjuhëtarët shqiptarë, në rend të parë gjuhëtari Eqrem Çabej, zhvlehtësuan shumë argumente me të cilat deri sot mohohej lidhja birërore ndërmjet gjuhës shqipe dhe ilire. Pikërisht njohja e pamjaftueshme e lëndës gjuhësore shqiptare nxiti shumë shkencëtarë të përfundojnë se shqiptarët nuk kanë terminologji vetjake detare dhe peshkatore dhe këtë e merrnin si argument se shqiptarët nuk kanë mundësi t'i banojnë zonat bregdetare, ku kjo terminologji ka qenë e nevojshme, pra pranë detit. Por, u tregua se ky përfundim është i pasaktë, sepse shqiptarët kanë terminologji shumë të pasur detare dhe peshkatore, për ç'gjë gjuhëtarët e mëtejshëm thjesht nuk dinin se ekzistonte.

4. Radosllav Katiçiqi: gjuha shqipe ka dalë nga ilirishtja

Është interesante së gjuhëtarët, natyrisht jo të gjithë, të cilët argumentet e veta i mbështesin gati kryesisht në studimin e gjuhës shqipe e të gjuhëve ballkanike, mohonin lidhjen ndërmjet shqiptarëve dhe ilirëve, në kohën më të re, gjithnjë sjellin argumente më të shumta, me të cilat këtë lidhje e argumentojnë dhe kështu pikërisht gjuhëtarët u bënë kundërshtarët kryesorë të teorisë së autoktonisë së prejardhjes së shqiptarëve. Dhe, këto argumente vërtet janë bindëse. Në mesin e tyre është p.sh. edhe e dhëna se në gjuhën shqipe janë ruajtur huazime nga dialekti dorik i gjuhës së vjetër greke, të cilat, është e qartë, i huazuan ilirët në periudhën antike nga kolonistët grekë në trojet ilire (Apidamnos, Apollonia, Orikon etj), me të cilat ilirët jetuan në simbiozë një kohë shumë të gjatë. Sa për ilustrim po përmendim fjalët *b l e t ë*, e cila ka prejardhje nga fjala greke; fjala *m o k ë n ë*, mulli rotativ dore në të cilën dallojmë fjalën greke etj. Emrat e shumtë të vendeve të kohës antike janë ruajtur në gjuhën e sotme shqipe, në ato forma në të cilat më shpesh mund të shpjegohen me ligjshmëritë fonologjike të gjuhës shqipe. Në rezultate të ngjashme kanë arritur gjuhëtarët duke studiuar antroponiminë dhe çështje të tjera gjuhësore. Kjo pati si pasojë se edhe gjuhëtarët gjithnjë e më shumë po përqafojnë teorinë e prejardhjes së drejtpërdrejtë të gjuhës shqipe nga gjuha ilire (V. Pisani, W. Cimohovski etj.), ndërkaq gjuhëtari zagrebas Radoslav Katiçiq qëndrimin e vet për këtë çështje e ka përmbyllur në fjalinë: *“Është normale dhe e natyrshme të konsiderohet se gjuha shqipe ka dalë nga ilirishtja”*. Ky gjuhëtar hodhi poshtë prejardhjen trakase, sepse mendon se ngjashmëritë ndërmjet gjuhës shqipe e rumune nuk mjaftojnë për të nxjerrë përfundime për lidhjen e tyre gjenetike.

Teorinë trakase e kundërshtoi ashpër edhe filologu Italian Vitore Pizani, i cili me të drejtë vëren se “ nëse në periudhën antike në Shqipëri është folur gjuha ilire, nuk shoh se si popullsia e Shqipërisë këtë gjuhë ka mundur ta zëvendësojë me trakishten”, gjegjësisht, “ nëse pandehim se ata deri në okupimin romak kanë folur ilirishten, nuk shoh se si kanë mundur ta zëvendësojnë gjuhën e vet me gjuhën e një populli tjetër i cili kurrë nuk e ka sulmuar ose okupuar Shqipërinë”. Mirëpo, sado që lënda gjuhësore dhe interpretimi i saj është me rëndësi të dorës së parë për studimin e problemit të etnogjenezës së shqiptarëve, prapë duhet theksuar se kjo lëndë nuk është e vetmja, me të cilën përpiqet të ndriçohet ky problem. Me rëndësi të veçantë janë rezultatet e reja të hulumtimeve arkeologjike, të cilat gati në heshtje të plotë të burimeve historike, për periudhën nga shekulli i VI e deri në shekullin XI se çka ngjarë në këtë pjesë të Ballkanit, ofrojnë mbështetje më bindëse për ndjekjen e fatit të banorëve të vjetër gjatë mesjetës së hershme. Në këto rezultatet duhet konsideruar edhe ata që, në kohën më të re, kanë shënuar shkencat e tjera, p.sh. etnologjia, antropologjia etj. Me hulumtimin e këtij problemi kompleks sot merren shumë specialistë, në rend të parë shqiptarë. Për problemin e etnogjenezës së shqiptarëve është diskutuar në tubimin shkencor, i cili u organizua në Tiranë më 1969. Në aktet e këtij tubimi, të cilat më parë u botuan në gjuhën shqipe e pastaj edhe në gjuhën frëngjishte me titull “Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve, (Tiranë 1971), hasim punime të cilat këtë problematikë e ndriçojnë nga aspekti gjuhësor (E. Çabej, J. Gjinari etj). Edhe një konferencë e ngjashme me titullin “Konferenca kombëtare për gjenezën e popullit shqiptar, gjuhën dhe kulturën e tij”, me pjesëmarrje të shumë specialistëve të huaj, u mbajt në Tiranë më 1982. Këtij problemi pjesërisht i kushtohet edhe Kuvendi i parë i studimeve ilire (Tiranë 1972), po ashtu me pjesëmarrje të specialistëve të shumtë të huaj, në mesin e të cilëve pati edhe nga Jugosllavia titiste.

5. Ndhimesa e disiplinave të tjera shkencore

Gjithë kjo pati për pasojë se sot problemet që lidhen me etnogjenezën e shqiptarëve pakrahasueshëm janë me të njohura se sa kanë qenë para njëzet vjetësh. Të shohim tani se si me ndihmën e disiplinave shkencore u shkoi përdore specialistëve të hidhnin shkëndija drite në rrethanat e kësaj pjese të Ballkanit Perëndimor, në kohën e mesjetës së hershme dhe se si sot, përballë shumë paqartësive dhe problemeve të panjohura mund të përcillet procesi etnogjenetik, i cili solli krijimin e popullit shqiptar në hapësirën gjeografike në të cilën jeton sot. Në kohën parahistorike, në hapësirën ku sot jetojnë shqiptarët, kanë jetuar fise të ndryshme ilire, në mesin e të cilëve edhe një, i cili për problematikën tonë, është me rëndësi të veçantë, emrin e të cilit nuk e ka ruajtur gjeografi grek Ptolemeu në qindvjetorin e dytë të erës sonë. Ky është fisi Albanoi me kryeqytetin Albanopolis. Dimë se ky fis është në pjesën qendrore të Shqipërisë së sotme dhe se Albanopolisi, sigurisht ka qenë në Zgërdhesh në afërsi të Krujës, ku janë zbuluar relikte monumentale të fortifikimeve, ndërtimeve etj. Në kohën e sundimit të gjatë romak në disa krahina, sidomos nëpër qytete dhe në rrethinën e tyre është krijuar një lloj simbioze, më parë greko-ilire e më vonë edhe iliro-romake. Në qytetet e mëdha siç

kanë qenë: Apollonia, Scodra, Dyrrachiumi, Lissusi e të tjerë, në kohën romake vijjnë kolonistë italikë, të cilët imponojnë gjuhën e vet latine, si gjuhë të administratës, ushtrisë dhe në përgjithësi në jetën publike. Ata me vete sjellin teknologji më të përparuar për ndërtimin e enëve të baltës, për përpunimin e metalit, ndërtojnë rrugë të shkëlqyera, nëpër të cilat bashkë me ushtrinë do të vijjnë nga Italia dhe nga krahinat e tjera të Perandorisë romake prodhime të ndryshme kulturore, si dhe ide të reja e religjione të reja. Prodhimi serik i mallit të konsumit të përgjithshëm do të sjellë stagnimin dhe rënien e kulturës tradicionale materiale vendase dhe në bazë të pranisë së punëtorive romake, në qytetet e vendbanimet ilire, ka nxitur shumë hulumtues të sotëm ta mbiçmojnë intensitetin e romanizimit. Fakti se ilirët as në jug, as në pjesët tjera të Ballkanit nuk kanë hartuar alfabet kombëtar dhe se mbishkrimet varrore e në objekte të tjera i kanë shkruar kryesisht në gjuhën latine ose greke dhe më shumë i ka kontribuar sjelljes së përfundimeve të pasakta për romanizimin e krahinave ilire.

Në të vërtetë, anasit e vjetër të Ilirisë Jugore, përkundër ndikimit në një kohëzgjatjeje shumëshekullore të bashkëjetesës që kanë ushtruar kolonistët grekë, pastaj romakë, vazhduan ta jetojnë jetën e vet, ta flasin gjuhën popullore, të besojnë në hyjnitë e veta të moçme, të shërohen me ilaçe të moçme popullore etj. Ndërkaq, romakët nuk kanë qenë gjithaq të interesuar patjetër të denacionalizojnë vendin që kanë okupuar, andaj në ato vende kanë pasur qëndrim tolerant ndaj vendasve, ndaj kulturës së tyre, gjuhës e religjionit. Pikërisht në Ilirinë e Jugut, për këtë kemi argumente bindëse: jashtë vendbanimeve urbane, kazamateve ushtarake, qendrave xehtare dhe vendkryqëzimeve të mëdha nuk gjejmë mbishkrime në gjuhën latine. Në brendësi, populli, pa u penguar nga ardhësi-ardhacakët, vazhdoi ta jetojë jetën e vet e ta flasë gjuhën e vet. Sa i përket gjuhës, kemi argumente pikërisht nga antika e vonë, për më tepër Shën Jeronimi, i cili sigurisht e njëjtte mirë situatën e pjesës perëndimore të Ballkanit në kapërcyell të antikës sepse edhe vetë ishte i lindur ilir, shënon në shekullin V, në jetëshkrimin e vet për Shën Hilarionin, se në rrethinën e Epidaurumit (Cavtatit të sotëm), flitet në gjuhën e vendit, e këtë gjuhë të vendit e përmend edhe një herë në komentet e veta të Isaisë si “gentilis barbarusque sermo”.

6. Emrat e përdorur ilirë

Fundin e antikës dhe dyndjen e popujve, krahinat e ilirëve të jugut e pritën me popullsi romane e me vendëse të romanizuar ose gjysmë të romanizuar në qendrat urbane e me popullsi autoktone në brendësi. Sidomos kjo popullsi e paromanizuar që e pranishme në vendkalimet malore, vështirë të arritshme, të cilat kurrë nuk kanë qenë të nënshtruara procesit të romanizimit. Megjithëkëtë, edhe ajo shtresë e popullsisë vendase që u romanizua nëpër qytete ose në afërsinë e tyre, nuk e kishte harruar prejardhjen e vet, siç mund të argumentohet bukur mirë me faktin se me këmbëngulësi fëmijëve të vet u vënë emra të vjetër ilirë, si p.sh. Pletor, Gentius, Tata, Anula dhe shumë e shumë të tjerë, të cilët i lexojmë nëpër monumentet mbivarrore të shkruar në gjuhën latine ose greke. Përveç të tjerash në këto monumente, jo rrallë hasim të latuar heronj vendës të veshur me rroba popullore,

nga e cila mund të shihet mirë se me çfarë këmbëngulje ilirët ruanin tiparet dhe identitetin e vet nacional.

Ndarja e mbretërisë në qindvjeçarin e katërt të erës sonë në atë të lindjes dhe të perëndimit, e cila ilirët e jugut i mbërtheu në përbërje të perandorisë lindore romake, si dhe shtegtimet afatshkurta të gotëve e hunëve në qindvjeçarin e pestë, nuk sollën kurrfarë ndryshimesh të rëndësishme etnike. Ndryshime të këtilla nuk ndodhën as në periudhën e dyndjes së popujve, as shtegtimeve të avarëve e sllavëve, sepse e kemi të njohur dhe të ditur nga burimet historike, se kjo zonë ilire, në këtë kohë, nuk u gjet në sulmin kryesor të valës migracionale avaro-sllave. Shprishje më të mëdha etnike nxiti përqendrimi i mëvonshëm i sllavëve si pasojë e invazionit bullgar nga gjysma e dytë e shekullit IX deri në fillim të shekullit XI dhe atë pikërisht në jug të Shqipërisë së sotme, si dhe zgjerimi i elementit sllav në Shqipërinë Veriore.

Burimet shumë më të mangëta historike nga mesjeta e hershme, që kanë të bëjnë me zonën e krahinave jugore ilire, vështirë mund të na ndihmojnë për rekonstruimin e gjithë asaj që ka ngjarë me popullsinë e vjetër banuese, por që për etnogjenezën e shqiptarëve ka rëndësi shumë të madhe. Sa ka qenë numri i ardhacakëve, në rend të parë atyre sllavë, në atë zonë dhe a kanë pasur sukses t'ua imponojnë vendësve gjuhën e kulturën e vet deri në atë masë, sa që ta ndryshojë përbërjen etnike të popullsisë, ashtu siç ka ngjarë kjo në zonat tjera të Ballkanit perëndimor?

7. Arkeologjia - Kultura e Komanit

Për zbërthimin e kësaj pyetjeje themelore kemi në dispozicion një lëndë shumë të pasur arkeologjike, të rrëmihur në pjesën më të madhe në këta dhjetëvjeçarët e fundit, pastaj edhe rezultatet e disiplinave të tjera shkencore. Më parë, të shohim ç'thonë për këtë çështje gërmimet arkeologjike. Në kalimin nga shekulli i kaluar në këtë shekull, në Shqipëri, në afërsi të Kështjellës "Kalaja e Dalmacies", në fshatin Koman, është zbuluar i pari nekropol i rëndësishme i mesjetës së hershme. Gjetjet e shumta më të reja të kësaj kulture, e cila sipas gjetjes së parë u quajt "Kultura e Komanit" dhe, e cila pati lulëzuar ndërmjet shekujve VI dhe VIII të erës sonë, arkeologëve u mundësuan të kenë njohuri në detaje për kulturën materiale pikërisht të kësaj periudhe, e cila fort pak, ose aspak, ka qenë e njohur nga burimet e shkruara. Në kohën e njohjes së pakët të kësaj kulture, specialistët supozonin se bartësit e kësaj kulture janë sllavët dhe të tjerët, ndërkaq në tipologjinë e mjeteve të gjetura vërenin tipare të kulturës avarë, dhe në bazë të kësaj argumentonin praninë e sllavëve, gjegjësisht avarëve në Shqipërinë veriore. Lidhur me këtë kulturë, sot shumëçka është më e qartë, prejse arkeologët gjetën dhe hulumtuan tridhjetë nekropole me material shumë të pasur, i cili tipologjikisht i përkiste kësaj kulture. Që në fillim u tregua se lënda e gjetur në këtë nekropol, në pjesën më të madhe nuk është e përpunimit as sllav, as avar, por i përkiste popullsisë e cila edhe më parë banonte aty. Pa dyshim, materiali i zbuluar nga gërmimet në varreza, kishte karakteristika të kulturës autoktone ilire dhe mjeteve të tjera të stolisjes, të cilat tipologjikisht ndërlidhen drejtpërdrejt me ilirët. Dukuria e

disa simboleve religjioze ilire, në disa nga këto mjete, të cilat për nga forma dhe përmbajtja, dukshëm janë identike me simbolet religjioze ilire parahistorike, tregon qartë se punonjësit e tyre dhe ata që i kanë mbajtur ato mjete në mesjetë u kanë dhënë atyre atë kuptim të njëjtë simbolik që kanë pasur ato në kohërat parahistorike në këtë hapësirë. Për lidhshmërinë e kësaj kulture mesjetare me atë parahistorike, flet edhe fakti se forma e varrezave është identike si edhe në kohën parahistorike. Bartësit e kësaj kulture mesjetare kanë varrosur të vdekurit e vet në varreza të cilat kanë qenë të ndërtuara me pllaka vertikale gurore, ashtu siç kanë vepruar ilirët e kësaj hapësire para shumë qindvjeçarëve.

Megjithatë në këtë kulturë mund të vërehen lirisht elementet e kulturës së vonë materiale të provincës romake, elemente të kulturës bizantine, gjithashtu edhe elemente të kulturës sllave dhe avarë. Gjithë kjo na zbulon se në mesjetën e hershme në zonën e Ilirisë Jugore u shprehën në kulturën materiale dhe shpirtërore të vendësve të gjithë faktorët relevantë etnikë, politikë dhe kulturorë të kësaj kohe në këtë pjesë të Ballkanit. Por, prania e elementëve të përmendur joautentikë në kulturën e Komanit nuk ndryshojnë veçoritë kryesore të kësaj kulture. Jashtë çdo dyshimi, se kjo kulturë është kulturë dhe vepër e popullatës vendase dhe se elementët joautoktonë që u përmendën nuk mund të shpjegohen si faktorë për pjesëmarrje të rëndësishme të popullatës jovendase në krijimin e kësaj kulture, si dhe as për prani të rëndësishme të elementëve të huaj etnikë, të cilët dukshëm do ta shprishnin strukturën etnike të këtyre anëve në mesjetën e hershme.

Përkundër kësaj teze, shpesh përdoret fakti se në Shqipërinë mesjetare shumë të shpeshta janë emrat sllavë të vendeve, me ç'gjë dëshirohet të argumentohet se elementi etnik sllav ka luajtur një rol të rëndësishëm për ndryshimet etnike të këtyre anëve, sesa që tani del nga materiali arkeologjik. Ky argument vetëm sipërfaqësisht sjell në dyshim konstatimet e dhëna më lart. Mirëpo, është e vërtetë se janë të shumta toponimet sllave në Shqipërinë mesjetare, një numër mjaft i madh sosh është ruajtur deri në ditët e sotme, që mund të shërbejë si argument i pranishëm sllavë në këto anë, ku është formuar populli shqiptar, por po ashtu është e vërtetë se në këto anë edhe atëherë edhe sot, jetojnë shqiptarët, që tregon se ardhacakët sllavë gjatë kohës janë asimiluar, respektivisht shqiptarizuar dhe se ata u bënë njëri nga elementet konstituive të etnogjenezës së shqiptarëve. Lidhur me këto toponime sllave, duhet shtuar se ata më tepër janë argument i shtrirjes së shtetit bullgar, maqedonas dhe serb në këto krahina, se sa dokument për praninë e madhe të elementit etnik sllav. Për atë se është kështu, vërteton edhe e dhëna se mbreti Konstantin Porfirogenet, në qindvjeçarin e dhjetë, disa qytete në Shqipëri ende i quan me emrat e tyre të moçëm (antikë) dhe shumë shpejt pas kësaj këto qytete të njëjta në burime që do të dalin i quajnë me emra sllavë.

Emri i ilirëve për shenjzimin e popullsisë vendase në këtë pjesë të Ballkanit për herë të fundit del në shekullin VII në aktet “MIRACULA SANCTI DEMETRII”, kjo ndërkaq është koha e lulëzimit të kulturës së Komanit. Lidhur me këtë shtrohet një pyetje qenësore: ç'ndryshime janë bërë në përbërjen etnike të popullatës vendëse në shekuj pas përmendjes së fundit të ilirëve deri në përmendjen e parë të emrit të shqiptarëve në shekullin XI dhe pse përgjithësisht ka ardhur deri te zëvendësimi i këtij emir? Po ashtu, lidhur me këtë na imponohet edhe një pyetje

tjetër e rëndësishme: pse banorët e lashtë si emër të tyre kombëtar pranuan emrin e një fisi ilir nga brendia e vendit, i cili në periudhën parahistorike dhe antike nuk luajti ndonjë rol të rëndësishëm, e nuk morën emrin e ndonjë nga fiset më të njohura, bie fjala të taulantëve, pirustëve etj?

Shumë më lehtë është të shtrohen pyetje të këtilla se sa në ato të jepen përgjigje. Fakti se banorët e lashtë në brendi i kanë ruajtur shumë më mirë doket e veta, gjuhën dhe kulturën e vet kombëtare se sa ata në pjesët bregdetare të Shqipërisë së sotme, të cilët ishin të ekspozuar procesit shumë më intensive të romanizimit, mund të na shërbejë si mbështetje për shpjegimin e pyetjes pse *Albanoit* e moçëm (antikë) u bënë faktor kaq i rëndësishëm në Shqipërinë mesjetare. Gjithsesi, nuk është i parëndësishëm fakti se kultura e hershme mesjetare e Komanit u zhvillua më intensivisht në brendinë e Shqipërisë së Mesme dhe Veriore dhe se njëra nga nekropolet më të mëdha të kësaj kulture gjendet në Shqipërinë e Mesme, në Krujë, pra pikërisht në atë zonë në të cilën në kohën antike jetonte fisi ilir ALBANOI, dhe ku gjendej qyteti i tyre kryesor ALBANOPOLIS. Asgjë e jashtëzakonshme, pra, që banorët antikë vendës dhe ata të moçëm, të cilët emrin e vet kombëtar e ruajtën gjatë okupimit romak, e ruajtën po këtë emër edhe atëherë kur Perandoria Romake u shpartallua. Në çrregullimet e shumta që ndodhën në fund të antikës dhe në mesjetën e hershme, zona në të cilën jetonte ky fis u bë jashtëzakonisht e rëndësishme. Këtu do të zhvillohet një nga qendrat më të forta kulturore të kulturës autoktone mesjetare, ndërkaq Albanoitët do ta ruajnë emrin e tyre nacional të cilin shkrimtarët bizantinë nga qindvjeçari i njëmbëdhjetë e këndej do ta quajnë popull të zonës *Albanon*, i cili qendrën e vet e ka pasur në Krujë. Prandaj, nuk duhet në mënyrë të veçantë të argumentohet se *Arbanonët*, të cilët shkrimtarët bizantinë i quanin "*Arbanitai*" e ngjashëm, në të vërtetë janë pasardhës të fisit ilir të *Albanëve*. Kjo ruajtje këmbëngulëse e emrit fisnor, në të njëjtin vendbanim, më parë dëshmon për vazhdimësinë etnike dhe veç kësaj përjashton mundësinë se *Arbanitait* mesjetar kanë ardhur nga diku, sepse është e pabesueshme që ardhësi dhe ardhacakët ta kenë lënë emrin e tyre nacional dhe ta kishin marrë e pranuar emrin e një fisi të huaj të cilin e gjetën në atdheun e ri. Në të vërtetë, pikërisht fakti se në mesjetë është ruajtur emir fisnor i *Albanëve* ilirë për shenjzimin e banorëve të kësaj ane është dokumenti më bindës i vazhdimësisë etnike iliro-shqiptare.

Indicie për rolin e rëndësishëm që *Albanoit* kanë luajtur në mesjetë më shumë se sa në kohërat e vjetra gjejmë në faktin se Kruja një kohë të gjatë ka qenë qendër me rëndësi e Shqipërisë mesjetare. Këtu e ka pasur selinë e vet kryepeshkëvi, i cili është quajtur "EPISCOPUS ALBANENSIS", këtu ka qenë edhe qendra politike e *Albanonit*. Me kalimin e kohës emir *Arbanoi*, *Albanenses* e të ngjashëm, i cili më parë ka shenjzuar banorët e zonës *Arbanon*, që ka qenë shtrirë si duket në Shqipërinë e Mesme, ndërmjet Durrësit dhe Dibrës, do të shtrihet edhe tek pjesëtarët të tjerë të këtij populli, kurse gjuha të cilën ky popull e ka folur do të quhet *gjuha arbëreshe*.

8. Etnologjia, veshjet ilire-xhubleta kambanë

Përveç argumenteve të përmendura gjuhësore dhe arkeologjike, në dobi të

vazhdimësisë iliro-shqiptare, vlen të përmendet se edhe shkencat e tjera, në kohën e fundit kanë identifikuar lidhjet gjenetike ndërmjet ilirëve dhe shqiptarëve. Rezultate të rëndësishme kanë sjellë etnologët, të cilët në kulturën materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve të sotëm zbulojnë elemente të kulturës ilire. Kështu, qysh Franc Nopça, më 1910, pat konstatuar se ca forma të veshjes popullore shqiptare vijnë drejtpërdrejt nga veshja që ka qenë në përdorim në këtë hapësirë nga koha parahistorike. Këtu në rend të parë është fjala për tipin e fustanes së mbledhur në formë të kabanës (zilit), të quajtur *xhubletë*, e cila është pasqyruar në shumë monumente ilire të kohës antike dhe e cila e pandryshuar është ruajtur deri në ditët tona në krahinat kodrinore të Shqipërisë Veriore, mandej në zonat e fisit të Kelmendasve në Kosovë dhe tek shqiptarët në Mal të Zi. Ky tip i veshjes në Ballkan është shumë i lashtë dhe nuk e kanë përdorur vetëm ilirët, por fakti se është ruajtur vetëm tek shqiptarët e vendeve malore dhe vështirë të kalueshme, ku përndryshe janë ruajtur edhe shumë relikte të tjera të kohës parahistorike, është një argument bindës se xhubleta është me prejardhje ilire. Shqiptarët kanë ruajtur edhe një numër shumë të madh elementesh të tjera të veshjes popullore, të cilët në periudhën parahistorike dhe antike kanë qenë pjesë përbërëse e veshjes ilire. Me rëndësi të veçantë është veshja e gjatë, të cilën romakët e quanin “*dalmatica*”. Edhe kjo është ruajtur tek shqiptarët, por edhe tek popujt e tjerë të Ballkanit. Rast i ngjashëm janë edhe opingat, prejardhja e të cilave nga koha parahistorike është e padiskutueshme, mandej mbulesa të llojllojshme të kohës etj. Secili nga këto elemente të veshjes popullore shqiptare veç e veç nuk flet në mënyrë eksplicite për vazhdimësinë iliro-shqiptare, siç është rasti me xhubletën, por të gjitha këto relikte të veshjes popullore ilire së bashku, krijojnë inventarin e veshjes shqiptare, të cilat mbështesin teorinë autoktone të prejardhjes së shqiptarëve. Etnologët na kanë dhënë shumë elemente të tjerë të cilët mbështesin këtë teori. Të përmendim rastin e kalendarit shumë të lashtë, i cili vitin e ndan në tetë periudha kohore me 45 ditë për secilën dhe vitin e niste më 25 prill, d.m.th në fillim të përtrirjes së ciklit biologjik në natyrë. Ky kalendar tërheq rrënjët e veta të thella që nga kohërat e lashta parahistorike dhe antike, sigurisht edhe nga koha parailire, ndërsa është ruajtur i pandryshueshëm tek malësorët e Bjeshkëve të Nemuna, bjeshkë të pashkelura dhe të lashta, që janë si dëshmitar i gjallë i vazhdimësisë antike në këto male, që nga parahistoria e deri në ditët tona të sotme. Më tej, rëndësi të madhe ka fakti se në folklorin bashkëkohor muzikor shqiptar paraqiten disa karakteristika (format polifone në Jug e ato homofone në Veri), që shpjegohen me dallimet e formave muzikore që kanë ekzistuar në këtë hapësirë që në periudhën parahistorike. Këtë dukuri, ndërmjet tjerash, po ashtu e kemi edhe në Bosnjë e Hercegovinë, që konsiderohet relik i kohës së lashtë ilire.

9. Religjioni dhe simbolet e kultit

Shumë të gjalla po ashtu janë reliket ilire në besimet popullore shqiptare lidhur me gjarprin, kafshën e cila në religjionin e lashtë ilir, sidomos në religjionin e besimit të ilirëve jugorë, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm, mandej besimet lidhur me kalin si kafshë autoktonie, etj. Analizat në imtësira të onomastikës popullore, pastaj

e disa riteve të vdekjes, vallëzimit popullor dhe të shumë fshave të tjera të jetës të shqiptarëve na çojnë në burime të largëta ilire dhe nëse nuk është e mundur për secilën nga ngjashmëritë ndërmjet dokeve ilire, shqiptare, besimeve etj. të konstatohet se paraqesin argument për vazhdimësinë iliro-shqiptare, nuk mund të mohohet vlera e atyre ngjashmërive për studimin e kësaj vazhdimësie.

Teza se shqiptarët në periudhën antike ose në mesjetë, në trojet ku sot jetojnë janë të ardhur nga diku dhe se nuk ekziston lidhja etnogjenetike ndërmjet banorëve të lashtë ilirë dhe shqiptarëve, nisët nga supozimi se ilirët janë zhdukur që para ardhjes së shqiptarëve, se ilirët janë zhdukur si popull, d.m.th. janë romanizuar në atë shkallë sa që në periudhën antike kanë humbur gjuhën e vet dhe identitetin e vet nacional. Një hipotezë e këtillë ndërkaq jo vetëm që është e kundërt me faktet prej të cilëve disa i sollëm, por edhe metodologjikisht është e gabuar, sepse pikënisjen e ka në mendimin e papranuar për ekzistimin e shtresave etnike të ndara ashpër, të cilat në atë hapësirë janë zëvendësuar njëra pas tjetrës. Dihet se shtresat e këtilla në histori janë jashtëzakonisht të rralla dhe se rregullisht ardhacakët përzihen me vendasit dhe se nga kjo përzierje lindin krijime etnike, amalgame etnike të cilat herë bartin emrin e ardhacakëve e herë emrin e vendasve. Në Ballkan në kohën e antikës, së vonë, dhe të mesjetës së hershme, popujt sllavë, të cilët nga lindja kishin vërshuar pjesën perëndimore të Siujdhesës Ballkanike, në të cilën kanë jetuar ilirët, vendasit e romanizuar dhe ardhacakët nga Italia e nga vise të tjera të Perandorisë Romake, asimiluan pjesën më të madhe të popullatës vendëse, duke ua imponuar gjuhën dhe kulturën e vet. Në të njëjtën kohë ata nga vendasit pranuan shumë doke, njohuri teknologjike, besime, forma muzikore, veshje, etj. Mirëpo sllavët nuk arritën t'i sllavizojnë menjëherë qytetet e mëdha përgjatë detit si dhe zonat në të cilat sot jetojnë shqiptarët. Këtu, në këto anë, elementi vendës arriti t'i asimilojë atë numër të vogël enklavash sllave dhe të tjera dhe kështu ta ruajë gjuhën dhe identitetin e vet kombëtar. Ky proces i asimilimit nuk është e mundur të konstruktohet, porse rezultatet në të cilat ka rritur shkenca për prejardhjen e shqiptarëve shprishi shumë dyshime të mëparshme dhe shpjegoi shumë paqartësi. Për më tepër, teorive për dyndjen e shqiptarëve në zonat në të cilat sot jetojnë nuk i shkoi për dore as më herët të japin përgjigje gjegjëse në pyetjen të cilën qysh Thunmani e pat shtruar dhe të cilën edhe sot e konsiderojmë shumë të rëndësishme për problemin e etnogjenezës së shqiptarëve. T'i shtojmë këtij argumenti pyetjen: a është e mundur që një dyndje e këtillë të mbetet e pavërejtur dhe e paregjistruar në aktet bizantine e të ngjashme dhe në burimet historike të asaj kohe. Nuk duhet të harrojmë se, sikur këto teori për ardhjen e shqiptarëve të ishin të vërteta, atëherë shqiptarët do të duhej të vendosen në afërsi të Dyrrachiumit dhe të qyteteve të tjera të rëndësishme nën administratën bizantine dhe sigurisht do të duhej ta vërenin ardhjen e tyre, njësoj siç kanë regjistruar dyndjen ose bile edhe vetëm kalimin e popujve të tjerë në kohën e mesjetës. Jo vetëm në burimet historike, por as në traditën popullore të shqiptarëve nuk hasen gjurmë për ndonjë ardhje të tyre në këto anë dhe një gjurmë e këtillë sikur të ekzistonte, do të ruhej në përralla ose këngë dhe të shpjegonte se ka ngjarë një dyndje e këtillë.

10. Përfundim

Gjithë atë që sollëm në këtë shënim, pa dyshim flet për shqiptarët si banorë të lashtë, gjegjësisht si pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve të moçëm. Nga kjo, natyrisht, nuk nënkuptohet se vetëm ilirët morën pjesë në etnogjenezën e shqiptarëve, por ama elementi i vendësve të moçëm ilirë ka qenë ai faktor i cili në atë etnogjenezë ka luajtur rol vendimtar. Por nuk ka fije dyshimi se shqiptarët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve.

*(Ky studim i ilirologut arbëresh Akademik Aleksandër Stipçeviq është botuar në sllovenisht në edicionin "Albanci", në "Cankarjeva založba" Ljubljana, më 1984.)
Përgatiti: Mehmet Latifi, - Për ZSH: Abert Zholi*

LAVDOSH AHMETAJ

MBI SHTETFORMIMIN E HERSHËM ILIR

Aftësia shtetformuese tek ilirët në kohë më të hershme se ajo që trajtohet nga historiografia e lashtë, ose ajo që quhet prehistori, është një çështje kërkimore e vështirë dhe që lëviz në një terren ekuivok. Lënda mbi të cilën mund të mbështetemi për të krijuar ndonjë ide më të qartë, edhe pse afërmendsh jo përfundimtare, mbi realitetin, peshën dhe fuqinë e ilirëve në shtetformim, vjen nga disa drejtime: burimet shkrimore, arkeologjia, numizmatika dhe epigrafia. Gërshetimi i të dhënave që ato japin mbush disa boshllëqe në tablonë e kohës, por në trajtesën tonë mbi shtetin në hershmëri tek ilirët, do të ndalemi kryesisht në burimet shkrimore që kanë lënë autorët antikë grekë dhe latinë.

Në burimet shkrimore të kohës, të cilat për fat të keq nuk zbresin tej shekullit V p.e.s., shihet se ilirët janë protagonistë të fuqishëm në ngjarjet dhe jetën politike të Gadishullit Ballkanik, të detit Adriatik, por dhe të brigjeve lindore të Gadishullit Apenin. Pra, pa hezitim mund t'i vështrojmë si një ndër fuqitë mbizotëruese të kohës në këtë pellg. Por, duhet nënvizuar se këto burime nuk mund të merren në kontekstin e tyre të plotë, pasi në to është evident subjektiviteti dhe njëanshmëria në trajtim, apo deri dhe tendencioziteti i autorëve, siç vëren Taloci: "Autorët e lashtë i përshkruajnë kështu ato fise (ilire), natyrshëm sikurse bëjnë dhe kanë bërë gjithherë kronistët, shkrimtarët dhe misionarët e popujve të qytetëruar kur kanë shkruar mbi një popull që u ka kundërshtuar"¹.

E nga ky këndvështrim i tyre, edhe historiografia e mëvonshme, duke pasur në themel pikërisht këto burime shkrimore të autorëve të lashtë, në përgjithësi i ka paraqitur ilirët si një popull i prapambetur, konservator, pasiv dhe inert krahasimisht me të tjerët, me një organizim politik të nivelit të ulët të shtetformimit, deri në masën e shtetit fisnor. Në rastin më të mirë historia politike e ilirëve është trajtuar si shtojcë e historisë helene apo romake nga pozita të helenocentrizmit dhe romanocentrizmit. Këtë ka parasysh arkeologu dhe historiani anglez Artur Evans kur shkruan se "historianët e Greqisë dhe të Romës theksonin

¹ L. Thallosy: *Illyrisch-albanisch Forschungen*, Mynih dhe Lajpcig 1916.

më tepër anët pirateske dhe barbare të jetës së ilirëve”, duke vënë në dukje më tej se ai “gjente tek ata institucione më të përparuara për kohën”².

Pra, gjatë hulumtimit të kësaj lënde burimore për të zbuluar elementët që shërbejnë për rindërtimin e historisë shtetformuese tek ilirët në hershmëri, duhet bërë kujdes për të mos rënë në kurthin e kësaj fryme, por me vështrim kritik, duke zbritur koeficientin e njëanshmërisë dhe duke i vlerësuar ngjarjet dhe të dhënat nga këndvështrimi tashmë i përkundërt, me metodën e deduksionit dhe krahasimit, të arrihet në një përfundim më të mundshëm realist.

Dhe, në të vërtetë, këto burime vlejné mjaft për të nxjerrë në spikamë aftësinë shtetformuese, rëndësinë dhe fuqinë e njësive shtetërore tek ilirët. Që shteti ilir me institucionet e tij është një realitet i pamohueshëm dhe në periudhën prehistorike, domethënë për kohën kur nuk kemi burime shkrimore (para shekullit V p.e.s.) apo burime që ndërthurin më së shumti legjendën dhe elementin mistik se atë rrëfimtari apo historiografik, del qartë po të qëmtojmë ato pak të dhëna që kujtohen nga autorët e mëvonshëm. Vetë fakti që faktori ilir mbizotërues përmendet nga autorë që kanë shkruar pesë apo më tepër shekuj më vonë, është një dëshmi domethënëse për jehonën që ka lënë protagonizmi i tyre në botën e antikitetit më të vonë. Autorë si Teopompi, Flori, Straboni, Plini, Festi etj., i përmendin liburnët ilirë si një fuqi dominuese në shekujt X-VI p.e.s. Madje jo vetëm në Adriatik, por edhe për inkursionet e tyre në detin Egje, kolonizimin e Korkyrës, si dhe për një kolonizim në anët lindore të gadishullit italik, duke lënë dhe entitete të dalluara atje si Mesapia, Picenia, Daunia, Japigia. Në rastin e fundit theksojmë se nuk bëhet fjalë për dyndje dhe lëvizje fisesh por për kolonizim të mirëfilltë. Me të vërtetë Plini³ nënvizon origjinën ilire të fisit të pedikulëve (duke dhënë dhe qytetet e tyre Rudia, Egnatia dhe Barion)⁴, ndërsa Festi⁵ për atë të peliginëve dhe të daunëve në Apuli, por po Plini shkruan se limani Truentum ishte pikëqëndresë e liburnëve, ndërsa Teopompi shkruan se liburnët themeluan qytetin Adria, e më tej Flori vëren se liburnët shtriheshin nëpër tërë detin Adriatik⁶. Por ngritja e qyteteve nënkupton edhe organizim shtetëror, ndërsa vetë fuqia detare dhe kolonizuese e liburnëve nuk mund të jetë tjetër veçse rrjedhojë e këtij organizimi. Për më tepër janë të shumtë autorët që vënë në dukje talasokracinë ilire (sundimin mbi det), përmes liburnëve më herët dhe ardianëve më vonë me mbretërinë e Agronit, Teutës dhe Gentit. Por talasokraci pa organizim shtetëror nuk mund të ketë. Guljelmo Menis, duke trajtuar ngjarjet e detit Adriatik, shkruan: “...Liburnët që zinin një pjesë të madhe të ishujve, dhe një pjesë të mirë të bregut lindor sa dhe perëndimor...”, dhe më tej “...është e sigurt se kombi liburnik pati një influencë të madhe mbi Adriatik, duke u shtrirë edhe në detin Mesdhe e deri në brigjet e Afrikës. Zotëronin shumë vendngulime përgjatë bregdetit të majtë (të Italisë) nga Ankona deri në Otranto... Në kohën e tyre liburnët ishin populli me marrëdhënie më të shtrira tregtare, tepër

² A. Evans: *Antiquarian researches in Illyricum*, Uestminster, 1883, faqe 43.

³ C. Plinii Secundi: *Historiae Mundi*, Venecia 1844.

⁴ idem, libri III, faqe 373-4: “Nëntë djem dhe po aq vajza duke ardhur këtu prej Ilirisë gjeneruan trembëdhjetë popuj”.

⁵ S. Pompei Festi: “*De verborum significat uquae supersunt...*”, Lajpeig 1913, faqe 248.

⁶ L. Anneo Floro: *La storia romana*, Milano 1823. “*longissime per totum Adriani maris litus effusi*”.

me përvojë më lundrim, që shkonte nga Adriatiku deri në Pont Euzina, dhe nëpër brigjet e Mesdheut deri në ngushticën e Gjiblartarit. Themelimi i Ankonës, sipas disa autorëve, i takon liburnëve; nga këta quhen liburnë disa popuj në Piceni, Liburn një mal në Pulje, qyteti i Livornos në Toskanë; dhe, sipas Polibit, një qytet i Francës në Gaskonjë prej tyre mori gjithashtu emrin Liburna. Vetë deti humbi emrin Pellazgjik dhe u shënuar me atë Liburnik; emërtim, i cili në dëshmi të Ciceronit u shtri edhe në Mesdhe⁷.

Pavarësisht se pohimet e Menisit duken disi të tepruara, qoftë edhe për nocionet e sugjeruara apo të ngulitura deri më tani nga literatura e vonë mbi realitetet në antikitet, mund të themi se elementët e mbledhur nga ai në burimet antike greke e romake qëndrojnë, dhe ekzagjerimi në dukje i përket më tepër mbledhjes dhe vendosjes së tyre në një interpretim dhe këndvështrim të ri. Këto gjurmë të fuqisë së liburnëve ilirë, padyshim të çojnë në rrjedhime logjike që nuk mund të anashkalohen.

Së pari, ata që nga fillimi i mijëvjeçarit të parë para erës së re duhet të kenë pasur një organizim shtetëror efikas, që u bënte të mundur zotërimin e detit Adriatik (Liburnik në kohën e fuqisë së tyre) e më tej, si dhe ngritjen e kolonive në Korkyrë, në pjesën lindore të gadishullit italik, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me pellgun e Mesdheut, duke qenë padyshim ndër fuqitë mbizotëruese të shkallës së parë për kohën kur vepruan. Pa një organizim shtetëror është e pamundur të ngrihet një kapacitet i tillë protagonizmi. Dhe kjo fuqi e kohës do të bjerë në shkallë të dytë vetëm në shekullin V p.e.s., siç shënon A. Stipçeviçi⁸.

Së dyti, mund të deduktohet se organizimi shoqëror tek ata ka qenë me profil demokratik, pasi autorët që përshkruajnë shoqërinë liburne vënë në dukje, edhe pse me habi⁹, rolin e grave në të. Kështu Skilaksi i Kariandës, pasi rendit qytetet e liburnëve, vëren se “ata i nënshtrohen pushtetit të grave”¹⁰, duke shtuar më tej lirshmërinë e marrëdhënieve gjinore tek ata. Apo shënimet e Nikollës së Damaskut, Florit etj.

Së treti, për një traditë shtetformimi të hershme dhe për një organizim shoqëror demokratik flet dhe fakti se në kohën e mbretërimit të Gentit mbi shtetin ilir me kufij tepër të gjerë të trashëguar nga Agroni (kufij që shkonin nga Friuli deri në Himarë), pasi regjimi i këtij mbreti ishte tiranik dhe i padëshirueshëm, siç shënon A. Çikareli, “...popujt e lumit Arsia deri në ato të Ticios apo Karkës krijuan qeverisjen republikane me emrin e lashtë të Liburnisë”¹¹.

Së katërti, autorë të ndryshëm shënojnë qytetet liburne, çka i nxjerr prej sajësës historiografike të organizimit fisnor të tyre, duke i ngritur realisht në nivelin e organizimit shtetëror të mirëfilltë me qendra urbane e tregtare dhe shoqëri qytetare.

⁷ Guglielmo Menis: *Il Mare Adriatico, descritto ed illustrato con notizie topografiche, idrogeologiche, fisiche, etnografiche e storiche*, Zara 1848, faqe 200-202.

⁸ Aleksandër Stipçeviç: *Ilirët, historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*, Toena, Tiranë 2002, faqe 38.

⁹ Tek disa autorë të lashtë habia shkaktohet nga botëkuptimi i ndryshëm mes shoqërive nga vinin dhe atyre që shihnin apo përshkruanin.

¹⁰ Scylacis Cariandensis: *Periplus*, cituar sipas botimit *Ilirët dhe Iliria*, Tiranë 1965, faqe 35.

¹¹ A. Ciccarelli: *Saggio sopra la città di Narona e sopra Repubblica Narentana in Dalmazia*, Zara 1822, faqe 12.

Më tej aftësia e tyre në detari, emri që lanë anijet e tyre dhe tek popujt e tjerë, kontrolli dhe sundimi i gjerë dhe ekskluziv i detit, përsëri nuk mund të mbeten në rangun e organizimit fisnor por flet për një fuqi shtetërore që qëndron në vend të parë krahasimisht me të tjerat fuqi të kohës.

Në këtë hulli, duke qëndruar tek urbanizimi tek ilirët, faktor që shpreh organizim shtetëror, shohim se edhe në njësi të tjera të Ilirisë ky faktor është gjerësisht i pranishëm. Një dëshmi na vjen për qytetin e Naronës, i cili në kohën kur e viziton Skilaksi i Kariandës në shek. VI-V p.e.s. është një Empori, domethënë një qendër tregtare, në portat e së cilës vijnë anijet që lundrojnë nëpër lumin Naronë (Naretva) dhe që shërben si nyje grumbullimi për prodhimet që vijnë nga brendësia e vendit¹². Dhe kjo qendër tregtare është në tokat e manëve, që përfshiheshin tek autariatët e fuqishëm dhe me zë në mesin e mijëvjeçarit të parë para erës së re.

Ndërkohë gjurmë të tjera mund të shihen dhe deduksione të mëtejshme mund të nxirren për entitete shtetërore ilire të shtrira gjerësisht në gadishull, pa u ndalur këtu në shtetin apo mbretërinë ilire të ardianëve që spikat më pas në shekujt V-IV p.e.s. Një nga këto entitete është dhe shteti i enkelejve që e pati lulëzimin në shekujt VIII-VII p.e.s. dhe bie krejtësisht në shekullin IV p.e.s. Shënimet më të vjetra për këtë shtet i përkasin më tepër sferës së mitologjisë se asaj të historisë. Herodoti i përmend enkelejtë si strehuesit e Kadmit të përzënë nga Teba “kadmejtë, të dëbuar nga argasit, u strehuan tek enkelejtë...” dhe më tej si plaçkitësit e tempullit të Delfit: “...kjo thënie e orakullit, të cilin Mardoni kujtonte se ishte për persët, nuk i përkiste atyre, por ilirëve dhe ushtrisë së enkelejve...”¹³. Po ashtu dhe Skimni e Apollodori flasin për enkelejtë në lidhje me Kadmin dhe Harmoninë¹⁴. Ndërsa Pausania shkruan “Kadmi emigroi tek ilirët, tek ata ilirë që quhen enkelej...”¹⁵. Dhe kjo lidhje mes Kadmit fenikas dhe enkelejve të Ilirisë jugore është tregues i marrëdhënieve që ekzistonin mes enkelejve dhe pellgut të Egjeut dhe Lindjes së Afërme, çka është vërtetuar më tej edhe nga arkeologët përmes vlerave kulturore të gjetura. Por shkëmbime të tilla me rajone të Mesdheut lindor dëshmojnë për një organizim shtetëror të rëndësishëm dhe jo për fise.

Një dëshmi e tërthortë tashmë për rënien e shtetit të enkelejve (domethënë edhe për ekzistencën e tij më parë) vjen nga njoftimet për shtetin tjetër ilir të taulantëve, i cili me luftërat e parreshtura ishte dhe një nga shkaqet e rënies përfundimtare të tij. Por shteti i taulantëve hyn tashmë në sferën e periudhës historike dhe për të do të sjellim vetëm faktin se në fund të shekullit VII p.e.s. sundimtari i tyre Gaulari zhvilloi një luftë kundër mbretit maqedon Argeu (659-645 p.e.s.)¹⁶. Më pas ata janë mjaft të përmendur edhe si të përfshirë në incidentin e Epidamnit që shkaktoi luftën e Peloponezitet mes Spartës dhe Athinës në shekullin V, çka e dëshmon qartë dhe Tuqididi në veprën e tij¹⁷.

¹² Po aty, faqe 9.

¹³ Erodoto Alicarnaseo: *Le nove Muse*, v. III, Milano 1820.

¹⁴ *Ilirët dhe Iliria*, Tiranë 1965, faqe 73 dhe 75.

¹⁵ Pausania: *La Grecia*, v. I, Milano 1826.

¹⁶ Polieno: *Gli Stratagemmi*, Milano 1821, faqe 152. Aleksandër Stipçeviq: *Ilirët*, etj. vep. cit., faqe 42.

¹⁷ Tuqididi: *Lufta e Peloponezitet*, Tiranë 1986, faqe 29 e në vijim.

Ndërkohë një entitet tjetër shtetëror gjendet në Ilirinë lindore, tek paionët (peonët), të cilët përmenden që nga Homeri "...Pyraihmi solli paionët harklakuar / larg prej Amidonit, nga Aksi (Vardari) shtratgjere..."¹⁸. Ndërsa Herodoti ndër të tjera shkruan për konfliktin e paionëve me Darin e Persisë: "Paionët, si morën vesh se persët po marshonin kundër tyre, u përgatitën që t'i zbrapsnin... Paionët kur mësuan se qytetet e tyre ishin në duart e armikut u shpërndanë..."¹⁹. Por Justini flet për një histori më të largët të mbretërve të Paionisë: "Në Paioni, që tashmë është pjesë e Maqedonisë, thonë se ka sunduar Telegoni (Pelagoni), i ati i Asteropeut, emri i të cilit ka arritur deri tek ne midis emrave të mbrojtësve më të lavdishëm të qytetit [Trojë] në kohën e luftës trojane. Në anën tjetër, në Europë, ishte mbret Europi..."²⁰. Pra, një entitet që gjendet që në kohën e Trojës, një fuqi që përballet me Persinë e madhe, që ka një mori qytetesh e fortesash, nuk mund të shihet si një organizim i papërfillshëm fisnor por si një organizim i mirëfilltë shtetëror me mjaft peshë. Është trajtuar mjaft për paionët se në shekujt e fundit të mijëvjeçarit të parë para erës së re ata u helenizuan dhe nuk shiheshin më si ilirë, ashtu siç do të vështrohen nga historiografia moderne dhe maqedonët e kohës së Aleksandrit, por ky nuk është objekt i këtij shqyrtimi, kështu që edhe këtë entitet do ta shohim në kuadrin e aftësive shtetformuese tek ilirët. Dhe duke parë dëshmitë, edhe pse të pakta, mund të nxirret si rrjedhojë se paionët, ashtu si liburnët, taulantët e enkelejtë, përbëjnë entitetet shtetërore parake të ilirëve në gadishull, duke qenë faktor i rëndësishëm krahasimisht me të tjerat fuqi të kohës së parahistorisë.

Në këtë shqyrtim nuk u ndalëm në gjurmët e shtetformimit tek dardanët, edhe pse ata përmenden mjaft herët në Luftën e Trojës, apo sipas A. Severyns në *La Grecia...*: "...mbas shkatërrimit të Trojës, dardanët i gjejmë edhe si pjesëmarrës në betejën e famshme në Kadesh, në vitin 1286 p.e.s., në anën e hetitëve, kundër faraonit egjiptian Ramses II". Ashtu siç nuk morëm në shqyrtim hershmërinë e institucioneve shtetërore në Epir, që do të përbëjë lëndën e një trajtесе tjetër.

Ajo çka mund të themi si përfundim është se duke hulumtuar në burimet shkrimore të autorëve antikë grekë e romakë, duke mbledhur të dhëna sporadike apo edhe të tërthorta, e duke i përpunuar në mënyrë analitike e kritike, nën një interpretim të ri, del si rrjedhojë se ilirët patën që në hershmëri, shumë shekuj para shtetit ilir të ardianëve në shek. IV p.e.s e në vijim, organizime shtetërore të fuqishme që u ngritën deri në lartësinë e fuqive të shkallës së parë në kohën e tyre. Aftësia shtetformuese tek ata, së paku qysh në shekujt e parë të mijëvjeçarit në fjalë, zhvlerëson interpretimet e shpeshta që kanë krijuar një profil inferioriteti të tyre në krahasim me popuj të tjerë përqark, duke dhënë shtysën për një studim edhe më të thelluar të këtij aspekti të rëndësishëm në historinë e përgjithshme të ilirëve. Në përmbyllje dhe si përfundim të kësaj që thamë më lart, po sjellim pohimin e Polibit për vjetërsinë dhe madhësinë e ilirëve, në librin e dytë të tij kur flet për luftën e ilirëve në Etoli: "...Ilirët shtinë në dorë të gjitha armët dhe plaçkat e etolëve. Ngadhënjimi i armëve të dëgjuaara ilire ishte i plotë... u kthyen në Shkodër, në

¹⁸ *Ilirët dhe Iliria*: vep. cit., faqe 9.

¹⁹ Erodoti: vep. cit. v. III.

²⁰ Giustino: *Storie Filipiche*, libri VII, Venecia 1836.

kryeqytetin e famshëm të ilirëve, ku kurora mbretërore kishte qenë e trashëguar brez pas brezi që në kohëra që nuk mbahen mend prej njerëzve, e as kujtohen prej historisë. Aq e vjetër kishte qenë mbretëria ilire dhe kryeqyteti i saj Shkodra...”.

QEMAL MURATI

**ALBANËSIA E “PROVINCAVE ONOMASTIKE”
NË AREALIN E MAQEDONISË – DËSHMI E
AUTOKTONISË SË SHQIPTARËVE NË KËTO
VISE QË NGA PERIODA ANTIKE E DERI SOT**

Abstrakt. Në këtë punim autori rimerr çështjen e dëshmimit dhe përhapjes gjeografike të emrit të vjetër të shqiptarëve, Arbën/Arbër dhe sjell një dëshmi shtesë për praninë e këtij emërtimi në trajtën Albano e Albanop(ol) në shekujt 3, 4 të erës sonë, në trojet e Maqedonisë së sotme (në lokalitetin antik Stobi dhe në Solnjën e Epërme të Shkupit), duke krijuar kështu një stacion të ndërmjetëm mes dëshmimit të këtij emërtimi te Ptolemeu (shekulli i dytë) dhe atij të mëvonshmit, të njohurit, te Ataliati e Komnena (shekulli i njëmbëdhjetë), i cili i heq njëkohësisht një gur të rëndësishëm dyshimit rreth kësaj mospërmendjeje të gjatë. Nga ana tjetër krahas formave të vjetra Arban / Alban, në fondin toponomastik historik apo të sotëm të Maqedonisë së sotme autori gjen edhe një varg emërtime, që përmbajnë emrin e shqiptarëve dhe që dalin me trajta të vjetra si ato sllavojugore Arbanas, Arbanaško, Arbasanci, Raban, greke Arvat, apo arumune Arbinesh, Arbinovë, çka flet për një shtrirje të lashtë e të gjerë të shqiptarëve në këto vise.

Alban, Arbën, Arbër “shqiptar”, Albani, Arbëni, Arbëri (emri i vjetruar) i vendit “Shqipëri”. Në trajtimin e përimtuar etimologjik që i bën këtij etnonimi, E. Çabej (1986: 61), për punën e burimit të fjalës, nga dy trajtat e saj *alb-* e *arb-* pranon që trajta e mirëfilltë e emrit ka qenë me *arb-*. Pas këtij dijetari, *arbën* nuk mund të jetë latino-roman (se do të ishte *alb-*), as grek (se do të ishte *arv*), as sllav (do të ishte *rab-*) dhe, si përfundim, pranon një burim vendi të emrit *arb-ën(ë)*, nga një më e lashtë **arb-an*, e afrueshme me lat. *arvum*, me kuptimin e parë “arë, fushë, rrafshinë”.

Emri në shqyrtim, po të vështrohet pa e komplikuar me krahasime të shumta e të gabuara, mbase mund të rrjedhë nga emri i një fisi kryesor *Albët*, për të cilin mësojmë nga Ptolemeu se në shek. II pas Krishtit jetonin rreth qytetit *Albanopoli*,

Krujës së mëvonshme. Ky emër u shtri në tërë popullatën që nga shekulli XI, latinisht *Arbanases* ose *Albaneses* (*Αλβανοί, Αρβανταί*), nga ka rrjedhur forma sllave *Arbanasi* (Jireček 2010: 183). Emri i këtij fisi të vjetër, me ndërmjetësinë e popullsisë vllehe, shumë e pranishme në këto zona, dha *Arban*, përmes transformimit të *-l-së* në *-r-* (fenomen i përgjithshëm në rumanisht, i kufizuar tek elementi i trashëguar dhe substrati, Brânkuş 2009: 167), khs. si tek arum. *arbă e rajă* – shq. *bardhë e zi*. Me këtë formë ky emër hyri dhe te sllavët në periodën e mesjetës *Rabanija*, që me metatezën e njohur të likuidave dha dhe *Rabanija*. Vetë rrënja e këtij emri *Alb* e *Alban* ka dalë nga lat. *albus* “i bardhë”, formuar si opozit ndaj adjektivit “i zi”, khs. si tek emri *Monte Negro* (Mali i Zi), që ndodhet në prapashpinën e Albanëve (Shqipëri), pastaj tek emrat e lumenjve *Drini i Bardhë/Drini i Zi*. Ballkanologu i njohur R. Solta shprehet se nuk duhet përshtatur mundësia që emri *Alban* ta kenë burimin te ndonjë gjuhë më e lashtë, që flitej në trevat ballkanike para ardhjes së ilirëve, trakasve. Emri i tillë *Alban, Arbën, Arbër* në fillim ishte emër i një krahine, rrethi i Durrësit. Ana Komnena, historiane bizantine, *Arbën-in* e shekullit XI e përshkruan të shtrirë nga Durrësi në Dibër. Serbët, në shek. XII, në *Arbëni* (*Arbanija*) përfshinë edhe krahinën e Matit. Në shek. XII-XV burimet e Raguzës i zgjerojnë kufijtë e *Arbën-it* tej Podgoricës, Kotorrit e Tivarit (Th. Ippen, *Contribution a l’Albanie du XII au XV siecle*). Të kihet parasysh këtu dhe topiku *Mons Albanus* për Malin Sharr (Scardus Mons), (Krivokapić 1969: 16-18). Si përfundim, del që ky emër nuk ishte gjithëpërfshirës deri në shek. XV për shqiptarët e sotëm, prandaj më vonë, në periodën e sundimit turk, lindi emri përgjithësues *Shqiptar*, si duket po ashtu nga një emër familjeje *Scipudar*, kur u krijua dhe ndjesia për një jetë të përbashkët të këtij populli.

Nga emërtimi më i hershëm i vendbanimit të shqiptarëve *Arban / Alban*, që i është shtuar prapashtesa karakteristike *-an*, me të cilën formoheshin emrat e banorëve të një vendi në gjuhën e huaj përkatëse, dolën trajtat latine *arban-ens-is*, greqisht *arvan-it-is*, sllavisht *arban-as* apo *Raban* dhe *rabënëski*, trajta turke *arnaut*, italisht *alban-ese*, frëngjisht *alban-ais*, anglisht *Alban-ian*, etj. (Demiraj 1998).

Emrin *Alban, Arban* e ndeshim posaçërisht të përhapur në arealin gjeografik të Maqedonisë, në trajta të vjetra latine, sllave e turke dhe në përdorime të ndryshme antroponimike (emra personalë), patronimike (emra familjesh), ojkonimike (emra vendbanimesh) e toponimike (emra vendesh), kronologjikisht në lakun e një kohe rreth 2000 vjeçare, pra që nga antika e deri më sot.

II. “Provinca onomastike” Arbanase në truallin gjeografik të Maqedonisë

Në kohë të vjetra antike e gjatë gjithë mesjetës areali i Maqedonisë së sotme banohej nga fise e popuj të ndryshëm, midis të cilëve dhe nga elementi i ndjeshëm i fisit ilir *Alban, Arbanas*, paraardhësit e shqiptarëve të sotëm. Për këtë flasin disa mbishkrime mbivarrore të zbuluara në një nekropol të Sollnjes së Epërme të Shkupit të shek. II, dhe në lokalitetin e madh arkeologjik Stobi (shek. III-IV), si dhe “provinca onomastike” (term i E. Çabejt) me emrin *Arbanas* në gjithë hapësirën gjeografike të Maqedonisë.

Të sjellim tani dëshmitë onomastike nga pikëpamja kronologjike.

Emra vetjakë me bazën Albanop(oli), Albano

1. Albanop(oli) – emër në gjuhën latine, i gdhendur në një stelë të shekullit II, gjetur në vitin 1930 në Gorno Solnje nga Nikola Vuliç (Sollnja e Epërme), fshat i cili ndodhet në jugperëndim të Shkupit (në anën e pasme të lagjes Vodno dhe fshatit Nerez).

Teksti origjinal i mbishkrimit duket kështu:

*POSIMES
TYLVF. FL.
DELUS MV
ALBANOP
IPSADELVS*

*Posis Mes/tylu f Fl/ Delus Mu/cati f
Dom/ Albanop/ ipsa Delus/ /---/*

Këtë mbishkrim Borka Dragojeviç - Josifovska (Josifovska 1971: 516) e ka lexuar:

*Posis Mes
tylu f(i)lius) Fl(avis)
Delus Mu/cati(i)lia)
dom(o)/ Albanop(oli)
Ipsa Delus*

(*Posis Mestylu/ i biri i Flavia (dhe) Dela, e bija e Mukatit nga vendbanimi i Albanopolit*) (Idrizi 2003: 20; Pollozhani 2012). Te trajta *ALBANOP*, ne shohim një emër vetjak homonim *Albanop(ol)*, rrjedhur nga rrënja *Alban* dhe sufiksi – *(o)pol*, ngjashëm sikurse dhe tek *Moskopol (Voskopojë)*, *Xhinxhopol* (fshat me popullsi toske, Manastir) *Trepol (Tropojë)*, etj. E kësaj provenience mbase do të jetë dhe *Albanopoli* që shënon gjeografi i kohës antike Klaud Ptolemej në hartën e tij në shek. II pas Krishtit, në tokën e Albanëve (*Albanoi*), afër Zgërdheshit të sotëm në Krujë.

2. Flavij Albano, Emilijan Albanos

Antroponime të tilla të karakterit epigrafik, të tipit *Albano*, hasim dhe në kompleksin e qytetit antik Stobi të Maqedonisë qendrore, në nekropolin e quajtur *Suburbium*, në një varrezë të identifikuar si *Varri i shkruesit nga Stobi* (Macedoniae 1996), të determinuar kronologjikisht ndërmjet shek. III-IV të kohës sonë, ku në pllakën mbivarrore gjendet i skalitur me shkrim grek ky mbishkrim përkujtimor:

ΦΛ(ΑΒΙΩ) ΑΛΒΑΝΩ ΤΩ Τ(Ε)ΚΝΩ

A ΜΙΑΙΑΝΟΣ ΑΛΒΑΝΟ(Σ) ΜΝΗΜ(Η)Σ ΝΑΕ

(*Na svoeto dete Flavij Albano, Emilijan Albanos za spomen – Flavio Albano, të birit Emilianos Albanos për përkujtim*) (Dimitrovska 1976).

Pas përmendjes më të parë të fisit *Albanoi* te Ptolemeu në sh. II, në hartën e tij të botës, emrit *Albanop(oli)* në Sollnje të Epërme afër Shkupit (shek. II), kjo është një dëshmia tjetër e rëndësishme e shfaqjes së emrit *Albano(s)* një a dy shekuj më pas në zbrazëtirën e “heshtjes” së albanëve, përkatësisht shqiptarëve prej 8 shekujsh, që është marrë nga shumëkush kjo mospërmendje, e sidomos nga autorët sllavë, si dëshmi kundër autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre etnike të sotme dhe historike. Shfaqja e emrit personal *Albano* në Stobi për më tepër dëshmon edhe këtë fakt, se elementi *Alban* nuk është shtrirë vetëm në një enklavë të ngushtë afër Krujës, por arrinte deri dhe te Stobi në Maqedoninë qendrore. Elementi *Alban* në fillim do të jetë përdorur si emër vetjak, pastaj dha emrin e fisit *Albanoi*, e më pas dhe atë etnik *Albanët* (për shqiptarët e sotëm).

3. Арванъ-a nom. propr. loci. Stanislav prolog, v. 1330 Kratovska škola Vataški minej, 1453, Zapadna Makedonija (*Rečnik na crkovnoslovenskiot jazik od Makedonska redakcija I*, Institut za makedonski jazik “Krstе Misirkov”, Skopje, 2006: 293). Nga *Arban*, me ndërndërrim të grupit konsonantik *rb-rv* me ndërnmjetësi të greqishtes, khs. si te topiku *Arvati* (Prespë).

III. Nekropole (varreza të kohëve të vjetra) Arbanase

4. Arbanovci – nekropol (varrezë) në Banjishte të Dibrës (Murati 1999).

5. Arbasinovec – tumë e kohës së hekurit (Biljanik, Manastir), që ruan emrin etnik *Arbanas* (Murati 1999: 36).

IV. Emra vendbanimesh

6. Arbanashko (maq. *Arbanaško*) – vendbanim në verilindje të rajonit të komunës Staro Nagoriçane, përkatësisht në rrethinën “Kozjaça”, prej nga popullata e shumë fshatrave është shpërngulur, kryesisht, në Kumanovë. Fshati është i shkapërderdhur dhe ka karakter kodrinor-malor, lagjet e të cilit ndodhen në një lartësi prej 770-920 metrash të lartësisë mbidetare. Ky vendbanim ndodhet 14 km larg rrugës Kumanovë-Kriva Palanka, kurse nga Kumanova 34 km. Sipas të dhënave që jep Mitko Panov (Panov 1998: 12), ky territor përfshin një sipërfaqe prej 8,3 km katrorë, me tokë të punueshme 397,1 hektarë, me kullosa 206,1 hektarë, dhe me pyje 203,7 hektarë. Vendbanimi është i vogël, në vitin 1961 ka pasur 263 banorë, kurse në vitin 1994 ky numër është zvogëluar në 63 banorë, nga të cilët 58 maqedonas, kurse katër serbë. Në *Arbanashko* ka pasur dhe një kishë të vjetër, tanimë e rrënuar.

Siç e tregon dhe vetë emri i këtij lokaliteti, topiku *Arbanashko* i ruajtur në gojën e popullsisë sllave me trajtën e vjetër fonetike të sllavishtes *Arbanaš* dhe sufiksit *-ko* që nga kohërat e vjetra e deri më tani (përkundrejt trajtës së sotme *Albanec*), dëshmon për një vendbanim të vjetër a territor të gjerë i cili dikur banohej nga popullsi arbanase, përkatësisht shqiptare, kurse tani ka mbetur pa asnjë banor shqiptar. Ky përbën edhe një fakt tjetër me interes se trojet shqiptare historikisht janë shtrirë edhe më hapët gjeografisë së Maqedonisë qendrore e lindore, kurse më vonë kanë pësuar restriksion, e jo ekspansion.

7. Arbanaško – fshat i vjetër i zhdukur në kodrën e Pavleshencit të Bregallnicës. Rrjedhur nga *Arbanaš* (1468: Bogdan, i biri i Arbanash-it TD II 162; 1467-68: Bozidar Arbanaš TD I 528) (Ivanova 1996: 14).

8. Arbasanci (maq. *Arbasanci*) – fshat në lindje të komunës Sveti Nikole, që kufizohet me komunën e Probishtipit. Ka karakter kodrinor, me lartësi 490 metra mbi nivelin e detit. Ky vendbanim ndodhet më se 15 kilometra larg nga qendra e Sveti Nikoles, dhe ka kushte të mira për punë blegtorie. Ky vendbanim i vogël në vitin 1961 ka pasur 163 banorë, kurse në vitin 1994 vetëm katër banorë, të përkatësisë maqedonase (Panov 1998: 13). Në regjistrat turq të shek. XVI del si *Arbasanci Gorno* (me 93 familjarë të krishterë) dhe *Arbasanci Dolno* (me 60 familjarë të krishterë), sigurisht *arbanas* (shqiptarë, Murati 1999, 35). Forma *Arbasanci* – nga **Arbanasci*, kjo e dalë nga 1. emri i vendit *Arbanasi* 2. emër vetjak ose ofiç *Arbanas* (sipas *Arbanasa*) (Ivanova 1996: 14).

Në vijimësi të vendbanimeve të hershme historike *Arbanase* (shqiptare), në Maqedoninë verilindore e qendrore, ky emër *Arbasanci* i këtij vendbanimi paraqet një kontinuitet të lokalitetit tjetër *Arbanashko*, dëshmi e shtrirjes më të gjerë të elementit Arbanas në këto tërthore gjeografike, nga të cilat sot kanë mbetur vetëm relikte toponomastike.

9. Arbinovë (maq. *Arbinivo*) – vendbanim në pjesën veriore të ish- komunës së Ohrit, përkatësisht lokalizuar në pjesën qendrore të rajonit të njohur “Debarca”, që i takon komunës Belçishta, sot i banuar me popullsi maqedonase. Fshati ka karakter kodrinor, me lartësi mbidetare 880 metra. Ndodhet larg qytetit të Ohrit 34 km. Në vitin 1961 ka pasur 311 banorë, kurse më 1994 vetëm 32 banorë, të etnikumit maqedonas (Panov 1998: 13).

Për herë të parë dokumentohet në *Defterin e regjistrimit turk Nr. 25* për Sanxhakun e Ohrit më 1589 me format *H`rbino* e *Harbino*, me një *h* sekundare.

Emri i këtij topiku, që dëshmohej në *Defterin e regjistrimit turk Nr. 25* për Sanxhakun e Ohrit më 1589 me format *H`rbino* e *Harbino*, me një *h* sekondare. Emri i këtij topiku lidhet me bazën etnike *Arbin*, formuar me ndërmjetësi të arumanishtes *Arban* me ndërndërrimin fonetik të kësaj gjuhe *a:i* dhe sufiksit sllav – *ovë* (*-ovo*), siç e ka shtjelluar drejt dhe Petar Hr. Ilievski (BLS 482), e jo me fitonimin *vrba* (salix), siç janë shprehur J. Zaimov (*Zaselvane na blgarskite slavjane*, Sofija, 1967, 185) dhe V. Pjanka (TOPB 90). Ndërkaq, trajta vlllehe *Arbin* shënon banorët e këtij lokaliteti, dikur të përkatësisë etnike shqiptare (arbane),

sikundër dhe vetë topiku *Arbinovë* e jo, “banorin e shpërngulur nga Shqipëria pavarësisht prej përkatësisë së tij të vërtetë etnike”, sikundër gjykon kështu jo drejt Petar Hr. Ilievski (Ilievski 1988: 484).

Të shënojmë këtu që *Arbino* del dhe si emër fshati në Nahijen e Follorinës, që rrjedh po ashtu nga emri etnik shqiptar *Arban/Arbin* sikundër dhe emri i fshatit të mësipërm *Arbinovë* i rrethit të Ohrit dhe *Albince* në Jakupicë të Maqedonisë qendrore. Khs. këtu dhe emrin vetjak *Arbina* që del të përmendet 4 herë në fshatin *Alagin* të Follorinës /NF TD II 365/. (TD II 432).

Në fushën e onomastikës të truallit të Maqedonisë dalin të ruhen gjurmë të vjetra shqiptare që përshfaqen me fonetikën e arumanishtes. Këtu mund të sjellim disa emra lagjesh e topikësh që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ruajtjen e elementit shqiptar në arumanishten.

10. *Albince* – katund baritor në Jakupicë (Cvijić 1906: 138), ku del të ruhet trajta vllahe *Albin* e etnonimit shqiptar *Alban*, me shndërndërrimin e njohur fonetik *a-i*. T. Stamoski te ky topik paravendon me pa të drejtë trajtën *Aldinci*, duke e marrë të parën *Albince* si “gabim të regjistruarit ose si gabim shtypi” (MO 198)! Qëllimi i këtij shpjegimi është i qartë, që të “fshihen” gjurmët shqiptare në territorin e Maqedonisë me sa të jetë e mundur dhe me të gjitha mjetet.

11. *Arvati* (maq. *Arvati*) – fshat në pjesën lindore të Prespës së Epërme, afër Kranjit. Në burimet e literaturës e hasim me format *Hërvat* në dokumentat turke (*Hërvat* – Timar Dimitri Prespe Hërvate Asagi, më 1431). *Harvati* në Kodikun e Slepçenit (shek. XVI – XVII). *Hrvati* (*rvati*) të Kënçovi etj., me një *h* sekundare, khs. si te *Hrbino*, *Harbino* për *Arbinovë*, mbi bazën e të cilave V. Pjanka (TOPB 131) ka ndërtuar një etimologji të gabuar duke e lidhur emrin e këtij topiku me etnikun *Hrvati* (“nacija” (popull)).

E vërteta këtu qëndron krejt ndryshe, që te emri i këtij fshati, i zonës kufitare me Greqinë, në thelb ruhet trajta bizantine (greke) *Arv* e *Arb-*, me ndërndërrimin e njohur *rb:rv* përmes greqishtes, khs. si dhe te *Arbanon* – greq. *Arvanon*, *Albanese* – greq. *Arvanitis* (për vendin dhe emrin e shqiptarëve), dhe sufiksi i shqipes *-at*, i shpeshtë në emra vendesh (qytetesh, fshatrash e lagjesh), khs. si te *Bularat*, *Dukat*, *Dunavat*, *Filat*, *Lazarat* etj. (Çabej SGJ III 210), dhe jo etniku fantom *Hrvati*, siç është shprehur onomasticieni polak Vlodjimjezh Pjanka, sepse këtu as nuk ka pasur dhe as nuk ka kroatë, por ka pasur dhe ka shqiptarë, përkatësisht arbanë/ arvanitas, siç quhen në gojën e grekëve.

Mbi këtë bazë dhe *Arvince* (TD V 431) - fshat i paubikuar në Sanxhakun e Questendilit, rrjedhur a formuar nga baza etnike shqiptare *Zaravinca*, *Radovnica*, sikundër është shprehur A. Stojanovski.

Një emër tjetër fshati formuar mbi bazën e emrit etnik të shqiptarëve duket të jetë edhe *Ranutovë* në verilindje të Vranjës (TD V 335), një formim metatetik nga *Arnutovë*, ky nga *Arnaut* “shqiptar”.

12. *Arbişiea* – vendbanim shqiptar në rrethinat e Shtipit, tanimë i zhdukur, që del të përmendet në tregimet popullore vllehe:

Cât ea hoara ș' pulitiea

Cât ea hoara ș' pulitiea

Si cu tuta *Arbișiea*

(U selo imalo,

u selo imalo,

Kolku seloto bilo ubavo, tolku bilo i lošo,

Seloto ubavo, ne e samo selo bilo,

Ovaj Albansko selo, Arbašija. Albansko selo...)

(Përrallën në formë vargësh e tregoi në gjuhën vllehe dhe maqedonase Atanas Ristov Taškov, i lindur më 1908 në fsh. Urarci, Kočevsko. Ka jetuar në Star Karaorman, Shtipsko. Me përkatësi etnike vllahe, me profesion qiraxhi; Popvasileve 1987: 128-129).

13. Labino – lokalitet me rrënoja arkeologjike të kohës së bronzit dhe të mesjetës së hershme, që shtrihet në jugperëndim të kështjellës së Samoilit në Ohër. Tek emri i këtij lokaliteti gjejmë të zhvilluar metatezën sllave të likuidave *al/la: *Albino:Labino* (Murati 1999: 37).

14. Llabunishtë (maq. *Llabuništa*) – fshati më i madh i Anadrinit (Strugë), që del të përmendet me të njëjtin emër qysh në shek. XVI në Kodikun e Slepçenit (Pjanka 1970: 63). Rrënja *Llabun* – e këtij topiku, siç ka vënë re me të drejtë V. Pjanka, është vazhdim i asaj *Alban* – me metatezën e njohur sllave të likuidave khs. *al: la/ ar:ra/* dhe të zëvendësimit të fundores *-an-në -un-* tek popullsia arumune e këtyre viseve.

15. Arnaçi/ Ornaçi (maq. *Arnačija*) - fshat në juglindje të Dervenit, rreth 10 km larg Shkupit. Shqiptarët e vendit i thonë *Ornaçi*, me labializim të *a-së* në *o*. Emër i dalë nga *Arnaut Koj*, sipas modelit turk, një term terreni me të cilin shënjohej “vendi i Arnautëve” (Skok 1978: 82). Khs. këtu dhe *Arnaut-Koj* lokalitet shqiptar në Bullgari, si dhe vendbanimet në zonën e jugut të Edernesë, që ishin fshatra shqiptare, dhe grekët i quanin *Arnautqoi*, që do të thotë “fshatra shqiptare”.

V. Emra lagjesh

16. Arbinesh – lagje në Krushevë të Maqedonisë (*Məhələ dila Arbineshi/ ose Arbişesku Məhələ* (Goļab 1984, 20), tani e vllahizuar. Ruan trajtën arumune *Arbin* prej *Arban* me zhvillimin fonetik të rregullt *a:i* (Murati 1999: 41).

17. Arbun (TD VI II (1568-69), 365) – lagje në fshatin Vrapçisht të Gostivarit, që ruan emrin etnik *Arbun* nga një emër vetjak *Arban*, i shpeshtë në periodën e mesjetës, me ndërmjetësi të ligjeve fonetike të arumanishtes *a:u* (Murati 1999: 41). Te topikët e mësipërm *Arbin e Arbun* shihet të ruhen trajtat fonetike të arumanishtes *-in/ -un* të emrit etnik *Arban*.

18. Arnavad (TD 198) – lagje shqiptare në qytetin e Kërçovës, e njohur a e cilësuar në shek. XV si *Mahalla Arnavad*, që përbëhej nga një numër i konsiderueshmë kryefamiljarësh shqiptarësh të krishterë, si *Shagman, Martin, Gjon, Gjergj, Gjin, Arnaut, Kolo, Progon, Projko, Lesko* etj. Si e këtillë kjo njihej dhe si njëra nga

lagjet kryesore të këtij qyteti bashkë dhe me mëhallën tjetër të cilësuar si serbe, por në fakt edhe kjo e dyta e përbërë nga persona që mbajnë emra shqiptarë si *Blakor*, *Caparnik*, *Gjin*, *Progon*, *Ragan*, etj.

Emërtime të tjera mikrotoponimike

VI. Në truallin e Maqedonisë hasim një mori topikësh nga të periodës paraturke me cilësimin *Arbanasi*, *Arbanaš*, nga vetë popullsitë sllave dhe arumune, për shqiptarët që ishin këtu, një dëshmi edhe kjo se ku ishin shqiptarët kur erdhën sllavët në këto lakadredha gjeografike.

19. Arbina – vis në Podbregje të Tetovës (Trifunoski 1976: 44).

20. Arbino – ngulim i zhdukur i antikës së vonë në fshatin Raotincë të Tetovës, ku janë gjetur themele, objekte, fragmente të enëve të qeramikës (AKRM II 424; Petruševski 1999: 11; Murati 1999: 44).

21. Arbino – lokalitet arkeologjik në fshatin Kopancë të rrethit të Tetovës, i periodës romake, në të cilin janë zbuluar fragmente të enëve të qeramikës, tjegulla dhe materiale ndërtimore (AKRM II 420; Murati 1999: 44).

22. Arbajnica – lokalite në Izdeglavje të Ohrit. Nga **Arbanasica*, *Arbanas* “shqiptar” dhe suf. *-ica* (Stankovska 2001: 21).

23. Arbanasi – katund i zhdukur në fshatin Atishtë të Kërçovës, i banuar tani me popullsi sllavomaqedonase (Murati 1999: 37).

24. Arbanasi – nuk ka një identifikim dhe lokalizim të këtij toponimi. Përmendet vetëm në krisobulën e parë dhe të tretë të Mbretit Stefan Dushan (1334, 1337), me të cilat ky ia dhuronte këtë Manastirit Treskavec që ndodhej në veri të Prilepit. Në bazë të atyre krisobulave mund të pohohet se vendbanimi *Arbanasi* gjendej ndërmjet fshatrave Drenovci e Dupjaçani. Toponimi *Arbanasi* nuk regjistrohet në defterët osmanë të shek. XV-XVI (Axhievski 1999: 191).

25. Arbanasinovec – lokalitet i kohës së hekurit në fsh. Badovenci të Manastirit (Murati 1999: 35).

26. Arbanasa – ara, kodër (Dellçevë). 2. Kopshte, ara në fsh. Kosovo Dabje. Nga Arbanas “Albanec, Arnaut” – gr. *arvanos*, *alvanos* “Albanec” (1467-68: *Arbanas, sin na Petko* TD I 258; *Nikola Arbanas* TD III 40 (Ivanova 1996: 14).

27. Arbanašnica – ara në Matkë të Shkupit.

28. Arbanašica – ara (Nerz, Shkup). Nga një paraformë **Arbanaštica* – *Arbanasštica* **Arbanaška* (Niva), këto nga etn. *Arbanas* “shqiptar” (Stankovska 2001: 21).
29. Arbanaš – vendbanim i zhdukur në nahijen e Shtipit në shek. XVI. Ky lokalitet i vjetër sot quhet Zhidjanci (SHBI 34).
30. Arbanaški – vendbanim i zhdukur në Manastir-Dolencë të Kërçovës, tek i cili ruhen gjurmë të vjetra arkeologjike (Murati 1999: 35).
31. Arbanaško – vendbanim i zhdukur (Sveti Nikole), që ruan emrin etnik *Arbanas* / *Arbanash*.
32. Arbanaško – vendbanim i vjetër i zhdukur në kodrën Pavleshenci (Ivanova 1996).
33. Arbasanska Meša – vend në kufi me fshatin Arbasanci (Ivanova 1996: 14).
34. Arbasanski Lojza – vresht në sinorin e fsh. *Arbasanci* (Ivanova 1996).
35. Rabini Grobishta – te popullsia torbeshe e fshatit Papradnik të Dibrës, nga *Varret e Arbinve* (shqiptarëve).
36. Raban – kullosë në Rusinovo të Bregallnicës. Ky topik duhet të përmbajë emrin vetjak *Arban*, mjaft i shpeshtë në këto hapësira në periodën e mesjetës, që me metatezën e njohur të likuidave sllave dha *Raban*, në rastin konkret me kuptimin “*kullosa e Rabanit/ Arbanit*”, dhe jo siç shprehet Olga Ivanova (Ivanova 1996: 528) të ketë dalë nga një emër vetjak i supozuar prej saj **Rabanjb*, ky nga *Raban*, *Rab(e)+an*, e *rab* “rob, shërbëtor”.
37. Rabanov Dol – luginë e thatë në rajonin e Kamenicës në Bregallnicë (Ivanova 1996: 528). Edhe ky topik në fakt duhet shpjeguar si më sipër, formim metatetik nga **Arbanov Dol* – lugina e Arbanit.

Shënim 1. Me epitelin (atributin) *Arbanas* në mesjetë administrata sllave shënjonte një kategori sociale të barinjve, blegtorin, jo një kategori etnike, që si të tillë ua jepte personave në funksion të nofkës: *Petre, Arbanas, Nikolla Arbanash, Gon Arbanas*. Atributin *Arbanas* në kuptimin e “bariut” nuk ia vunë vetes vetë shqiptarët, por ardhësit, përkatësisht pushtuesit sllavë. Emri *Arbën* u mor nga serbët në fillim si emër etnik, e më pas mori dhe funksionin e sinonimit për “bariun” (Gashi 2007: 324).

Shënim 2. Te topikët e marrë në vështrim që përmbajnë emrin e vjetër të shqiptarëve, kronologjikisht mund të bëjmë një hierarkizim të kështillë:

a) Në fondin onomastik historik apo të sotëm të Maqedonisë së sotme ndeshim antroponime me forma të vjetra latine: *Albanop(oli)*, *Albano*, *Albanos*, *Arban*, që në shek. III-IV të erës sonë.

b) Format sllave *Rabънь/Labънь* dëshmojnë për metatezën e likuidave, një dukuri fonetike e gjuhës së përbashkët parasllave, që te sllavët e ardhur në Gadishullin e Ballkanit ka qenë e gjallë deri para shek. 10-të (Belić 1972: 96). Ndërsa emërtimi *Arbanasi* ka dalë më vonë, kur kishte pushuar së vepruari ky fenomen (Loma 1990). Me një moshë të sllavishtes së vjetër paraqiten dhe format *Arbanaško* e ajo arumune *Arbinesh*, për punë të refleksit *s-sh*, gjithsesi gjatë periodës paraturke.

c) Forma greke *Arvati* dhe ajo turke *Arnaçi* (*Arnaukt Koj*) kronologjikisht reflektojnë zhvillime më të reja fonetike.

Duke patur parasysh dëshminë e gjurmëve të tilla në toponimi, të gjitha këto forma flasin për një shtrirje të lashtë e të gjerë të shqiptarëve në këto vise të Maqedonisë.

VII. Emri i vjetër i shqiptarëve në defterët e regjistrimeve osmane të shek. XV në arealin e Maqedonisë

Emri *Arbanas* për shqiptarët në mesjetë, në këtë periodë në lakadredhat shqiptare të Maqedonisë e hasim me një përdorim shumë të shpeshtë në funksione të ndryshme antroponimike, patronimike, etnonimike dhe toponimike. Ky emër, të cilin e ndeshim dhe me variacionet *Arbanash*, *Arbina*, *Arnaut*, *Arnavud*, *Arnavid* e *Olbanash*, përveç atyre *Arbanas* e *Arbanash*, madje del me një vlerë më të madhe përdorimi nga të gjithë emrat e tjerë etnikë që i ndeshim të përdoren në mesjetë në këtë trevë, khs. ato *Grk*, *Vlah*, *Bolgarin*, *Bugarin*, *Srbin*, *Ermen*, *Kuman*, *German*, etj.

Një shfaqje më të hapët ka sidomos në rrethinën (Nahijen) e Manastirit, të Velesit, të Shkupit, të Tetovës, të Kërçovës, të Mariovës, të Follorinës (Maqedonia egjejane) etj., por nuk është pa një përhapje të vogël as dhe në rrethinat e tjera gjeografike të Maqedonisë, që dëshmon kjo për karakterin e ngulët të elementit shqiptar në këto lakadredha gjeografike.

Në periodën e sundimit turk, emrin *Arbanas* në tërthoret e Maqedonisë e ndeshim dhe me trajtën e turqizuar *Arnaut*, mbi bazën e të cilit janë krijuar një radhë topikësh që shënojnë emra vendburimesh dhe lokalitetesh të ndryshme, si: *Arnautski Nivje*, *Arnautski Mezhd*i në pellgun e Ohrit dhe të Prespës (Pjanka 1970: 204). *Arnaukite*, *Arnutkite* ara në Piperevë (Dukatin), *Arnauckata Shirina* kodër e mal në Varvarixë, *Arnauckite Trli* ara e mal në Stinek, *Arnucka* mulli në Vodoçë, *Arnaucka Mala* në Boriovë, etj.

Mbi bazën e këtij emri janë formuar po kështu edhe një radhë patronimikash të ndryshme që dalin të përdoren si mbiemra familjarë, sot të sllavomaqedonizuara, më këto forma: *Arnaudovski*, *Arnaudoski*, *Arnautovski* (Manastir, Ohër, Prilep, Shkup), *Arnautov*, *Arnaudov* (Shtip, Prespë, Bogdanc, Gjevgjeli, Kavadar, Shkup), *Arnautova*, *Arnaudova* (Ohër, Shkup). Si mbiemër i tillë familjar ka shtegtuar edhe te serbët me format *Arnautov*, *Arnautoviq*, *Arbanas*, *Arbanasin* (I.

Grković RI 24) dhe te bullgarët *Arnaudov* e *Arnaudovci* disa familje shqiptare në katundin Banja në Jugperëndim të Panagjurishtes.

Këtu më poshtë do të sjellim një varg emrash personalë, në bashkëvajtje me emra kryefamiljarësh, te të cilët përmbahet ky emër me format *Arbanas/ Arbanash e Arnaut/ Arnaud* si element i parë (emri i të birit) apo i dytë (i të jatit) dhe si element atributiv i përkatësisë etnike, të nxjerrë nga defterët e regjistrimeve turke-osmane të shek. XV. Nga shembujt e këtillë antroponimikë po veçojmë këtë fond emrash vetjakë sipas krahinave të ndryshme gjeografike.

Nahija e Manastirit:

Martin Arnaut Mahalla Dabizhiv TD II 144/. *Gin Arnaut* /fsh. Porodin TD II 147/. *Pejo Arnaut/ fsh.* Kanino TD II 148. *Rale, vëllai i Arnaudit/ fsh.* Novak TD II 148/*Mile Arnaut /fsh.* Kanino TD II 151/. *Jandro Arnaut /fsh.* Grumaz TD II 152/. *Minkul Arnaut, Dedie Arnaut/ fsh.* Gradeshnicë TD II 154/. *Leko Arnaut, Bard Arnaut, Nikolla Arnaut/fsh.* Rakitnicë TD II 164. *Sire, b. Arnautit, Pavle Arnaut/fsh.* Optičar, TD II 166, / *Nikolla Arbanash/fsh.* Slladofçe TD II 170/, *Arnaud/fsh.* Çeltukxhi TD II 175/, *Andreja Arbanash, Bozhik, b. Arbanashit/fsh.* Dobromir TD II 177/, *Miho Arbanash/fsh.* Poodin TD II 178/, *Gerg, b. Arbanashit, Kosta Arbanash/fsh.* Drevenik TD II 179/, *Miho, b. Arbanashit, Gerg, b. Arbanashit/fsh.* Negočan TD II 181/, *Todor Arnaut/fsh.* Bareshan TD II 194/, *Mustaa Arnaut/fsh.* Vasharejcë TD II 197/, *Martin Arnaut, Gin, b. Arnautit/fsh.* satnisha Livada TD II 203, 204/, *Dedie Arbanash/fsh.* Kllobuçishtë TD II 206/, *Todor Arbanash, Kojo b. Arbanashit, Jove, b. Arbanashit, Bojko Arbanash/fsh.* Pançar TD II 210/, *Kozmo, b. Arbanashit/fsh.* Sveta Petka TD II 211/, *Gerg, b. Arbanashit/fsh.* Krklino TD II 213/, *Kolo Srnaud, Stojko Arnaut/fsh.* Opsirin TD II 217/, *Ilko Arnaut/fsh.* Opsirin TD II 219/, *Nikolla, b. Arbanashit/fsh.* Alinc TD II 222/, *Tode Arbanash/fsh.* Bisticë TD II 226/, *Jandre Arbanash/fsh.* Drazhe Pole TD II 227/, *Leko Arbanash, None Arbanasg/fsh.* Ostrec TD 231/, *Boshko, b. Arbanashit, Llazar Arbanash, Gego Arbanash/fsh.* Selcë TD II 233/, *Kojo, b. Arbanashit/fsh.* Snegovë TD II 234/, *Gerg Arbanash/fsh.* Postran TD II 239, *Petre Arnaut, Gon, b. Arnautit, Petre, b. Arnautit/fsh.* Tepavc TD II 242/, *Petre Arbanash/fsh.* Zhurçe TD II 244/, *Gin Arbanash/fsh.* Dragozhan TD II 248/, *Dimitri Arbanash, Nikolla Arbanash/fsh.* Dragne TD II 255/, *Stojko Arbanash/fsh.* gabrovë TD II 257/, *Berlin Arbanas/fsh.* Bitushë TD II 262/;

Nahija dhe vilajeti i Tetovës:

Gon Arnaut/ TD 294/, Dola/ Dula/ Arnaut/ TD 294/, Gon Arbanas/fsh. Bogovi, Ponorishte TD 358/, *Gon Arnaut/ TD 294, 298/, Llazar Arbanas/fsh.* Zherovjan TD 305/, *Gjura Arbanas, Dimitri Arbanas/fsh.* Leshnicë TD 305, *Nena'(?)* *Arbanash/fsh.* Morovishte TD 308/, *Dano Arbanas/fsh.* Bogovi TD 313/, *Nikolla, Arnaut/fsh.* Leunovë TD 334/, *Martin Arbanas/fsh.* Çellopek TD 332/, *Nikolla, b. Arbanasit/fsh.* Sedllarcë TD 334/, *Gjuro Arbanas/fsh.* Peçkovë TD 336/, *Koljo, b. Arbanasit/fsh.* Poroj TD 354/, *Pejo Arbanas/fsh.* Negotin TD 362/, *Nikolla*

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

Arnaud/fsh. Banjia e Epërme TD 375/, Pavle Arnaut/fsh. Kamenjan TD 401/, Pejo, b. Arbanasit/fsh. Vrapçisht, Tunçvisht TD 407/, Manuel Arbanas/fsh. Ponorishte TD III 41/, Nikolla Arbanas, Andreja Arnaut, Grgur Arnaut/fsh. Miletinë TD III 40/, Marko Arbanas, Stanisha Arbanas/fsh. Çellopek TD III 43/, Petru, b. Arbanasit/fsh. Negotin TD III 45/, Gjorash, b. Arnautit/fsh. Reçicë TD III 48/, Nikolla Arnaut, Harbati Arnaut/fsh. Hvalishta TD III 49/, Gon Arnaut/fsh. Gorno Turçani TD III 51/, Dimitri Arnaut, Nikolisha Arnaut, velko Arnaut/fsh. Zherovjan TD III 56/, Pero, b. Arnaudit/fsh. Shtençe TD III 57/, Marin Arbanas/fsh. Strumeshnicë TD III 61/, Stifo Arbanas/fsh. Gare TD III 62/, L Lazar Arbanas/fsh. Malo Turçani TD III 63/, Mano Arbanas, Gjorgji, b. Arbanasit/fsh. Zdujçe TD III 64/, Petru Arnaut/fsh. Bogovine TD III 64/, Dabizhiv Arnaut/fsh. Reçicë TD III 80/, Dimitri Arbanas /fsh. Brevnicë TD III 83/, Mrgo Arbanas/fsh. Gorjon TD III 85/, Gjorgj Arnaut/fsh. Leshnicë TD III 86/, Pavlo Arnaut/fsh. Leshnica e Epërme TD III 88/, Lazor, b. Arbanasit, Gjergji Arbanas/fsh. Pallçisht i Epërm TD III 93/, Gin, b. Arbanasit, Gon Arnaut/fsh. Çegran TD III 97/, Marko Arnaut, Gin, b. Arnautit/fsh. Kalishte TD III 99/, Andreja, b. Arbanasit / TD III 104/, Marko Arbanas, Kolo Arbanas, Gijash Arbanas, Petre Arbanas/fsh. Leshok TD III 106/, Petru, b. Arbanasit/fsh. Podbreg TD III 109/, Pavlo Arnaut/fsh. Reçan TD III 114/, Stojko Arbanas/fsh. Gjurgjevisht TD III 116; Dimitri Arbanas, Radiç Arbanas/ Vrutok TD III 119/;

Vilajeti i Shkupit:

Jusuf Arnaut/fsh. Topçe IShakli TD III 149/, Gjore / Gure/ Arnaut/fsh. Draçevë TD III 150/, Bander Arnaut/ Mah. Stanimir TD III 166/, Gon Arnaut/fsh. Radishan TD III 167/, Millosh Arnaut/ Mah. Jandro TD III 166/, Nikolla Arnaut/fsh. Krasimirc TD III 197/, Nikolla Arnaut, Todor Arnaut/fsh. Gradec TD III 222, Dimitri Arbanas/fsh. Novosell TD III 262/, rade Arbanas/fsh. Krasimirc TD 453/, Gjin Arnaut/fsh. Gradec TD 480/, Dobre, b. Arbanasit/fsh. Gradimanc TD 499/, Arnaut Shahin/ TD 514/, Bozhidar Arbanash/fsh. Dobërcë TD 528/, Nikolla Arbanash/ fsh. Draçevë TD 535/.

Nahija e Kërçovës:

Kala Arnaut/ Mahalla e Shqiptarëve TD 198/, Gjergj Arnaut/fsh. Drenovë TD 210/, Tanush Arnaut/fsh. Brzhdan TD 211/, Tanush/ Janush/ Arnaut/fsh. Oreovec TD 237/, Dimitri, b. Arbanasit/fsh. Barbaras TD 250/, Arbanas, b. Petkos/fsh. Çellopek TD 258/, Stanisha, b. Arbanasit/fsh. Sërbicë TD 271/, Rale, b. Arbanasit/fsh. Topollnicë TD 278/, Nikolla, b. Arnautit/fsh. Llopshnik TD 284/, Tanush/ Banush, Arnaut/fsh. Klladnik TD 554/;

Vilajeti i Rekës së Dibrës:

Petar Arbanas, Dimitri Arbanas /fsh. Pristojnicë TD III 294/, Petko Arbanas, Pavle Arbanas/fsh. Bitushë TD III 393/, Tanush Arbanas/fsh. Zirkklan TD III 369/;

Vilajeti i Velesit (Qupërlisë):

Gon Arnaud/ fsh. Goshtrizhan TD 50/, Gin Arnaud/fsh. Krivogashtan TD 49/, Ishak Arnaud/ Mah. Adil TD 50/, Dimitri, b. arbanasit/fsh. Sv. Dimitri RD 80/, Nikollçe, b. Arnaudit/fsh. mala Rosica TD 85., Dimitri Arnaud/fsh. Crnilishte TD 86/, Petre Arbanas/fsh. Galiçan TD 88/, Rale, b. Arbanasit /fsh. Zhitoshe TD 94/, Nikolla arbanash /fsh. Ropotovë TD 96/, Gon Arbanas/fsh. Veselçan TD 87/, Dimitri Arbanash/fsh. Kutleshevë TD 100/, Gerg Arbanas / Mirç TD 155/, Ice Arbanash/fsh. Topallnicë TD 164/, Jandre, b. Arbanasit/fsh. Kapesh/;

Nahija e Follorinës (Maqedonia egjeiane):

Stefan, b. Arnautit/fsh. Leskovec NF TD II 323/, Veliçko, b. Arnautit, Gon, b. Arnautit/fsh. Siroviçevë NF TD II 324/, Pero, b. Arnautit/fsh. Rakitë ND TD II 325/, Nikolla, b. Arnautit/fsh. Neveska NF TD II 328/, Gjin Arnaud/fsh. Vilan NF TD II 329/, Nikolla, b. Arbanasit/fsh. Krushorad NF TD II 338/, Karagjoz Arnaud, Gergi, b. Arnautit/fsh. Voshtan NF TD II 347/, Gon, b. Arnautit/fsh. Ribarc NF TD II 360/, Tomo, b. Arnautit/fsh. Divem NF TD II 362/, Karagjoz Arnaud/fsh. Radunisht NF TD II 388/, Mihal, b. Arbinasit, Gon, b. Arbinasit, Pano, b. Arbinasit, Pejo, b. Arbinasit/fsh. Alagin NF TD II 365/, Kozmo, b. Arbinasit/fsh. Neret NF TD II 366/, Gon, b. Arnautit/fsh. Buh NF TD II 368/, Filip, b. Arbanasit/fsh. Spanc NF TD 369/, Gon, b. Arnautit/fsh. Britolm NF TD II 371/, Gon Arnaud/fsh. Armenohor TD II 392/, Andreja Arnaud/fsh. Ostrovë NF TD II 403/, Gin, b. Arnautit, Gon, b. Arnautit/fsh. Selicë NF TD II 411/, Ugiç Arnaud/fsh. Drenovë NF TD II 418/, Gergi Arnaud/fsh. Nevoljan NF TD II 421/, Aleksa, b. Arnautit/fsh. Çegran NF TD II 435/, Meksha, b. Arnautit/fsh. Uxhan NF TD II 428/, Shahin Arnaud/ NF TD II 435/, Tono, b. Arnautit, Jonko, b. Arnautit, Andreja, b. Arnautit/fsh. Lipore NF TD III 438, Stojko Arnaud, Altoman Arnaud/fsh. Palihor NF TD III 444, 447/, Kalan Arnaud/fsh. Palihor NF TD II 447/, Nikolla, b. Arnautit/fsh. Lipore NF TD II 449/, Gere, b. Arnautit/fsh. Vrapçin NF TD II 450/, Laskari Arnaud, Gin Arnaud/fsh. Emboria NF TD II 452/, Gin Arnaud, Gon Arnaud/fsh. Dobrodisht NF TD II 457/, Dedir, b. Arbanasit/fsh. Negovan NF TD II 462/, Niko, b. Arnautit/fsh. Komanovë NF TD II 465/, Oruç, b. Arnautit/fsh. Kollarc NF TD II 477/, Andronik, b. Arnautit/fsh. Pelka NF TD II 488/, Dedie Arnaud/fsh. Vrbovec NF TD II 483/, Pejo Arnaud/fsh. Katrancië ME TD 566/, Dimitri Arbanas/fsh. Dunje Nahija e Mariovës TD 129/.

Këto trajta të këtij emri etnik, përdorur ne funksion antroponimik dhe patronimik, perveç që dalin në bashkëvajtje me antroponimet shqiptare *Bard/ Bardh, Gego, Gere, Gerg, Gjergj, Gju/ Gjin, Gijash, Gon/ Gjon, Dedir, Dimitri, Grgor, Ilko, Kala, Kojo, Leko, Minkul, None, Laskari, Marko, Martin, Tanush*, etj., i ndeshim të përdoren edhe me emra të tjerë familjarë të përkatësisë gjuhësore sllave: *Belin, Bogdan, Boshko, Bozhidar, Dobre, Gjore, Gjuraj/ Gjurash, Jove, Jandro, Llazar, Mile, Millosh, Meksha, Novak, Nenaç, Pejo, Petre, Petko, Pavle, Rade, Rale, Stanisha, Sive, Todor, Tomo, Veliçko*, etj.

Si konkluzion, në truallin e Maqedonisë së sotme, si në asnjë vend tjetër në rajon, ndeshim emra personash dhe emra vendbanimesh me cilësimin *Arbanas*, si dëshmi e sigurt se në këtë provincë së paku që nga antika e përgjatë gjithë mesjetës gjallonte dikur popullsia arbanase, të parët e shqiptarëve të sotëm, të cilët në kohë të më vona u rruhdën kryesisht në Maqedoninë Perëndimore. Me këtë vërtetohet teza e E. Çabejt për autoktoninë e shqiptarëve në këtë truall dhe se elementi arbanas (shqiptar) në viset që i ka pasur dikur ka pësuar restriksion e jo ekspansion. Topikët me cilësimin *Arbanasi* nuk janë ishuj të izoluar, por përfshijnë “vatra” e “provinca onomastike” në të gjithë arealin e Maqedonisë perëndimore, verilindore, qendrore e jugore: shtrihen në zonën e Shkupit, në Kumanovë, Sveti Nikole, Shtip, Kratovë, Prespë, Manastir, Ohër, Prilep, Kërçovë, Gostivar, Tetovë “Provincat onomastike Arbanase” në arealin e Maqedonisë kronologjikisht janë me një moshë të vjetër çka flet për kontakte të hershme të arbanasve (shqiptarëve) me latinishten dhe me sllavishten e vjetër, dhe ua nxjerrin rrënjët në diell trillimeve sllavomaqedonase se të parët e shqiptarëve të sotëm paskan ardhur në Maqedoni në shek. 18-të.

Prania e elementit të tillë të theksuar toponomastik autokton shqiptar në Maqedoni është një fakt historik që nuk mund të mohohet nga askush, pra as nga onomasticienët maqedonase dhe nga Petar Hr. Ilievski, i cili kur flet për toponimin e Kërçovës thekson se “*Asnjë mal i madh, asnjë lumë i madh, asnjë vendbanim në Kërçovë nuk është emërtuar me fjalë shqipe. Emërtimet e objekteve më të mëdha gjeografike janë adaptuar ose drejtpërdrejt nga emërtimet maqedonase, ose me ndërmjetësi të turqishtes*” (Ilievski 1988: 521). Ky akademik maqedonas jo vetëm që nuk sheh asnjë toponim shqiptar, madje as ato të tipit *Arbanasinec, Arbanasi, Arbanashec, Arbinovë* etj., të përhapura në gjithë Maqedoninë dhe në disa tërthore të tjera të Ballkanit dhe të krijuara madje nga vetë sllavomaqedonasit për t’i dalluar këto vendbanime joslave nga ato sllavet, të cilat gjëllinin në bashkëjetesë e në kontakt, por ky nuk i sheh drejt as patronimet shqiptare të krijuara mbi këtë bazë, si p.sh. patronimin shqiptar *Arnaudovski* (siç e tregon dhe vetë emri etnik *arnaut* “shqiptar”) që përdoret si mbiemër familjar te maqedonasit: “*I denes ima makedonski familii so prezime Arnaudovski, zatoa što se doseleni od Albanija, a ne se Alanci*”! Ja pra ku të çon gjykimi i izoluar pansllavist maqedonas dhe mohimi nga ana tjetër i elementit shqiptar, që edhe emri etnik popullor i shqiptarëve *Arnaut* (te turqit) të kryqëzohet si emër etnik “maqedonas” (këtyre të fundit sikur nuk u mjafton që kanë përvetësuar një herë emrin etnik të një popullsie joslave maqedonase).

Ndërkaq, emrin *Arbanas* ja si e përkufizon p.sh. Fjalori i bullgarishtes: *Arbanasčanin мъж* kojto e roden ili živee v selo Arbanasi”; *Arbanascanka* f. “žena, kojto e rodена ili živee v selo Arbanasi” (RBE I, 298).

Duke përfunduar theksojmë se në këtë mes nuk mund të jetë një gjë e rastit fakti që emri i albanoivët antike të Shqipërisë qendrore-veriore rron edhe sot, si emër nacional i vjetër i popullit e i vendit (*Arbën, Arbër*), në truall të shqipes e në ngulimet shqiptare të Italisë e të Greqisë (E. Çabej), ashtu siç nuk mund të jetë e rastit që ky emër rron edhe në toponomastikën historike dhe të sotme të arealit të

Maqedonisë, me trajtën e vjetër latine *Albano*, *Albanop(ol)*, e *Arban* (nga shek. III-IV), me atë të sllavishtes së vjetër *Arbanas*, *Arbanaško*, *Arbasanci*, *Raban*, greke *Arvat*, e arumune *Arbinovë*, si shprehje e shtrirjes së këtij elementi lashtërisht e gjerësisht në këto tërthore.

“Në përgjithësi, është pranuar që emri *Arbën(ë)/ Arbër(ë)* e ka burimin tek emri i fisit ilir *Alban-oi*, që Ptolemeu i Aleksandrisë në shekullin II të erës sonë e përmend si një fis që banonte diku në viset e Shqipërisë së mesme, afër Durrësit (shih Çabej, 1976: 65). Ptolemeu, në veprën e tij, libri III,12, ku bën fjalë për provincën romake të Maqedonisë, shkruan: *Në tokën e albanëve (Albanoi) Albanopolis*. Por pas Ptolemeut emri i *albanëve* nuk del në burimet historike deri në shekullin XI, kur përmendet nga Mihal Ataliati dhe Ana Komnena (Sh. Demiraj); Ky pohim duhet korrigjuar e plotësuar në këtë: Me faktin që emrin *Albano* e *Albanop(ol)* e ndeshim edhe në vazhdim të shek. III-IV të erës sonë në arealin e Maqedonisë.

Çështjes thelbësore: shqiptarët autoktonë apo të ardhur në arealin e sotëm të tyre në Maqedoni, i jep përgjigje më së miri materiali që shtruan më sipër.

Bibliografia:

- AKRM II = AKRM 1996 = *Arheološka Karta na Republika Makedonija*, MANU. Tom II. Skopje 1996.
- Axhievski 1994 = Axhievski, Kosta, *Pelagonija vo sredniot vek*, Institut za nacionalja istorija, Skopje, 1994.
- Belić 1972 = Belić, Aleksandar, *Osnovi istorije srpskohrvatskog jezika* I. Fonetika. Univerzitetska predavanja, Beograd, 1972.
- Cvijić 1906 = Cvijić, J. *Osnove za geografiju i geologiju Makedonije*, Beograd, 1906.
- Çabej 1988 = Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1988.
- Dimitrovska 1976 = Dimitrovska, Gordana Spasovska, “*Grobot na pisarot od Stobi*” “*Macedoniae acta archeologica*” nr. 14, Makedonsko Arheološko Društvo, Skopje, 1976.
- Gashi 2007 = Gashi, Skënder, *Mendime rreth kuptimit të nocionit “Arbanas” në burimet kishtare serbe të shek. 13-16*, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë – Materialet e punimeve të Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë 16-23 shtator 2007, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë-Ohër, 2007.
- Idrizi 2003 = Idrizi 2003 = Idrizi, Xhemaludin, *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup, 2003.
- Ilievski 1988 = Ilievski, Petar, *Balkanološki lingvistički studii*, Skopje, 1988.
- Ivanova 1996 = Ivanova, Olga. *Rečnik na toponimite vo oblata po slivot za Bregalnica*. Skopje 1996.
- Jireček 2010 = Jireček, Konstandin, *Historia e serbëve*, Intelligenda, Shtëpia botuese “55”, Tiranë, 2010.
- Josifovska 1971 = Josifovska, Borka Dragojević, ADD, AD Spomenik, LXXXXI 557 Albanopolis, “*Жива антика*” XXI, Skopje, 1971.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

- Loma 1990 = Loma, Aleksandar Loma, In: "Становништво словенског поријекла у Албанији" - Зборник радова са међународног научног скупа одржаног на Цетињу 21, 22. и 23. јуна 1990. године, Титоград (стр. 279–327).
- Krivokapić 1969 = Krivokapić, D. Šar planina, Beograd, 1969.
- Macedoniae 1976 = Macedoniae acta archaeologica 14, Skopje 1996.
- Murati 1999 = Murati, Qemal. *Shqiptarët dhe Ballkani ilirik në dritën e emrave të vendeve dhe të familjeve*, Tetovë, 1999.
- Panov 1998 = Panov, Mitko, Enciklopedija na selita vo Republika Makedonija, Skopje, 1998.
- Petruševski 1999 = Petruševski 1999 = Petruševski, Ilija, Petruševska, Nikolina, *Zborovnik na toponimi na severoistočniot del od Dolni Polog*, Luboten, 1999.
- Pjanka 1970 = Pjanka, Vlodyjmež, *Toponomastikata na Ohridsko-Prespanskiot bazen*, Skopje, 1970.
- Pollozhani 2012 = Pollozhani, Mixhait, *Mbishkrimi nga Shkupi, Albanopolisi antik*, Revista Shenja, nr. 10, shkurt 2012.
- Skok 1978 = Skok, Petar, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të Luginës së Shkupit*, Studime Gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978.
- TD *Turski dokumenti za istorijata na Makedonskiot narod*, Opširen popisni defter Nr. 4/1467-1468/, Skopje, 1971; Opsirni popisni defteri od XV vek. Tom II. Skopje, 1973; Tom III. Skopje, 1976; Tom IV, Skopje, 1978; Opširni popisni defteri od XVI vek za Kustendilskiот sanxhak. Tom V. Kn. VI, Skopje, 1985.
- Trifunoski 1976 = Trifunoski 1976 = Trifunoski, J. Polog. *Antropogeografska proučavanja*. Beograd 1976.

SKENDER ASANI

AUTOKTONËSIA SHQIPTARE E SHKUPIT NË DOKUMENTE AUTENTIKE

Me rastin e 100 - vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, po nxjerrim në dritë këtë dokument për të argumentuar para opinionit vendas dhe atij ndërkombëtar vazhdimësinë shqiptare të qytetit të Shkupit, në kuptimin historik dhe demografik. Për Shkupin ekziston një gamë shumë e madhe e të dhënave të dokumentuara, nga udhëpërshkrimet dhe raportet nga konsujt e ndryshëm në Shkup, që shtjellojnë një periudhë shumë të vështirë nëpër të cilën ka kaluar populli shqiptar, duke u ballafaquar me projektet asimiluese që kishin zbatuar pushtuesit e ndryshëm ndaj këtij qyteti.

Dokumentin që po e ofrojmë për lexuesit është hulumtuar në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë në Shkup (Државен Архив на Република Македонија во Скопје), në fondin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, përkatësisht është dokument që është sjellë nga ky arkiv në Shkup.

Ky dokument është shumë argumentues, sepse të dhënat dalin nga një zyrtar (këshilltar) në Kuvendin e qytetit të Shkupit. Në brendinë e këtij raporti flitet dhe për prejardhjen ilire të popullatës shqiptare të Shkupit. Dokumenti përfshin periudhën e fundit të sundimit të Perandorisë Osmane, ndërsa në aspektin demografik nga ky dokument kuptojmë se Shkupi në vazhdimësi ka pasur shumicë të konsiderueshme të popullsisë shqiptare.

Shkupi, edhe pse truall i tërësisë etnike shqiptare, vazhdimisht u sfidua nëpërmjet projekteve pushtuese nga bullgarët, serbët, që tentonin t'i kolonizojnë me dhunë këto territore, gjë që rezultoi me ndryshimin e strukturës së popullsisë, sllavizimin e saj dhe shlyerjen e memories kolektive të shqiptarëve për këtë qytet. Edhe burimet serbe konfirmojnë të dhënat statistikore për numrin e popullsisë dhe dominimin e shqiptarëve në Shkup e rrethinë. Këto burime vërtetojnë se nëpërmjet

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

reformës agrare dhe kolonizimit, synimi i hegjemonisë e politikës serbe ishte popullzimi i Shkupit me serbë¹ dhe asgjësimi i elementit shqiptar në Shkup.

Me anë të zbatimit të projekteve të ndryshme për shfarosjen e elementit shqiptar nga Shkupi, pseudoshkencëtarët do të tentojnë të argumentojnë më pastaj me anë të sajësive të shpikura pretendimin anakronik në të drejtën historike për këtë qytet. Prandaj, në pjesën e parë të shekullit XX politika ekspansioniste serbe hyri në veprim me Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene dhe Jugosllavinë mbretërore deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, duke vazhduar me politikën asimiluese me pushtimin bullgar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

OKUPIMI BULLGAR NË MAQEDONI

Konsullata në Sofje në datën 14 prill 1941 të këtij muaji referoi:

“Kemi nderin që të dërgojmë këtë raport prej Konsullit në Shkup në datën 5 prill 1941.

“Policia sekrete gjermane e cila vazhdon hetimet e saj në Maqedoni ka kërkuar Memorandum prej Muhamed Rusten Bej, person i rëndësishëm në Shkup me origjinë turke, mbështetës i bashkimit të këtyre rajoneve me Shqipërinë.

Si shtesë është përkthimi i memorandumit paraprakisht të përkthyer i cili për qytetin e Shkupit tregon ndalimin e turqve dhe shqiptarëve (këta të fundit janë rreth 25.000), ndërsa po rritet shumë numri i serbëve në llogari të bullgarëve, ose thënë më mirë maqedonasve, pothuajse duke ndërruar pozitat në shifra: numri i përgjithshëm i sllavëve i dhënë për Shkupin prej Muhamed Beut nuk është shumë më i ulët se numri i vërtetë i cili në 5 prill mundej të llogaritet në rreth 50.000.

Në shtesë jepet përkthimi i memorandumit për të cilin bëhet fjalë.

27-XX-2

Shkupi para Okupimit² ka pasur rreth 87.000 banorë.

Në kohën antike Shkupi ka mbajtur emrin Skupi³, kryeqyteti i provincës romake të Dardanisë, dhe madje edhe deri në ditën e sotme quhej Shkup nga ana e shqiptarëve të cilët sipas prejardhjes pjesërisht kanë ardhur nga Dardanët.

¹ Архив на Институтот за Национална Историја, Врховна Команда, Полициско оделение у Скопљу, 24.10.1912; Јужна Србија, “ Време “, дт.13.02.1923, Београд, 1923, f.3; Муслимани и арнаути, “ Време “, дт.13.02.1923, Београд, 1923, f.3.

² Sipas marrëveshjes së Vienës: Shkupi bie në sferat e interesave bullgare dhe sipas planit të paraparë në fund të prill 1941 Shkupi okupohet nga forcat bullgare.

³ Meqë gjuhës latine i mungon shkronja Sh, për këto arsye Shkupi gjatë okupimit romak u quajt Skupi.

Turqit e pushtojnë Shkupin në vitin 1392. Me mbrojtjen nga një kala⁴, qyteti është zhvilluar dhe është bërë kryeqyteti i Vilajetit të Kosovës. Vilajeti i Kosovës është kufizuar në lindje dhe në veri me Mbretërinë Serbe, në juglindje përfshirë edhe qytetin Veles me Vilajetin e Selanikut, ndërsa në jug me Vilajetin e Manastirit (Bitola).

Si nyje e shumë hekurudhave, të cilat siç është edhe e njohur janë ndërtuar nga Baroni austriak Hirsh⁵, është bërë qendër ekonomike e Turqisë evropiane perëndimore. Në vitin 1912 qyteti ka pasur rreth 50.000 banorë, prej të cilëve:

40.000 shqiptarë
4.000 bullgarë
150 serbë

Përveç tyre ka pasur edhe hebrenj, romë, etj.

Rrethi i Shkupit ka:

63 fshatra shqiptare me 45.000 banorë
3 koloni turke me 2.500 banorë
9 fshatra të mëdha serbe me 7.000 banorë
22 fshatra bullgare me 15.000 banorë

Siç ishte theksuar paraprakisht, para okupimit qyteti i Shkupit ka pasur 87.000 banorë, prej të cilëve:

33.000 shqiptarë
30.000 serbë
11.000 bullgarë
5.000 hebrenj
3.000 romë

Përveç romëve ka edhe kombësi të tjera.

27-XX-3

Në funksionin tim si këshilltar komunal në Shkup në një periudhë prej shumë viteve, mund të vërtetoj se prej vitit 1918 ka 7.000 imigrantë maqedonas në Shkup, të cilët tani quhen bullgarë, dhe 30.000 serbë. Maqedonasit, të cilët gjatë kohës së dominimit serb prezantoheshin si serbë të mirë, kanë ditur të shfrytëzojnë situatën ekonomike dhe politike, ashtu që për shembull prej 18.000 hektarëve tokë e cila u

⁴ Kalaja e Shkupit buz brigjeve të lumit Vardar.

⁵ Linja hekurudhore Shkup – Mitrovicë, në vitet 1873 - 1878 lëshohet në përdorim nga Perandoria Austro – Hungareze.

ishte marrë myslimanëve⁶ në rrethin e Shkupit, pa asnjë kompensim, vetëm 4.000 hektarë u ishin dhuruar serbëve, derisa maqedonasit kanë fituar pjesën më të madhe të asaj që ka mbetur.

Sot pasi serbët e kanë braktisur Shkupin, shqiptarët përsëri e kanë shumicën në krahasim me maqedonasit. Gjatë 23 vjetëve, prej vitit 1918 deri në vitin 1941, pas okupimit serb shumica shqiptare e ka ruajtur dominimin. Karakteristike është të shënohet se shqiptarët kanë ndërtuar fshatrat e tyre nëpër kodrinat: në këtë i ka detyruar lufta shekullore kundër sllavëve. Politika serbe e asgjësimit nuk e goditi këtë popullatë energjike, pa marrë parasysh se sa ka rënë në minimum standardi jetësor. Ushqimi i dobët dhe kushtet e këqija të jetesës e kanë shkatërruar masën. Vdekshmëria te foshnjat e porsalindura e verifikuar në bazë të listave të Komunës ka qenë 68%.

Në Evropë nuk ka popull tjetër i cili aq ngrohtë e ka pritur dhe e ka përshëndetur lirinë si shqiptarët. Kur të mbushur me shpresë kanë shpresuar për një ardhmëri më të mirë, paraqitja e trupave bullgare i ka shkatërruar ata shpresa. Ka kaluar një kohë shumë e shkurtër dhe terrori prej të cilit ishin frikësuar nga ana e bullgarëve kishte filluar. Nëpër fshatrat ka pasur të vdekur, pleq mbi 70 vjet, gra dhe fëmijë janë rrahur, shtëpitë janë grabitur, ndërsa vajzat e reja janë dhunuar. Në periudhë prej një muaji fshatarët shqiptarë nuk kanë mundur të drejtohen nga tregu në Shkup. Në një periudhë në Shkup, shqiptarët nuk kanë mundur të mbajnë as fesin e kuq e as kapelën e bardhë shqiptare⁷. Pushteti gjerman e dinte mirë se një zejtar i cili fitonte në Shkup duke shitur kapela të bardha, ka qenë i arrestuar në mes të ditës, i rrahur me shkop, aq shumë sa që ditën e ardhshme ka vdekur. Disa studentë të burgosur diku, dhe siç kuptohet ndodhen në rrethin e qytetit Plovdiv.

Gjatë kohë së okupimit në Shkup nga ana e gjermanëve, kisha nderin e veçantë që të jem i emërtuar si komisar nga ana e gjeneralit Lindeman. Në këtë periudhë Shkupin e vizitoi Ministri gjerman në Sofje, Von Rihtofen, të cilin për fat të keq nuk mundesha ta përshëndes sepse Komiteti Maqedonas m'u kërcënua me vdekje. U ishte ndaluar të gjithë shqiptarëve që të paraqiten në vendin e takimit, me qëllim që të fshihet shumica shqiptare.

E dinte populli i madh gjerman dhe Fyreri i tyre se në Evropën Jugore një popull i pafajshëm i është nënshtruar tiranisë, por pse?

Përgjigja është: pasi që mbrohet nga shpërndarja e shpejtë e sllavizmit.

27-XX-4

Dardania një kohë ka qenë provincë romake, ne vijmë me prejardhje nga Dardanët dhe nuk dëshirojmë asgjë tjetër vetëm se të jetojmë në provincën romake e cila quhet Shqipëri.

⁶ Në mbretërinë e Serbëve – Kroatëve – Sllovenëve, shqiptarët ishin të paraqitur në grafën fetare muslimane dhe toka nëpërmjet kolonizimit e reformave agrare në Shkup dhe rrethinë u ishte marrë me dhunë shqiptarëve.

⁷ Plisin

BESNIK EMINI

MAQEDONIA NË SHKRIMET E GAZETËS “SHKUPI”

Kanë kaluar 100 vjet prej kur më 29 gusht 1911 në Shkup filloi të botohej gazeta në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke me emrin “Shkupi”, nën drejtimin e Jashar S. Erebarës. Gazeta botohej një herë në javë, ashtu siç shkruante edhe në ballinën e saj. Gjithsej janë botuar 34 numra të kësaj gazete. Gjatë vitit 1911 janë botuar numrat 1-14, ndërsa në vitin 1912 janë botuar numrat 15-34. Numri i fundit doli nga shtypi më 19 shtator para se të fillonte Lufta e Parë Ballkanike. Në gazetë është botuar vetëm një fotografi, edhe atë në numrin e fundit, ndërsa bëhet fjalë për fotografinë e Hasan Prishtinës, nën fotografinë e të cilit shënohet emri Hasan bei Vuçitirni. Deri në ditën e sotme, në biblioteka të ndryshme janë gjetur të gjitha numrat që janë botuar, përveç numrit 21, i cili nuk është gjetur.¹ Gazeta është shtypur me format 26,5x36 cm në gjithsej katër faqe. Dy faqet e para janë shtypur në gjuhën shqipe me shkronja latine, ndërsa dy faqet e fundit janë shtypur në gjuhën turke me alfabet arab. Pjesë e studimit të këtij shkrimi janë tekstet e botuara në gjuhën shqipe me alfabet latin (përveç numrit 21 që nuk është gjetur ende). Duke pasur parasysh që koha kur është botuar gazeta kanë qenë vitet e fundit të Perandorisë Osmane në këto hapësira, nëpër shkrimet e kësaj gazete trajtohen tema të ndryshme të kohës. Edhe pse gazeta nuk kishte rubrika standarde, zakonisht në faqen e parë janë botuar informacione për rrethanat politike në Ballkan, Evropë dhe botë. Në gazetë shkrimet botoheshin pa emrin a autorit, që të mbrohen autorët nga

¹ Faqet e shtypura në gjuhën shqipe janë ribotuar në një format libri me dimensione 28x19 cm nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, përgatitur për shtyp nga Skender Asani dhe Ardian Limani. Megjithëse është ribotuar i tërë fondi i gjetur deri tani (përveç numrit 21), në këtë ribotim është përvjedhur një gabim teknik, me ç'rast nuk është botuar faqja e dytë e numrit 9, si dhe faqja e dytë e numrit 18. Në vend të këtyre faqeve janë botuar faqet e dyta të numrave të tjerë, respektivisht të numrit 14 dhe 24. Në këtë shkrim janë marrë parasysh edhe këto dy faqe, e që si fond i plotë në formë të fotokopjuar ruhet në Bibliotekën e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

pasojat e censurës, ndërsa shpesh janë përcjellë shkrime të botuara në gazeta të tjera.

Në shkrimet e gazetës shfaqen edhe disa tekste në të cilat përmendet edhe Maqedonia në kontekste të ndryshme. Në numrin 9 të 29 tetorit 1911 në shkrimin me titull “Kursi i politikës së re në Evropë” është botuar lajmi se: “gazetat e Evropës shkruajnë se më 20 tetor 1912 qeveritë e Anglisë dhe Rusisë e kanë pa të udhës që të bashkohen të tëra shtetet e Ballkanit, ku do të hynin edhe Turqia, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi dhe Greqia. Për këtë punë ka ardhur këtu edhe ambasadori i Anglisë në Beograd. Ky plan i është bërë me dije edhe vezirit në Stamboll. Kur të bëhen këto bashkime Shqipëria dhe Maqedonia do të fitojnë një administratë si autonomi. Ky bashkim i shteteve të Ballkanit do të jetë nën hije të Anglisë dhe Rusisë. Maqedonia dhe Shqipëria nuk do të mund të bashkohen me ndonjë shtet të Ballkanit. Dhe të gjitha këto shtete do të mbledhen bashkë për t’u ruajtur nga hovi i Austrisë për në Selanik. Në qoftë se Gjermania do ta shtyjë Austrinë drejt Selanikut, atëherë kjo ushtri duhet të nxirret përballë Austrisë: Bullgaria 200 mijë, Serbia 120 mijë, Turqia në Evropë 300 mijë, Greqia 100 mijë. Nëse Austria merr hov drejt Selanikut, kjo ushtri e shteteve të bashkuara të Ballkanit do t’i qëndrojë përballë, dhe Evropa nuk do të përzihet fare, kanë dhënë urdhër”.² Në fund të fjalës qëndron “Utro”, që tregon për atë se teksti është marrë nga gazeta me këtë emër.

Në numrin e njëjtë përcillet një tekst i botuar në gazetën rumune të Bukureshtit “Adeverul” në të cilin thuhet: “Bullgaria si lepur e gjuan kohën të hyjë e të marrë edhe ajo një copë nga Maqedonia. Ashtu një ditë edhe Bullgaria do të bëhet Bullgaria e Madhe dhe e fortë karshi nesh (Rumanisë). Çka do të fitojmë ne Rumania me gjithë këtë miqësi që kemi me Austrinë? Flitet që Rumania do të marrë një copë nga Bullgaria, që nga Rusçuku – Varna.”³

Në numrin 10 të 5 nëntorit 1911 është botuar shkrimi me titull “Disa shenja të historisë” ku mes të tjerash parashtrohet pyetja: Po Maqedonia çka është? Më pas teksti vazhdon me këto fjalë: “Përpara se me u përgjigj mbi këtë punë po më duhet të kaloj në kohë fort të vjetra, sepse kështu kemi për ta vështruar për ta kuptuar më mirë... Emri Maqedoni është dëgjuar pikë së pari prej grekëve të vjetër shumë vjet përpara Azreti Isait. Po shqip emri Maqedhoni do të thotë kjo: Magje (sanduk) e dhoni do të thotë: dhanie, plot, boluk, dhe nga ajo vjen Maqedhoni “Magj e madhe”. Grekët e thërrisnin me këtë emër atë që për ta gjendej nga verilindja, por kufi nuk kishte dhe ndonjëherë përfshinte më shumë, e nganjëherë më pak, si t’u pëlqente shkrimtarëve që na kanë lënë shkrime mbi këtë dhe. Në këtë dhe në kohë të vjetra kanë ndenjor ose sikur thuhet më mirë kanë zotëruar popuj që me ne shqiptarët kanë qenë të një kombi e një gjuhe. Por nëse duam me gjithë arsye mund të themi se sa qenë prej kombit tonë. Disa vjet pas vdekjes së Lekës së Madh Maqedhonija me krejt Shqypnien tjetër ra nën sundim të Romakëve; më vonë pas Azreti Isait, ranë me krejt Shqypnien por më tepër në lindje, nga Maqedonija kombe të huaja e sidomos Bullgarët, që ishin fis Tartarsh, por që më vonë duke u

² “Shkupi” Gaset’ e përjavshme, Nr. 9, 29.10.1911, fq. 1

³ “Shkupi” Gaset’ e përjavshme, Nr. 9, 29.10.1911, fq. 2

përzier me Sllavët morën besën e gjuhën e tyre dhe u sllavizuan krejt. Po vendasit e vjetër të Maqedonisë a mund t'u qëndronin të huajve? Jo, por madje për rrezik të madh tonin u përzien me të huajt dhe e humbën kombësinë e gjuhën e vet e u mbajtën kush me Bullgar e kush me Grek. Nga ato kohëra e deri tash vonë emri i vjetër Maqedhoni është harruar krejt. Kombet e huaja që u rrasën në Maqedhoni, sikur Bullgarët, Grekët, Serbët filluan ta përdornin sërish emrin e vjetër, filluan sërish këtë ta thërrisnin Maqedhoni. E për çka? Për t'i dëftuar Evropës që ky dhe, dikur në kohë të vjetra, një mbretëri në vete, kishte të drejtë të ngrihej sërish në vete, si Serbia, Greqia, Bullgaria e Rumania e kështu të shkëputej prej Turqisë.

Dhe përnjëmend emri Maqedhoni filloi aq fort të përmendet prej Bullgarve, prej Serbëve e prej Grekëve sa Evropa besoi se në Maqedhoni nuk gjenden tjerë veç se Bullgarë, Serbë e Grekë e pra, arsye për ta ndarë prej Turqisë. Atëherë Evropa e "qytetëruar" filloi të përzihet në punët tona si të ishte në shtëpi të vet! Edhe vilajetin e Shkupit, ku gjenden sa Bullgarë e sa Serb deshën të ja mbathin Maqedhonisë, pse Evropa Shqypetarët që janë vendasit e të zotit të këtij vilajeti nuk i njihte për asgjë. Evropa me e fol të drejtën shumë faj nuk kishte, pse krejt fajin e kishte Stambolli, që nuk na linte me u thirr Shqypetar, e i mjeri ai që guxonte të lexojë libra e gazeta shqipe, sepse menjëherë fërfëlluhej në burgje ose tretej kah Anadulli. Kështu Shkupi e një pjesë e madhe të këtij Vilajeti u gjendën në Maqedhoni dhe ky dhe për pak gjë do të binte ndër duar të të huajve dhe do të bëhej si Gjiriti. Por doli kanuni esasi, siç thuhet turqisht; apo kushtetuta, si i thotë Evropa; por më mirë kanuni ndërtimtar si vyen t'i themi ne Shqypetarët në gjuhën tonë. Pasi e dha kanuni ndërtimtar Evropa hoqi dorë prej nesh. Po Bullgarët, Serbët e Grekët a punojnë si përpara? Po punojnë dhe ne e Stambolli e dimë. Edhe ne Shqypetarët deshëm të punojmë për vendin tonë e këtu në Shkup ishte ngritur një klub me emër bukur të madh, por Stambolli në vend që të na ndihmojë deshi të shkojë pas mendimeve të vjetra e u çua me një mijë kundërshtime kundër nesh. E Shqypetarët u frikuan e ranë përdhe e sot s'kemi as shkolla, as klube as kurrëgjë. E Serbët shkojnë gjithnjë përpara e Stambolli edhe me të holla u ka ndihmuar. E Shqypetarët, sikur gjithmonë flenë e nuk janë duke marrë vesh se do të hupin, si kanë hupë vëllezërit tanë të Maqedonies. Ku janë Shqypetarët, e sidomos ata që thirren Shqypetarë të flakët? Mo Zot ma keq për ne! Po me gjithë këto padrejtësi që janë duke na bërë, po prapë shqiptari s'ka tjetër mendim përveç se të jetojë me mbretërinë otomane, e jo sur nen t'huaj."⁴ Ky shkrim është shkrimi më i gjatë që është botuar në gazetën "Shkupi" në të cilin përmendet Maqedonia.

Në të njëjtin numër, është botuar një shkrim me titull "Komitet revolucionar Maqedon në Sërbi", ku përcillet një informatë e gazetës "Narod" rreth formimit të një komiteti me emrin e përmendur me seli në Beograd, qëllimi i të cilit është bashkimi i popullit serb".⁵ Në faqen e dytë të po të njëjtit numër është botuar shkrimi me titull: "Memorandumi (lajihaja) i organizatës Bullgare brenda në Maqedhoni" ku thuhet: "Organizata bullgare nga brenda e paska pa të udhës të bëjë një memorandum dhe ta dërgojë te konsujt e fuqive të mëdha në Selanik, Shkup,

⁴ "Shkupi" Gaset' e përjavshme, N. 10, 5.11.1911, fq. 1

⁵ "Shkupi" Gaset' e përjavshme, N. 10, 5.11.1911, fq. 1

Manastir dhe Edrene, ku me këtë memorandum ua bënë me dije konsujve të Evropës që e ka përsëritur sërish Organizatën e kryengritësve të vetë në Maqedoni. Me këtë memorandum organizata bullgare të parën herë fillon duke e shënuar gjendjen e ligë që është sot mbi ata që jetojnë në Turqi, dhe për shkaktar të këtij zullumi që nuk durohet më është fajtor regjimi dhe qeverisja e padrejtë dhe e pakuptueshme, është faji i Turqve të rinj, kjo gjendje që sot është në Maqedoni le që më nuk durohet nga barbaria e xhonve po është udhëheqje më e keqe se në kohën e qeverisjes së Hamitit, dhe ajo paudhësi e Hamitit solli që të përzihet Evropa në punët e Turqisë”. Në shkrim gjithashtu përmendet edhe se synimi kryesor i kësaj organizate është Autonomia e Maqedonisë”. Më pas është bashkëngjitur edhe një pjesë e tekstit si në vijim: “Shkupi”: Këto sende që i shënojmë më sipër i kemi parë e i kemi lexuar nëpër gazetën e Europës, megjithëse nuk na duken të jenë pas kohës këto kërkime nga bullgarët e Maqedonisë, por këto të qara le t’i mendojë Dr. Nazim pomaku, Nijazi Lopxhari e torbesh Ejubi, se ato putheshin nëpër sokakët e Selanikut duke thënë: Iashasin katrashlik!”⁶

Në faqen e dytë të numrit të 11-të të datës 11 nëntor 1911 është botuar një shkrim me këtë përmbajtje: “6 nëntor 1911 Londër (Angli). “Universul” gazetë e Bukureshtit e ka marrë dhe ka shtypur këtë telegram: Puna e Makedonis dhe e Shqipënis si në politikë ashtu edhe në administratë s’është në dorë dhe sipas mendimit të Austro Rusis në lindje. Çështja e këtyre dy provincave të Turqisë në Evropë, është një çështje e madhe ku me asnjë mënyrë e qëllim tjetër nuk bëhet me u shkatërrua. Turqia duhet që me kohë t’u japë shqiptarëve 400 mijë pushkë sistem Mauzer që ta ruajnë vatanin e vet nga rrëmbimi i huaj, po të ndodh, mbi Shqipëri.” Më pas shkrimi vazhdon: “Sh. Sh. Ne e përkthym këtë telegraf fjalë pas fjale, po ashtu edhe nga ana jonë i themi këto: duket që Evropa e paska bërë një program që të mos priset çështja që sot në Turqi. Dhe këshilla për t’u dhënë armë Shqiptarëve pastër duket që Shqipënin dhe Makedhonin s’e bëjnë kopsht të luajnë atllarët e Vjenës dhe të Petersburgut. Dhe ky telegram prej së largu ua bën me dije shqiptarëve: tani po të jeni të zotë për kombin dhe vatanin e juaj punoni se ndihmën (jardenim) e keni prej Evrope po nën hije të të lumtës mbretëri osmane.”⁷

Në numrin 17 të datës 28 janar 1912 është botuar shkrimi me titull: “Sorrat e zeza po fluturojmë mbi hapësirën e Ballkanit “Dencer Arme-Zejtung” mbi çështjet””, ku ndër të tjera thuhet edhe kjo: “Ashtu më i madhi dhe i pari dhe i afërmi fqinj i Turqisë sot është Bullgaria. Bullgaria mendon se ka të drejtë sipas historisë në Makedhoni, ku shumica e ndenjësve që kur u themelua ekzarhia (1871) u bënë bullgarë. Andaj, ëndrra e Bullgarisë është një Bullgari e madhe. Marrëveshja e Sh. Stefanit për pak mbeti me ja çelë këtë ëndërr, por Kongresi i Berlinit me gërshtërit e veta ndryshe e preu setrën e Moskovit. Që kur Bullgaria i ndreqi punët e saja brenda, tani mund të quhet se është shteti i dytë në Ballkan pas Rumanisë, as një minutë (dakik) se kalon kot pa mos i nxjerrë në shesh aspiratat e saja që i ka mbi Maqedhonin”⁸. Më poshtë teksti vijon me këtë përmbajtje: “Me gjithë këto

⁶ Po aty

⁷ “Shkupi” Gaset’ e përjavshme, N. 11, 16.11.1911, fq. 2

⁸ “Shkupi” Gaset’ e përjavshme, N. 17, 27.01.1912, fq. 2

shpallje nuk është bash ashtu rëndë të mbyllet kjo çështje, që Bullgarisë sa orë t'i vjen për shtati, të mos kthen sytë karshi dashurisë së saj të farkuar (Maqedonis) dhe kush na bëhet garantues se s'na hap një të përzier të re në Turqi".⁹

Në numrin 18 të datës 8 shkurt 1912, në faqen e parë është botuar shkrimi me titull: "Vëllezërit e kuq", e që ka të bëjë me themelimin e shoqërisë së fshehtë me të njëjtin emër. Pas sqarimit se kjo shoqëri e fshehtë ka dërguar letër deri te të gjitha gazetaret e Ballkanit, përcillet edhe përmbajtja e letres së përmendur. Mes tjerash në letër qëndron edhe kjo: "Ne vëllezërit e Kuq në emër të lirisë do ta çojmë bajrakun e kryengritjes të Ballkanasve. Egërsisë dhe trembjes do t'i përgjigjemi me egërsi dhe trembje. Kundër fuqisë që mundohet të shtypë do ta nxjerrim shpatën e përgjakur të kryengritjes. Atdhetarë dhe kryengritës, grumbullohuni rreth bajrakut tonë. Qeverisë Osmane e komitetit të Turqve të Rinj, që rijnë fshehur pas qeverisë, po i themi: Ju do të jeni më të parët përmbi të cilët do ta shfryjmë mërinë tonë, por në qoftë se nuk diktoni e jepni laikun atyre që janë duke shtyrë mërinë në kazanë e Florinës e të Llangazes; nuk do t'i gjykoni gjakësorët e Grebenës, vrasjet e Zeki beut, të gazetarit; nuk do t'i faroni çetat që janë duke e nderuar popullin e Maqedonies e nuk u jepni fund e t'u jepni laikun atyre që kanë qenë shkak të derdhet gjaku në Shtip. Rroftë Vëllazëria e kombësive të mbretërisë Osmane e të Ballkanit! Rroftë besa e Ballkanasve! Rroftë kryengritja e Ballkanasve! Vëllezërit e Kuq."¹⁰

Në numrin 20 të datës 1 mars 1912 është botuar teksti: "Reformat" (Islahati) në Maqedoni dhe Shqipni. Në këtë tekst shkruan se komisioni i reformave i përbërë prej 9 personave kanë marrë kompensime për vete dhe se koha do të tregojë si do të rrjedhë kjo dallavere e kohës së re.¹¹

Në numrin 22 të datës 21.03.1912 në tekstin me titull: "Reformat" (Islahati) i ri në Maqedoni dhe Shqipni", teksti fillon me fjalët: "Ka një kohë që tepër shpesh po dëgjohen këto "reforma" pothuajse si një rrufe prej qiellit të kthjellët po bien mbi dhe, duke na e bërë me dije "për reformat e reja" sido n'Shqipni, sido n'Jemen dhe n'Makedhoni... Tërë një listë është mbushur me shkraba dhe përralla duke thënë "reforma" në Maqedoni dhe n'Shqipëri... Tani le të shikojnë mirë Makedhonsit dhe Shqiptart, se me ç'rrugë do t'i bëjë çirak me "reforma" "në kohën e lirisë" rahmetli xhemieti... Në këtë mënyrë Stambolli, do të shtijë hi në sytë e Makedhonsivët dhe t'Shqipetarvet, duke u thënë që dëshirojnë të bëjnë "reforma" dhe ta çojnë vendin pas kohës së qytetërimit në shekullin 20. Në Shqipni e n'Makedhoni s'ka njeri sipas mendimit tonë që u zë besë përrallave që po dalin prej kokave të zbrazëta të një pomak Nazimit e shokut të tij, të cilët e rrjepin dhe do ta rrjepin këtë budalla milet që fle hala."¹²

Gazeta "Shkupi" nr. 26 e datës 3 maj 1912 në faqen e dytë e sjell shkrimin me titull: "Misioni i maqedonasve në Sofje". Teksti i këtij shkrimi i përmban këtë fjalë: "Edhe më parë u kemi shkruar që Komiteti Bullgar çoi një mision në Evropë, për ta

⁹ Po aty

¹⁰ "Shkupi" Gaset' e përjavshme, N. 18, 08.02.1912, fq. 1

¹¹ "Shkupi" Gaset' e përjavshme, N. 20, 01.03.1912, fq. 1

¹² "Shkupi" Gaset' e përjavshme, N. 22, 21.03.1912, fq. 1

treguar situatën dhe padrejtësinë që bëhet në Maqedoni kundër kombit Bullgar. Tani u kthye në Sofje Z.Z. Miletiq e Gergovi të cilët e patën këtë mision dhe i thanë gazetës “Reç”: Misioni i jonë në Evropë shumë më tepër ka pas efekt tani se sa e mendonim ne vet. Mendimin në Evropë e kemi gjetur shumë kundër administratës dhe mendimit të Xhemietit. Na morën në audiencë dhe na e dëgjuan hallin tonë shefat e politikës nëpër ministritë e punëve të jashtme, si në Petersburg, Londër, Paris, Romë, përveç këtyre kemi folur edhe me qindra njerëz tjerë të politikës në Evropë. Para këtyre njerëzve kemi folur me gojë dhe dhënë me të shkruara tërë situatën dhe lutjet tona sistematike për Makedoni. Besimin në qarqet politike të Evropës e kemi marrë vesh dhe fituar, se vërtet Evropa mendon që vërtet të shpëtojnë Makedonit prej tiranisë që sot, duhet vetëm me ua dhënë dhe aplikuar programin e Revalit. Në Vjenë dhe Berlin nuk shkuam, nga shkaku që në programin e Revalit nuk ka marrë pjesë as Vjena as Berlini. Miletiqi thotë që qëndrimet dhe vështrimet e komitetit të Ballkanit për punët e Maqedonisë është pothuajse ai mendim që e ka organizata Makedon. Besim dhe shpresë të fortë kemi në dritën që hapet e shikohet mbi situatën e Maqedonisë, dhe si do të jetë puna kombi bullgar nuk do të jetë i padrejtësuar për hakun e vetë që e ka në Makedoni. Dhe kemi dhënë besim në ato vende ku kemi qenë që në Turqi asgjë nuk është dëgjuar që nga koha e vjetër, megjithëse që sot ka kushtetutë. Organizata e Makedonlive ka dhënë urdhër që të zgjatet lufta kundër aksionit dhe administratës së xhemietit deri sa ta shuaje, që sa më shpejtë të bëjë intervenim Evropa (të përzihet në punët e Turqisë).¹³

Numri 27 i datës 15 maj 1912 e sjell shkrimin me titull: “Detyra e madhe e Bullgarisë”. Ky shkrim përcillet nga gazeta bullgare e Sofjes “Veçerna Posta”. Në tekst shkruhet: “Nga të folmet e Sazanofit dhe të Bertholdit po duket që asnjë gjë nuk do të ndryshohet në punët e Makedonis dhe do të jetë sikur është sot, me gjithë se lufta do të ndalet dhe pajtimi do të bëhet në mes të Turqisë dhe Italisë. Por situata në Maqedhoni është aq keq sa s’durohet më, se Turqia atje e kthen politikën e vet për ta faruar kombin Bullgar, mbi këtë Turqia ka (makina infernal për t’i vra Bullgarët e lirë, domethënë bullgarët në Bullgari). Në qoftë se Bulgaria e le kështu si sot Turqinë, në pak kohë për një të ardhme të mirë për Bullgari mos e prit aspak, dhe po të kërkohet që të ndryshohet situata në Makedhoni si më mirë gjithashtu, veç kësaj do të jetë dhe do të bëhet një dëm i madh dhe i trembshëm nga ana e Turqisë për Bullgarinë e Lindjes (Rumelinë). Dëmi dhe rreziku për Bullgarinë e për Makedhoni po shikohet sy me sy dhe vetëm të verbët nuk e shohin”.¹⁴ Shkrimi më poshtë vijon: “Gazeta sërish pyetet a janë prishur kaq të holla për të qëndruar kundër Serbëve dhe Rumunëve a për ta realizuar idealin tonë që kemi për Makedhoni”.¹⁵ Më pas ky shkrim vijon me këtë përmbajtje: “Si gazeta ashtu edhe një bullgar tjetër që ka folur disa ditë më parë po lypin që të mblidhet një Parlament

¹³ “Shkupi” Gaset’ e përjavshme, N. 26, 03.05.1912, fq. 2

¹⁴ “Shkupi” Gaset’ e përjavshme, N. 27, 15.05.1912, fq. 1

¹⁵ Po aty

i madh për ta treguar e shoshur se në ç'farë udhe duhet shkatërruar e ndrequr situata e kombit Bullgar si në Bulgari ashtu dhe në Makedhoni¹⁶.

Në numrin e njëjtë, në faqen e dytë është botuar shkrimi me titull: “Studentët bullgarë dhe Makedhonia”, ku shkruan: “Studentët e Bullgarisë kanë pas një mbledhje me të cilën kanë bërë këtë program e rezolutë: Sot e më tej do të punojmë më rreptë për t’u fituar autonomia e Makedhonis, dhe të bëjmë një memorandum të cilin do t’ua japim kabinetëve të Evropës ku do të shënojmë: ja autonomi Makedhonis, ja t’ja japin zjarrin anë e kënd e ku ndodhet një shpirt Bullgar”.¹⁷

Në numrin 29 të datës 16 qershor 1912 botohet shkrimi i fundit që ka të bëjë me Maqedoninë. Shkrimi mban titullin: “Anglia dhe Turqi”. Në të thuhet: “Anglia (hyqmeti) i thotë Turqisë po të duash të holla unë po t’i gjej, ose po të jap hua, po ti do ta kesh si për detyrë për t’i dhënë si një vetëqeverisje të vogël Shqipnis dhe Makedonis. Vetëm atëherë do të gjesh dhe mund të të japim të holla”¹⁸.

¹⁶ Po aty

¹⁷ Po aty, fq. 2

¹⁸ “Shkupi” Gaset’ e përjavshme, N. 29, 16.06.1912, fq. 2

ZUNUN ZUNUNI
SILVANA JOVÇESKA

SHPËRNGULJA E POPULLSISË NGA RAJONI I MAVROVËS DHE ROSTUSHËS PËR NË TURQI

***Abstrakt.** Shpërngulja e popullsisë nga fshatrat e Komunës së Mavrovës dhe Rostushës të Maqedonisë për në Republikën e Turqisë paraqet një proces të dhembshëm dhe me pasoja të pashërueshme. Edhe pas një gjysmë shekulli e më shumë, banorët e Komunës së Mavrovës dhe Rostushës, para se gjithash më të moshuarit, me vuajtje në fytyrë kujtojnë fotografitë e dikurshme të ndarjeve nga familja, të ndjenjës së dhembjes dhe keqardhjes dhe të jetës përplot pasiguri. Periudha mes viteve 1953 dhe 1960, përshkruhet si e rëndë, kujtimet kanë qenë të drejtuara në drejtim pa kthim, të cilin e ka mbartur me vete mërgimi.*

Në punimin “Shpërngulja e popullsisë nga Komuna e Mavrovës dhe Rostushës në Republikën e Turqisë” jepet një fotografi e qartë për procesin e migrimit të pakthyesëm të popullsisë nga këto vende. Është bërë një përshkrim i qartë dhe konciz i shkaqeve, ndikimeve dhe faktorëve të cilët kanë sjellë për shpërnguljen dhe boshatisjen e kësaj hapësire shumë të bukur. Është përshkruar procedura dhe problemet me të cilat është ballafaquar popullata gjatë sigurimit të dokumenteve të nevojshme për shpërngulje. Është bërë një paraqitje tabelare e numrit të të shpërngulurve, në vitet kur kjo dukuri merr hov të madh dhe kulmon me qindra qytetarë të shpërngulur nga fshatrat e komunës gjatë një viti. Është bërë një vështrim i akomodimit të mërgimtarëve në vendin e tyre të ri, Republikën e Turqisë, si dhe janë dhënë vështrime për ruajtjen dhe kultivimin e traditave të vendlindjes dhe kontakteve të mërgimtarëve me vendlindjen e tyre.

a) Arsyet e shpërnguljes

Shkaqet për shpërnguljen e popullsisë nga Komuna e Mavrovës dhe Rostushës, për në Republikën e Turqisë, qëndrojnë në sistemin e ri politik, i cili atëherë zbatohet në RSM. Shpërngulja nga disa vende të shtetit filloi menjëherë pas çlirimit të tij në

vitin 1945. Kështu, lirisht mund të thuhet se nuk ka ekzistuar ndonjë lagje ku ka jetuar popullsi me besim islam, ku kjo çështje nuk ka qenë e përditshme dhe aktuale. Mbeten diskutabile pyetjet nëse ishte shpërngulja e popullsisë e (para)menduar nga regjimi i atëhershëm me sjelljen e disa ligjeve, të cilat tangonin të drejtat fetare dhe bindjet e të shpërngulurve, dhe a mund që kjo të ndalej. Ashtu si në pjesët të tjera të vendit, procesi i shpërnguljes së njerëzve nga vendbanimet e Komunës së Mavrovës dhe Rostushës fillon pas vitit 1951, ndërsa kulmin e arrin në vitin 1955 dhe 1956. Shpërngulja vazhdon edhe gjatë viteve të gjashtëdhjeta, por me intensitet më të ulët. Për dallim nga periudha e parë e migrimit në këtë rajon, i cili zhvillohej (lëvizte) fshat-qytet, në kuadër të kufijve shtetërorë, tani bëhet fjalë për migrim të jashtëm, i cili zhvillohej jashtë kufijve shtetërorë. Ky migrim është karakteristik për faktin se i ka përfshirë në tërësi fshatrat me popullsi myslimane. Krahas shkaqeve të tjera që kanë ekzistuar, rol të madh në këtë proces ka luajtur edhe propaganda, e cila zgjerohej dhe kishte kontribut të rëndësishëm në sjelljen e vendimit pozitiv për shpërnguljen. Një pjesë e mirë e popullsisë turke në vend ishte poseduese e madhe e pronave, që do të thotë se ata veçanërisht kanë qenë të goditur nga Ligji për nacionalizim të pronës private, blerjes së obliguar, kolektivizimit dhe nga Ligjet e tjera dhe masat e shtetit, të miratuara në periudhën e viteve 1948-1953. E gjithë kjo ka nxitur aksionin për shpërnguljen e tyre sistematike nga Maqedonia. Shpërngulja është rritur në mënyrë plotësuese me Ligjin për heqjen e ferexhesë, në vitin 1951. Ky ligj në mënyrë të drejtpërdrejtë ka goditur ndjenjat fetare të popullsisë myslimane, që është kuptuar si ofendim i nderit nacional dhe dinjitetit të këtij populli.

Kërkesën e pakicës turke për kthim në Turqi, pushteti zyrtar shtetëror-partiak e cilësonte si “aktivitet armiqësor kundër rikonstruimit socialist të fshatit”, i zbatuar nga “elementet reaksionare”. Ky zhvillim i ngjarjeve kishte shkaktuar frikë te kjo popullsi, nga jetesia e mëtejshme në një vend me rregullim socialist. Popullsia turke “pa faj dhe pa borxh, sikur të duhej të paguante mëkatin e sundimit pesëshekullor otoman në Maqedoni”. Në kushtet e atëhershme ndërkombëtare të ndarjes rigorozë ideologjike-politike në taborë “socialistë” dhe “kapitalistë”, turqit sikur të ishin të shpallur si “pakicë armike”, sepse Turqia ishte vend kapitalist, ndërsa Maqedonia vend me sistem socialist të qeverisjes. Sipas disa të dhënave, në vitet e pesëdhjeta dhe gjashtëdhjeta, nga Maqedonia janë shpërngulur rreth 150 mijë turq dhe njerëz të tjerë me besim islam, ndërsa në tërë periudhën e pasluftës, mbi 200 mijë persona. Me ardhjen e komunistëve në pushtet, të cilët ishin deklaruar si ateistë, turqit në masë të madhe janë ndier fetarisht të cenuar, duke vlerësuar se nuk ka “religjion pa mbret”, sepse në kohën e Jugosllavisë së vjetër, besimi fetar ka qenë i garantuar me Ligj. Për shkak kësaj, prirja e tyre kah sistemi i ri, ka qenë e vogël.

Shteti, duke propaganduar barazi nacionale, praktikisht ka konsideruar se do të krijojë një ambient të ri, por shpejt është bërë e qartë se jeta sipas rregullave islamike, për turqit do të ishte më me rëndësi sesa barazia e proklamuar. Në fakt, në Mbretërinë e Jugosllavisë, ata nuk kanë pasur të drejtat e pakicës, por kanë pasur lirinë e besimit fetar, shkollave fetare (mektebe), të cilat kanë ekzistuar pothuajse në çdo xhami dhe kanë qenë masivisht të vizituara nga fëmijët, në llogari të shkollave të rregullta. Së pari, pakënaqësi nga mënyra e re e qeverisje, kanë

shprehur përfaqësuesit më të njohur fetarë, e më pas edhe njerëzit e tjerë. Për shkak këtij fakti, edhe shpërnguljet e para janë shpjeguar me “ndjenjën fetare dhe nacionale”. Këtu, një nxitje plotësuese për shpërnguljen ka dhënë edhe qëndrimi i shtetit “që të mos i jepet askujt e drejta e shpërnguljes”, me çka autoriteti i kanë penguar kërkesat për shpërngulje, ndërsa kjo ka sjellë deri tek kalimi ilegal i kufirit. E tërë kjo ka qenë e përcjelltë me një propagandë të madhe. Është kërkuar ndihmë nga qeveria turke, për shpëtimin e komunizmit në Jugosllavi.

Situata njerëzve u është dukur më e volitshme me Rezolutën e Informbyrosë së vitit 1948 dhe me ftohjen e marrëdhënieve me vendet socialiste, dhe nga ana tjetër, përmirësimin me ato kapitaliste, me çka janë përmirësuar marrëdhëniet me Turqinë. Ky ndryshim ka mundësuar ardhjen e delegacioneve turke në Maqedoni, të cilat kanë treguar një fotografi idilike dhe joshëse për jetën në Turqi dhe për kujdesin e qeverisë turke për ardhacakët, që ka ndikuar mjaft fort tek turqit në Maqedoni, tek maqedonasit e besimit islam, dhe në masë më të vogël te popullsia shqiptare.

Popullsia nga Komuna e Mavrovës dhe Rostushës nuk ka qenë edhe aq e goditur nga Ligji për kufizimin e pronës tokësore në 10 hektarë, të sjellë në vitin 1953, ashtu siç kanë qenë të goditur bujqit turq, por prapëseprapë, ka qenë e tanguar nga Ligji për blerje të obliguar (1946) dhe nga nacionalizimi i pronës private (1948). Këto masa ligjore, veçanërisht kanë prekur tregtarët dhe zanatçinjtë, të cilët nuk kanë mundur t’u përshtaten këtyre ndryshimeve, dhe kanë kërkuar shpëtim tek shpërngulja. Sidoqoftë, popullata më së shumti ka qenë e goditur nga pakujdesia e shtetit dhe propaganda, e cila përhapej në këto vende, sepse tanimë dihej se kusht për shkuarje në Turqi ka qenë njohja e gjuhës turke dhe deklarimi i të shpërngulurit si turk.

Si shkak plotësues për shpërnguljen ka qenë edhe Ligji për heqjen e feresës, i sjellë më 12.01.1951. Ajo është kuptuar si ofendim i nderit nacional dhe dinjitetit të popullsisë turke dhe të tjerëve që i përkisnin besimit islam. Pas sjelljes së këtij ligji, autoritetet janë hedhur në zbatimin e ashpër të dispozitave ligjore për heqjen e mbulesës, me çka në mënyrë plotësuese kanë nxitur ndjenjën antikomuniste te ky popull dhe në qëndrimin e tij për shpërnguljen, si alternativë e vetme dhe shpëtim nga komunizmi.

Në vitin 1954, Komisioni për pakica kombëtare pranë KQ të SKM-së ka konstatuar se shpërngulja – migrimi nuk është dukuri e re, që do të thotë se nuk është veprim kundër ndërtimit të socializmit, edhe po qe se do të paraqiteshin të tilla dukuri, ato nuk do të ishin të rëndësishme për shpërnguljen. Kjo do të thotë se nga viti 1954, praktikisht hapen dyert e shtetit për shpërnguljen e një pjesë të popullatës, gjegjësisht fitohet e drejta për shpërngulje pa asnjë pengesë nga ana e shtetit. Gjithashtu, ka qenë e lejuar që personat që shpërngulen t’i shesin pronat e tyre, ndërsa kjo ka qenë e rëndësishme së madhe për turqit, sepse ata kanë qenë posedues të mëdhenj të pronave.

Shpërngulja e popullsisë nga Komuna e Mavrovës dhe Rostushës në Turqi ka qenë më e vogël në krahasim me shpërnguljen nëpër pjesët tjera të vendit, ku në mënyrë masive janë braktisur fshatra dhe qytete të tëra. Në Komunën e Mavrovës dhe Rostushës është vërejtur vetëm një rast i shpërnguljes masive, edhe atë në fshatin

Boletin. Njerëzit e Boletinit kanë thirrur tubime ku kanë bërë organizimin e shpërnguljes së tërë fshatit. Në Boletin, me regjistrimin e popullsisë në vitin 1953, janë regjistruar 390 banorë, ndërsa me regjistrimin e vitit 1961 janë regjistruar vetëm 15 banorë, të cilët më vonë janë shpërngulur. Kështu, sot në Boletin mund të vërehen vetëm muret e rrënuara të shtëpive, të cilat kanë ekzistuar në vitet e gjashtëdhjeta. Kjo do të thotë se shpërngulja e popullsisë nga fshatrat e Komunës së Mavrovës dhe Rostushës ka qenë individuale. Në fillim dëshira për shpërngulje është paraqitur tek disa nëpunës fetarë, dhe njerëz të tjerë të pasur, ndërsa më vonë edhe tek pjesa e mbetur e popullatës myslimane. Me këtë është nxitur dëshira që të shpërngulen edhe njerëzit më të varfër që të mos mbeten të vetëm në vendlindjen e tyre.

b) Zhvillimi dhe procedura e shpërnguljes – probleme me sigurimin e dokumenteve për shpërngulje

Leje për shpërngulje (vesikë) nga Konsullata Turke në Shkup kanë fituar vetëm ata kandidatë që në legjitimacionet e tyre janë evidentuar si turq dhe që kanë folur gjuhën turke. Aplikuesit kanë dorëzuar kërkesa tek organet e punëve të brendshme në terren, gjegjësisht në komunë për çregjistrimin e nënshtetësisë jugosllave, duke i dorëzuar edhe dokumentet e nevojshme. I tërë procedura ka qenë shoqëruar me dhënien e mjeteve të caktuara financiare për mbulimin e shpenzimeve për shpërnguljen dhe të rrugës. Në fillim, janë paraqitur probleme lidhur me grumbullimin dhe sigurimin e dokumenteve për shpërngulje. Që të noterizoheshin të gjitha dokumentet ka qenë i nevojshëm një vit, ndonëse periudha e zakonshme ka qenë 6 deri në 8 muaj. Gjatë sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm, vështirësi veçanërisht kanë pasur njerëzit e lagjeve të fshatrave malore, siç janë Komuna e Mavrovës dhe Rostushës. Këtë konstatim e mbështesin edhe një sërë shkaqesh. Njerëzit e fshatrave nuk kanë qenë mjaft të arsimuar, që do të thotë se nuk i kanë kuptuar ligjet dhe procedurat për mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm. Gjithashtu, për ata ka paraqitur problem edhe shpenzimet financiare, të cilat është dashur t'i mbulojnë të gjithë personat madhorë të një familjeje. Kjo për ta ka qenë vërtet e vështirë, aq më shumë që gjatë procedurës së nevojshme është dashur të shkojnë disa herë deri tek organet: për parashtrimin e lutjes, për çregjistrimin e nënshtetësisë jugosllave, për dhënien në shpallje dhe pranimin e vendimit. E tërë kjo ka paraqitur një vështirësi plotësuese për banorët e këtyre fshatrave, për arsye se ato, që sot i përfshin Komuna e Mavrovës dhe Rostushës, kanë qenë në kuadër të Rrethit të Tetovës. Shpenzimet financiare kanë sjellë pasoja të reja për jetën e njerëzve. Ekzistojnë raste që flasin për pasigurinë me të cilën janë ballafaquar njerëzit, kur atyre nuk u është pranuar kërkesa për shpërngulje. Ata, me qëllim që të sigurojnë mjete financiare të nevojshme për shpenzimet e procedurës për shpërngulje, fillimisht kanë shitur një pjesë të pronës, ose ua kanë lënë familjarëve të tyre, si garanci për huan e marrë nga ata. Kur atyre u është refuzuar kërkesa për shpërngulje, ata kanë qenë të detyruar të vazhdojnë të jetojnë në kushte të rënda, pa asnjë pronë dhe pa shpresë për ardhmërinë e tyre. Gjithashtu, vështirësi janë paraqitur edhe gjatë marrjes së letrave garantuese. Disa nga fshatarët nuk kanë

pasur familjarë në Turqi, prandaj i janë drejtuar qverisë turke, me kërkesë që t'u japë garanci, për të cilën është dashur të presin disa muaj.

Për shkak të vështirësive që janë paraqitur gjatë kërkesave për dhënie e lejeve për shpërngulje, kjo procedurë pas vitit 1954 ka qenë e përshpejtuar dhe lëndët zakonisht janë kryer për 2-3 muaj, përfshirë këtu edhe kohën për fitimin e pëlqimit nga Sekretariati Federal Shtetëror për Punë të Brendshme. Vala më e madhe e shpërnguljes është shënuar pas viteve 1954, 1955, 1956 dhe 1957, ndërsa më pas interesi për shpërngulje është ulur. D.m.th, shpërngulja intensive ka filluar diku në vitin 1951, ndërsa kulmon në vitin 1955. Sipas disa indikacioneve, kjo shpjegohet me faktin se deri atëherë janë shpërngulur të gjithë ata persona më të pasur, gjegjësisht ata që kanë mundur të fillojnë një veprimtari private në Turqi, ndërsa kanë mbetur ata që kanë qenë në gjendje më të dobët materiale. Shkak për këtë kanë qenë edhe taksat e larta, të cilat është dashur të paguhen gjatë çregjistrimit të nënshtetësisë jugosllave. Ndikim në ndërprerjen e shpërnguljes ka pasur edhe Ligji për nacionalizim të tokës shtetërore, miratuar më 25.11.1958. Me këtë Ligj është ndaluar shitja e një pjese të pronës së patundshme private, që ka sjellë probleme plotësuese. Kështu, janë paraqitur raste kur personat që i kanë shitur pronat e tyre, nuk kanë mundur t'ua bartin pronësinë blerësve, sepse paraprakisht pronat kanë qenë të nacionalizuara nga shteti.

Krahas këtyre shkaqeve, për uljen e valës së madhe të shpërnguljes, ka ndikuar edhe propaganda e cila ka ardhur nga Turqia dhe të thënave për jetën e vështirë dhe të lodhshme, nga njerëzit të cilët paraprakisht janë shpërngulur në atë vend. Turqia për ata ka qenë e panjohur dhe një vend i ri, ku është dashur të punojnë nga mëngjesi e deri në mbrëmje, për të siguruar ekzistencë për familjet e tyre. Një pjesë e njerëzve, të cilët janë shpërngulur më herët, u kanë shkruar familjarëve të tyre që të qëndrojnë në Maqedoni, sepse jeta në Turqi është e rëndë dhe paraqet luftë për mbijetesë ekonomike. Edhe pse Turqia paraprakisht është paraqitur si vend i parajsës, me kushte të mira ekonomike që ekzistojnë vetëm atje, vend ku me pak punë dhe pak të holla mund të arrihet shumë, realiteti me të cilin janë ballafaquar pas vendosjes atje, ka qenë krejtësisht tjetër. Për dallim nga Turqia, në Maqedoni prindërit për fëmijët e tyre kanë marrë kompensim në të holla, ndërsa ata që kanë pasur më shumë fëmijë kanë fituar mjete plotësuese, si shpërblim.

Shpërngulja ka krijuar një fotografi të dhimbshme. Janë ndarë prindërit nga bijtë dhe bijat e tyre, nga vëllezërit dhe motrat, miqtë dhe fqinjët, janë prishur marrëdhëniet familjare dhe familja në tërësi. Shkak për këtë fotografi të dhimbshme, është shpërngulja jo e plotë e familjeve dhe mbetja e një pjese të tyre në vendlindje. *Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, numri më i madh i të shpërngulurve nga Republika e Maqedonisë në Republikën e Turqisë, është shënuar në vitin 1955, kur brenda vitit janë shpërngulur 38.145 persona.*

Tabela 2 – Persona të shpërngulur nga R. e Maqedonisë në R. e Turqisë, në periudhën prej 1951 deri në 1958

Vitit 1951	31 persona
1952	153
1953	1931
1954	17.369
1955	38.145
1956	28.816
1957	27.432
1958	13.244

Burim: Përlllogaritje të mia, në bazë të regjistrimit të popullsisë në Republikën e Maqedonisë, të zbatuar në vitin 2002.

Në periudhën prej vitit 1953 deri më 1971, në Republikën e Turqisë janë shpërngulur mbi 200 persona nga vendbanimet e Komunës së Mavrovës dhe Rostushës. Krahas fshatit Boletin, prej ku janë shpërngulur të gjithë 390 banorë (aq banorë ka pasur me regjistrimin e popullsisë në vitin 1953), numri i të shpërngulurve është i lartë në fshatrat e tjera: nga Zhirovnica janë shpërngulur më shumë se 400 persona, nga Skudrinja 300 persona, nga Vidusha 250 persona, nga Trebishta 200 persona, nga Velebrda 140 persona, nga Rostusha mbi 150 persona dhe në numër më të vogël në fshatrat e tjerë të komunës, ku ka jetuar popullsi myslimane. Popullsia në këtë rajon është koncentruar në qytetet turke, si: Stamboll, Izmir, Adana, Manica, Izmit, ndërsa një pjesë e vogël në qendrat tjera ekonomike në Turqi. Sot, në këto qytete të Turqisë, ka rrugë të tëra të banuara më banorë nga rajoni i Reçanit të ulët.

c) Problemi i adaptimit të të shpërngulurve të Komunës së Mavrovës dhe Rostushës në mjedisin e ri në Turqi

Shpërngulja në Turqi ka qenë e vështirë dhe e pasigurt, gjë të cilën e dëshmojnë vështirësitë me të cilat janë ballafaquar të shpërngulurit në mjedisin e ri. Fotografia për Turqinë, e cila paraqitej si idilike, në fakt ka qenë një realitet krejtësisht tjetër. Kur të shpërngulurit e Komunës së Mavrovës dhe Rostushës kanë arritur në Turqi, problemi i parë me të cilin disa prej tyre janë ballafaquar ka qenë mosnjohja e gjuhës turke, me çka u është rënduar komunikimi me autoritetet kompetente dhe me popullatën e atjeshme. Kjo e fundit nuk i ka pranuar me gëzim të shpërngulurit nga Maqedonia, por ata i shihet si të huaj të panjohur, me të cilët në të ardhmen do të duhet ta ndajnë bukën. Ata i kanë konsideruar si konkurrentë dhe rrezikues të hapësirës së banimit dhe të fondeve shtetërore, në të cilat ata i kanë inkasuar tatimet e tyre. Për popullatën e atjeshme turke, të ardhurit ishin “maxhirë” – ardhacakë. Me këtë term johuman, vite me radhë janë quajtur të shpërngulurit të cilët janë vendosur në Turqi. Ata gjithashtu janë ballafaquar edhe me probleme gjatë punësimit, sigurimit të shtëpive (shtëpive të përkohshme, të cilat ua ka dhënë

shteti), ndërsa janë ballafaquar edhe me probleme gjatë shkollimit të fëmijëve, sepse nuk e kanë njohur gjuhën turke.

Jeta e të shpërngulurve nga Komuna e Mavrovës dhe Rostushës, në mjedisin e ri, në fillim ka qenë përplot me sfida, por në periudhën që pason, me ndihmën e shtetit dhe me aftësitë për krijim, të shpërngulurit janë bërë të arsimuar, të pasur dhe qytetarë dinjitozë të Turqisë.

ç) Ruajtja dhe kultivimi i traditave të vendlindjes dhe të kontakteve me Maqedoninë

Pas shpërnguljes, tek banorët e shpërngulur shpesh paraqitej dëshira për vizitë në vendin e lindjes dhe për ruajtjen e lidhjeve me miqtë dhe familjarët. Kështu, ata në fillim për vizitë në vendlindje shkonin një herë në vit. Por, më vonë numri i atyre vizitave është rralluar dhe janë bërë një herë në dy apo tre vite, ose janë bërë me ndonjë shkas, si për shembull dasma e ndonjë familjari të afërt dhe të ngjashme, që do të thotë rrallë e më rrallë.

Kjo ka ndodhur për shkak të largësisë mes Turqisë dhe Maqedonisë dhe për shkak se mjetet financiare të nevojshme për realizimin e vizitave kanë qenë vërtet të mëdha. Por, këtu ka ekzistuar edhe në shkak tjetër. Gjegjësisht, me dispozitat e kushtëzuara nga marrëdhëniet mes RSFJ-së dhe Turqisë, të cilat në atë kohë kanë qenë në fuqi, qytetarët të cilët e kanë braktisur Maqedoninë kanë qenë të obliguar t'i zgjidhin të gjitha çështjet juridiko-pronësore, me qëllim që në të ardhmen e largët ata të mos kenë të drejtë në asnjëfarë kompensimi. Kjo do të thotë se njerëzit të cilët janë shpërngulur, kanë qenë të obliguar t'i shesin shtëpitë dhe pronat e tyre. Prandaj, ata kur kanë ardhur në Maqedoni, është dashur të qëndrojnë tek familjarët dhe miqtë e tyre, gjë që sigurisht se e ka kufizuar qëndrimin e tyre. Marrëdhëniet e ndërsjella janë ruajtur edhe në mënyrë që njerëzit, të cilët kanë mbetur të jetojnë në Maqedoni, shpeshherë i kanë vizituar familjarët e tyre, miqtë dhe bashkëfshatarët në Turqi.

Megjithatë, pasi kanë kaluar 40-50 vjet nga vala e madhe e shpërnguljes, lidhjet në mënyrë të natyrshme janë zbehur, kështu që tani nuk ka vizita të mëdha nga Turqia në Maqedoni, ose anasjelltas. Kjo është plotësisht normale, sepse gjeneratat e reja tashmë nuk janë, ndërsa fëmijët, të cilët atëherë kanë qenë në moshën 5-6 vjeçare, tash janë në moshën 50-vjeçare, kështu që lidhjet familjare dhe miqësore ngadalë janë zbehur. Sidoqoftë, nostalgjia për vendlindjen ka mbetur, e ndoshta sikur të shpërngulurit (mërgimtarët) të kishin mundësi për vendosje në vendin e lindjes së tyre, vizitat në Maqedoni sërish do të shpeshtoheshin. Gjegjësisht, sipas mërgimtarëve, autoritetet komunale duhet të gjejnë mënyrë dhe të sigurojnë lokacione për ndërtimin e hoteleve dhe bungallove, të cilat do të jenë të rëndësishme së madhe për vizitat në vendlindjen e tyre.

Kur flasim për migrimin, duke e ditur se njëra nga shkaqet për shpërngulje ka qenë kërkesa për një jetë më të mirë ekonomike, do të përmend se në hulumtimin tim erdha deri tek informacionet se një pjesë e njerëzve, të cilët janë shpërngulur në Turqi, kanë një jetë modeste, njëjtë sikurse jetohej edhe në Republikën e Maqedonisë. Derisa ata që edhe këtu kanë qenë më të pasur dhe më të arsimuar,

praktikisht edhe në Republikën e Turqisë e kanë vërtetuar të njëjtën. Një pjesë e mërgimtarëve tanë janë kyçur aktivisht në jetën politike në Turqi. Do të përmend këtu rastin me Ferit Hoxhën, si njëri nga të shumtit që janë. Ferit Hoxha është i lindur më fshatin Rostushë dhe gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore, ndërsa paraprakisht edhe në Mbretërinë e Jugosllavisë, ka qenë hoxhë në fshatin Rostushë. Pas çlirimit, ka kryer disa kurse për arsimtar dhe ka punuar si mësimdhënës në shkollën e fshatit Rostushë, derisa është shpërngulur në Turqi. Aftësia e tij, dituria dhe shkathtësia, asnjëherë nuk kanë qenë kontestuese. Ai në Turqi ka jetuar në qytetin e Bursës, ku ka vazhduar të punojë si mësimdhënës, falë asaj që, si hoxhë, e ka njohur gjuhën turke. Për shkak të dashurisë së madhe ndaj vendlindjes, Ferit Hoxha mbiemrit të tij ia ka shtuar edhe shtesën “Rekali”, dhe emri i tij i plot është Ferit Hoxha Rekali. Ai sot në Turqi posedon hotel pranë Detit e Marmarasë, në qytetin Kurshumli, ndërsa djemtë e tij, si kuadro mirë të arsimuara, ushtrojnë funksione të larta në Bursë.

Për atë se ekziston nostalgji për vendlindjen, flet edhe e dhëna se në fshatin Boletin janë ndërtuar dy vila nga mërgimtarë të mëparshëm në Turqi. Gjithashtu, i udhëhequr nga kujtimi dhe rrënjët që tërheqin kah vendlindja, mërgimtari Fuat Beqiçi i dhuroi Shtëpisë së Shëndetit në Rostushë një automjet modern sanitar për ndihmë të shpejtë. Një mërgimtar tjetër, me emrin Haxhi Demir Tahirogllu, është një nga investitorët dhe donatorët më të mëdhenj në xhaminë e ndërtuar në vendlindjen e tij, fshatin Prisojnicë.

Literatura:

Зунуни З., Општина Ростуше во периодот 1945-2000 година со посебен осврт на миграционите движења, Институт за историја, универзитет “Св. Кирил и Методиј”, Скопје, 2004.

Зунуни З., Емиграционите движења од Македонија во Европа со посебен осврт на Италија, Институт за социолошки и политичко правни истражувања, Скопје, 2008.

Административно – територијални поделби во македонија 1944-2004, Документи, Институт за национална историја, Скопје, 2007.

Лазаров Л., Општествено – политичките организации во обновата и изградбата на НР Македонија 1944-1948, ИНИ, Скопје, 1979.

Аграрната реформа и колонизацијата во Македонија 1944 – 1953, ИНИ, Скопје, 1997.

Ачкоска В., Некои демографски движења и етничките промени во Р. Македонија по Втората Светска војна, Зборник: Македонците и Словенците во Југославија 1918 – 1991, Скопје, Љубљана, 1999.

Ачкоска В., Иселувањето на Турците од НРМ по Втората Светска војна 1945 – 1960, бр. 1-2, Скопје, 2002.

IZAIM MURTEZANI

KAH HERMENEUTIKA E DISA LOJËRAVE POPULLORE ME PRAPAVIJË TEATRORE

*Njeriu është qenie që luan. Njeriu vetëm në lojë është njeri
Shiler*

Abstrakt. Punimi mëton të trajtojë disa çështje që ndërlidhen me lojën popullore. Nëpërmjet prezantimit të disa lojërave popullore tentohet të depërtohet në fshehtësinë e tyre dhe të shpaloset logjika e ekzekutimit të tyre, sidomos ajo me natyrë pagane. Lojërat popullore, sidomos ato që i referohen kohës më të lashtë, si zakonisht ekzekutoheshin gjatë ndonjë ndodhie të rëndësishme të karakterit antropologjik (synetia, dasma, etj.), dhe kalendarik (kalimi prej dimrit në verë). Nëpërmjet tyre shënohej kalimi nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore, apo nga një status shoqëror në një status tjetër shoqëror. Si të tilla, këto lojëra, në shumicën e rasteve, ishin invariante të magjisë, rritit e kështu me radhë.

Loja si fenomen i ekzistencës njerëzore

Loja duke iu referuar një numri të madh të autorëve të ndryshëm, paraqet themelin e kulturës njerëzore, madje shkohet aq larg saqë thuhet se vetë kultura, por edhe arti në përgjithësi, e kanë zanafillën nga loja. Njeriu nuk mund ta paramendoj jetën pa lojë, madje kjo e përcjell atë në të gjitha fazat e jetës së tij duke filluar nga lindja e deri në vdekje. Si rrjedhojë, njeriu që kur ekziston asnjëherë nuk e ka ndërprerë lojën, madje e ka edhe shumë të vështirë, të mos themi të pamundshme, ta paramendojë jetën pa të. Disa studiues, ndër të cilët edhe Huizing duke e vërejtur këtë element si shumë të rëndësishëm shkonin aq larg saqë e cilësonin njeriun si *homo ludens*, madje një libër i tij ishte i pagëzuar me këtë sintagmë. Në këtë kontekst duke u ndërlidhur me këtë problematikë, filozofi i njohur Eugen Fink me plot të drejtë thekson se loja paraqet elementin e pestë themelor të ekzistencës njerëzore. Nëse këtë element, pra lojën, Eugen Finku, e radhit si të pestën në librin e tij, kjo nuk do të thotë se ajo është më pak e rëndësishme se elementet apo fenomenet tjera të ekzistencës njerëzore, si vdekja, puna, qeverisja dhe dashuria (Fink, 1984: 292). I njëjti autor nënvizon më tej se loja plekset me të gjitha këto

fenomene të ekzistencës njerëzore. Edhe pse loja është më e pranishme në fazën e fëmijërisë, kjo nuk do të thotë se ajo nuk paraqet fenomen themelor të ekzistencës njerëzore. Ajo që njeriun e përcakton si genie kohore nuk do të thotë se duhet të përsëritet në të gjitha fazat e jetës së tij. Kështu, vdekja qëndron në fazën e fundit jetësore, dashuria në kulminacionin e jetës, kurse loja (si lojë fëmijërore) në fillimin e jetës. Pra, të gjitha këto fenomene që paraqiten në faza të ndryshme jetësore e karakterizojnë dhe njëherësh e përbëjnë jetën e njeriut (Sipas Fink, 1984: 295).

Në funksion të kërkimit të përgjigjes se cili është ai faktor vendimtar që e detyron njeriun të luajë, pothuajse të gjithë autorët që merren me këtë problematikë, e vënë në pah nevojën e shpenzimit të energjisë së tepruar që e posedon qenia njerëzore. Në këtë kontekst theksohet se edhe kafshët nuk e shfrytëzojnë energjinë e tyre fizike vetëm në funksion të mbijetesës, apo sigurimit të ekzistencës biologjike, por një pjesë, apo tepicën e saj, e orientojnë kah argëtimi, apo *loja*. Nëse kjo vlen për kafshët, atëherë me siguri se një gjë e tillë edhe më tepër do t'i referohej njeriut i cili kur është i shëndoshë posedon një energji tejet të madhe, të cilën, përveç në procesin e punës, e shpenzon, sidomos tepicën e saj, në funksion të relaksimit, këngës, brohoritjes, lojës e kështu me radhë. Pra, të gjitha lojërat njerëzore janë rrjedhojë e nevojës së shpenzimit të energjisë së tepruar, prehjes, argëtimit, por edhe prologut para ndonjë aktiviteti më serioz. Kjo energji, meqenëse është më e madhe në kohën e rinisë, atëherë në këtë moshë ajo është edhe më e theksuar, kurse më vonë, sa më shumë që kalojnë vitet, aq më shumë bie niveli i saj.

Autorët e ndryshëm i kanë kushtuar kujdes, veç tjerash, edhe çështjes së klasifikimit të lojërave. Klasifikimi i tyre bëhet në mënyra të ndryshme. Sipas moshës, ato mund të jenë të destinuara për fëmijë, por edhe për moshën madhore. Sipas përkatësisë gjinore të subjektit, ato mund të jenë femërore dhe mashkullore, kurse sipas stinës së vitit, mund të jenë verore dhe dimërore. Sipas bartësve, apo pjesëmarrësve të tyre mund të jenë individuale, në çifte dhe grupe. Në kontekst të klasifikimit të lojërave duhet përmendur librin me titull *Lojëra dhe njerëz* të botuar në gjuhën frënge në vitin 1958 nga studiuesi francez Rozhe Kajoa. Ky libër që i destinohet krejtësisht teorisë së lojës, veçohet me të dhënë se mëton të bëjë klasifikimin e lojërave. Sipas këtij klasifikimi dallohen katër grupe themelore të lojërave që bazohen në këto parime: 1. Agon; 2. Alea; 3. Mimikria dhe 4. Ilinks. Grupi i parë i përfshin lojërat në të cilat del në shesh karakteri i tyre garues, si p. sh., shahu, futbollit, etj. Në grupin e dytë përfshihen lojërat e fatit (ruleti, lotaria e kështu me radhë). Në grupin e tretë hyjnë lojërat e bindjes që të besohet në diçka se kinse paraqet të vërtetën, apo realen. Këtu aderojnë, sidomos lojërat me maska. Kategoria e katërt e lojërave është shumë specifike dhe kjo e favorizon joharmoniken dhe njëherësh mëton kah realizimi i marramendjes së lirisë absolute. Të tilla janë lojërat e rrotullimit molisës në rreth, ngjitja në lartësi, etj (Kajoa, 1965). Nga kjo që përmendëm më lartë duhet të cekim faktin se në punimin tonë do të trajtohen vetëm disa lojëra që më shumë gravitojnë kah klasifikimi i tretë, apo kah lojërat, thënë kushtimisht me maska. Pikërisht në këto lojëra dalin në shesh elemente që kanë të bëjnë me një botëkuptim shumë të lashtë me prapavijë pagane.

Përmbajtja e lojërave në fjalë, mes tjerash, ka ardhur më shumë në shprehje në ndodhi të caktuara të ciklit jetësor, sidomos gjatë dasmës, por edhe gjatë ceremonive të vdekjes. Po ashtu, ajo është e pranishme edhe në ceremonitë e ciklit kalendarik, por fatkeqësisht këtu në Maqedoni, këto ceremoni, apo lojëra, janë atakuar nga kleri mysliman dhe sot mund të haset vetëm ndonjë gjurmë e tyre që ka arritur t'i mbijetojë kohës. Këto gjurmë në mënyrë më të hapur mund të vërehen në festën e Shëngjergjit, përkatësisht në dasmën me prapavijë komike që ekzekutohet me këtë rast në fshatin Reçan të Gostivarit. Pra, këto lojëra që në strukturën e tyre përmbajtjesore ngërthejnë shumë elemente magjike, sot, e ke vështirë t'i hasësh në terren, pasi, si rrjedhojë e kushteve tekniko-teknologjike në të cilat jetojmë, e kanë përmyllur jetën e tyre dhe fatkeqësisht nuk janë regjistruar dhe sistematizuar, gjë që do ta bënte më të lehtë studimin e tyre teorik. Megjithatë, në punimin tonë kemi bërë përpjekje që t'i paraqesim disa lojëra popullore, qoftë edhe të cinguara, por disa prej tyre edhe në mënyrë integrale me të vetmin qëllim që të venerohet aspekti teorik, apo fshehtësia e ekzekutimit të tyre. Në këtë mënyrë do të mund të depërtohet më lehtë në logjikën arkaike e cila ka funksionuar sipas disa parametrave të veçantë si rrjedhojë e zhvillimit të ulët të vetëdijes njerëzore. Përndryshe, lojërat në fjalë janë ekzekutuar në ambiente ty mbyllura, por edhe të hapura dhe kanë qenë të pranishme te të dy gjinitë, edhe tek ajo mashkullore, por edhe ajo femërore. Lojërat popullore, në shumicën e rasteve, u kanë ngjarë edhe lojërave teatrore, pasi kanë poseduar edhe elemente të kësaj natyre. Në funksion të ekzekutimit të këtyre lojërave, bartësit e tyre janë shërbyer me fjalë, mimikë dhe gjeste të ndryshme që do të thotë se ato është dashur të posedojnë edhe vlera artistike për ta përçarur sa më mirë mesazhin e tyre. Po ashtu edhe ekzistimi i aksionit, apo veprimit, kanë ndikuar që këto lojëra të gravitojnë kah teatri popullor, por larg logjikës së një teatri të mirëfilltë me të gjitha elementet e tij përbërëse. Në vazhdim të tekstit do të prezantojmë disa lojëra popullore duke tentuar të bëjmë rikonstruksionin e tyre, por edhe disa lojëra, apo sekuenca të tjera rituale që janë përshkruar nga autorë të tjerë me qëllim që të venerojmë mënyrën e gjykimit, apo perceptimit të realitetit objektiv nga njeriu pagan ku mungojnë vijat e prera, apo ndarëse mes lojës, magjisë, kultit, rritit e kështu me radhë.

Përshkrimi i disa lojërave popullore

Një lojë tipike e cila është ekzekutuar në shumicën e rasteve, në rajonin e Dervenit të Shkupit, sidomos në ambiente të mbyllura kur dhoma ishte e mbushur përplot me njerëz, ishte ajo e pagëzuar si *loja e Arapit*. Kjo ishte një lojë individuale dhe ekzekutohej vetëm nga një person i cili kishte aftësi dhe shkathtësi të duhura për këtë aktivitet. Ky person, në raste të caktuara, mund të ishte edhe i gjymtuar dhe kjo e metë e tij edhe më tepër ia shtonte gazin dhe ahengun lojës në fjalë. Kryepersoni i kësaj loje, paraprakisht duhej të maskohej mirë, andaj e lyente fytyrën me thëngjillin e zjarrit të shuar, kurse e zhvishte pjesën e sipërme të veshmbathjes duke mbetur i lakuriqësuar në këtë pjesë të trupit. Në pjesën e poshtme të trupit vishej si zakonisht me pantallona, por të kthyer mbrapshtë. Ai pasi ishte i siguruar se ishte maskuar mirë futej me shpejtësi marramendëse në

dhomën e mbushur përplot me njerëz. Ai në çastin kur futej në dhomë e mbante të hapur draprin në dorë dhe fillonte të lozte valle në mes të dhomës. Ritmet e valles së tij përcilleshin nga tingujt e defit që i binte dikush nga të pranishmit. Ai duke luajtur valle me draprin në dorë ua shtinte lemerinë të pranishmëve, pasi shumë herë u afrohej atyre, sidomos atyre që frikësoheshin më shumë dhe nuk i dinin fshehtësinë e lojës dhe simulonte se kinse donte t’ua presë kokën. Në të vërtetë, ai nuk ua priste kokën, por i lyente vetëm me thëngjill, pasi duart i kishte të përlyera me këtë. Loja në fjalë shkaktonte të qeshura të shumta, pasi kryeprogonisti i saj i befasonte sidomos ata që nuk i kishin përjetuar fshehtësitë dhe efektet e kësaj loje, andaj ndonjëri prej tyre frikësohej tej mase, pasi pretendonte se ekzekutuesi i kësaj loje mund të ishte nga bota e mbinatyrshme, ose demoniake. Një lojë tjetër e cila është ekzekutuar po ashtu në rajonin e Dervenit të Shkupit, ishte edhe loja e cilësuar si *loja e govedarit (loparit)*. Edhe kjo lojë kishte ngjashmëri me lojën e parë sa i përket maskimit. Kryeprogonisti i saj, apo lopari vishej me një ferexhe me zhele, apo me pjesë të grisura. Rreth qafës së tij vendoste vargonj me specë të kuq, kurse në duart mbante të shtrënguar ndonjë shkop. Si i tillë, lopari hynte në dhomën me njerëz dhe kërkonte nga të pranishmit që ta merrnin në cilësinë e loparit në fshatin e tyre. Zhvillohej një dialog mes tij dhe ndonjë përfaqësuesi të të pranishmëve dhe në fund pasonte pëlqimi. Kur lopari e merrte pëlqimin prej tyre, atëherë brohoriste, si: *hajde lëshoni lopët*. Ai me këtë rast duke i identifikuar njerëzit e dhomës me lopë, me shkopin e tij që e mbante në dorë, i qëllonte njerëzit kah këmbët duke krijuar kështu rrëmujë të vërtetë në dhomë. Nënkuptohej se më shumë pësonin ata që ishin pranë tij.

Një lojë tjetër e cila ngërthen në brendinë e saj edhe elemente të transvestizmit e që ekzekutohej në trevën e Dervenit të Shkupit, ishte loja e pagëzuar si *loja e nuses*. Në epiqendër të kësaj loje ishin babai dhe bija e tij, por njëkohësisht edhe çifti tjetër – babai dhe i biri. Të dy çiftet futeshin në dhomën e burrave dhe fillonte dialogu midis tyre. Babai i drejtohet të birit duke e lutur që t’i ruante lopët e fshatit dhe të siguronte një lloj ekzistence biologjike. Djali i përgjigjej se nuk donte t’i ruante lopët e fshatit. Babai i kundërpërgjigjej se pasi nuk donte t’i ruante lopët, atëherë ta martonte, apo t’i gjente nuse. Nusja në dhomë, në ndërkohë, e shponte me gjilpërë fshehurazi djalin. Kur babai i thoshte ta martonte, djali përgjigjej se nuk donte të martohej, pasi nusja kafshonte. Përderisa zhvillohet ky dialog mes babait dhe djalit dikush tjetër nga të pranishmit e ngacmonte seksualisht nusen, por kjo e fundit kur i jepej rasti, i shponte ata me gjilpërën që e mbante fshehurazi në dorë. Në fund, nusja i vërsulej djalit, por ky i shmangej dhe nuk donte assesit të martohej me të. Kështu krijoheshin skena komike. Përndryshe, rolin e nuses, nënkuptohet me veshje të saj, e luante ndonjë pjesëtar i gjinisë mashkullore, por ai maskohej mirë dhe dallohej vështirë nga një nuse e vërtetë.

Një lojë tipike, por njëherësh edhe shumë arkaike që zhvillohej në ambient të hapur, por që i ngërthente edhe disa segmente të lojërave të sipërshënuara ishte *loja e xhamallit* që përshkruhet detajisht nga folkloristi Bexhet Asani. Kjo lojë ekzekutohej në rajonin e Strugës. Xhamalli, në rajonin e Strugës, njihej me emrat: lugat, gogol, xhamball dhe gogoloç. Xhamalli kishte edhe “nusen e tij” rolin e së cilës e luante ndonjë mashkull. Xhamalli ishte i pranishëm në dasmën e vogël

(syneti) dhe dasmën e madhe (martesa). Xhamalli maskohej mirë me të gjitha rekuizitat e nevojshme dhe gjatë shëtitjes së synetliut nëpër rrugicat e fshatit, si dhe nga momenti i nisjes së krushqve për ta marr nusen në fshat, ose në ndonjë fshat fqinj, apo për ta shëtitur synetliun, tërë kohën lugati, apo xhamalli do të bëjë lojëra të ndryshme. U lëshohet fëmijëve t'i trembë, trembë ndonjë kalimtar të rastit që takon gjatë rrugës, i turret dhe i matet "t'i bie" me shpatë. Ka pasur raste kur ndonjë udhëtari, ose ndonjë dasmori i binte të fikët. Ndërkaq, kur dikush nga krushqit do të vallëzonte, ose do "t'ia merrte nusen" lugatit, ai, atëherë egërsohej dhe i sulmonte të tillët duke i rrëzuar në baltë, ose borë kudo që t'i zinte. Ndërkaq, nusja e xhamallit e cila vazhdimisht luan valle dhe i përqafton krushqit, në dorë mbante një gjilpërë me qëllim që t'i shpojë, apo pickojë burrat, apo "të dashurit e saj". "Nusja e xhamallit", ishte burrë i veshur me rrobat e nuseve të reja. Xhamalli ishte i pranishëm edhe te gratë, por me të vetmin dallim se kryepersonazhet e tij tani ishin gratë (sipas Asanit, 2010: 643-644). Pjesë të ndryshme të lojërave që u ngjasojnë më tepër sekuencave, apo shfaqjeve teatrore, janë të përfshira edhe në strukturën përmbajtësore të dasmës. Elemente të tilla ka shumë, por ne i kemi përzgjedhur disa që janë më tipike. Një të tillë e sjell prof. dr. Fadil Sulejmani i cili mes tjerash thekson: "Në katundet Gurgurnicë dhe Sallarevë është zakon që kujdestari, ose çausi i krushqve të veshë një këmishë të bardhë e të gjatë deri ndër gjunjë në formë të një dollomaje. Për beli lidh një rrip, në të cilin var disa këmbora lopësh e dhensh. Fytyrën e nxin me gaca, kurse në dhëmbë vë një cipë (mezder) qepe. Në sup të krahut të djathtë var një palë çorapë (kalçin) që ia kanë dhënë bakshish, kurse në sup të krahut të majtë var një strajcë të mbushur plot me hi, me të cilin herë pas here përhin krushqit u qet nga pak hi sipër gjatë rrugës. Kështu i veshur me dolloma, i nxirë, me këmbora bagëtish e me strajcën me hi ky çaus i krushqve të Malit të Thatë shëmbëllen plotësisht në një gogol të vërtetë, nga i cili frikësohen mjaft krushqit dhe mbajnë disiplinën e rreshtit të tyre. Me fjalë të tjera, ky është një karnaval dasmor i krushqve të kësaj ane" (Sulejmani, 2005: 231).

Edhe në trevën e Dervenit të Shkupit veçohet një segment i dasmës me prapavijë teatrore i cili ndërlidhet me temën për të cilën bëjmë fjalë. Kësisoj, në përfundim të ditës së premtë (dasma zhvillohet të dielën), diku pas mesnate ushtrohet aktiviteti i lypjes së pulave. Pulat lypen nga vajzat e reja, por të përcjella edhe nga djemtë e rinj, por që janë në lidhje farefisnore me vajzat. Ky grup i të rinjve, marrin një gjel ndër sjetulla dhe shkojnë nëpër shtëpitë e farefisit të dhëndrit dhe duke kënduar e luajtur valle, kërkojnë në trajtë peshqeshi ndonjë pulë. Peshqeshin e sigurojnë vajzat pasi më parë këndojnë ndonjë djalë të familjes që e ka radhën për t'u martuar, apo për t'u bërë synet. Pas përfundimit të aktivitetit, disa nga të rinjtë, apo vajzat vishen me rroba burrash, me tirqe, vendosin mustaqe, ngjyrosin fytyrën për t'u dukur sa më qesharake, ndërsa djemtë vishen me rroba grash, fustanesh nuse, vendosin stolitë etj. Vlen të përmendet në këtë drejtim edhe e dhëna që na e jep dr. Fadil Sulejmani i cili duke bërë fjalë për malësinë e Tetovës thekson se edhe në këtë anë "me rastin e lypjes së pulës disa nga vajzat vishen me tesha burrash, me lurkë, me kësulë të bardhë etj. Dhe vënë mustaqe duke marrë edhe një shkop në dorë. Disa nga vajzat e tjera bëhen sende (hexhine) të ndryshme: duke u nxirë kah fytyra e duke u veshur me tesha të llojllojshme burrash e femrash dhe në mënyra të

ndryshme: vënë edhe këmborë nëpër trup, bëhen si thonë këndej, “vasalica/veselica” të vërteta që ngjajnë me karnavalet (Sulejmani 2005: 282). Ata tërë natën rrinë bashkë, vallëzojnë, këndojnë, bëjnë humor deri në mëngjes ku shtrohet sofa e pulave të pjekura, të mbledhura atë natë. Përgatitja e banketit dhe ngrënia e pulave bëhet mu atë natë kur vajza bëhet nuse, apo kur i mbaron beqaria, nënkuptohet në aspektin formal. Pra, ky aktivitet është i ndërlidhur pikërisht me këto momente të hidhura të jetës së vajzës e cila i jep fund periudhës së beqarisë. Ndërkaq, ngrënia që shtrohet me këtë rast, interpretohet me fjalët se kinse “hahet beqaria e cucës, ajo mbaron vdes më” – Kjo logjikë del edhe nga disa këngë të vajzave të dasmës.

Një aktivitet tjetër me nuanca teatrore që i referohet zonës së Dervenit të Shkupit, por edhe ndonjë zonë tjetër eventuale dhe që zhvillohet të nesërmen (në mëngjes) e natës së gjerdekut, është edhe improvizimi i një loje nëpërmjet së cilës bëhet përqeshja e prindërve të nuses. Paraprakisht, një vajzë e afërme e familjes së dhëndrit hyn në dhomën ku është nusja dhe e thyen bardakun e vjedhur në shtëpinë e nuses. Pas këtij akti, futet në dhomë një e afërme e dhëndrit, por që nuk hetohet si e tillë, pasi ajo është e veshur në cilësinë e berberit dhe në dorë mban një valixhe. Kjo ulet para nuses dhe nga valixhja e saj e nxjerr thikën për të bërë synet një burrë tjetër që simulon rolin e babait të nuses. Edhe rolin e këtij të fundit e luan ndonjë vajzë e afërme me familjen e dhëndrit e cila në vend të falusit bart një spec të cilin kinse ia pret, apo e bën synet berberi.

Këto që i prezantuam deri tani ishin vetëm disa lojëra nga repertori i gjerë i lojërave popullore që ekzistojnë te shqiptarët e Maqedonisë, por njëkohësisht edhe disa sequenca, apo fragmente të strukturës përmbajtësore të dasmës ku dalin në sipërfaqe një numër i madh i çështjeve që kanë të bëjnë me studimin e tyre, apo diagnostifikimin e atyre elementeve që i referohen një logjike krejtësisht pagane, por edhe një logjike që në vazhdimësi është modifikuar në përputhje me frymën e kohës. Ne, nëpërmjet një përvoje të deritanishme teorike, do të tentojmë të depërtojmë në prapavijën e ekzekutimit të këtyre lojërave popullore duke pasur parasysh gjithmonë faktin se është e vështirë dhe e ndërlikuar qasja ndaj tyre nga dioptria e sotme kohore kur ato nuk ekzistojnë më.

Kategoria e kohës dhe karnavaleskes në lojërat popullore

Ekzekutimi i këtyre lojërave popullore ka qenë i ndërlidhur me segmente të caktuara kohore, por edhe me raste të veçanta të ndodhive që kanë të bëjnë me njeriun si krijesë biologjike. Në këtë drejtim, veçohet, sidomos dasma si një rit tipik i kalimit nga një periudhë në një tjetër periudhë kohore. Më konkretisht bëhet fjalë për kalim nga një status ontologjik në një status tjetër ontologjik, apo nga faza e beqarisë në atë të burrisë dhe nusërisë. Disa lojëra në fjalë, si ajo e xhamallit, ekzekutohej edhe gjatë dasmës së synetisë. Disa lojëra janë ekzekutuar edhe para shkuarjes në shërbimin ushtarak, sidomos në kohën e ish-Jugosllavisë socialiste kur moshatarët e fshatrave, sidomos të Dervenit të Shkupit, organizonin darka të majme dhe ahengu e loja nuk kishin fund dhe zgjatnin deri në orët e mëngjesit. Pra, loja edhe këtu ishte në funksion të kalimit nga faza e pubertetit në fazën tjetër të

pjekurisë, kurse kryerja e shërbimit ushtarak konsiderohej si një element shumë i rëndësishëm i këtij tranzicioni, pas të cilit, si zakonisht pasonte akti i martesës. Ekzekutimi i lojërave në fjalë nuk ndiqte vetëm momentet kryesore që shënonin ndonjë kalim në planin antropologjik, por edhe kalimet, apo ndryshimet që ndodhnin në planin kalendarik. Lojërat ekzekutoheshin gjatë periudhës së dimrit, apo në shumicën e rasteve, gjatë periudhave kohore kur bëhej kalimi nga periudha e dimrit në atë të verës. Lojërat e përshkruara më lartë, në strukturën e tyre përmbajtjesore, posedonin shumë elemente që mund të ndërlidhen edhe me karnavalet që dikur me siguri kanë qenë të pranishme edhe në këtë anë, por, meqenëse janë atakuar, mendoj nga kleri mysliman, atëherë ato janë zhdukur, por gjurmët e tyre kanë mbetur në lojërat në fjalë. Që të vërehet përkimi, qoftë edhe më i vogël midis tyre dhe karnavaleve duhet t'u kthehemi ndoshta fqinjve tanë të vjetër, përkatësisht grekëve të lashtë dhe romakëve, apo më mirë thënë, gjurmëve që përshkruajnë karnavalet e tyre. Dihet se në Romën e Lashtë festoheshin saturnalet në periudhën kohore prej 17 deri më 23 dhjetor. Me këto kremte shënohej kalimi nga një vit në vitin tjetër. Kjo ishte festë e hyjnisë së pjellorisë dhe kthimit simbolik të tokës nën pushtetin e Saturnit. Edhe në Greqinë e Lashtë kanë ekzistuar kulte ndaj hyjnive të ndryshëm të cilët festoheshin në mënyra të ndryshme. Sidomos veçohen dionisianet e famshme që organizoheshin për hir të perëndisë Dionis. Duke iu referuar këtyre fakteve, por edhe fakteve të tjera që i jep antropologu Frejzer në librin e tij të njohur "Dega e artë" (1977) rezultoi teoria e antropologëve të Kembrixhit e cila quhet edhe evolutive (pasi bëhet fjalë për kalim të ritit në teatër) dhe bazohet në mitin e ringjalljes dhe vdekjes së perëndive të caktuara. Thënë më prerazi, kjo teori ngulmonte se teatri kishte lindur nga Dionisitë e Mëdha të cilat si pjesë e kultit të Dionisit, ekzekutoheshin për hir të Dhemetrës, kurse ishin të lidhura ngushtë me solemnitete bujqësore. Këtu Dionisi venerohej si hyjni i vitit me ç'rast ringjallja e tij shënonte periudhën e verës, kurse vdekja e tij shënonte periudhën e dimrit. Pikërisht kah fundi i vitit ekzekutoheshin një varg rimesh me të cilat synohej të ringjallej Dionisi dhe si rrjedhojë edhe periudha e verës. Pra, Dionisi venerohej si *Eniautos-diamon*, kurse komedia dhe tragjedia si stade të ndryshme të jetës së tij (komedia – dasëm, kurse tragjedia – vdekje). Dionisianet ishin manifestime për hir të perëndisë Dionis që mbaheshin në shumë vende të Greqisë së Lashtë. Dionisianet më të njohura dhe më të lashta ishin në Athinë. Në këto festa organizoheshin gara të mëdha muzikore dhe shfaqje teatrore. Më vonë si dionisiane cilësohej çdo festë në të cilën jepeshin shfaqje teatrore. Sa më shumë që rritej popullariteti i dramës, aq më shumë dionisianet filluan të festoheshin në mbarë Greqinë. Dionisianet e Athinës festoheshin katër herë brenda vitit: Antesteritë, Lenetë, dionisianet e fshatit dhe dionisianet e mëdha, ose të qytetit. Në dionisianet e fshatit (nëntor-dhjetor) janë mbajtur procesione falusore kultike me pjesëmarrje të kortezheve ekzaltuese. Këto kortezhe ekzaltuese, pas ngrënies së ushqimit të majmë me rastin e solemniteteve dasmore, ose të festave (veçmas për hir të Dionisit) shëtitnin nëpër vendbanimin e tyre duke kënduar nën përcjellje muzikore, por njëherit edhe duke duke bërë vepra komike. Këto garime, apo festa ndikuan në zhvillimin e komedisë. Dionisianet e Mëdha, ose të qytetit janë zhvilluar shumë vonë, me siguri në gjysmën e dytë të shekullit VI para erës

sonë. Mbaheshin 5 ditë dhe me një pompozitet të madh. Edhe në këtë kremte mbretëronte procesioni falusor, por ana kultike e solemnitetit ishte nën hijen e shfaqjeve teatrore, sidomos tragjedisë. Ndërkaq, Antesteritë (festa e luleve) paraqiste një solemnitet të rëndësishëm pranveror të shumica e grekëve jonian. Ajo kishte karakter të dyfishtë: të hareshëm dhe të pikëllueshëm. Ngrihej dollia për perëndinë Dionis dhe njëherit pihej verë, kurse në fund të festës treditëshe jepeshin flijime për të vdekurit me lutje për hyjnitë nëntokësore. Për ritualet e Dionisianeve Lenease (që festoheshin në dhjetor-janar) nuk kemi shumë të dhëna, edhe pse ishte një ndër festat kryesore dedikuar Dionisit. Në fillim kishin karakter orgjik. Edhe në këto festa organizoheshin shfaqje dramatike dhe në radhë të parë – komedi (sipas RKT, 1992: 139).

Pra, edhe nga karnavalet e Greqisë së Lashtë mund të vërehen disa pikëtakime me lojërat popullore që i kemi shënuar më lartë. Në këtë kontekst, mund të venerohen përkime që i referohen kultit të Dionisit. Një element i tillë është bartja e shkopinjeve që paraqesin simbole të falusit, por të kësaj natyre janë edhe duelet simbolike. Bartja e shkopinjeve nga subjektet e maskuara që simbolizojnë falusin, mund të interpretohen si element tipik i kultit dionisian, kurse ndeshjet simbolike mund të konsiderohen si mbijetojë e flijimit mitik të Dionisit. Të rëndësishme janë edhe aktet seksuale, apo koituset që simulohen mes subjekteve të gjinive të kundërta edhe në karnavale, por edhe në lojërat popullore, pasi nëpërmjet tyre, besohet se nxitet akti i pjellorisë, qoftë në planin antropologjik (dasma), qoftë në planin kalendarik (ndërrimi i stinëve), apo më mirë thënë, nxitet pjelloria e tokës që të japë rendimente të larta bujqësore. Edhe studiuesi i njohur Peter Burke thekson rëndësinë e seksit gjatë karnavaleve. Ai në kontekst të tij thekson: “seksi, si zakonisht, ishte simbolikisht më interesant sesa ushqimi, për shkak të mënyrave me të cilat ai maskohej, sado transparente që të kenë qenë këto vello. Karnavali ishte një kohë e aktivitetit seksual, veçanërisht të fuqishëm, siç kanë qenë në gjendje të tregojnë historianët e Francës së shekullit tetëmbëdhjetë me tabelat e tyre të lëvizjes stinore të mbarsjeve: piku ishte maj-qershor, por kishte një pik tjetër në shkurt ose aty rrotull. Dasmat bëheshin shpesh gjatë Karnavalit dhe dasmat tallëse ishin një formë loje popullore” (Burke, 1996: 182).

Ndoshta përkimi më i mirë mes lojërave popullore dhe karnavaleve mund të vërehet me rastin e Thrakisë së Lashtë ku subjektet e maskuara quheshin xhamallarë. Një nga burrat, i veshur me rroba grash, identifikohet me nusen e re – xhamallën, kurse të tjerët ishin të maskuar dhe rreth qafës dhe këmbëve bartnin kambana me madhësi të ndryshme. Kortezi ndalej në çdo shtëpi dhe luante nën shoqërimin e tingujve të gajdes. Të gjithë të pranishmit luanin me nusen dhe e qëllonin atë kohë pas kohe me shkop duke simbolizuar aktin e koitusit. Gjatë zhvillimit të lojës pasonte grindja midis tyre dhe një nga pjesëmarrësit vritej në mënyrë simbolike, kurse një tjetër tentonte që t’ia kthente sërish jetën. Një sekuencë e tillë parake me siguri se gjurmët e saj i ngërthen edhe në përmbajtjen e lojërave në fjalë. Kjo lojë thrakase përkon pothuajse plotësisht me përmbajtjen e lojës së xhamallit që e përshkruam më lartë në kontekst të rajonit të Strugës. Madje edhe emërtimi i saj përkon me lojën në fjalë. Pra, kemi një njëjtësim mes planit kalendarik kur nëpërmjet simulimit të aktit seksual kërkohet që toka të nxitet në

pjellorinë e saj dhe dasmës kur po ashtu kërkohet që të rinjtë të kurorëzojnë martesën e tyre me shumë fëmijë. Loja e tillë me siguri se është zhvendosur në dasmë, apo kemi të bëjmë me një funksion të njëjtë të saj (nxitja e pjellorisë) pa marr parasysh se ku ezekutohet kjo lojë. Dihet se njeriu pagan ka njëjtësuar Tokën me femrën, kurse Qiellin me mashkullin. Si rrjedhojë edhe ritet që shënojnë kalim nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore, janë shumë të ngjashme.

Një dukuri e ndodhive që shënojnë kalim në një periudhë të re kohore është edhe bollëku në të ngrënë e në të pirë. Edhe gjatë lojërave popullore që ekzekutohen për hir të ndonjë kalimi në planin antropologjik, por edhe gjatë karnavaleve që shënojnë po ashtu kalimin në një periudhë të re kalendarike, përveç që hahet e pihet mirë, edhe këndohet e vallëzohet ku dominon hareja e lasciviteti. Edhe studiuesi Peter Burke që bën përshkrimin e karnavaleve në disa pjesë të Evropës thekson se gjatë këtyre solemniteteve “kafshët ishin viktima të zakonshme të çmendurisë së karnavalit; qentë mund të hidheshin mbi batanije dhe gjelat të gjuheshin për vdekje (Burke, 1996: 179). Kjo logjikë përkon edhe me fragmentin e dasmës që e shënuam më lartë kur vajzat e reja pas përfundimit të aktivitetit të lypjes së pulave, e piqnin mishin e tyre dhe më pas e shtronin gostinë. Gjeli dhe pula ishin simbole bashkëkohore të epshit. Pra, karnavali, në shumicën e rasteve, i ngjason dasmës, andaj në përmbajtjen e tij fshihet magjia e pjellorisë nëpërmjet së cilës vendoset lidhja me kultet e lashta agrare, me imazhin mitik të kthimit të stërgjyshërve në periudhën dimërore. Në funksion të këtij pohimi mund të numërohen një varg veprimesh që i konfirmojnë këto supozime: ndërrimi i gjinive të subjekteve të ritualizuara, inskenimi i lindjes, gjallërimi i të vdekurit, etj. Kjo vë në dijeni faktin se personat e maskuar e tregojnë ciklin jetësor të njeriut dhe me këtë ndikojnë në vazhdimin e pjellorisë dhe mëkëmbjes së ciklit kalendarik vegetativ. Përveç afërsisë me dasmën nëpërmjet inskenimit të saj si pjesë përbërëse e ritualit, mund të thuhet se karnavali e bashkon jetën dhe vdekjen në mënyrë të ngjashme ashtu siç i zbut të gjitha kundërshtitë tjera. Ndoshta rasti më tipik që përkon me këto konstatime ka të bëjë me dasmën e Reçanit të Gostivarit që ekzekutohet në ditën e Shëngjergjit kur ndodh kalimi nga periudha verore në atë dimërore. Vallë kjo dasmë me prapavijë komike nuk i ngjason, apo nuk përkon tërësisht me një karnaval të lashtë duke përfshirë në brendinë e saj të gjitha elementet përbërëse të tij.

Pra, siç vërehet më lartë, ekzekutimi i lojërave popullore, por edhe i karnavaleve si trajta më të lashta, ishte i ndërlidhur me ngjarje me të cilat shënohej kalimi nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore. Meqenëse në këto ngjarje ndodhte ky kalim dhe njëherësh përmbysja e statuseve ontologjike, atëherë këto periudha kohore konsideroheshin të rrezikshme dhe ishin të mbarsura me krizë. Si rrjedhojë, duhej që të ekzekutoheshin lojëra, apo rite të ndryshme me qëllim që sa më lehtë të bëhej ky kalim. Këto ngjarje që zhvilloheshin pikërisht në këto kthesa kohore, etnologu i njohur botëror Arnold Van Zhenep i kishte pagëzuar si rite të kalimit. Ai, në librin e tij me titull “Rite të kalimit” (1981) kishte veçuar tri faza të këtyre riteve. Fazën e dytë e kishte pagëzuar si margjinale, apo liminale dhe kjo i destinohet çastit kur duhej të bëhej ky kalim në një status tjetër ontologjik. Kjo fazë nënkuptonte praninë e simboleve të vdekjes, pasi i referohej “vdekjes” së një

periudhe kohore dhe “lindjes” së një periudhe tjetër kohore, apo përfitimit të një statusi të ri shoqëror dhe humbjes së statusit të mëparshëm shoqëror (gjerësisht, Murtezani, 2008: 65-67). Nuk është vështirë të hetohet se edhe lojërat popullore, por edhe prototipat e tyre – karnavalet, kanë një numër të madh të elementeve të kësaj natyre.

Kategoria e protagonistëve dhe komikes në lojërat popullore

Në kontekst të disa lojërave popullore me prapavijë teatrore, të përshkruara më lartë, një vend të rëndësishëm zë edhe kategoria e subjekteve, apo më mirë thënë, e protagonistëve të tyre. Pothuajse në të gjitha këto lojëra popullore nevojitet që bartësit e tyre të posedojnë talent të theksuar dhe të reflektojnë frymën e mendësisë popullore, sidomos kërkohet që ata të posedojnë aftësi komike. Si rrjedhojë, çdo fshat i ka pasur aktorët e vet, të cilët në raste të caktuara, sidomos gjatë dasmave dhe ahengjeve të ndryshme, kanë ditur që t’i argëtojnë të pranishmit me repertorin e gjerë të lojërave të tyre popullore. Esenca e komunikimit me rastin e ekzekutimit të këtyre lojërave përmbledh në faktin se nuk ekzistonte ndonjë kufi i qartë mes aktorit dhe audiencës (publikut), andaj edhe aktori edhe publiku përbënin një tërësi homogjene. Kjo vlen, sidomos për lojërat që zhvilloheshin në ambiente të mbyllura pasi çdo pjesëmarrës, madje edhe nga radhët e audiencës, mund të përfshihej në lojë, qoftë edhe në mënyrë pasive, pasi kryesubjekti i lojës mund ta ngacmonte, apo ta provokonte atë. Subjektet që ekzekutonin lojën, kishin në dispozicion të tyre një numër të caktuar të mjeteve, si ato mimike (gjeste, valle, pantomimë), akustike (fjalë, këngë, transformim etj.) dhe optike (kostume, maska, rekuizite të tjera).

Shumica e studiuesve që merren me teatrin folklorik theksojnë se shenja dalluese dhe kryesore e këtij teatri është kostumografia dhe në veçanti - maskimi. Maskës, si instrument më i mirë i metamorfozës duke filluar nga koha e lashtë e deri më sot, i është atribuar një rëndësi e madhe religjioze dhe magjike. Me ndihmën e maskave, njeriu shndërrohet në perëndi, në fuqi demoniake, apo në të gjitha llojet e hyjnive, qoftë me natyrë krijuese, apo rrënuese. Maskimi ka rëndësi apotroepike dhe kësaj dukurie i nënshtrohen persona të caktuar. Maskimi bëhej me lyerje të fytyrës, në shumicën e rasteve me thëngjill, veshje të lëkurave të kafshëve, etj. Subjektet e maskuara, në kokë vendosin kapela të grisura, veshen me rroba të vjetra të demoduara, në duar mbajnë shkopinj të gjatë dhe trasta të mbushura me hi. Përdorin edhe specin, qepët e kështu me radhë. Ja, si maskohet xhamalli: vesh gunë të vjetër, herë-herë edhe të grisur, përvesh krahët gjer në bërryl, pantallona të përveshura apo të grisura deri te gjunjët etj. Në kokë vinte sheshir i cili vende-vende, ndërsa në fytyrë nxihej me thëngjill, vinte mustaqe dhe mjekër, ndërsa mbi gunë varte zinxhirë, katarinë (dry) e këmborë të llojeve të ndryshme, kurorë me qepë e vargje me specatë të thata. Mbante bastun dhe shpatë (Asani, 2010: 643). Pra, mund të vërehet se subjekti i maskuar, apo transformimi më radikal i tij, ndodh me ngritjen e fytyrës me thëngjill, apo me ngritjen e zezë. Ngjyra e zezë, nga pikëpamja semiotike, asocion në diçka të neveritshme, në ndjellëse të kobit, apo vdekje (botën tjetër), pastaj në rrezik, jopastërti etj. Kjo ngjyrë është e kundërt me ngjyrën e bardhë e cila nga pikëpamja semiotike, identifikohet me këtë botë, apo

jetën, pastaj të mirën, të pastrën etj. Ngjyra e zezë, apo maska, paraqet ndërmjetësim mes njeriut dhe fuqive metafizike. Maska e ndërlidh botën e të gjallëve me botën e të vdekurve, botën e njerëzve me atë të hyjnive e kështu me radhë. Në këtë drejtim, edhe figura e çaushtit që e përshkruam më lartë, impresionon me dukjen e tij, pasi edhe ai e ka të nxirë fytyrën me ngjyrë të zezë dhe është i pranishëm në fazën liminale, përkatësisht në kohën kur krushqit nisen për ta marr nusen dhe për ta sjell në shtëpinë e dhëndrit. Roli i tij ishte që të përkujdesej për atmosferën gazmore të dasmës, andaj duhej të posedonte cilësi komike, të ishte i shkathët për improvizime komike, etj. Vetitë e tij autentike, apo parake kanë qenë të natyrës magjike. Ai, me ngjyrën e tij të zezë, tenton të hyjë në kontakt me forcat demonike dhe t'i zbut ato me qëllim që të mos i dëmtojnë dasmorë dhe kryeprogonistët e tyre (nusen dhe dhëndrin). Autorë të ndryshëm pandehin se çaushti, meqenëse është i ndryshëm nga krushqit e tjerë, nënkuptohet sipas maskimit, atëherë ai mishëron të parët tanë, përkatësisht të vdekurit që marrin pjesë në këtë ndodhi familjare (dasëm). Se çaushti përfaqëson fuqi demoniake të botës tjetër, është bindës fakti se ai e lye fytyrën me ngjyrë të zezë. Ndërkaq, demonët e zinj i takojnë "botës tjetër". Më vonë tiparet e tyre i marrin arapët e zinj. Ndërkaq, prania e kambanave të çaushtit paraqet mjet profilaktik që shërben për dëbimin e çdo të keqeje. Figura e çaushtit deri paradokohe i kishte humbur vetitë parake dhe shërbente në funksion të zbavitjes dhe argëtimit të krushqve. Përndryshe, maskimi çdoherë është i ndërlidhur me ndonjë kalim, apo ndryshim të statusit shoqëror të protagonistëve të tij. Në rastin konkret, vajza-nuse dhe dhëndri kalojnë në një status tjetër, apo në atë të burrërisë dhe nusërisë, andaj është krejtësisht e zakonshme prania e dukurisë së maskimit.

Një ndër elementet e protagonistëve të lojërave popullore, por njëherësh edhe cilësisë së tyre, ka qenë kostumografia, apo veshmbathja e cila ka ndikuar dukshëm në krijimin e skenave komike, por njëherësh edhe në krijimin e skenave me prapavijë lemeritëse. Nëpërmjet veshmbathjes ka ndryshuar identiteti i protagonistëve, madje në raste të shumta, edhe identiteti gjinor. Ky fenomen i njohur si transvestizëm, paraqet madje edhe bërthamën e bukurisë së këtyre lojërave popullore. Pra, në këto lojëra, meqenëse ahengjet ishin të ndara nga aspekti gjinor, atëherë rolin e gruas e luante ndonjë burrë dhe anasjelltas. Përndryshe, burrat që visheshin si gra, shfrytëzonin çarçafin e bardhë, kurse në kokë vendosnin ndonjë shami. Më të rëndësishëm në cilësinë e protagonistëve ishin nusja dhe dhëndri. Nusja duhej të ishte e maskuar mirë me qëllim që të mos identifikohet nga të pranishmit dhe njëherësh duhej t'i posedonte tiparet dalluese të femrës, veçmas pjesën e përparme të gjoksit për ta provokuar potencën seksuale të meshkujve të pranishëm. Këta të fundit posa futej nusja (burri i maskuar) në dhomë e ngacmonin atë fizikisht, por ajo mbrohej nga ai që përkujdesej për të.

Parashtrohet pyetja se cila ishte esenca e ndërrimit të gjinive në këto lojëra dhe pse realizohej një akt i tillë. Më parë theksuam se në ritet e kalimit, sidomos në fazën e dytë, apo të mesme, e cilësuar si faza liminale, apo marginale, në shoqëritë arkaike, rishtarët u nënshtrohen procedurave rituale që janë të kundërta me gjendjen e zakonshme apo normale. Sipas kësaj logjike, lojërat që ekzekutoheshin gjatë shënimit të ndonjë kalimi identifikoheshin me të shenjtën, apo më mirë thënë,

me jo të përditshmen. Si rrjedhojë përmysej struktura normale duke i lënë vend të mbrapshtës, andaj jo rastësisht dalin në skenë ndërrime të përkatësive gjinore, qoftë edhe nëpërmjet veshmbathjes. Kjo fazë liminale, sipas studiueses Majerhorf, i referohet antistrukturës. “Së këndejmi, në shoqëritë me strukturë mitike, ndërrimet ndërgjinore të veshmbathjes, të praktikuar në kuadër të disa solemniteteve dhe ceremonive të ndryshme (si në dasmë) do të mundej të interpretoheshin si akt i fundit i konfuzionit seksual që i paraprin ndarjes definitive të gjinive. Andaj në sekuencat e këtij *kalimi* mund të venerohet imitimi i unitetit primordial gjinor. Ndërrimi i veshjes në këto rite, sipas Delkurit, mbështetet në një ide të qartë: veçoritë dhe fuqitë e gjinisë së kundërt përvetësohen pikërisht para definimit përfundimtar të statusit gjinor në grupin shoqëror, ashtu që androgjiniteti simbolik i rishtarit ka vlerë krijuese dhe pozitive. E njëjta autore thotë se veshmbathja e gjinisë së kundërt ishte edhe një shkathtësi e llojit të vet, në radhë të parë dedikuar shmangies së ndikimit të keq të forcave të liga dhe forcave tjera mbinatyrore që mund ta dëmtonin bashkimin martesor (Delcourt, 1958: 27). Disa nga lojërat popullore me prapavijë teatrore që i përmendëm më lartë, si element të tyre përbërës, e kishin edhe vallen. Ajo shoqëronte ekzekutimin, apo shfaqjen nëpërmjet lëvizjeve ritmike të trupit që ndiqte tingujt e instrumenteve muzikore ose këngës. Një element tjetër i lojërave në fjalë është kategoria e komikes. Dihet se të qeshurat e reduktojnë tensionin shpirtëror, të shkaktojnë droja se periudha e dimrit mund të vazhdojë më gjatë dhe t’i harxhojë burimet ekonomike të njerëzve me botëkuptim pagan. Edhe studiuesi i njohur i miteve greke Grevs në analizën e tij destinuar mitit të Dhemetrës thekson se shakatë e pamatura të shërbëtores Jamba, ose Bauba kishin për qëllim të lehtësonin tensionin shpirtëror gjatë kohës së Mistereve Eleusine, të cilat për Grevsin paraqitnin dramë të vegetacionit, e orientuar kah përkrahja dhe ruajtja e këtij cikli (Grevs, 1974: 95). Miti i Dhemetrës përmendet edhe nga Propi në funksion të besimit se të qeshurat kanë fuqi të zgjojnë fuqinë jetësore, të ndikojnë në pjellorinë e tokës dhe ringjalljen e njeriut. Përndryshe, dihet sipas mitit se Persefona – vajza e Dhemetrës me bekimin e Zeusit grabitet nga Hadi – perëndi i nëntokës. Perëndesha Dhemetra nisat ta kërkojë vajzën e grabitur, por nuk mundet ta gjej atë, andaj e ndërpret krejtësisht buzëqeshjen e saj dhe si rrjedhojë natyra fillon të shkretohet, të mos bulëzojnë frytet dhe vegetacioni. Dhemetra, duke e kërkuar vajzën, arrin në oborrin e mbretit eleusin Kelej ku shërbëtorja Jamba me qëllim që ta dispononte hyjneshën, e çon lartë fustanin e saj duke kryer një akt të pahijshëm. Dhemetra më në fund buzëqesh dhe kjo buzëqeshje e saj e rigjallëron natyrën dhe për një çast kthen sërish në skenë sezonin e verës. Shembullin e dytë, Propi e gjen te jakutët e lashtë të cilët besonin se të qeshurat e hyjneshës Ijehat gjatë kohës së lindjes i ndihmonin gruas që të lindte jetë të re.

Te disa popuj, të qeshurat ishin të obligueshme gjatë kohës së solemniteteve të rishtarisë duke simbolizuar lindjen e re të rishtarit. Procesionet falusore antike shkaktonin të qeshura të përgjithshme dhe njëherësh ngazëllim deri në ekstazë, kurse të qeshurat dhe gjithçka që ishte e ndërlidhur me to, ndihmonin përparimin e të mbjellave. Propi duke u ndërlidhur me të qeshurat karnavaleske shtonte se ato ishin të shëndetshme dhe reflektonin kënaqësinë animale të jetës fiziologjike dhe

njëherit paraqitnin vazhdimësi të të qeshurave të riteve të lashta agrare. Të qeshurat e tilla besohet se i ndihmonin tokës që të zgjohej për një jetë të re dhe lindje të re (Prop, 1984: 148-152). Ndërkaq, nëse u referohemi studimeve që kërkonin ta definojnë komiken, Kanti - filozofi i njohur gjerman, theksonte se ajo buron nga një përmbysje e papritur që u bën bisht pritjeve tona, por që njëkohësisht i zbut, apo i redukton disa tensione dhe shtrëngesa trupore. Përmbysjen, ose kundërshtinë, apo mospërputhjen e përmend edhe Shopenhaueri. Sipas tij, komikja është reflektim i joharmonisë mes abstraksionit (vlerës postulative) dhe realitetit, dhe kjo në dobi të realitetit; pra, komikja është fitore e gjendjes faktike ndaj së paramenduarës. Edhe në analizën e Bergsonit theksohet kontrasti si element thelbësor i komikes. Teza kryesore e Bergsonit është se në të qeshurën ndikon e gjithë ajo që në një çast të dhënë vepron në mënyrë mekanike, jonatyrore dhe shtrënguese. Pra, komikja është ndodhi gjatë së cilës në mënyrë të papritshme, ose krejtësisht befasuese manifestohet natyra fizike e njeriut (RKT, 1992: 389).

Përfundim

Loja, pa marr parasysh natyrën e saj, është pjesë përbërëse e artit. Nga ana tjetër, thuhet me të drejtë se “arti është edhe mimesis (imitim), edhe ekspresion (shprehje, ligjërim), edhe trajtë, edhe lojë, edhe krijimtari, edhe simbol (edhe si shënjuet dhe e shënjuar), edhe ritual (që nga e kaluara është i pleksur në vetë bazën e lojës), edhe institucion. Pra, loja e identifikuar me artin, por edhe me magjinë dhe ritin ka qenë pjesë përbërëse e ndodhive që shënonin kalim nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore, qoftë në rrafshin antropologjik, qoftë në atë kalendarik. Nëpërmjet këtyre lojërave popullore, njeriu jo vetëm që ka gjetur mundësinë e argëtimit, por edhe mundësinë e manifestimit të botëkuptimit të tij ndaj realitetit objektiv, nënkuptohet përmes magjisë, ritit, e kështu me radhë. Pra, varianti teatror i ritit, valles popullore dhe dramës përmbledhet, apo fokusohet në lojë. Loja paraqet sistem të veçantë shenjues të transformimit teatror e cila përcaktohet nga dy shenja qenësore: metamorfoza gjinore dhe veprimi, të realizuar në një moment të caktuar. Ky moment ndër lidhet me ndonjë ndodhi që, siç thamë më lartë, shënon kalimin nga një periudhë kohore në një tjetër periudhë kohore. Këtë e konfirmon edhe studiuesi i njohur me famë botërore Viktor Tarner i cili thekson se fazat kufitare (kalimi në një status tjetër të qenies) janë të përshtatshme për invencionin e lojës. Ai shton se “këto zhanre simbolike-ekspresive, siç janë miti dhe rituali, duhet të perceptohen njëherësh edhe si punë, edhe si lojë, ose si veprimtari kulturore në të cilat bashkarisht puna dhe loja janë të pleksura njëra me tjetrën (Tarner, 1989: 61).

BIBLIOGRAFIA dhe shkurtesat:

- Asani, Bexhet (2010): Lojërat dramatike të Xhamallit në trevën e Strugës. *Aktet*. Revistë shkencore e Institutit Alb-Shkenca. Vëll. III, Nr. 4, 2009. Tiranë. Prishtinë. Shkup.
- Burke, Peter (1996): *Kultura popullore në Evropë në fillimet e Kohës së Re*. Arbri. CEU. Tiranë.
- Delcourt, Marie (1958): *Hermaphrodite*. Puf. Paris.
- EI (2003): *Estetika na igrata*. Përgatiti Ivan Xheparovski. „Kultura“. Skopje.
- Fink, Eugen (1984): *Osnovni fenomeni ljudskog postojanja*. „Nolit“. Beograd.
- Frejzer, Džems (1977): *Zlatna grana. 1,2*. BIGZ. Beograd.
- Gennep, Arnold (1981): *Rites de passage*. Picard. Paris.
- Grevs, Robert (1974): *Grčki mitovi. I*. Beograd.
- Huizinga, Johan (1992): *Homo ludens. O podrijetlu kulture u igri*. Naprijed. Zagreb.
- Kajoa, Rože (1965): *Igre i ljudi*. Nolit. Beograd.
- Murtezani, Izaim (2008): *Rite dhe praktika magjike të ciklit jetësor*. Logos 5. Shkup.
- Prop, Vladimir (1984): *Problemi komike i smeha*. Novi Sad.
- RKT (1992): *Rečnik književnih termina*. Institut za književnost i umetnost. Beograd.
- Sulejmani, Fadil (2005): *Lindja, martesë dhe mortja në Malësitë e Tetovës*. SHB „Çabej“. Tetovë.
- Tarner, Viktor (1989): *Od rituala do teatarë*. Avgust Cesarec. Zagreb.

BUKURIJE MUSTAFA**VËZHGIME MBI LEKSIKUN E TË FOLMEVE
SHQIPE TË MAQEDONISË****Etnografia e të folurit****Emërtimet familjare dhe emra përkëdhelës në të folme të shqipes**

Gjuha shqipe ka një shtrirje të gjerë të përdorimit për sa u përket emërtimeve familjare e farefisnore, të cilat paraqiten me më shumë varietete dialektore a krahinore. Në këto përmasa të përfshirjes të leksikut të sferës familjare, shprehet e pasqyrohet etnografia e të folurit si pjesë e kulturës dhe raporteve brenda dhe jashtë familjes. Përgjithësisht, këto emra kanë kuptim zbutues dhe jo të gjitha bëjnë pjesë në fondin leksikor letrar. Vështirësitë që ne hasim në terren lidhen me ndryshime në përdorimin gjinor e që i ka rrënjët më të thella në vetë mënyrën e jetesës së shqiptarëve. Vëmendja përqendrohet në disa emërtime më të lashta dhe forma të të folmeve, që ndryshojnë përdorimin. Është fjala për disa nga emërtimet e sferës familjare e të respektit, që krijohen e sillen brenda një shoqërie. Kështu, si emër respekti, me një shtrirje më të gjerë në gjuhët e familjes indoevropiane, është emërtimi *tatë-tata*. Çabej dhe studiues të tjerë pajtohen me sqarimin që kjo formë të jetë e gjuhës foshnjore, me të cilën i drejtohen babait; “emri me të cilin thërret fëmija *t’anë*”¹. Këtë e arsyetojnë edhe me emërtimet: *tatëmadh*, *tatëzot* me kuptim gjyshi². Po në të folme, ndodhin ndryshime të përdorimit në gjininë femërore, apo forma të riprodhuara nga një temë. Kështu, emërtimi *tatë – tata*, në të folme të Kërçovës ka kuptimin e nënës, *tota*, mund të merret si një formë e riprodhuar nga forma *tatë/tata* duke formuar emërtim po ashtu për nënën në Dibër, diku edhe emërtim për motrën e madhe, ashtu siç e kemi në Strugë; *tota* - nënë; motra e madhe.

¹ E. Çabej, Studime gjuhësore II, Prishtinë, 1976, fq. 166.

² Po aty.

Gj. Shkurtaç me të drejtë flet për statusin dhe rolin e folësve, që ndërlihet me rolet që i kanë anëtarët e një shoqërie dhe thekson rëndësinë e rolit të babait, të djalit të madh apo djalit të parë³. Kjo mund të shërbejë si arsye se pse në disa emërtime paraqiten luhajtje gjatë përdorimit, ngase në rrethana të caktuara ndodh ndërrimi i roleve. Këtë më mirë mund ta ilustrojmë me varietetet leksikore: *date* e *dati*, që në rajone të caktuara përdoret si emërtim për baba, diku emërtim për vëlla, e diku i ka që të dy kuptimet.

Date, emërtim për baba e *dati*, emërtim për vëllanë e madh në Dibër; në Kërçovë emërtimi *dati* përdoret për vëllanë më të madh edhe për babanë, por forma dyshe, në këtë të folme, *date* e *dati*, zakonisht përdoret më shumë për vëllanë⁴. Në Strugë, kanë vepruar ashtu si në Dibër, duke i ndarë emërtimet sipas ndërrimeve fonetike, përkatësisht dallimi i tingujve fundor, *date* - babë, *dati* - vëllai më i madh. Ndryshimet kuptimore e variantet leksikore janë brenda vetë territoreve⁵.

Emërtimi tjetër *bac- baca-baci*, po ashtu përdoret për vëllanë e madh, apo edhe *bac-i*, *bac-a* me kuptim baba, por ky përdorim mund të zgjerohet në aspekt të të drejtuarit edhe personave tjerë të vjetër të huaj e që është i pranishëm në të folmet gege. (Gj. Shkurtaç, - Kur kreshnikëve u flitet në emër, zakonisht, u paraprin fjala zbuluese *bac-i*, *bac-a*, kryesisht për Mujin e Halilin, zakonisht në parandejtim: *baca Mujë, baci Halil ...*)⁶

Po në rrethana të njëjta janë zhvilluar edhe emërtimet për gjininë femërore, për statusin dhe rolin që e kanë nëna dhe motra e madhe (si shem. i mësipërm: *tatë* - *tata*- nënë; *tota* - nënë; motra e madhe). Kështu emërtimi *dadë- dada - dado* (pers. *dādā*, turq. *dadī*) në rajon të Karshiakës paraqitet kryesisht si emërtim të motrës së madhe, por në f. Patishka Rekë të këtij rajoni, *dadë* përdoret për nënën⁷.

Mes këtyre emërtimeve të huaja sinonimike, ka një shtrirje përdorimi emërtimi *aba*; në Dibër emërtimi *aba* i drejtohet motrës së madhe ose hallës së vogël, që përsëri lidhet me pozitën e hallës e motrës dhe shfaq një respekt të të rinjve ndaj më të vjetërve brenda familjes, po në raste individuale ndodh që fëmijët i drejtohen me emërtimin *aba* edhe nënës. Si emërtim leksikor, që i referohet vëllait më të madh është emri *abi*, i po të njëjtit burim, por në kuadër të kësaj nuk njihen përdorime tjera.

Vështirësi kuptimore nuk paraqiten me fjalën *babë - baba* të gurrës turke, e cila sot është e shtrirë në tërë gjuhën shqipe, ashtu si edhe në disa gjuhë të tjera ballkanike. Fare çdokund përdoret në këtë kuptim. Etimologjinë e këtij emërtimi, Çabej e

³ Gj. Shkurtaç. Sociolinguistikë e shqipes, 2009, fq. 130

⁴ Kështu e sqaron edhe Q. Murati, që është nga kjo anë; “*dat-i* është përdorur dikur nga fëmijët, në rrethinën e Tuhinit të Kërçovës, si shenjë respekti, për babanë, sot kjo fjalë përdoret më rrallë; kurse në rrethinën tjetër të Zajazit të Kërçovës, *dat-i* e *dat-e* përdoret më shumë për vëllanë”. Q. Murati, Kërçova, Shkup, 2008.

⁵ Q. Murati. Kërçova, Shkup, 2008.

⁶ Gj. Shkurtaç, Etnografia e të folurit në eposin e kreshnikëve, GjA, SShF. 39/2009, Prishtinë, 2010, fq. 90.

⁷ Këto emërtime, me po të njëjtin kuptim, *baci*, *baca* e *dadë*, janë forma të të folmeve të Veriut, po edhe *babdaj* e *ap-a*, i jep si emërtime të gegërishtes veriperëndimore. Gj. Shkurtaç, Sociolinguistikë e shqipes, 2009, fq. 382/383.

mbështet në ndërrimin e formave në geg. *babë*, tosk. *babá*, duke krahasuar me theksin e fjalës turke *abá*, e nga ana tjetër nuk gjendet te e folmja arbëreshe.⁸ Por në f. Patishka Rekë, shkojnë edhe më larg në linjën familjare, sepse vendosin një shkallëzim, në të cilën emërtimet *babë* dhe *babai i ri* bartin dallim të gjeneratave, me emrin *babë* i drejtohen gjyshit, duke e dalluar babanë e vet me emërtimin tjetër *babai ri*, po vërehet edhe një emërtim tjetër krahas këtyre të parave, e kjo është fjala *baç*, përsëri me kuptim baba dhe si formë përkëdhelëse.

Familjet shqiptare, duke përcaktuar statusin dhe rolet e çdo anëtari të familjes, me respekt të jashtëzakonshëm ndaj më të vjetërve dhe rolit të burrit/babë, në njërën anë, po edhe të gruas/nënës në anë tjetër, kanë ndikuar edhe në forma tjera leksikore, të cilat nuk janë gjithëpërfshirëse në aspekt të përdorimit. Në favor të kësaj ekzistojnë emërtime të tipit: *nëna e dejxhës* për gjyshen, *babai i dejxhës* ose edhe *babai e dejxhës*, për gjyshin, që vërehet në disa të folme të Tetovës, derisa në Strugë përdoret si fjalë e përbërë, p.sh. *nonadaes*, *babadaes*, apo në të folmet toske të Strugës, ku njihet vetëm emërtimi për gjyshen *nonadates*, ashtu si në Dibër, në të cilën kemi emërtimin *nana e dajës*, por jo edhe babai i dajës. Kjo ka të bëjë përsëri me statusin dhe rolin që ka e djali/vëllai në familjet shqiptare përkundër atij të vajzave/bijave/nënave. Por edhe për gjyshen nga ana e babait është një formë shprehjeje respekti duke e zëvendësuar babain me xhaxhain më të madh; në Strugë; *nëna e babit/nëna e axhit/nëna e madhe*.

Përcaktimi i këtyre rregullave brenda familjes sjell deri dhe krijimin e shprehjeve të respektit që vlejné vetëm për një grup, kështu nusët në Strugë, tezeve dhe hallave të burrit u drejtohen me emërtime përkëdhelëse, *onkohalla* e *onkotezja*, po edhe *onkonene* për stërgjyshen e *agobaba* për vjehrrin. Në të folme të Dibrës, përdorin emërtimin përkëdhelës *teka* për teze dhe *lala* për hallë. Vështirësi, përkatësisht ndryshime të njohjes së emrit *lalë-lala-lal*, në fjalor përcaktohet si e gjinisë mashkullore, në të folme ky emër përdoret më shpesh, si e gjinisë femërore, ashtu si ndodh në të folme të Dibrës e të Strugës, ku ka kuptimin e hallës; derisa në të folme të Tetovës përdoret në gjininë mashkullore. Po e njëjta gjë ndodh edhe me emërtimin *gocë*, që në fjalor njihet si e gjinisë femërore, ndërsa në të folme të Kërçovës ky emër përdoret si i gjinisë mashkullore *goc* “djale”.

Emërtimet e tjera të gjinisë mashkullore kanë thujse çdokund përdorim të njëjtë, kështu fjala: *agë/ag* – *agá* (*aga* - tur. *ağa*- zotëri) dhe *xhaxha/ axhë/axha* (tur. *amica- mixha*), përdoren si emërtime të relacioneve familjare, por diku përdoren si forma respekti për t’iu drejtuar më të vjetërve, por edhe të panjohurve. Këto emërtime funksionojnë si sinonimike dhe kanë një shtrirje përdorimi më të gjerë, në të folmet shqipe, si p.sh. në të folme të Karshiakës, si formë e respekti përdoret më shpesh emërtimi *aga* për persona më të vjetër, e diku përdoret edhe emërtimi *axha*.

Edhe relacionet tjera brenda familjes janë të rregulluara po ashtu. Kjo është e theksuar në raportin e respektimit dhe të folmeve të fëmijëve ndaj femrave tjera në familje, përveç nënës e motrës. Këto në esencë janë shkurtesa që dalin nga emërtimet e plota; (emërtime të gjinisë femërore që ndërtohen mbi emra të gjinisë

⁸ E. Çabej, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 1976, fq. 46.

mashkullore, *mixh-a*), si p.sh. *mixhavica*, në Patishkë ka dhënë emërtimin përkëdhelës *vice*, në Dibër *mixhovëjca* ka dhënë emërtimin *xica*, nga *dajvëjca* është përfituar emërtimi *vëjca*. Për lidhjen e fuqishme në familje që kanë edhe me nuset e axhës dhe rolin që kryejnë ato, ndodh të përdoren më shumë emërtime: *tata / nuse/ doke*, së bashku me *tezet, tota / tete*; ose duke barazuar xhaxhain me babain, si p.sh.: *axhi/xhaxhi/dati*.

Po edhe çdo rajon ka krijuar emërtime e forma vetjake të ngjyrimin përkëdhelës duke shprehur respekt ndaj më të vjetërve, si p.sh. *puça* në Tetovë, *gagë* në të folme të Likovës e Kumanovës, apo *kekë* në Patishka Rekë e *kako* në të folme të Kërçovës.

“Varianti i fjalës *puçe* në Tetovë nuk përdoret, përdoren forma të tjera, si: *puça, puço* – thirrrore. Me emërtimin, *o puço*, u drejtohen axhallarëve”⁹. Përdoret gjithashtu forma e shkurtër: *pça* Lazim, *pça* Emin etj. Po vërehet një dallimi ngjyrimi, derisa për folësit burimorë ajo ka kuptim përkëdhelës, te të tjerët ajo ka marrë kuptim përbuzës e tallës, megjithatë në përdorim të drejtë dhe të gjerë, emërtimi *puço-puça*, shërben për t’u drejtuar njerëzve më të rritur, duke shprehur një mirënjohje dhe duke u dhënë një status nderi. Madje edhe për t’u drejtuar një njeriu më të moshuar që nuk ia njohim emrin e që mbase e takojnë edhe rastësisht, i drejtohen me fjalën *puço*, duke i dhënë një pozicion nderues në komunikim. Sa u përket emërimeve të femrave, ato nuk janë të shumta: *aba* e *xhixha* (grua e moshuar), *nuçe - nuçja* (emër përkëdhelës për gjyshet) etj.

Në disa të folme të Tetovës po ashtu paraqitet edhe një emërtim tjetër që nuk ka përhapje kudo njësoj, është forma e respektit ndaj më të vjetërve, siç është *api* a *apa*, ndërsa në Strugë emërtimi *apo* shpreh lidhje familjare, përdoret për babë, por edhe për vëlla më të madh. *Api/apa/apo*, janë tri variante fonetike që i gjejmë në të folmet shqipe, ndërsa në të folmet maqedonase është e pranishme forma me prapashtesën *-o*, (si huazim e ndikim nga shqipja)¹⁰.

Po një formë e të folmes foshnjore e të respektit, gjithandej e njohur dhe e përhapur në të folme të Likovës e të Kumanovës është edhe forma *gaga* duke iu drejtuar të

⁹ I intervistuari (f. Çellopek i Tetovës): Varianti i fjalës PUÇE në vendin ku jetoj (f. Çollopek) nuk përdoret. Përdoren forma të tjera: PUÇA, PUÇO. Bie fjala unë axhës tim i drejtohem me fjalën *o puço*. Edhe djemtë e axhës babait tim po ashtu. Ose edhe kështu: *Erdhi puça dhe pyeti a je në shpi*. Përdoret gjithashtu forma e shpejtë e shqiptimit: *pça* Lazim, *pça* Emin etj. Nuk përdoret në asnjë rast për dajallarët në mjedisin ku jam rritur. Varianti *puçe*, përdoret kryesisht pas vitit 1991, me ngjyrim tallës e ironik mes rinisë në qytet dhe mes studentëve për të personifikuar burrat tradicionalë që janë pronarë, por janë të paarsimuar, p.sh. *puçe Tetove*, përdoret nga studentët që nuk janë nga Tetova e rrethina. Kështu, emërtimi *puçe* mund të interpretohet si shprehje e krijuar nga ata që nuk e kanë në të folurit e tyre dhe ndjehet si ofendim dhe shtrembërim nga ata që e përdorin në formë burimore, *puça, puço* ose *pça*.

¹⁰ Boris Markov vëren më shumë emërtime familjare të gjuhës shqipe në të folme maqedonase, si: *apo/ano, bir-o/бир-о, gjalo/ѓало, gjusha/ѓуша, nusa/нуса* etj. Марков, Борис. Албанско-македонски лексички контакти во обраќање кон роднини и други лица, Скопје, 2010 fq. 8.

vjetërve. Po edhe forma respekti *gaga*, (ashtu siç ndodh me emërtimin *pça*), kalon në një formë të shkurtuar përkëdhelëse të emërtimit, *ga*.

Po nga i tërë rajoni i Karshiakës, Patishka Reka ka emërtime të veçanta që përdoren edhe në të folmet shqipe të Rekës. Kështu emër respekti, me të cilat u drejtohen plakave janë *kekë-keka*, *keka Lep* etj.

Përdoren edhe format tjera, me prapangjijtjen e prapashtesave të ngjyrimin përkëdhelës –*çe*: *hallçe*, *luçe*, *tezuçe*, *nëjçe*, *babë-babuç apo babush* etj.

Dibër:

Date - babë;

Totë-a- nënë;

Nana e dajës - gjyshja

Dati – vëllai i madh;

Aba – motra e madhe ose halla e vogël (zakonisht për hallen që fëmija e ka në shtëpi);

Lala- hallë;

Teka – teze;

Dajvëca/vëjca – nusja e dajës;

Mixhovëjca/xica – nusen e axhës;

Axhi / mixha;

Coc-a - vajzë

Voc – djalë;

Gjal – djalë;

Nëjçe –nip;

Kërçovë:

Dati – babë;

Tatë-a – nënë;

Date/dati – vëllai i madh;

Kako- motra e burrit; (kështu i quan nusja të afërmet e burrit në shenjë nderimi; ... si ndajshtime, prej kokonë, gr. kokona “zonj”) (Q.Murati, Kërçova, Shkup, 2008, fq. 83)

xhaka – (përkëdh.) mixha;

dajxhojc- nga dajë/daja, nusja e dajës;

luçe – (përkëdh.) hallë; është fare e kuptueshme se forma *luçe* s’është asgjë tjetër, përveç shkurtesë nga emërtimi përkëdhelës *halluç-lluçe*, që ka kaluar në *luçe*;

tezuçe – (përk.) për tezen;

gocë – djalë;

Strugë

pjesa gege e Strugës:

Date – babë;

madh;

Dati – vëllai i madh;

byrazerka- motra;

pjesa toske e Strugës:

apo – babë, por edhe vëllai më i

byrazer – vëllai më i madh;

byrazerka- motra;

<i>Tota</i> - nënë; motra e madhe;	<i>tata/ mamkë/doke</i> – nënë;
<i>Niene/ onkonene</i> – stërgjyshja;	<i>nëna e babit/nëna e axhit/ nëna e</i>
<i>madhe</i>	<i>Onkohalla</i> – halla (përk. -
- gjyshja;	
në të folme të nuseve);	<i>babush/date, babi i babit</i> – gjyshi
<i>Onkotezja</i> – tezja (përk.-	<i>hanko- vjehrra;</i>
në të folme të nuseve);	
<i>lala</i> – hallë;	<i>halla e madhe/halla e vogël</i> - halla;
<i>kunatoll- vëllai i nuses, kunat;</i>	<i>kunatoll</i> – vëllai i nuses, kunat;
<i>çun</i> – djalë;	<i>çun</i> – djalë;
<i>couc- vajzë;</i>	<i>cuc- vajzë;</i>
<i>voc</i> – djalë;	
<i>dajovëjc- nuse e dajës;</i>	<i>aba</i> – nusja e dajës;
<i>mixhovëjc</i> – nuse e axhës;	<i>tata / nuse/ doke</i> – nuse e axhës;
<i>xhaxhi/axhe</i> – xhaxhai;	<i>axhi/xhaxhi/dati</i> – xhaxhai;
<i>tjeze/teze</i> – teze;	<i>tota/tete</i> – tezja;
<i>baxhanak</i> – burri i motrës së gruas;	
<i>baxhanake</i> – motra e gruas.	

Në pjesën më të madhe të të folmeve të Karshiakës përdoren emërtime që janë kudo të njohura, të cilat paraqiten emërtime kryesisht me ndërrime fonetike: *cauca, caull, mixh/ maixh /mainxh/ mëixh, dajxha/daixh/daxh/daj, thmai, zollv/kunatë, balldosk/ balldoze* “motër e gruas”, *babaxhish/babagjish, babaqak/ babapqak, nanalluke, ag* “vëllai më i madh”; por edhe: *bac, voc, carrok* etj.¹¹ E vetmja Patishka Reka bën përjashtim duke përdorur disa emërtime familjare e forma të veçanta respekti:

Bab – gjyshi;
Babai ri – babë;
Baç – babë;
Non /dadë – nënë;
Nonalluke- njerka; (në vetë emërtimin përmbahet kuptimi dhe roli i saj, e cila merr kujdesin mbi fëmijët);
Kekë – të afërmet, tezja e halla;
Vica – grua e mixhës;
Dajxh/daj;
Dajxhevica – nusja e dajës;
Vash/cuc – vajzë;
Gjal – djalë;
Krushk- mikut;
Krushka- mikeshës.

Në këto rajone, kur bëhet fjalë për raporte të respektit ndaj grave, zakonisht krijohen emërtime të prejardhura. Më shpesh, gratë njihen sipas emrit të burrit,

¹¹ H. Ymeri, E folmja shqipe e Karshiakës, Shkup, 1998.

ashtu që u prapangjitet prapashtesa *-vica* e *-ica*, p.sh. *Filevica*, *Hasanica* etj. dhe kjo formë ka shtrirje më të gjerë përkundër emërtimeve që marrin prapashtesën *-ka*, si: *Eshtrëfka*, *Beharka*, *Naserka* etj. (Kjo ka shkaktuar që në Patishkë të përdoren e të dëgjohen, njëkohësisht të dyja format, edhe me *-vica* e *-ica* edhe me *-ka*.)¹²

Bibliografia:

- E. Çabej, Studime gjuhësore I, Prishtinë, 1976.
 E. Çabej, Studime gjuhësore II, Prishtinë, 1976.
 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A-M, Prishtinë, 1981.
 Fjalor i gjuhës së sotme shqipe N-Zh, Prishtinë, 1981.
 Fjalor i gjuhës shqipe, Prishtinë, (ribotim 1965).
 Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.
 Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë, 2000.
 Марков, Борис. Албанско-македонски лексички контакти во обраќање кон роднини и други лица, Скопје, 2010.
 Murati, Qemal. Kërçova – Hulumtime gjuhësore, etnografike dhe folklorike, Shkup, 2008.
 Shkurtaj, Gjovalin. Sociolinguistikë e shqipes, Tiranë, 2009.
 Shkurtaj, Gjovalin. Etnografia e të folurit në eposin e kreshnikëve, GjA, SShF. 39/2009, Prishtinë, 2010.
 Ymeri, Haki. E folmja shqipe e Karshiakës, Shkup, 1998.

¹² Gj. Shkurtaj, këto forma të prejardhura me prapashtesën *-vica* i gjen në të folme të Korçës. Sociolinguistika, Tiranë, 2009, fq. 386.

NAZMI BEQIRI

QASJE E SHKURTËR MBI TË FOLMEN E KUMANOVËS

E folmja e Kumanovës i takon të folmes së gegërishtes së jugut, të një gegërishte të butë, që më tepër i ngjason mesogjuhës. Këtë mendim e mbajnë shumë gjuhëtarë në mesin e të cilëve edhe Dr. Ali Jashari, Prof. dr. Zijadin Munishi etj., por studim për këtë të folme nuk është bërë thuaja se fare deri më tani. Me sugjerim të profesorëve të mi, bëra një studim të vogël mbi këtë të folme, duke u përqendruar në foljet ndihmëse: *kam, jam, di, mbaj, flas* etj. Një ndihmë të konsiderueshme e mora edhe nga Dr. Ali Jashari, i cili pohon se kjo e folme i takon të folmes së gegërishtes jugore, që shtrihet anës së majtë të Matit: Durrësit, Elbasanit, Peshkopisë, Dibrës, Shkupit dhe Kumanovës. Pa e kundërshtuar fare mendimin e tyre, i cili nuk lidhet fare me anën territoriale, do të lidhem me mendimin tjetër të tyre për mesozonën gjuhësore, mes dialekteve të shqipes e cila shtrihet prej bregdetit për Shkumbin deri në Qafëthanë. Kjo vijë thuhet se u ngulit në kohën e ndarjes së Perandorisë Romake dhe Bizantine, më 1054, kur merret edhe si fillim i ndarjes së dialekteve, apo kohës së rotacizmit (siç njihet në gjuhësi). Pavarësisht se, që nga Durrësi e deri në Qafëthanë, kjo ndasi bëhet e prerë nga aty, duke i përfshirë vendet e Maqedonisë së stome, Kosovës, Luginës së Moravës, e në lindje kah flitej shqipja, se ishte nën përfshirjen e sundimit të Bizantit, ku si praktikë e vendeve paraprake dominon toskërishtja, këtu rotacizmi nuk arriti që ta shtrijë ndikimin e vet.

Këtë çështje duhet shtruar edhe nga aspekti historik, në një simpozium të ardhshëm, prej nga do të del se, pos pranimit të fesë së Bizantit, aty nuk ishte arritur që të vihet një regjim i egër si në jug, apo në perëndim.

Unë do ta vazhdoj këtë mesozonë, për ta mbrojtur si të tillë me të folmen e Kumanovës, që e ndanë Brezavia, sikurse Shkumbini mesozonën, e cila fillon prej Durrësit e mbaron në Qafëthanë, në dy anët e liqenit të Ohrit, anës veriore të liqenit të Prespës, për të dalë në Manastir, nga do të vazhdohet përmes rrjedhës së lumit Cërna për në Dardhë dhe Përlep (Prilep). Nga aty, rrjedhës së lumit Babunë për të përfunduar në Stobi (Veles – si një ndër qytetet më të mëdha ilire). Pastaj, përskaaj Bardhanit (Vardari), kap lumin Përçonjë (Pçinja), për të vazhduar rrjedhës së

Brezavisë (Golema e quan S. Frashëri), kurse në harta (as ato etnike), ky lum nuk ka kurrfarë emri, kurse emrin Brezavi e kam marrë nga një toponim mes Brezës dhe Gushincës që i ndanë ky lum, e që vendasit e quajnë Brezavi, Brezavir), duke e ndarë të folmen e shqipes në dy krahë. Kurse, e folmja e anës së djathtë (duke shkuar drejt veriut) të këtij lumi do të vazhdojë deri në Nisus (Nish) e tutje, rrjedhës së Moravës.

Që nga Manastiri e deri në Kumanovë, kësaj ane që e përmendëm, shqiptarët që ishin me besim ortodoks i sllavizuan, një numër i myslimanëve u shpërngulën ose u turqizuan, e shumë pak prej këtyre fshatrave të izoluar e ruajtën identitetin e tyre kombëtar. Kjo vijë e shkëputur etnike shqiptare i çon mendimtarët e shumtë që të fluturojnë nga Mati e drejtë në Kumanovë, duke e kaluar Pollogun e Ndërvenin (Dërvenin), për të dalë fushës së Zallishtës apo Kumanovës (siç quhet sot), pa e shikuar se e folmja e Pollogut mbaron në Brezavijë. Ndërsa, e folmja e Dibrës dallon nga ajo e Pellagonisë, e qëndron më afër të folmes së Kumanovës, e cila është bartur përmes rrjedhës së lumit Drin, kurse Kërçova flet më ndryshe.

Është interesant se Brezavinë, për nga ana e të folmes, as interesat e përziera, as të dëbuarit që janë vendosur këtu (që nga Vranja, Leskoci e Piroti), madje as shkollimi me një qendër të mesme shkollore në rrethinën e Kumanovës, nuk arritën ta ndryshojnë.

Fshatrat që kanë gjuhë të ndryshme kanë vetëm tre deri në pesë kilometra, kurse disa prej tyre i ndanë vetëm lumi.

Duke shkuar anës veri – perëndimore të qytetit, për të përcjellë rrjedhën e lumit, në anën e djathtë të tij, janë këto fshatra: Opajë, Sllupçan, Vaksincë, Llojan, për të vazhduar me Miratocin e Preshevën, të cilët i largohen shtratit të këtij lumi.

Atë (lumin) më tutje e përcjellin Allasheca, Izvori (Kroni), Runica, Ballanoci, Shtraza, Zllakuçani, Stanqiçi, ndërkaq anës së majtë Llopati, Ropalca, Mateçi, Nakushtaku, Vishtica, Hotla, Strima, Presnica, Orkoca, Orizarja, Likova, Gllazhnja, Dumanoca dhe Gushica, janë të vendosura në shtrat apo pranë shtratit të lumit, të cilët kanë një të folme mesatare, duke e marrë anën e të folmes që i takojnë. P.sh.: Llopati është i vendosur skaj anës së majtë të lumit, dhe mbante anën e të folmes së majtë, kurse Orizarja është e vendosur anës së djathtë sikurse edhe Goshinca, dhe e mbajnë anën e të folmes së katundeve që janë të vendosura në anën e djathtë. Ana e të folmes së majtë përdorë:

“gj” në vend të “g”,

“q” për “p”,

“a” për “i”,

“au” për “u”,

“a” për “e”,

“e” për “a”

“a” për “y”,

“a” për “u”,

”o” për ”ua”.

Shembull: gjuri – guri
qak – plak
rraush – rrush

Matajç – Mateç
 A u rrajte – a u rrujte (rruajte)
 A u rrajte – a u rrite
 katani – katuni (katundi)
 shpaj – shpi (shtëpi)
 kol-t – kual-t (kuajt)
 (për “a u rrite” dhe “a u rruajte” ata e përdorin të njëjtën formë – shprehje).

Ardhje – ikjet e popullsisë, më tepër i kanë takuar anës së djathtë dhe, duke pasur parasysh se qyteti i Kumanovës ka fare pak vendas, për të mos thënë fare, ngase është mbushur me të ardhur, më së shumti prej anës së djathtë të Brezavisë, duke filluar që nga Piroti e deri prej Vranje.

E prezantojmë këtë të folme, ngase mund t’i shërbejë dhe duhet t’u shërbejë gjuhëtarëve, historianëve, etnologëve për të ndriçuar gjërat e të kaluarës së kësaj krahine, ngase ashtu siç zbulon identitetin ADN – ja, ashtu gjuha zberthen të kaluarën e një populli në lëndët që i përmendëm.

Sot, në qytet dëgjohet vetëm kjo e folme, pos në rastet e rralla të ndonjë bisede nostalgjie apo ironie. Prandaj, zgjedhimin e foljeve *kam, jam, di, mbaj* dhe *flas* do ta bëj në të folmen e qytetit të Kumanovës.

Zgjedhimi vepror i foljes *kam* në të folmen e Kumanovës në mënyrën dëftore të kohës së tashme bënë:

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>	<i>e kryer e thjesht</i>
Kam	kam pasë	kishna	kishna pasë	pata
Kemi	kemi pasë	kishmi	kishmi pasë	patëm

Në të folmen e Kumanovës nuk thuhet *kishnim* por *kishmi* edhe pse në raste të rralla si në Likovë përdoret edhe *kishnëm* sh: *kishnëm harru*, jo *kishnim*.

<i>E kryer e tejshkuar</i>	<i>e ardhme</i>	<i>e ardhme e dytë (II)</i>	<i>e ardhme e përparme</i>
Patna pasë	do të kam	kam me pasë	do të kam pasë
Patëm pasë	do të kemi	kemi me pasë	do të kemi pasë

E ardhmja e së shkuarës - e ardhmja e së shkuarës së dytë (II) - E ardhme e përparme

Do të kishna	Kishna me pas pasë	Do të kishna pasë
Do të kishmi	Kishmi me pas pasë	Do të kishmi pasë

Në mënyrën habitore folja *kanë* në të folmen e Kumanovës në kohën e tashme bënë:

<i>E kryer</i>	<i>e tashme e pakryer</i>	<i>E tashme pakryer</i>	<i>më se e kryera</i>
Paskam	paskam pasë	paskëshna	paskëshna pasë
Paskemi	paskemi pasë	paskëshmi	paskëshmi pasë

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

Lidhorja do të bënte:

<i>e tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
të kam	të kam pasë	të kishna	të kishna pasë
të kemi	të kemi pasë	të kishmi	të kishmi pasë

Lidhore - habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të paskam	të paskam pasë	të paskëshna	të paskëshna pasë
Të paskemi	të paskemi pasë	të paskëshmi	të paskëshmi pasë

Folja *kam* në mënyrën kushtore në të folmen e Kumanovës në:

<i>kohën e tashme:</i>	<i>e tashme e dytë (II)</i>	<i>e kryer</i>
Do të kishna	kishna me pasë	do të kishna pasë
Do të kishmi	kishmi me pasë	do të kishmi pasë

Folja *kam* në të folmen e Kumanovës në mënyrën dëshirore:

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>
Paça	paça pasë
Paçmi	paçmi pasë

Urdhërorja:

ki
kini

Zgjedhimi jovepror i foljes *kam* në të folmen e Kumanovës në mënyrën dëftore:

<i>E tashmja</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Kihet	është i pasëm	kihej	ishte i pasëm
Kihen	janë të pasëm	kiheshin	ishin të pasëm

<i>E kryera e thjeshtë</i>	<i>e kryer e tejshkuar</i>	<i>e ardhme</i>	<i>e ardhme e dytë (II)</i>
U pat	ke pasë	do të kihet	ka për tu pasë
U patën	kanë pasë	do të kihen	kanë për tu pasë

<i>E ardhme e përparme</i>	<i>e ardhme e së shkuarës</i>	<i>e ardhme e së shkuarës së dytë (II)</i>
Do të jetë pasë	do të kihej	kishte për tu pasë
Do të jenë pasë	do të kiheshin	kishnin për tu pasë

E ardhme e përparme e së shkuarës

Do të ishe pasë
Do të ishin pasë

Folja *kam* në të folmen e Kumanovës në mënyrën habitore:

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
U paska	kanka pasë	u paskësh	kankësh pasë
U paskan	kankan pasë	u paskëshnin	kankëshnin pasë

Mënyra lidhore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pa kryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të kihet	të jetë pasë	të kihej	të ishte pasë
Të kihen	të jenë pasë	të kiheshin	të ishin pasë

Lidhore - habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pa kryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Tu paska	të kanka pasë	tu paskësh	të kenkësh pasë

Mënyra kushtore

<i>E tashme</i>	<i>e tashme dy</i>	<i>e kryer</i>
Do të kihej	kishte për tu pasë	do të ishte pasë
Do të kiheshnin	kishnin për tu pasë	do të ishnin pasë

Mënyra dëshirore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>
U pastë	koftë pasë
U paçin	kofshin pasë

Zgjedhimi vepror i foljes *jam* në të folmen e Kumanovës në mënyrën dëftore:

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Jam	kam kan	ishna	kishna kan
Jemi	kemi kanë	ishmi	kishmi kanë

<i>E kryera e thjeshtë</i>	<i>e kryera</i>	<i>e pa kryera</i>	<i>më se e kryera</i>
Kesh	pata kan	do të jam	kam me kan
Kem	patëm kanë	do të jemi	kemi me kanë

E ardhme e përparme - e ardhme e së shkuarës - e ardhme e së shkuarës dytë (II) - e ardhme e përparme e së shkuarës

Do të kem kan	do të ishna	kishna me kan	do të kishna kan
Do të kemi kanë	do të ishim	kishmi me kanë	do të kishmi kanë

Në mënyrën habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Kenkam	paskam kan	kankëshna	paskëshna kan
Kankemi	paskemi kanë	kankeshmi	paskëshmi kanë

Mënyra lidhore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pa kryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të jam	të kem kan	të ishna	të kishna kan
Të jemi	të kemi kanë	të ishmi	të kishmi kanë

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

Mënyra lidhore – habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pa kryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të kankam	të paskam kan	të kënkëshna	të paskëshna kan
Të kankemi	të paskemi kanë	të kankëshmi	të paskëshmi kanë

Mënyra kushtore

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e dytë (II)</i>	<i>e kryer</i>
Do të ishna	kishna me kan	do të kishna kan
Do të ishmi	kishmi me kanë	do të kishmi kanë

Mënyra dëshirore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>
Kofsha	paça kan
Kofshim	paçmi kanë

Urdhërorja

Ji
jini

Zgjedhimi vepror i foljes *di* në të folmen e Kumanovës në mënyrën dëftore:

<i>E tashme</i>	<i>-e tashme e caktuar</i>	<i>-e kryer</i>	<i>-e pa kryer</i>	<i>-e pa kryer e caktuar</i>
Di	jam tu ditë	kam ditë	dija	ishna tu ditë
Dim	jemi tu ditë	kemi ditë	dinim	ishmi tu ditë

Më se e kryer -e kryera e thjeshtë -e kryera e tejshkuar -e ardhme –e ardhme e dytë (II)

Kishna ditë	dita	pata ditë	do të di	kam me ditë
Kishmi ditë	ditëm	patëm ditë	do të dimë	kemi me ditë

E ardhme e përparme – *e ardhme e së shkuarës* –*e ardhme e së shkuarës së dytë (II -e ardhme e përparme e së shkuarës*

Do të kam ditë	do të dija	kishna me ditë	do të kishna ditë
Do të kemi ditë	do të dishmi	kishmi me ditë	do të kishmi ditë

Mënyra habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryera</i>	<i>e pa kryera</i>	<i>më se e kryera</i>
Ditkam	paskam ditë	ditkëshna	paskëshna ditë
Ditkemi	paskemi ditë	ditkëshnim	paskëshnim ditë

Mënyra habitore në të folmen e Kumanovës, si formë e veçantë përdoret shumë pak, ose nuk përdoret fare.

Mënyra lidhore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pa kryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të di	të kam ditë	të dija	të kishna ditë
Të dimë	të kemi ditë	të dinim	të kishmi ditë

Lidhore – habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pa kryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të ditkam	të paskam ditë	të ditkëshna	të paskëshna ditë
Të ditkemi	të paskemi ditë	të ditkëshmi	të paskëshmi ditë

Mënyra kushtore

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e dytë (II)</i>	<i>e kryer</i>
Do të dija	kishna me ditë	do të kishna ditë
Do të dinim	kishmi me ditë	do të kishmi ditë

Mënyra dëshirore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>
Ditsha	paça ditë
Ditshim	paçmi ditë

Mënyra urdhërore

Di
Dini

Zgjedhimi jovepror i foljes *di* në të folmen e Kumanovës në mënyrën dëftore:

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e caktuar</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pa kryer</i>	<i>e përkryer e caktuar</i>
Dihet	është tu u ditë	është ditë	dihej	ishte tu u ditë
Dihen	janë tu u ditë	janë ditë	diheshin	ishin tu u ditë

<i>Më se e kryer</i>	<i>e kryer e thjesht</i>	<i>e kryer e tejshkuar</i>	<i>e ardhme</i>	<i>e ardhme e dytë (II)</i>
Ishte ditë	u ditë	ke ditë	o të dihet	ka për tu ditë
Ishin ditë	u ditën	kanë ditë	do të dihen	kanë për tu ditë

E ardhme e përparme -e ardhme e së shkuarës - e ardhme e së shkuarës së dytë (II) -e ardhme e përparme e së shkuarës

Do të jetë ditë	do të dihej	kishte për t'u ditë	do të ishte ditë
Do të jenë ditë	do të diheshin	kishin për t'u ditë	do të ishin ditë

Mënyra habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
U ditka	kanka ditë	u ditkësh	kankësh ditë
U ditkan	kankan ditë	u ditkëshin	kankëshin ditë

Mënyra lidhore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të dihet	të jetë ditë	të dihej	të ishte ditë
Të dihen	të jenë ditë	të diheshin	të ishin ditë

Mënyra lidhore-habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Tu ditka	të kanka ditë	tu ditkësh	të kankësh ditë
Tu ditkan	të kankan ditë	tu ditkëshin	të kankëshin ditë

Mënyra kushtore

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e dytë (II)</i>	<i>e kryer</i>
Do të dihej	kishte për tu ditë	do të ishte ditë
Do të diheshin	kishin për tu ditë	do të ishin ditë

Mënyra dëshirore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>
U dittë (u dit-të)	kofhtë ditë
U ditshin	kofshin ditë

Zgjedhimi i foljes *mbaj* në të folmen e Kumanovës në zgjedhimin vepror të mënyrës dëftore:

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e dytë (II)</i>	<i>e caktuar e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>e pakryer e caktuar</i>
Maj	jam tu majtë	kam majtë	maja	ishna tu majtë
Majmë	jemi tu majtë	kemi majtë	manim	ishmi tu majtë

<i>Më se e kryer</i>	<i>e kryera e thjeshtë</i>	<i>e kryera e tejshkuar</i>	<i>e ardhme</i>
Kishna majtë	majta	pata majtë	do të maj
Kishmi majtë	majtëm	patëm majtë	do të majmë

<i>E ardhme e dytë (II)</i>	<i>e ardhme e përparme</i>	<i>e ardhme e së shkuarës</i>
Kam me majtë	do të kam majtë	do të maja
Kemi me majtë	do të kemi majtë	do të manim

<i>E ardhme e së shkuarës dy (II)</i>	<i>e ardhme e përparme e së shkuarës</i>
Kishna me majtë	do të kishna majtë
Kishmi me majtë	do të kishmi majtë

Mënyra habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Majtkam	paskam majtë	majtkëshna	paskëshna majtë
Majtkemi	paskemi majtë	majtkëshmi	paskëshmi majtë

Mënyra lidhore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të maj	të kam majtë	të maja	të kishna majtë
Të majmë	të kemi majtë	të manim	të kishmi majtë

Mënyra lidhore –habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të majtkam	të paskam majtë	të majtkëshna	të paskëshna majtë
Të majtkemi	të paskemi majtë	të majtkëshmi	të paskëshmi majtë

Mënyra kushtore

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e dytë (II)</i>	<i>e kryer</i>
Do të maja	kishna me majtë	do të kishna majtë
Do të manim	kishmi me majtë	do të kishmi majtë

Mënyra dëshirore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>
Majtsha	paça majtë
Majtshmi	paçmi majtë

Mënyra urdhërore

Maj
Mani

Zgjedhimi jo vepror i foljes *mbaj* të mënyrës dëftore në të folmen e Kumanovës:

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e caktuar</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>
Mahet	ashtë tu u majtë	ashtë majtë	mahej
Mahen	janë tu u majtë	janë majtë	maheshin

<i>E pakryer e caktuar</i>	<i>mëse e kryer</i>	<i>e kryer e thjeshtë</i>	<i>e kryer e tejshkuar</i>
Ishte tu i majtë	ishte majtë	u majtë	ke majtë
Ishin tu i majtë	ishin majtë	u majtën	kanë majtë

<i>E ardhme e dytë (II)</i>	<i>e ardhme e përparme</i>	<i>e ardhme e së shkuarës</i>
Ka për tu majtë	do të jetë majtë	do të mahej
Kanë për tu majtë	do të jenë majtë	do të maheshin

<i>E ardhme e së shkuarës dytë (II)</i>	<i>e ardhme e përparme e së shkuarës</i>
Kishte për tu majtë	do të ishte majtë
Kishin për tu majtë	do të ishin majtë

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

Mënyra habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
U majtka	kanka majtë	u majtkësh	kankësh majtë
U majtkan	kankan majtë	u majtkëshin	kankëshin majtë

Mënyra lidhore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të mahet	te jetë majtë	mahej	të ishte majtë
Të mahen	te jenë majtë	maheshin	të ishin majtë

Mënyra lidhore – habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Tu majtka	të kanka majtë	tu majtkësh	të kankësh majtë
Tu majtkan	të kankan majtë	tu majtkëshin	të kankëshnin majtë

Mënyra kushtore

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e dytë (II)</i>	<i>e kryer</i>
Do të mahej	kishte për tu majtë	do të ishte majtë
Do të maheshin	kishnin për tu majtë	do të ishin majtë

Mënyra dëshirore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>
U majtë	koftë majtë
U majtshin	kofshin majtë

Mënyra urdhërore

Mahu
manu

Folja *flas* në të folmen e Kumanovës në zgjedhimin vepror mënyra dëftore:

<i>e tashme</i>	<i>e tashme e caktuar</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>e pakryer e caktuar</i>
foli	jam tu folë	kam folë	flisja	ishna tu folë
folmi	jemi tu folë	kemi folë	folnim	ishim tu folë

Theksimi i foljes fol, në të folmen e Kumanovës, pos në rastin urdhërues që shumë qartë, madje kushtëzohet të theksohet pa “ë”, në të gjitha rastet kushtëzohet përdorimi i “ë”-së pas “i”-së.

<i>më se e kryer</i>	<i>e kryer e thjeshtë</i>	<i>e kryera e tejshkuar</i>	<i>e ardhme</i>	<i>e ardhme e dytë (II)</i>
kishna folë	folsha	pata folë	o të foli	kam për të folë
kishmi folë	folshmi	patëm folë	do të folmi	kemi për të folë

e ardhme e pakryer *e ardhme e së shkuarës* *e ardhme e së shkuarës dytë (II)*
e ardhme e përparme e së shkuarës
do të kam folë do të folsha kishna për të folë do të kishna folë
do të kemi folë do të folshmi kishmi për të folë do të kishmi folë

Mënyra habitore

e tashme *e kryer* *e pakryer* *më se e kryer*
folkam paskam folë folshna paskështa (paskëshna) folë
folkemi paskemi folë folshmi paskëshmi folë

Mënyra lidhore

e tashme *e kryer* *e pakryer* *më se e kryer*
të foli të kam folë të folsha të kishna folë
të folmi të kemi folë të folshmi të kishmi folë

Mënyra lidhore – habitore

E tashme *e kryer* *e pakryer* *më se e kryer*
të folkam të paskam folë të folshna të paskëshna folë
të folkemi të paskemi folë të folshmi të paskëshmi folë

Mënyra kushtore

E tashme *e tashme e dytë (II)* *e kryer*
do të folshna kishna me folë do të kishna folë
do të folshmi kishmi me folë do të kishmi folë

Mënyra dëshirore

E tashme *e kryer*
Folsha paça folë
Folshmi paçmi folë

Mënyra urdhërore

Fol
Folni

Zgjedhimi jo vepror i foljes *flas* në të folmen e Kumanovës në mënyrën dëftore:

E tashme *e tashme e caktuar* *e kryer* *e pakryer*
Folet është tu folë është folë folej
Folen janë tu folë janë folë foleshin

E pakryer e caktuar *më se e kryer* *e kryer e thjesht* *e kryera e tejshkuar*
Ishte tu u fol ishte folë u folë ke folë
Ishin tu u fol ishin folë u folën kanë folë

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

<i>E ardhme</i>	<i>e ardhme e dytë (II)</i>	<i>e ardhme e përparme</i>	<i>e ardhme e së shkuarës</i>
Do të folet	ka për tu folë	do të jet folë	do të folej
Do të folen	kanë për tu folë	do të jenë folë	do të foleshin

<i>E ardhme e së shkuarës së dytë (II)</i>	<i>e ardhme e përparme e së shkuarës</i>
Kishte për tu folë	do të ishte folë
Kishin për tu folë	do të ishin folë

Mënyra habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
U folka	kana folë	u folsh	kankësh folë
U folkan	kanan folë	u folshin	kankëshin folë

Mënyra lidhore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Të folet	të jetë folë	të folej	të ishte folë
Të folen	të janë folë	të foleshin	të ishin folë

Mënyra lidhore – habitore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>	<i>e pakryer</i>	<i>më se e kryer</i>
Tu folka	të kana folë	të u folkash	të kanash folë
Tu folkan	të kanan folë	të u folkashin	të kankëshin folë

Mënyra kushtore

<i>E tashme</i>	<i>e tashme e dytë (II)</i>	<i>e kryer</i>
Do të folej	kishte për tu folë	do të ishte folë
Do të foleshin	kishin për tu folë	do të ishin folë

Mënyra deshirore

<i>E tashme</i>	<i>e kryer</i>
U foltë	koftë folë
U folshin	kofshin folë

Foljet *kam, jam, di, mbaj, flas* i mora në zgjedhim ashtu siç përdoren në të folmen e regjionit të Kumanovës, duke besuar se me këtë kontribut modest do të pasqyrojmë disa karakteristika për këtë të folme, që të shërbejë për nxitjen e studiuesve të fushës së gjuhësisë dhe dialektologjisë...

P.S.

Një sqarim sa për t'iu gjetur gjuhëtarëve që në mënyrë të thellë do të merren me këtë studim. Kemi një rast të rrallë kur "a"-ja shndërrohet në "o". E veçanta e këtij ndryshimi është se, ky nuk e përfillë kufirin e përmendur, si te ndryshimi i zanoreve tjera, por gjendet gjithandej, e sidomos te femrat. Me që dëgjohet rrallë ky ndryshim edhe nuk respekton kufi, pata menduar se është deformim gjuhësorë, gjithsesi me qëllim të mirë, duke u nisur nga logjika se duhej folur ndryshe (në

gjuhën letrare). Ky ndryshim ndodh te folja ndihmëse kam, e që në këtë rast thuhet kom. E përdornin ca familje nga Shtraza, Kumanova, Çerkezi, Presheva, madje haset edhe në Shkup. Për të më bërë që ta shënoj edhe këtë ndryshim më bëri një hallexhi nga fshati Orizare që ishte i sëmurë nga lukthi. Më dukej se me kë takohej dhe i epej rasti që të bisedonte ai fliste për dhimbjet e barkut. Në preferencat që të përdorte ndonjë ilaç, ai fillonte: kom pi lëngë frashri, kom pi gaz (vajguri), kom pi raki, dhe e zgjaste listën e gjërave që kishte përdorur, por që nuk i kishin ndihmuar. Gjatë kësaj radhitje ai asnjëherë nuk harronte që foljen kam ta përdorte kom

FATMIR SULEJMANI

TAGRI I NJË VEPRIMTARIE TË PAZAKONTË ATDHETARE

Shkrimtari i harruar

Është i madh numri i shkrimtarëve shqiptarë emrat e të cilëve nuk kanë mundur të përmenden përgjatë periudhës së diktaturës komuniste, veprat e të cilëve nuk kanë mundur të lexohen nga publiku i gjerë lexues. Privilegjin e leximit të tyre e kishin vetëm *specialistët* e artit, të cilët përbënin në të vërtetë një hallkë të rëndësishme të zinxhirit të rojeve të namuzit bolshevik. Të tillët ishin ata që institucionalizonin eliminimin nga skena letrare të emrave dhe veprave të autorëve të papërshtatshëm për sistemin tani më të dështuar në nivel planetar, duke njollosur e duke nxirë si mos më keq figurat e shquara të artit e të kulturës sonë, në mesin e të cilëve më i rrezikshëm konceptohej Faik Konica, ky “mëkatari” i pashoq i çështjes shqiptare që u hoq nga panteoni i të madhërishmëve me direktiva aparatçikësh të verbuar nga urrejtja për ata që kishin guxuar ta kuptojnë botën ndryshe.

Për ta justifikuar disi veprën e tyre makabër, sepse të eliminosh skene krijues të kalibrit botëror, do të thotë të dëmtosh pariparueshëm shpirtin kolektiv të tërë një populli, Konicën e quajtnë *aristokrat*, *njeri të saloneve*, ambasador që *ironizonte e qeshte vendin e tij*, duke e quajtur *ZULULAND...* etj., etj.

Njohja e mirëfilltë e përmasave të tragjikomedisë që lidhet me larjen e memories kolektive nga kujtimi i personaliteteve që e krijuan shtetin dhe kombin shqiptar nga hiri i harresës pesëshekullore, dëshmon se, njësoj si Konica, kaluan edhe disa **LIBERATORË** të tjerë të kulturës sonë, të cilëve pushtetarët e monizmit nuk u dhanë “*as varr për hor*”!

Gjergj Fishtën, fjala vjen, të parin kolos të letërsisë shqipe të propozuar për çmimin Nobel; *Homerin shqiptar*; shkrimtarin e nderuar nga katër akademi të respektuara shkencash e artesh; poetin që aq mjeshtërisht portretoi *zogjt e shkinës* dhe *gomarët e Babatasit*; autorin e “*Lahutës së Malcisë*” dhe satirikun që nuk lind më; autorin e *gjuhës së gjallë*, *inspiratës së kulluar dhe sulmës lirike*; *Apostullin e lirisë së*

Atdheut; Orfeun e Shqipnisë; njeriun për nder të të cilit edhe një Eqrem Çabej ishte i gatshëm të bëhet katolik..., e akuzuan për tradhti kombëtare, duke iu referuar shrembtas vargjeve të poezisë së njohur satirike *METAMORPHOSIS* (tek “Anzat e Parnasit”): “*T’a dijë Shqyppnia/ Prá e sheklli mbarë,/ Se má mbas sodit/ Uu s’jam shqiptár...*”. Po kjo që veç alibia. E vërteta qëndronte në vargjet uragan të Fishtës, të frikshme për vijën e bashkim-vëllazërimit grotesko-tragjik mes shqiptarëve e sllavëve, nga përthekimi i të cilit ndoshta nuk kemi shpëtuar akoma. Mu për këtë, vargjet e sipërcituara nuk u kuptuan si satirë e fortë ndaj të tjetërsuarve nga etnia dhe Ëma e vet, por si akt i turpshëm tradhtie i poetit të lavdishëm...

Ernest Koliqin - njërin ndër intelektualët më të kompletuar të viteve të ’30-ta; *themeluesin e prozës moderne shqiptare;* estetin dhe autorin e dhjetëra studimeve dhe veprave letrare; *ministrin e arsimit (1941/42) që, nën përgjegjësinë personale themeloi shkollat shqipe në Kosovë dhe në trojet e okupuara shqiptare, duke dërguar atje qindra mësues të zellshëm, që vunë themelet e arsimit shqip në këtë trevë...*¹, e quajtnë *tregtar flamujsh, fashist, proitalian...* Po dhe kjo që veç alibia. Faji i tij ishte përskeqja e raporteve me padronët e “qufrit”. Ai e preku nëpërkën në bisht, guxoi të sfidojë xhambazët e vlerave më sublime kombëtare në kthetrat e të cilëve u gjet fati i Shqiptarisë, me novelën antologjike “*Tregtar flamujsh*”. Po, për çudinë e çudirave, njësoj si Gjergj Fishtës, iu mveshën nga atdhetarët e rremë tiparet e heronjve të tij negativë - u pagëzua *tregtar flamujsh!*?

Faik Konica, ndërkaq, si më i njohuri, më i rrezikshmi për sistemin komunist² dhe më i urryeri nga diktaturat e nënqiellit shqiptar³, ka një histori përrallë më vete. Ky gjeni mëkatmadh, që prishte keq notën mesatare të Levantinëve të kohës; *enciklopedia e gjallë; biri më eminent i Shqipërisë; pionieri i pavarësisë; Ati i prozës shqipe; zbuluesi i Flámurit shqiptar dhe propaganduesi i bëmave të Skënderbeut; mbrojtësi i patundur i çështjes arbnore dhe i të drejtave popullore;* eruditi që punoi me tërë qenien për themelet e ngrehinave më të rëndësishme të kombit: njësinë e gjuhës, njësinë e kombit dhe njësinë e shtetit shqiptar; *i vetmi njeri gjenial tek shqiptarët;* drejtuesi i revistës “*Albania*” - më të mirës të botuar ndonjëherë në shqip... - kësaj *ensiklopedie, monumenti e akademie shqiptare të kohës...*, s’kishte çare pa hyrë në tefterin e tradhëtarëve të kombit. Kombit të shqiptarëve, që, ndoshta dhe sot, ka problemin e nocioneve dhe emërtimeve të sakta të fenomeneve e dukurive...

¹ Parafrazuar nga parathënia e veprës *Tregtar flamujsh* (Buzuku, Prishtinë, 1991, f. 5), të shkruar nga Martin Camaj.

² Konica ka kundërshtuar fuqishëm komunizmin që në zanafillën e tij, akoma pa arritur as si ide në trojet shqiptare...

³ Faik Konica është i dënuari i shumëfishtë i mendimit të lirë. Për shkak të shkrimeve të tij, qeveria turke e ka dënuar dy here me vdekje, kurse Austria, pas pajtimit me projektin gjerman për ndarjen e tokave shqiptare mes Serbisë e Greqisë (1915), e shpalli *persona non grata*. Për paradoks, një dënim i rreptë për të, më 1922, u kërkua madje edhe në Parlamentin shqiptar...

Alibia e keqkuptimeve

Faik Konica, pra, nuk është i vetmi shkrimtar i keqkuptuar shqiptar. Janë të shumtë personalitetet e jetës politike e kulturore që kanë vepruar në të mirën e përgjithshme të kombit dhe që, për paradoksin e paradokseve tona, janë keqkuptuar nga vetë populli të cilit i kanë shërbyer përgjatë jetës së tyre. Shkaqet e keqkuptimeve, që shumëkujt ia nxinë jetën, buronin nga shpifjet e vazhdueshme të tipave mediokër e smirëzinj që nuk mund të pajtoheshin me më punëtorët e më të aftit se vetja e tyre dhe që nuk mund të lejonin që meritat për lëvizjet e gjërave kah e mbara t'u përshkruhen njerëzve të zot që dinin t'u kontribuojnë çështjeve ashtu si e donte nevoja në momentet e caktuara historike. Të tillët, në fakt, keqpërdornin vetëdijen e ultë të popullatës shqiptare, që asokohe mund të manipulohesh shumë lehtë.

Si të shpëtonte në këso konditash nga dhëmbëzori i pamëshirshëm i nëpërkëmbjeve Faik Konica - përfaqësuesi më i sinqertë e më largpamës i Rilindjes, njeriu që solli frymën liberale e kritike në mendimin shqiptar, pa të cilën çështjet politike e kulturore, sigurisht do të kishin rrjedhë më të ngadalshme dhe për pasojë shkalla e zhvillimit tonë nuk do të ishte kjo që është. Së këndejmi, është i kuptueshëm mashtrimi që tentoi ta përligjë baltën e hedhur në figurën e pastër të Konicës, të cilin e konsideruan lojal ndaj të huajve, të luhatshëm dhe, natyrisht: tradhëtar të kombit, për shkak të lidhjeve të afërta dhe besimit që, në periudha të ndryshme, pati me përfaqësues të rëndësishëm të Austro-Hungarisë, Italisë, Turqisë..., apo për shkak të guximit qytetar për ta shprehur mendimin e lirë mbi ngjarjet dhe personalitetet e rëndësishme të shoqërisë shqiptare.

Ishte pra veprimtaria transparente, shkrimet e tij të sinqerta dhe veçmas korrespondenca me përfaqësuesit e fuqive të ndryshme evropiane ato që ia dhanë shumëkujt të drejtën e gjurmimit me llupa të trasha në raportet gjoja jodinjitoze të Konicës dhe sharrimit të tij në ujëra shërbimesh agjenturore. Shpifësit shërbeheshin, fjala vjen, me copëzat e shkëputura nga shkrimet e tij, që vetëm si të tilla u bënë vend manipulimeve të paskrupullta. Ata keqinterpretorin pjesët mirësjellje dhe bonton të fillim-mbarimeve të letrave, që nisin në stilin:

- *"Meqë keni shprehur dëshirën që të jeni vazhdimisht në korrent të çdo gjëje..."*
- *"Kam nderin t'i dërgoj Shkëlqesisë Suaj një shënim mbi artikujt shqip..."*;
- *"Sipas dëshirës së Shkëlqesisë Suaj..."*;
- *"U vonova pak që t'Ju shkruaj..."*⁴ etj.

Tipat që pështynë figurën e Konicës nuk e kuptuan kurrë se Ai i shkruante një Baroni austriak që përfaqësonte fuqinë që mund të ndihmonte realisht çështjen shqiptare. Meskinët e kalibrit të padenjë për t'u marë me emrin dhe veprën e tij i lexuan një dajm shtrembtas raportimet plot entuziazëm për çdo sukses dhe për çdo përparim të Shqipërisë drejt statusit të një shteti independent. Ata, siç thamë dhe më lart, shkëpusin nga konteksti vetëm pjesët që si të tilla mbështesin disi këlbazat e paskrupullta, duke mos qenë të aftë të lexojnë mes rreshtash e të dallojnë bontonin prej qëndrimeve të patundshme që shpërfaqin bazamentin e pastër shqiptar të Faik

⁴ Faik Konica, *VEPRA 4*, Dudaj, Tiranë, 2001, f. 77, 80, 92 dhe 108.

Konicës e që shfaqen si në pjesën në vijim: “... *Shkëlqesia Juaj duhet të ketë bindjen se dëshirat tuaja janë të kuptueshme dhe se këshillat tuaja janë ndjekur në mënyrën më të përpiktë... Por nga ana tjetër unë e gjykoj të arësyeshme përhapjen e gjuhës shqipe, në mënyrë që të paksoj nëqoftëse s’e çfaros influencën që shtrton ose që munt të ushtrojë Revista, nëqoftëse unë do të isha vazhdimisht nën ndikimin e këshilltarëve të cilët pretendojnë se janë patriotë dhe që unë nga ana tjetër mjaftohem duke asistuar si spektator ose më shumë si këshilltar sesa partizan i luftës*”⁵.

Merre nga ta marrësh, tendenca për t’i shndërruar këto raporte në njolla të zeza dhe akuza përulëse përtej kufijve të lejueshëm njerëzorë, duhet parë në kontekstin e kohë-hapësirës së caktuar, gjithnjë në përqasje me veprimet që bënin atdhetarët bashkëkohanikë të Konicës, që, në përpjekje të gjetjes së rrugëzgjidhjeve sa më fatlume për ardhmërinë e ndritshme të Shqipërisë e të shqiptarëve, mund të kenë bërë dhe gabime në rreshtimet e tyre. Naimi e Samiu, ta zëmë, besuan një kohë se shpëtimi i Shqipërisë mund të vijë nga një Turqi e moderuar, Noli i besoi bolshevizmës ruse, Gurakuqi e De Rada i besuan Italisë, kurse Konica, në një moment delikat për Shqipërinë, shpëtimin e pa tek Austro-Hungaria. Lidhjet, miqësitë dhe tifozllëqet në fjalë, gati pa përjashtim, ishin lidhje mes individësh, hiq Nolin që, me sa dihet, as kur pati mundësi të veprojë në dëm të Atdheut, si njeriu i parë i një Qeverie, nuk bëri ndonjë pakt nënçmues e të dëmshëm për Shqipërinë. Të tjerët, ndërkaq, as që kanë mundur të lidhin marrëveshje të dyshimta e të dëmshme për kombin, sepse, thjesht: nuk patën kurfarë mandati ta bëjnë këtë. Së këndejmi dalin të shushatura akuzat e pamatura, të nxitura nga mendjelehtësitë dhe inatet e pafisnikëruara ballkanike. Si të sqarohen ndryshe shpifjet për lojëra të dëmshme e antishqiptare të një Konice, i cili, përveçse në gjuhën shqipe..., mbrojti me zjarr e me argumente të palëvizshme çështjen shqiptare edhe gjithandej gazetave evropiane, luftë kjo që nuk mund të bëhej as me institucione të tëra shtetesh të organizuara mirëfilli? Fundja, nga ka mundur ta dijë Konica se Austria nuk do ta mbajë fjalën dhe nuk do ta ndihmojë Shqipërinë ashtu siç premtonte? Dhe, pasi e kuptoi këtë, çfarë mundi të bëjë më tepër se sa ta ngrinte zërin kundër matrapazllëqeve dhe trukeve të bëra pas shpine dhe në dëm të Mëmëdheut të tij? Nuk duhet harruar as e dhëna se Konica, sado që nuk ishte politikan, nëse nuk i llogaritet këtu ambasadorllëku, u detyrua të veprojë si i tillë, sa herë që e donte e mira e Shqipërisë. Po ku ta dinin këtë kritikuesit mediokër, të mësuar t’i servojnë publikut gjykime në gjendje jeshillëku? Si ta kuptonin ata se problemet me të cilat ballafaqohej Shqipëria ishin të natyrës politike dhe për to duhej menduar dhe politikisht? Kush t’ua thoshte të vërtetën se lëngojnë kopeas nga ilet i “*të kuptuarit të reduktuar*” të fenomeneve shoqërore e politike, që ndihmoi keqkuptimin më të madh të shekullit XX në kulturën shqiptare? Prandaj, u desh të shembet kalaja bolshevike për të dalë në dritë e vërteta lakuriqe, sipas së cilës, edhe “*Përkundrejt turmës së ‘mendjeve të klasit të katërt’ Faiku nuk mund të ishte veçse i rreptë deri në mizori, mbasi ai ia dinte kufijtë së vërtetës origjinale. Për këtë arsye rrinte syçelët dhe i gatshëm ta braktiste një të vërtetë në çastin kur ajo bëhej e pavërtetë.*”

⁵ Po aty, f. 108-109.

Kjo më duket të jetë cilësia më e përpashme, aftësia më e rëndësishme e modelit mendor që e quaj 'konician'. Ta braktisësh të vërtetën...?! Por si ka mundësi...?! Pikërisht këtë aftësi gjeniale të mendjes njerëzore nuk ia kuptuan shumë nga bashkëkohësit dhe, madje, e kemi të vështirë ta rrokim edhe ne, të penguar prej 'të kuptuarit të reduktuar'. Kjo e pengon edhe sot e gjithë ditën shpërfaqjen në dritë të plotë të personalitetit të tij... Kështu ndodh që Faik Konica të vijojë të vuajë, ende sot, 'të kuptuarit e reduktuar', sepse ky lloj të kuptuari nuk e përkap dot strukturën logjike të dy qëndrimeve/ dy qëllimeve. Dy qëndrimet/ dy qëllimet mund të jenë kontradiktore mes syresh dhe, megjithëkëtë, të jenë plotësisht të pajtueshme. Është kjo struktura logjike e atyre që quhen dilema të mendimit politik të çdo kohe e të çdo vendi. Zgjidhjen e dilemave të tilla Rousseau-i e quante 'kthim të rrethit në katror'. Dhe të mos harrohet që Faiku pati qenë lexues i zellshëm i Rousseau-it qysh në të ri"⁶.

Po ta marrim esëll veprimtarinë e Faik Konicës, Ai, si në shumë fusha të tjera, edhe në të kuptuarit e drejtë të lojërave politike ishte një shekull para bashkatdhetarëve të tij. Një krahasim i bontoneve me të cilat ai i fillonte letrat dërguar personaliteteve të huaja me deklaratat e ditëpërditshme të telallëve të shumë qeverive të sotme që nuk përbëjnë kurrë faktor në arenën ndërkombëtare, siç janë qeveritë e shteteve ballkanike, e nxjerr Konicën kalorës dinjitoz e largpamës të politikës së jashtme, sepse edhe në kohën tonë, qeveritarët dhjetra herë në ditë e bindin opinionin publik se asgjë të vetme nuk ndërmarrin pa u këshilluar⁷ me miqtë dhe partnerët e tyre ndërkombëtarë...

A ishte Konica proaustriak?

Përgjigja është: PO! Një kohë që i tillë dhe këtë nuk e fshehu kurrë, sepse nuk kishte asnjë arsye të gënjejë. Për Konicën e ri dhe të apasionuar pas letërsisë e artit kjo përbente një arsye më shumë për t'besuar se: *"E bashkuar me Austrinë, Shqipëria do të zhvillohet lirisht në tri pikëpamje: nacionale, ekonomike dhe intelektuale"*⁸.

Nga letërkëmbimi i dendur i tij me Goluchovski-n a Theodor A. Ippen-in rezulton se kurrizi i Faik Konicës nuk u përku kurrë si kurriz kolaboracionisti. Përkundrazi: në mungesë institucionesh shtetërore, Ai bëri çmos për të ndryshuar kahjet e ngjarjeve që zhvilloheshin në disfavor të Shqipërisë.

Po, t'i lëmë këto çështje që rrisin një mal të madh pikëpyetjesh... dhe të shpalojmë pak konceptin e Konicës rreth asaj pse duhet vënë kontakte me të huajt, me shtetet që nuk mund të jenë të dëmshme për Shqipërinë, duke qenë gjeografikisht larg territorit të saj. Ai, sado i ri në moshë, e kuptoi se për të mbijetuar duhet: *"të imitojmë armiqtë tanë; të bëhemi konspiratorë dhe intrigantë..."*, nëse dëshirojmë t'i shpëtojmë vdekjes kolektive⁹. Në një shkrim të tijin madje e thotë shkoqur se është vetëm një ushtar i ushtrisë kombëtare shqiptare... A nuk mjaftojnë këto të

⁶ Aurel Plasari, *Faik Konica - nuk jam unë*, Gazeta 55, nr. 130, 18 maj 2003, f. 11-14.

⁷ Kush nuk e di se "pa u këshilluar" është sinonimike me shprehjen: *pa marë urdhëra të prera...*

⁸ Faik Konica, *Vepra 4*, Naim Frashëri, Tiranë 1993, f. 20.

⁹ Po aty, f. 9.

dhëna për të hedhur dritë mbi qëllimet dhe lojën e vërtetë të Konicës në raportet e tij me austriakët dhe me të tjerët më pastaj?

Besimi i Konicës se pikërisht Austria do jetë ajo që do ta ndihmojë mëkëmbjen e Shqipërisë bazohet edhe në elemente jashtëpolitike. Në letrën dërguar Theodor A. Ippen-it - konsullit të Austro-Hungarisë në Shkodër (1897), Konica shkruan: *“Konsujt e Austrisë kanë ndihmuar, kush më pak e kush më shumë, në rilindjen shqiptare. A nuk ishte një konsull i Austrisë Hahni, i cili punoi dhe mendoj plot tridhjetë vjet për botimin e monumentit të parë e të çmuar mbi shqiptarët”*¹⁰?

Kur lexon njeriu letrat proaustriake të Konicës, të shkruara para një shekulli, vërtet ndjenja e parë që i viziton shpirtin dhe mendjen është ndjenja e dyshimit. Ç’po ndodhte me këtë njeri që kishte, pa dyshimin më të vogël, formimin që do t’ia lakmonin eruditët e klasës së parë? Si qe e mundur që, fjala vjen, gjatë pushtimit turk të ishte proaustriak e antiturk, kurse, më 1916, kur Austria shtriu kthetrat e saj në pjesën veriore të Shqipërisë, u bë proturk dhe antiaustriak?

Përgjigja është e thjeshtë: keqkuptimet i sqaron më së miri leximi i plotë i veprave të Konicës, që ta bëjnë më të afërt kohën e tij. Paskëtaj, sakaq e kupton se fajin për ndryshimet në disponim ndaj fuqive e personaliteteve të caktuara nuk e mbante Konica, po ndryshimet e befta e krejt të papritura të situatave politike, në vorbullën e të cilave u gjet shpesh dhe gjysëmshiteti i pafuqishëm shqiptar, të cilit i rrezikohej vazhdimisht ekzistenca.

Njohja e veprës së tij gjithsesi e nxjerr në syprinë dhe angazhimin dinjitoz të Konicës për vendosjen e raporteve bashkëpunuese me qeveritarët e Austrisë. Për këtë më së miri flet letra e tij e 26 nëntorit të vitit 1897, dërguar Baronit Golluhovski në Vjenë, ku katërcipërisht hedh në baltë dhe i shndërron në shpifje të pastra akuzat për lojalitet të tepruar. Gjërat që i kërkon Ai në këtë letër janë programe ndoshta më të mira se ato që kanë sot shqiptarët e shkapërderdhur nëpër shtetet ballkanike e që kërkojnë të futen brenda kornizave të organizmave të njohura euro-atlantike. Konica, në tri pika, shtron planin e tij të përpunuar gati në detaje, ku përparësi i jep shkollës shqipe, mosndasive fetare, mosmbetjes së Shqipërisë nën mëshirën e shteteve fqinje, siç mjerisht ndodhi me më shumë se gjysmën e territorit të saj etj., etj. Pikërisht kjo frikë e fiksuar në mendjen e ndritur të Konicës e shtyri që të bëjë dhe gjëra që nganjëherë i japin pamjen e një njeriu lojal. Po kjo duket kësisoj vetëm nëse i kundrojmë brengat e tij të mëdha nga distanca e rehative të dekadave të mëpastajme.

Në fakt ndoshta është më e drejtë të thuhet se Konica nuk qe kurrë as proaustriak as proturk i mirëfilltë, sepse natyra e tij e dyshimtë nuk ia lejonte këtë tip zeje. Ai, thjesht: ishte pro vijës së tij të luftës që do t’i siguronte Shqipërisë një independencë të vërtetë. Është e njohur se ai ndërroi shpesh disponimin e tij ndaj shteteve më të fuqishme se Shqipëria, veçmas ndaj shteteve që kishin mundësi t’i lëvizin gurët e kufijve ballkanas me vend e pa vend. Po duhet ta dimë se kohët ishin të tilla, kohë kur pushtuesit vinin e iknin orë e çast...

¹⁰ Po aty, f. 20.

Konica mes nesh dhe të tjerëve

Në këtë pikë po e hapim një parantezë, që ka të bëjë pikërisht me frymën e mohimit të veprës madhore të Konicës, Fishtës, Koliqit... me mënyrën se si ne i përziejmë në një tas dardhat e kumbullat, duke bërë përjashtim nga veprimet e meseve të civilizuara. Në dallim prej nesh, një evro-perëndimor as që mund ta kapë budallallëkun e identifikimit të disa të metave me një vepër madhore letrare, sepse, po të ishte kështu, Evropa që moti do të duhej të hiqte dorë nga shumë emra të mëdhenj të kulturës e të letërsisë. Imagjinoni si do t'i kishim zhbërë veprat unicate letrare të: Dantes, Gëtes, Bajronit, Balzakut, Pushkinit, Edgar Alan Posë, Bodlerit..., sikur ata të kishin shkruar rastësisht në gjuhën shqipe dhe të ishin përpjekur për avansimin e gjuhës e të kulturës shqiptare.

Imagjinoni ç'do t'i ndodhte Konicës sikur, llafi vjen, qëndrimin e tij të njohur ndaj Naim Frashërit të mos e kishte bërë 30 e sa vjet pas vdekjes së tij, po ditën e varrimit të poetit kombëtar, ashtu siç veproi shkrimtari Zhyl Vales në fjalimin e rreptë dhe të pamëshirshëm të mbajtur mbi arkivolin e mikut të tij Bodlerit, më të madhit poet të simbolizmit evropian, me çrast tha: *"Fatziu ishte komediant dhe për keqardhje... Nuk ishte kurrë poet i ardhur dhe është dashur t'i shkaktonte vetes vuajtje të tmerrshme që të bëhej poet... Gjëja më e madhe që mund të shpresojnë adhuruesit e tij është që ndonjë kureshtar ose ndonjë i marrë në kompaninë e leshatakëve ekcentristë ta fusi në një vëllim të shtypur në njëqind ekzemplarë. Nuk kërkojmë më tepër për njeriun: as që ka merituar më shumë..."*¹¹

Imagjinoni si do ta trajtonin figurën e Konicës "studuesit parimorë" e midelinj të soc-realizmit, sikur ai të vuante nga veset nga të cilët vuanin disa nga krijuesit më gjenialë të botës, si: Bajroni, Gëteja, Gogoli, Edgar Allan Po, Balzaku, Bodleri..., biografët e të cilëve kanë dhënë një mori të dhënash që lidhen me shizofreni, narkomani, marrëdhënie incestoide, përdhunime, lapërdhari, gënjeshtër e borxhe të pakthyera kurrë, konformizëm e shumë devijime të tjera që, për lexuesin shqiptarë, të mësuar ta konceptojë letrarin si modelin më të mirë njerëzor duken të shpifura.

A do t'arrinin shqiptarët t'i kundronin të shkëputura nga jeta private veprat e një Bodleri që jetonte me hardhuca, thente vitrina dyqanesh, vuante nga narkomania, sadizmi, egoizmi...; e një egocentriku të pashoq si Gogoli, që urrente për vdekje edhe nënën e tij, që nuk e njihnte kategorinë dashuri e që vuante nga paranoja religjioze...; e një Bajroni që njihej për sadizmin e tij dhe torturat që ia bënte të shoqes, që pinte morfium e që e dhunoi vajzën e xhaxhait...; e një Balzaku që gënjente ngado që shkonte e këdo që mundej, që jetonte me paratë dhe huatë që s'i kthente kurrë...; e një interesaxhiu si Gëteja, që njihej si njeri lojal e servil i përbetuar, i cili njerëzve të pushtetit u thoshte: *PËR JU BËJ ÇDO GJË...*, që sillej keq me shokët dhe gratë, që ishte egoist e neurotik e që u diagnostifikua nga mjeku i tij personal si 100 % neuropat...; e një njeriu labil si Edgar Alan Po që kishte sjellje të çorroditura, që qe alkoolist i përbetuar, që vuante nga *hipohondria* (kriza e pijanecëve) dhe *grandomania* (mania e vdekjes)...; e një Rusoi që vuante nga frika

¹¹ Miroslav Kërlezha, *Ese*, Rilindja, Prishtinë 1979, f. 288...

e vdekjes që ishte nevrík i madh, që kishte probleme me njerëzit dhe s'i duronte fare pranë vetes...

Bazuar në mohimet dhe kapitujt e shumë "studimeve" që kanë shkruar "eruditët" e soc-realizmit shqiptar mbi Faik Konicën, Gjergj Fishtë, Ernest Koliqin... bazuar në akuzat e përrjetshme nga të cilat akoma nuk kemi arritur t'i rehabilitojmë plotësisht shkrimtarët dhe veprimtarët e mëdhenj shqiptarë, sigurisht që nuk do t'i pranonim ashtu siç i pranon bota veprat dhe personalitetet e posapërmendur të kulturës së saj.

I solla këto raste për të dëshmuar sa dallim kanë të tjerët prej nesh shqiptarëve kur merr e gjykon mbi madhësitë dhe kuotat e veta, sa për të parë se Faik Konica ishte njeri krejt normal në një kohë abnormale. Ai deshi t'i shohë edhe shqiptarët si qytetarët e botës, deshi ta *lëvrojë shkëmbin*, deshi t'i shërojë veset tona kolektive, gjërat që na e ndalin rritjen, duke na shëruar nga mendjemadhësia, komplekset e ulëta dhe dregëzat e tjera që nuk shërohen duke i gudulisur me petale trëndafilí.

I vetmi faj i Faik Konicës, për mendimin tim, është e dhëna se erdhi shumë para kohe në letërsinë dhe kulturën shqiptare, e dhëna se ishte më inteligjenti dhe më largpamësi në mesin e rilindasve të kohës së tij. Faji i tij qe jokonformizmi i dëshmuar me vepër. Dhe, nëse gjërat që bëri ai janë faje, ato assesi nuk mund të jenë më të mëdha, më të dëmshme e më të pamoralshme se hatri i rremë i armatës së konformistëve tanë që e kanë kthyer aktin e bërjeqejfit në virtyt kombëtar.

Literatura:

- Konica, Faik, *Vepra 1 - 5*, Dudaj 2001
Starova, Luan, *Kthimi i Faik Konicës*, Flaka, Shkup 2001
Starova, Luan, *Një miqësi evropiane*, Onufri, Tiranë 2001
Kastrati, Jup, *Faik Konica*, Gjonlekaj Publishing Company, Neë York 1995
Hamiti, Sabri, *Faik Konica: jam unë*, Rilindja, Prishtinë 1991
Aliu, Ali, *Don Kishoti te shqiptarët*, ASHA e Kosovës, Prishtinë 2005
Kadare, Ismail, *Migjeni ose uragani i ndërprerë*, PenA, Prishtinë 1990
Karjagdiu, Abdullah, *Me Konicën në Evropë*, Lidhja e shkrimtarëve, Tiranë 1993
Blaku, Murat, *Roli i revistës "Albania" në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe*, LogosA, Shkup 2007
Shkodra, Shefik, *"Albania" e Konicës pergamenë shqiptare*, Rilindja, Prishtinë 1995
Konferencë shkencore për Faik Konicën, ASHA e Kosovës & ASH e Shqipërisë, Prishtinë 2006
Noli, Fan, *Vepra 2 - 3*, Rilindja, Prishtinë 1988
Kodra, Lame, *Vepra letrare 1, 3*, Argeta LMG, Tiranë 1998
Koliqi, Ernest, *Kritikë dhe estetikë*, Apollonia, Tiranë 1999
Fishta, Gjergj, *Estetikë dhe kritikë*, Hylli i Dritës & Shtëpia e Librit, Tiranë 1999
Poradeci, Lasgush, *Vepra 2*, Onufri, Tiranë 1999
Kuteli, Mitrush, *Vepra letrare 5*, Naim Frashëri, Tiranë 1990
Koça, Vangjel, *Në udhën e shqiptarizmit*, PHOENIX, Tiranë 1999

ZEJNEPE ALILI – REXHEPI**POEZIA E MESAZHIT UNIVERSAL NË
“VARGJET E LIRA”**

Në vëllimin poetik *Vargjet e lira* Migjeni reflekton ndjeshëm frymën filozofiko-meditative, me të gjitha nuancat reale të jetës, ku përsiatjet mbi tragjikomedinë shoqërore kanë porosi moralizuese. Ky mjeshër i fjalës dhe i ndjenjës, të duket sikur me tërë qenien i përkushtohet krijimit të vargut. Nganjëherë, hollësisht përkshkruan skena tejet prekëse, jep ide shumë vizionare, gjen figura njerëzore të përvuajtura e të formësuara që kryekëput i përkasin nënqiellit prej ku ai edhe frymëzohet. Prirja dhe afiniteti ndaj lirikës, poetin e ndjek gjatë gjithë frymëzimit. *Poetika e tij sintetizon përvojat e ndryshme estetike që ekzistonin në vend dhe jashtë. Vepra e Migjenit e pasuron me elemente të reja traditën realiste që e filluan: Çajupi, Asdreni, Noli, Mjeda, Ali Asllani, Mihal Grameno.*¹

Motivet e poezisë së Migjenit zakonisht marrin jetë nga aktualiteti e më pas talenti dhe mprehtësia vrojtuese, veprës së tij i jep ...*karakterin e një realizmi pa brigje, një realizmi universal, i cili meqë ka qenë i hapur për komunikim me rryma e drejtime të ndryshme, mund të emërtohet me termin realizëm sintetik.*² Poezia thuret përmes vargut të lirë, që ky poet, ndër të parët, dukshëm e përdor për t'i thyer kornizat e poezisë tradicionale dhe me të depërton në vargun modern. I karakterizuar me stil të larmishëm e figuracion të pasur poetik, poeti sjell frymë të re si në formë, ashtu edhe në përmbajtje të veprës.

Meqenëse poezitë janë të përzgjedhura dhe të radhitura në cikle, sipas brendisë ideore dhe motiveve që trajtojnë, Migjeni parapëlqen që të hap vëllimin me poezinë *Parathanja e parathanjeve*,³ e cila konsiderohet e veçantë, për kah origjinaliteti i formësimit filozofik të poetit, mesazhi i fuqishëm që përmban dhe sakrificat njerëzore për ndërtimin e *Kullës së Babilonit*, e më pas kur ngjitet në lartësitë e saj, ...*dhe ka me thirrë: Perendi! Ku je?*⁴

¹ Rexhep Qosja, *Kontinuitete*, Rilindja, Prishtinë, 1972, f. 147.

² Sefedin Fetiu, *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, Prishtinë, 1984, f. 9.

³ *Migjeni I* (Zgjedhje e përgatiti për shtyp: Rrahman Dedaj), “Rilindja”, Prishtinë, 1977, f. 11.

⁴ Po aty.

Poezia paraprirëse *Parathanja e parathanjeve* ngrihet si *Kanga mbi Kangët e Salomonit*, me përgjithësimin e konceptit Njeri-Zot, shfaq pikëpamjet përparimtare të poetit, për t'i përmbledhur tok dilemat e shumta: politike, sociale, kulturore, fetare... që e preokupojnë njeriun, por pa i dhënë forcë dalluese kësaj qenieje, mbi baza gjinore, si burrë-grua. Për të është i rëndësishëm avancimi i jetës, zbërthimi i enigmës së krijimit të botës, vetëdijesimi i njeriut për të përmbysur një botë të dalë kohe e për të ngritur një tjetër më të sinqertë.

Siç vihet re, Migjeni, niset nga koncepti i njohur *schopenhauerian* mbi *vullnetin hyjnor*. Poezia mund të ketë synimin e një shprehjeje të *thjeshtë e paqësore*, por ajo fuqishëm aludon në ndryshimin e botës, në gjakimin e njeriut për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë e më përparimtare. Poezia përhap mesazhin e përmasave universale, por *...ajo nuk mund të konsumohet për një kohë të shkurtër, përkundrazi, është poezi që çon peshë e që kërkon studime më të gjithanshme. Edhe pse kjo poezi mund të duket si shumë personale dhe e kufizuar në kohë dhe hapësirë, fuqia e saj poetike në vete ngërthen vlera të gjithanshme dhe ka kuptim më të thellë se sa duket.*⁵ Ndjeshmëria, si shpërthim narrativ nga gjeneza e njerëzimit dhe përpjekjet e poetit për të sjellë pavarësinë emotive të njeriut nga botëkuptimi fetar i jetës, për të ndërfaqur frymën e kohës me shumë sens estetik, përkohë me modelin estetik të *Baumgarten-it*, në veprën *Aestetika* që në të vërtetë nënkupton: *tërheqjen nga këndvështrimi hyjnor në të mirë të atij të njeriut.*⁶ Në vargjet e kësaj fryme artikullohet përjetësia e jetës... Poeti, këtu e drejton idenë e tij në dy shtrirje kohore: *e sotmja* dhe *e ardhmja*.

Përderisa, konceptet për krijimin e botës e vërshojnë poezinë, Migjeni natyrshëm *zbret te konceptet e sociales*, përpiket ta ndërlidh lëmshin e këputur me hyjnitë (perëndinë) dhe njeriun. Atëherë, edhe më tepër ngatërrohen raportet midis tyre, njeriu ngrihet mbi perëndinë, gjë që shpie kah pyetja retorike mjaft paradoksale e tragjikomike: *Dhe tash s'po dihet ma, kush asht Zot e kush njeri.*⁷ Edhe pas këtyre përpjekjeve, Migjeni mbetet ateist *par excellance*. Ky dyzim nuk vjen te poeti për shkak se kryen shkollë jezuite dhe pushtohet nga fryma e religjionit, siç vihet re, ai nuk ndikohet fare nga besimi i verbër, gjegjësisht *dilema* për praninë e Zotit dhe formën-trajtën e tij. Për të një gjë dihet, fundi i perëndive është fare pranë:

Përditë perëndojnë zotat

dhe rrëshqasin trajtat e tyne

mbi vjet dhe shekuj

*dhe tash s'po dihet ma kush asht zot e kush njeri.*⁸

Për Migjenin *Zoti* nuk prezanton mishërim të poetit me fenë, as me fenomenet e natyrës, por me prirjen kërkuese në vazhdimësi deri te njohja e së vërtetës, madje të sendërtojë një shoqëri, ku individit do të çlirohet nga bota e traditës mistike. Ky pra, është intonimi poetik i vargjeve, si shtrirje ideore e poetit.

Dilema migjeniane, që përqendrohet në shprehjen: *Njeriu pjella e Zotit apo Zoti pjella e tij*, e mban peng njeriun. Kjo është një temë universale e trajtuar nga shumë

⁵ Vebi Bexheti, *Universalja në poezinë e Migjenit*, në "Cogito", Viti III, nr. 6, Tetovë, 2009, f. 50.

⁶ Lyk Ferri, *Homo Aestheticus – Shpikja e shijes në epokën e demokracisë*, Tiranë, 2002, f. 36.

⁷ *Migjeni I* (Zgjidhi e përgatiti për shtyp: Rrahman Dedaj), "Rilindja", Prishtinë, 1977, f. 11.

⁸ Po aty.

shkrimtarë. Për kah tematika, veçmas përkon me poezinë *Njeriu dhe zoti*, të Lasgush Poradecit: *O Zot! Po rroj pendesën e jetës me si nxire:/Stërmath në vete t'ënde – më dhe kaq vogëlsi.../E si m'a ngrite shpirtin në kurme lartësire–/Sesa në fund ke zbritur! Sesa në fund të ti!...*⁹ Poezitë e të dy autorëve, Migjenit dhe Lasgushit, ndërthuren përmes idesh filozofike, që sjellin një ndjenjë dëshpërimi, të shprehura përmes pyetjesh retorike e dilemash të shumta. Të dyja poezive, efekt të veçantë u jep edhe forma e vargut, pra në vargun migjenian dhe atë lasgushian përdoren pauzat e shpeshta, trepikëshi që shënon lënien e fjalës përgjysmë, gjë që e shton edhe më shumë mundësinë për dilema e këndvështrime të ndryshme filozofike, mbase shpëtimi i qenies njerëzore, peng i religjionit, mund të ketë ndonjë alternativë.

Përkundrejt Migjenit, Asdreni në lirikën e tij, fillimisht mbështetet te *Zoti*, si burim i jetës dhe *i dashurisë panjerëzore*, por ai nuk e gjen plotësisht *paqen shpirtërore*, andaj në poezinë *Paradoks*¹⁰ megjithatë përaftron me Migjenin, duke kërkuar shembjen e idhujve që ngrihen mbi hipokrizinë fetare. Ky mllef shpirtëror i Migjenit, përkon me revoltën e poetit rumun *Mihal Eminesk*-ut, ndonëse më së tepërmi lë gjurmë ndikimi te Asdreni. Me anë figurash analogjike, Migjeni e krijon konceptin ironik të vetëdijes se *njeriu* është *Zot*, kur në fakt vetë njeriu e krijoi *Zotin*. Këtu, madje nuk bën as *ndarje gjinore*, për të mjafton fjala *Njeri=Perëndi* (*a-ku kjo mbaresë të orienton në një kategori të caktuar gjinore*) dhe sikur me kaq e përmbledh peshën kryesore të idesë ku vihet në pah realiteti i vrazhdë jetësor me dilemat e mëdha të jetës. Kur me anë të besimit paradoksal, njeriu mundohet që t'i zgjidh dilemat, atëherë poeti i revoltuar pyet:

çka, çka krijove?

- E njeriu nuk e di:

a asht zoti pjella e tij

*apo ai – vetë pjella e zotit*¹¹

Vetë shprehja *pjella*, të nxit dilema tjera: a thua në të vërtetë këtë botë të re me njeriun që do të lind e koncepton pa praninë e qenies femërore?! Sigurisht që s'mund të bëhet tëhuajsimi i saj, meqë në tërë poezinë e Migjenit, edhe në atë filozofike, ajo është e pranishme, si në çdo pore të jetës, sepse e përvijon shprehja: *të pjellësh dhe të jesh pjella e po asaj qenieje*. Në golgotën shoqërore, që e reflekton vargu migjenian, pa mëdyshje bie pre edhe gruaja shqiptare, mjerisht ajo e mban përgjegjësinë e kësaj pjelle të dyzuar: *Njeri-Zot*. Religjioni del përthyes i pashmangshëm i vullnetit dhe dinjitetit të gruas, madje që nga *Mesjeta*, kur religjioni e kishte fjalën kryesore, femra u quajt *pjellë e djallit*, mirëpo, si qenie koshiente, njeriu në vazhdimësi përpiket ta zbulojë thelbin e vetëqenies, andaj kundërshtimi i tij ndaj *Zotit*, ndoshta vjen si një *autorefleksion* për atë që vetë e ka krijuar ndër shekuj dhe tani duhet ta zhbëjë. Është më se e vështirë të kuptohet njeriu me kompleksitetin e tij.

⁹ Lasgush Poradeci, *Poezi të zgjedhura*, “Vatra”, Shkup, 2008, f. 42.

¹⁰ Asdreni, *Andrra e lot'*, Prishtinë, 1971, f. 114.

¹¹ Migjeni, *Vepra I* (Zgjedhi e përgatiti për shtyp: Rrahman Dedaj), “Rilindja”, Prishtinë, 1977, f. 11.

Poezia *Parathënia e parathënieve* është moto e njeriut të përulur, i trimëron shpresëhumburit, e lartëson vetë njeriun, e fton në zgjim nga përgjumja, sepse kështu ai do të madhësohet, duke i parë zotërat se si ligështohen e bien. Migjeni, është një parathënës i fatit të shqiptarit, që vuan nën sistemin e kalbur feudalo-borgjez, andaj përmes thënies: *jam i bindur se je në gjendje të bësh çdo të keqe, prandaj e kërkoj të Mirën nga ti,*¹² flet e mendon si Niçe-ja në *Kështu fliste Zaratustra*, vepron si *Prometheu*, ngrihet kundër zotërave-idhuj, meqë njeriu duhet të veprojë i lirë, pa ngurrimin shpirtëror që ia imponon Zoti. Migjeni është *Promethe* i brengave të përditshme, është flakadan i botës reale, të cilën e jeton dhe e kritikon.

Me të njëjtin reflektim mesazhesh njerëzore, të përmasave universale, vjen poezia *Të lindet njeriu*, e cila është paraprirëse e ciklit *Kangët e ringjalljes* dhe në vete e bart simbolikën e fuqishme të një kredoje revolucionare, gjegjësisht mbetet sinteza më e fuqishme e pikëpamjeve të Migjenit. Është simotër me *Parathanja e parathanjeve* për kah subjekti lirik dhe shumëkuptimësia e mesazhit. Sarkazmi i fuqishëm bashkë me dëshirën gulshuese, bëjnë që poeti të jetë një *Diogjen* i kohës. Dëshpërimi gjithpopullor e vë atë në kërkim të një qenieje tjetër, më të përsosur. Në fakt, kjo qenie duhet të jetë e zakonshme, me shpirt të ndjeshëm, me “un” të çiltër e human që të mund ta shpëtojë botën – mbarë njerëzimin.

Përmes poezisë *Të lindet njeriu*, poeti aludon në njeriun e ri, në forcën e re intelektuale, që duhet të çlirohet nga prangat e religjionit, dhe përmes ideologjisë së re përparimtare t’i rreket punës për ndërtimin e së ardhmes më me perspektivë. Kur Migjeni e *...shihet prapambetjen e madhe të vendit, ëndërronte për një kohë kur atdheu i tij do të bëhej i lumtur. Po vetëm në atmosferën e lirisë së vërtetë, mendonte poeti, mund të shpërthejnë energjitë krijuese popullore.*¹³ Fillimisht, me vargun *Të lindet një njeri!*, poeti është më idealist, por më pas ai e sheh zgjidhjen e problemit gjithëpopullor në një përzgjedhje të re, në kërkim të një njeriu të drejtë e me intelekt të lartë. Ky ideal i poetit del si klithmë shpirtërore pas një dhembjeje të gjatë, pas vuajtjesh të shumta, vjen duke u rritur në një jehonë të fuqishme që kapërcen pragjet dhe shpalos një ëndërr të kahmotshme të çdo njeriu.

Të lindet një njeri

nga gjin’i dheut tonë të rim’ me lotë të vakët,

*nga thalb’ i shpirtit tonë që shkrihet në dëshirë të flakët*¹⁴

E tërë forca shpirtërore, me të cilën shqiptohet vargu që përngjet në një himn poetik: *Të lindet njeriu...* përqendrohet me bindje, me qëndrim të paluhatshtëm në vargun tjetër: *për një gen të ri.*¹⁵ Ky varg është si një gjetje e shumëkërkuar nga poeti, sepse të lindet një njeri me mision madhor, që do t’i prijë njerëzimit ndër ideale të reja, padyshim që duhet të jetë: i çiltër, i ndjeshëm dhe vizionar. Fundja, Migjeni i beson sërish njeriut, por me attribute tjera, si: mirësia, mençuria, forca... Kështu duhet të jetë njeriu i ri që do të lind, si personifikim i fatit njerëzor. Njeriu i Migjenit duhet të jetë i ndjeshëm ndaj të varfrit dhe punëtorit, i drejtë ndaj së

¹² Niçe, *Kështu fliste Zaratustra*, “Rilindja”, Prishtinë, 1981, f. 129.

¹³ Grup autorësh, *Historia e letërsisë shqipe*, “Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 548.

¹⁴ Migjeni, *Poezia shqipe*, (zgjodhi: Razi Brahimi), “Naim Frashëri”, Tiranë, 1972, f. 13.

¹⁵ Po aty.

vërtetës, pra i tillë që: *e ban synin ligshin' ta zhgjetojë,*¹⁶ dhe me ndërgjegje të pastër ta ndërtojë të ardhmen.

Migjeni kërkon që njeriu-prijës të jetë edhe atdhetar, ta çmojë kombin, traditën dhe kulturën e vendit të tij: *Të krijojë një Epope!* Të sjellë liri dhe lavdi për atdheun e vet.

Të dali një njeri!

Të mkambi një Kohë të Re!

Të krijojë një Epope!

*Ndër lahuta tona të këndohet Jeta e Re...*¹⁷

Këto vargje tingëllojnë si një jehonë domethënëse, por që të realizohet kjo, më parë duhet të përmbysset rendi *aktual* shoqëror, gjë që do të afronte edhe perëndimin e *idhujve pa krerë*. Vargjet tingëllojnë si: *kushtrimi për liri! Thirret lirija ndër frymëmarrje të gjata qi shkojnë tue u ngjitur në një "crescendo" të dalldisun.*¹⁸

Mos vallë s'qenë mjaft *epopetë* e huaja që na nënshtruan e: *flakë e zjarmit të tyre na i përzhiti ftyrat,*¹⁹ e na mbajti të robëruar ndër shekuj?!

Migjeni hedh idenë e çlirimit të njeriut nga prangat e mentalitetit të vjetruar dhe moralin e ndërtuar mbi kode të rrejtshme e të pasigurta për të ardhmen. Padija e ngulfat dhe e mban peng popullin, individi tëhuajësohet, përderisa gruaja shqiptare paraqitet me një botë shpirtërore të mekur e me moral të ulët, me ç'rast edhe mëkati i arsyetohet në emër të varfërisë.

Perceptimi i jetës me sy më real është rrjedha e mendimit lirik të poetit, kur shpalolet ndjenja e thellë humane dhe ideali për rilindjen e njeriut. Tingëllimi i ri poetik vjen përmes figurës së njeriut me *ideal bujar*, i cili do të jetë si *një kapiten që drejton anijen njerëzore*, me ndërgjegje më të çiltër për t'i shmangur furtunat e pakëndshme të jetës. Dhe tani, si ik syrit *sqimatar* të poetit, liria e brishtë, liria prej gaforreje. Ai e parandjen fort se vështirësive të jetës, skamjes e mjerimit duhet t'i vijë fundi. E për këtë duhet:

Të lindet një njeri

i madh si madhni

dhe ndërgjegjet tona t'i ndezi në dashni

për një ide të re, ideal bujar,

*për një agim të lum e të drejtë kombëtar.*²⁰

Vargjet e shprehin formësimin e lartë intelektual e kulturor të poetit, sepse mirësia që kërkon ai, i tejkalon përmasat e shoqërisë shqiptare, asaj kombëtares... lutja e tij është universale. Njeriu që krijon Migjeni në vargun e tij, është njeri që duhet të lindet, duhet të shmanget nga *epopetë* e fryra e lavditë kombëtare dhe e ardhmja e njerëzimit të kthehet kah vizionet më të qarta. Këto pikëpamje filozofike e pushtojnë frymëzimin fillestar të poetit, ashtu sikurse te *Hegel*-i që kushtimisht *poezia bëhet filozofi, sepse filozofia është hierarkia e shpirtit*. Poezia sikur krijohet

¹⁶ Po aty, f. 14.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Ndrëqim Kulla, *Mendimi kritik letrara shqiptar (1870 – 1945)*, „Plejad“, Tiranë, 2004, f. 221.

¹⁹ Migjeni, *Poezia shqipe*, (zgjodhi Razi Brahimi), „Naim Frashëri“, Tiranë, 1972, f. 14

²⁰ Po aty.

për të përmbushur një mision filozofik, të deshifrojë kode e të zbërthejë formula poetike, në favor të humanitetit njerëzor.

Kjo poezi, dhe të tjerat që Migjeni me të drejtë i quan *këngë*, sepse janë *reliktet* e tij, janë gëzimi fëmijëror që së shpejti do të prekin çdo zemër, çdokënd do ta zgjojnë nga përgjumja: *Se liria filloi me lulzue/dhe e ndjej nga dielli (alegorik) valën*,²¹ ku natyrisht Migjeni shprehet me aludime dhe nëntekste. Megjithëse, kjo poezi dhe *Trajtat e mbinjeriut*, gati nga shumë studiues trajtohen si ndikim *niçean*, duhet theksuar se poezitë e Migjenit më tepër vijnë si intonim i realitetit që poeti e percepton ditë për ditë, në vendin e tij. Dëshira për ta parë ndryshe këtë vend, ndonëse në dukje e pamundur për rrethanat aktuale të kohës e shtynë që të krijojë *Mbinjeriun*, këtë *sfings* të madhërisëm-njeriun e ri, njeriun e mençur e të pathyeshëm ndër stuhitë e kohës, virtyte këto që e lartësojnë këdo për t'u ngjitur në fron, por ku vetëm njeriu me vetëdije e moral të lartë do të dijë të udhëheqë.

Poezia *Trajtat e mbinjeriut* është një gërshetim motivesh filozofike, të rimarra e të trajtuara në *një kontekst universal*. Titulli i zgjedhur me shumë përkushtim nga Migjeni del si një *parodi groteske*, realisht, është si një himn i keqardhjes dhe revoltës njëkohësisht, është *Dityramb Niezchean*, ku si në: *Botën e mjerimit – një rreze e diellit*,²² paralajmëron një shtresë të re për botën e varfër. Mirëpo, ky optimizëm, kjo hare e përkohshme zhduket shpejt, papritur si *pranvera* që zhduket nga *stinët* tjera. Megjithatë, poeti është thellësisht i bindur se ndryshimi do të ndodhë, mbase me përmbysjen e rendit shoqëror totalitar, feudalo-borgjez, dhe më pas vendosjen e rendit të ri shoqëror, me parime e kode të reja morale, njeriu do të jetë më human. Në një këndvështrim më të thuktë, *Mbinjeriu i Niçes është uzurpator, tiran, mbytës i lirisë, armik i parë i popujve. Tek poeti ynë kemi një "Mbinjeri" krejt tjetër, humanitar, çlirues, mik të njerëzve të përbuzur*,²³ sepse *Niçe-ja është ideolog i borgjezisë dhe i nazizmit*, ndërsa Migjeni mbetet poet i të varfërve, i adhuruar nga masat popullore, edhe pse vargu i tij është i latuar artistikisht. Idetë e Migjenit dhe *Niçe-s* nuk përkojnë, ndonëse kanë një mesazh të përbashkët, madje sipas Arshi Pipës: *Atë që e tha filozofi me kuptime metafizike, Migjeni e tha në "një valë dëshpërimi". Edhe pse ata niseshin nga pikëpamje të kundërta Migjeni pajtohet me Filozofin se kjo botë duhet rrënuar*.²⁴

Ideja e rrënimt të botës, edhe pse ide vizionare, në prag të Luftës së Dytë Botërore, është e rrezikshme, andaj poeti, jo vetëm që nuk vlerësohet sa që në jetë, por edhe anatemohet, ndërsa vepra i censurohet. Fati i Migjenit, lirisht mund të krahasohet me fatin e *Ovid-it*, (Publius Ovidius Naso), poet i madh i botës latine, autor i veprave *Arti i të dashuruarit* dhe *Metamorfoza*²⁵, i cili fillimisht adhurohet për talentin e tij dhe emërohet poet oborrtar, por më pas syrgjynoset në një ishull. Edhe

²¹ Po aty.

²² Migjeni *Vepra* (përgatiti për botim: Rexhep Hoxha), Prishtinë, 1973, f. 46.

²³ Jeton Ostreni, *Disa mendime për veprën e Migjenit*, në Migjeni 4, *Kritikë*, "Rilindja", Prishtinë, 1977, f. 266.

²⁴ Arshi Pipa, *Historija e dhëmbshme e "shpirtit të ri"*, në *Kritika*, nr. 3. f. 112-120, dhe nr. 4. f. 147-160, Tiranë 1944, në *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Ibrahim Rugova, Prishtinë, 1996, f. 172.

²⁵ Aurel Plasari, *Letërsia dhe muret*, Tiranë, 1993, f. 6.

poezia e Migjenit sikurse e poetit latin bart në vete një tharm filozofik. *Fati i veprës poetike të Migjenit nis me botimin e një prej lirikave të tij në faqen e tretë të "Illyria"-s, faqe e cila u rezervohet vetëm shkrimtarëve të afirmuem e me autoritet,*²⁶ mirëpo më pas *Vargjet e lira* censurohet e s'lejohet në qarkullim.

Pse ndodh kjo?! Mos vallë pse përmes *mbinjeriut* dhe ndonjë poezie tjetër të kësaj natyre, Migjeni përpiqet t'i tejkalojë sfidat e rregullave dhe ligjeve sanksionuese, kodet e paragjykimeve morale dhe dogmatizmin, me të vetmen tendencë: krijimin e një jete të lirë. Është kohë, kur veç më, poezia e merr fizionominë e një jehone shpërthyesë për çlirimin e shpirtit njerëzor, (pse jo edhe atij femëror), gjë që edhe e profilizon poezinë e tij me vlera të rralla të artit letrar. Shkrimtari e transponon artistikisht realitetin shoqëror dhe dëshmon se kaosin shoqëror dhe jetën *falco* në të, e ndiejnë të gjithë, jetë të cilën pa dyshim e ndien edhe gruaja, si personazh i dashur i Migjenit. Gruaja s'është aktive, sepse s'ka forcë ta ndryshojë shoqërinë, ta vërë në lëvizje universin, sepse ajo mbetet vetëm: *Nana - dhe vejushë dhe me gjitë shitue/na pjell fryte t'egra, na pjell hithra, ferra,*²⁷ e që në përmasa universale aludon në mëmëdhenë e tij Shqipërinë, ndërsa *mbinjeriu*, nëse do të ishte një shtytje shpirtërore në shërbim të njeriut, pa dyshim mund ta bëjë këtë lëvizje, siç thotë Ernest Koliqi: "*trajta ndërron, jo palci*". Pra, njeriu do të mbetet po ai, do të ruajë thelbin e tij, vetëm se do të punojë dhe gjykojë më drejt, në të mirë të vetëvetes dhe mbarë popullit. Me këto përmasa, *mbinjeriu* krijohet si një mit ...*E miti për një poet ekziston si një e vërtetë e gjithmbarshme, ku shkrihet sinteza e një të vërtete të përjetuar e një trashëgimi shekullor të fatit njerëzor dhe personalitetit të poetit me fuqinë krijuese dhe transponuese të trajtave dhe ngjyrave të jetës, me të gjitha virtytet dhe maksimat jetësore, që mund t'i përcjellin dhe të jenë udhërrëfyes i një personi, shoqërie, popull apo njerëzimi.*²⁸

Përmes uverturës *Trajtat e mbinjeriut*, Migjeni, ngulmon që të trazojë ndërgjegjen njerëzore dhe këtë qenie ta përtafrojë me aktin e zgjimit të ndërgjegjes, jo dhunë e përbuzje, por më shumë respekt dhe dashuri ndaj asaj qenie që i fal jetë njeriut. Portretizimi i gruas shqiptare dhe jeta e mynxyrshme që bën ajo, është për keqardhje, edhe pse ajo duhet të zërë vendin e shenjtë si edukatore e familjes dhe shoqërisë, në të cilën s'mund të ketë përparim pa ngritjen intelektuale dhe shpirtërore të saj. Përmes një figuracioni të dyzuar, si dy simbole që plotësohen fuqimisht e shkojnë të pandashme..., nënkuptojmë se: ...*mëmëdheu është mëma që mëkon me qumështin e gjirit bijtë e saj, është bashkëshortja, që zgjon në zemër dashurinë dhe dhëmbshurinë. Qysh mundet një bir, pra që ka në zemër të skalitura ndjenja të çiltura e fisnike, të mos derdhë gjakun, të mos sakrifikojë jetën, gjithçka, për të shpëtuar nga robëria?*²⁹ Migjeni e ka të njohur këtë dhunti sublime, andaj s'i mungon shpirti revolucionar për *mbinjeriun* që duhet të lind. Natyrisht, personazhi i gruas jepet më e zbehtë, si krijesë e pafuqishme për përmbysje, për ndryshime të mëdha, por vetëm një zë i mekur që e mallkon fatin, *pjellën* e vet, jetën në

²⁶ Ernest Koliqi, *Kritikë dhe estetikë*, "Apollonia", Tiranë, 1999, 43.

²⁷ Migjeni *Vepra* (përgatiti për botim: Rexhep Hoxha) Prishtinë, 1973, f. 47.

²⁸ Ruzhdi Ushaku, *Miti i një poeti*, në *Migjeni 4 – Kritikë*, "Rilindja", Prishtinë, 1977, f. 232.

²⁹ Dora d'Istria *La nazionalita albanese secondo i canti popolari* (përkthyer nga A. Artam, Kozencë, 1867, f. 5), në "*Jehona*", nr. 2, Shkup, 2004, f. 89.

përgjithësi deri te krijuesi – Zoti. Madje, del se ajo është e ndrydhur në botën e pasigurt ku e ka ngjuar mjerimi, prandaj e mallkon fëmijën që vjen në jetë, skamjen që i bën të vdesin urie, fatin e mbrapshtë që e degdisi në skëterrën e pafundme, ku dhembja bëhet e pakapërcyeshme. Duke kërkuar njeriun – njeri, nga Migjeni kuptojmë se ...*Mbinjeriu i tij asht njeri i trollit, i problemeve dhe krajetave e idealeve të fshatarit dhe punëtorit shqiptar. Ai njeri asht vetëdije e kësaj mase. Përpara asht pa se sa përdëllimtar asht Migjeni ndaj skamnorit, ndaj “njeriut të vogël”, ndaj fëmisë dhe ndaj femnës, të cilën Niçe ashtu pamëshirshëm e nënçmon dhe fyen.*³⁰

Në poezinë e tij nuk e gjykon gruan drejtpërdrejt, por nuk e kursen plotësisht nga kritika dhe ironia, edhe pse realisht ai e ironizon burrin si pjesë e asaj shoqërie të shthurur. Mjafton të kujtojmë vargun: - *s’u gjet’ burr’i dej andjet me ia zgjue.*³¹ Në të vërtetë, gruaja ndihet e braktisur, pa mbështetje. Jeta për të sa vjen e vështirësohet. Ironia, madje bëhet edhe më e mprehtë, edhe më shpotitëse, kur në vargjet e mëposhtme ai i demaskon ata që ëndërrojnë kot, shpresojnë kot:

Kot e kanë sot njerzit, dhe me kot dikojnë djersën...

sa qesharak’ mbesin,

sa qesharak’ vdesin

*ndër ethe mundimi për me shijue jetën!*³²

Megjithatë, shpresa vdes e fundit, jeta mbase mund të ndryshojë, gjë që poeti e paralajmëron përmes një strofe, përmes së cilës shënohet një kthesë, jeta mund të gjallërohet në pritje të një *grusht graniti* që kurrë nuk do thyhet, mbase mund të veprojë një fuqi tjetër, mbase... ku i dihet?!

N’ardhmeni të trash’gueme Mbinjeriu vrehet,

Ndërgjegjë pa dyshime,

Ndërgjegjë pa trillime,

*Me një grusht graniti që kurr nuk do thehet.*³³

Vargu migjenian jehon si këngë, përhapet si një mrekulli me besim të plotfuqishëm ndër ideale. Po këtë hov paksa ia ndal tragjikomedia njerëzore, që dergjet mbi këto ideale, tejet sublime për poetin. Me këtë shpresë, vargu i tij ngrihet si kult... Ai krijon një tjetër fuqi, me tjetër vizion për botën. Ky koncept filozofik i mishërimit me të varfrit, me të përvuajturit, por duke aluduar vetëm në forcën e *mbinjeriut* e afron me Niçe-n. Liria e qenies njerëzore është refreni më i dashur i vargjeve të tij, *Mbinjeriu* është heroi i shumëpritur. Ndoshta, në këtë mënyrë Migjeni edhe arrin te kjo ide, ide që kërkon ... *“Kohë të re” dhe “Jetë të re”, ku s’do të ketë të mjeruar, padrejtësi, vuajtje, përbuzje dhe amoralitet shumëshekullor, në kohë që klasa e privilegjuar punonte e egërsuar për ta mbajtur në vend atë “status quo” të së kaluarës së trishtuar dhe të së tashmes revoltuese e të dhembshme të kohës së tij.*³⁴ Mos vallë *Njeriu* duhet të zhduket për të ardhmen e *Mbinjeriut*?! Mirëpo,

³⁰ Rexhep Qosja, *Dialogje me shkrimtarët*, “Rilindja”, Prishtinë, 1968, f. 203 – 204.

³¹ Migjeni *Vepra* (përgatiti për botim: Rexhep Hoxha) Prishtinë, 1973, f. 47.

³² Po aty.

³³ Po aty.

³⁴ Petro Januar, *Migjeni*, “Flaka e vëllazërimit”, Shkup, 1982, f. 213.

entuziazmi rinor i Migjenit e ndal vullin përpara një shoqërie të amullt, ku pikërisht ai gjen pretekstin e ironizimit. *Fuqia e pjekurisë bjerret sa të bëhet e flashkët kur ballafaqohet me injorancë. Kërkimi i së vërtetës dhe dinjitetit njerëzor, kërkimi i vlerave të njëmendta njerëzore bastardhohen dhe degjenerohen në hipokrizi e servilitet.*³⁵

Lirika e lartë e poezive: *Parathanja e parathanjeve, Të lindet njeriu dhe Trajtat e mbinjeriut*, (këtë të fundit A. Uçi e veçon si një nga perlat më të bukura në krijimtarinë poetike) ngërthen në vete refleksionin poetik të Migjenit, njëkohësisht vë në pah prirjen e tij poetike e filozofike, madje shpesh ato edhe ndeshen, *sa herë që poeti befasisht ka formim filozofik ose anasjelltas, sa herë që filozofi ka një shpirt të ndjeshëm*. Poezitë s'mund të gjykohen si jokompetente ndaj artit letrar kur prekin çështje filozofike, sepse vetëm në këtë mënyrë ato ngrënë shumë pyetje rreth problemeve njerëzore. Këto tri poezi, duke u shtuar edhe poezinë *Zgjimi*, A. Uçi i quan poezi ku mbizotëron *të menduarit në mënyrë groteske*. Secila sosh, është mesazh në vete, jehonë e një force shpërthyes *minirevolucionare*, mbase secila prej tyre vë në pah *mitin e idesë*. Sidomos, kur vargjet vendosen *ndërmjet këngës dhe poezisë*, atëherë forca e mesazhit të tyre mbetet e përjetshme. ... *Vargu yt, poet është rrufe, sepse është i mbrojtur prej unë-it tënd, prej vetëmohimit tënd, prej sakrificave të tua të vogla e të mëdha. Vargu yt është copë mishi e këputur nga trupi yt, është fjala jote, dashuria e jote për ne.*³⁶

Me dhjetëra poetë thurën vargje për Migjenin, sepse frymëzohen nga poezia universale e tij, nxiten nga *intuita e poetit për poetin*, ndërsa mishërimi i Migjenit me pasqyrimin sa më real të jetës së popullit të vet, përvijohet me shprehjen *feniksi i atij populli*. Këto reflekse të pashkëputura në mes poetësh dhe *Vargjet e lira* që udhëtojnë lirshëm me kohën e bëjnë poetin *mit*, ndonëse krejtësisht të ndjeshme praninë e tij. Vetë transparenca e vargut migjenian, fle dhe zgjohet si revoltë me receptuesin bashkëkohor, me ironinë e kohës sonë, ku përlijet apoteoza e dashurisë njerëzore.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

Asdreni, *Andrra e lot'*, Prishtinë, 1971.

Arshi Pipa, *Historija e dhëmbshme e "shpirtit të ri"*, në *Kritika*, nr. 3. dhe nr. 4. Tiranë 1944, në *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Ibrahim Rugova, Prishtinë, 1996.

Aurel Plasari, *Letërsia dhe muret*, Tiranë, 1993.

Dora d'Istria *La nazionalita albanese secondo i canti popolari* (përkthyer nga A. Artam, Kozencë, 1867, f. 5), në "*Jehona*", nr. 2, Shkup, 2004.

Ernest Koliqi, *Kritikë dhe estetikë*, "Apollonia", Tiranë, 1999.

Grup autorësh, *Historia e letërsisë shqipe*, "Rilindja, Prishtinë, 1989.

Jeton Ostreni, *Disa mendime për veprën e Migjenit*, në Migjeni 4, *Kritikë*, "Rilindja", Prishtinë, 1977.

³⁵ Mensur Raifi, *Fan. S. Noli e Migjeni*, (Botimi II), Rilindja, Prishtinë, 1979, f. 149.

³⁶ Po aty, f. 159.

- Lasgush Poradeci, *Poezi të zgjedhura*, “Vatra”, Shkup, 2008.
- Lyk Ferri, *Homo Aestheticus – Shpikja e shijes në epokën e demokracisë*, Tiranë, 2002.
- Migjeni I* (Zgjedhi e përgatiti për shtyp: Rrahman Dedaj), “Rilindja”, Prishtinë, 1977.
- Migjeni, *Poezia shqipe*, (zgjedhi: Razi Brahimi), “Naim Frashëri”, Tiranë, 197.
- Migjeni, *Poezia shqipe*, (zgjedhi Razi Brahimi), “Naim Frashëri”, Tiranë, 1972.
- Migjeni *Vepra* (përgatiti për botim: Rexhep Hoxha), Prishtinë, 1973.
- Mensur Raifi, *Fan. S. Noli e Migjeni*, (Botimi II), Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Ndriçim Kulla, *Mendimi kritik letrara shqiptar (1870 – 1945)*, „Plejad“, Tiranë, 2004.
- Niçe, *Kështu fliste Zaratustra*, “Rilindja”, Prishtinë, 1981.
- Petro Januar, *Migjeni*, “Flaka e vëllazërimit“, Shkup, 1982.
- Rexhep Qosja, *Kontinuitete*, Rilindja, Prishtinë, 1972.
- Rexhep Qosja, *Dialogje me shkrimtarët*, “Rilindja”, Prishtinë, 1968.
- Ruzhdi Ushaku, *Miti i një poeti, Migjeni 4 – Kritikë*, “Rilindja”, Prishtinë, 1977.
- Sefedin Fetiu, *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, Prishtinë, 198.
- Vebi Bexheti, “*Universalja në poezinë e Migjenit*”, në “Cogito”, Viti III, nr. 6, Tetovë, 2000.

NAIM HALIMI

KONTRIBUTI I SHQIPTARËVE TË KARADAKUT NË ÇLIRIMIN E SHKUPIT DHE NË SHPALLJEN E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË NË VITIN 1912

Shqiptarët e trevës së Karadakut, ndonëse i takonin zonës periferike të trungut etnik shqiptar në juglindje të Vilajetit të Kosovës, morën pjesë në të gjitha ngjarjet e rëndësishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, e edhe në çlirimin e Shkupit dhe në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëntor 1912).

Shqiptarët e kësaj treve, të rritur në luftëra jo vetëm me sunduesit osmanë, por edhe me ndërhyrjet armiqësore të fqinjëve serbë e bullgarë, me kujdes i përcillnin ngjarjet e kohës që zhvilloheshin përreth tyre e më larg në trojet shqiptare.

Në trevën e Karadakut, e sidomos në Malësinë e saj, asnjëherë nuk u ndërpre lufta e armatosur e çetave për lirinë e Shqipërisë. Këto çeta u gjetën të gatshme për të luftuar edhe në vitin 1912, në Kryengritjen e Përgjithshme, posa u përhap lajmi se në Kuvendin e Junikut, Malësi e Gjakovës (21-25 maj 1912), 250 krerët e popullit shqiptarë me Hasan Prishtinën, Isë Boletin, Bajram Currin, Idriz Seferin etj. kishin vendosur të fillonin kryengritjen e përgjithshme antiosmane dhe kishin hartuar programin me gjashtë pikat e njohura: caktimi i kufijve të Shqipërisë, krijimi i administratës shqiptare, ngritja e flamurit kombëtar, njohja e shqipes si gjuhë zyrtare, caktimi i një guvernatori të përgjithshëm, që do të zgjidhej nga njëra prej familjeve të njohura të vendit, dhe garantimi i këtyre kërkesave nga Fuqitë e Mëdha, si dhe strategjinë e kryengritjes, e cila në fillim do t'iu siguronte shqiptarëve në katër vilajetet ku jetonin Autominë, e pastaj Pavarësinë e Shtetit Shqiptar.

Udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare në këtë trevë: Sali Aga, Ibrahim Gollaku, Emin Bllata, Kosum Seferi, Cenë Kurbalia, Kadri Hasani nga Presheva, Danë Miratoca, Xunë Çeliku, Isuf Pidiçi, Selim Shtraza, Demë Likova, Adri Hasani-Burimi, Sheh Strima, Halit Breza e shumë të tjerë, të prirë nga kryetrimi i Karadakut Idriz Seferi, hynë në lidhje me Isë Boletin dhe prijësit e tjerë kosovarë dhe iu vunë punës për përgatitjen e kryengritjes në këtë zonë. Me të siguruar armë, rreth 1.200 kryengritës të udhëhequr nga Idriz Seferi pritnin në Gjilan për të kaluar në aksion. Kur masa

kryengritëse filloi veprimet në plan të gjerë në Rrafshin e Kosovës (prill-maj), Sadiku njëri nga udhëheqësit e kryengritësve të Gjilanit, pasi dërgoi vëllanë e tij me shokë për t'u ndihmuar kryengritësve të Istogut, shkoi edhe vetë atje. Sipas planit të kryengritjes, kryengritësit e Karadakut që kishin përvojë në luftëra duhej t'i ndihmonin kryengritësit kudo që kishte nevojë derisa xhonturqit t'i plotësonin kërkesat e tyre, prandaj edhe zhvillimi i kryengritjes nga beteja në betejë u përcoll nga këta kryengritës derisa u çlirua tërë Vilajeti i Kosovë me kryeqytet Shkupin.¹ Konsulli serb në Prishtinë njoftonte se një grup tjetër kryengritësish po nga kazaja e Gjilanit nëpër Kosovë doli në Pejë, ku u bashkua me kryengritësit e asaj ane. Çeta të tjera të kësaj ane u bashkuan me kryengritësit edhe në rrethin e Mitrovicës. Veprimet e çetave të armatosura vazhduan edhe në zonat e tjera të Karadakut. Qeveria turke duke njohur rëndësinë strategjike të Karadakut dhe mentalitetin kryengritës të popullit të saj, i kushtoi rëndësi të veçantë kësaj treve dhe u orvat ta mbante atë larg vatrave të kryengritjes. Krahas masave ushtarake, ndërmori edhe veprime politike. Ministri i Brendshëm, Haxhi Abdyl Beu, më 23 maj organizoi në Shkup një takim me disa krerë shqiptarë, por Idriz Seferi nuk shkoi. Ai kishte marrë detyrë nga paria e Karadakut t'i përkrahte vendimet e Kuvendit të Junikut dhe t'i realizonte ato.² Pikërisht në këtë kohë, Isë Boletini shkoi në Gjilan, ku së bashku me Idriz Seferin dhe me drejtues të tjerë të lëvizjes mori masa për vijimin e kryengritjes dhe për organizimin e një sulmi në Grykën e Kaçanikut, nëpërmjet të cilit depërtonin ushtritë osmane në Kosovë kundër kryengritësve. Me t'u përhapur lajmi se Idriz Seferi me 300 kryengritës do ta sulmonte së shpejti Kaçanikun, respektivisht grykën e tij, për t'i ndalur depërtimet e ushtrisë turke, paraqiten vullnetarë jo vetëm nga Gjilani e rrethina, por edhe nga Ferizaj, Presheva e Kumanova. Ky lajm u përhap shpejt edhe në Shkup. Shumë ushtarë, kuptohet shqiptarë, nga Shkupi i braktisën repartet e tyre dhe iu bashkuan kryengritësve. Jo vetëm ushtarët, por edhe populli shqiptar i Shkupit, siç shkruante shtypi i kohës, pritnin që të kërciste pushka e Idriz Seferit për tu hedhur në Kaçanik. Ata mblodhën edhe shumë ndihma. Vetëm Mehmet Beu çoi te kryengritësit 2.000 lira turke. Burimet dokumentare të kohës, e sidomos ato bullgare, dëshmojnë se në korrik të vitit 1912, mjaft shqiptarë nga qyteti i Preshevës me rrethinë nën komandën e Kadri Hasanit të Preshevës u hodhën në drejtim të Prishtinës për t'u bashkuar me kryengritësit. Me vullnetarët e tjerë në Kosovë u bashkua edhe Ali Efendiu nga Kumanova me 500 luftëtarë. Po në këtë kohë, Çerkez Ahmet Beu nga Kumanova, Haxhi Hasani nga Rramanlia, Demë Likova, Halit e Ejup Vaksinca, Selim Çausi-Shtraza me shumë veta u arratisën dhe u bashkuan me kryengritësit.

¹ Historia e Shqipërisë II, Tiranë, 1984, f. 465-474. Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Tiranë, 1978, dok.151, f.234-235. „Liri e Shqipërisë”, Nr.43, Sofje, 31.5.1912. AIH, Vj.22-20-2034, Raporti i konsullit austro-hungarez nga Shkupi, Nr.35, 1 qershor 1912, dërguar Ministrisë të Punëve të Jashtme në Vijenë. AMAE, PE, Turqie, Gerre Ballcanicue, jun-juen 1912, Raport i konsullit francez në Shkup, dërguar Ministrisë të Punëve të Jashtme në Pariz. Prof. Ramiz Abdyl, Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912, Libri 2, Prishtinë, 2004, f.237-241. HHS, A, PA, A, Shkup, 8.2.1912.

² DASSIP, PP, Beograd, 2/15.5.1912; Prishtinë, 28.4/11.5.1912. Bogomil Hrabak, Arbanashki ustanci 1912, në „Vranjski Gllasnik”, XI, Vranjë, 1975, f.217. Sadulla Brestovci, Lëvizja Kombëtare në kazanë e Gjilanit 1908-1912, „Rilindja”, Prishtinë, 25.6.1971. „Liri e Shqipërisë”, Nr.41, Sofje, 9 maj 1912.

Në ato ditë kishin dezertuar edhe disa komandantë të xhandarmerisë në karakollët e Preshevës, të Bujanocit, në Zhegër, Sefer, Bellanoc, Brezë e Viti. Në këtë luftë kundër armikut të përbashkët osman, shqiptarët i ftuan edhe fqinjët e tyre bullgarë, serbë e maqedon, por përpjekja e tyre nuk gjeti përkrahje, sepse ata punonin sipas direktivave të Beogradit e Sofjes. Deri në gjysmën e gushtit forcat kryengritëse kishin çliruar pjesën më të madhe të Vilajetit të Kosovës dhe të trevës juglindore të saj. Autoritetet osmane në Shkup ishin të shqetësuara fort për shtrirjen e kryengritjes në kazanë e Gjilanit, Preshevës, Kumanovës, Kaçanikut e të Shkupit. Me urdhër të komandantit të garnizonit të Shkupit, bateritë e artillerisë i kishin kthyer grykat e topave drejt kryengritësve, ndërsa 10 batalione ushtarësh qëndronin të gatshëm për mbrojtjen e Kaçanikut nga çdo sulm i mundshëm i kryengritësve.³ Megjithatë, luftimet në Rrafshin e Kosovës e edhe në Karadak shkolin në favor të kryengritësve. Pasi Qeveria osmane nuk u përgjigjej pozitivisht kërkesave të shqiptarëve, lufta vazhdoi. Më 19-20 korrik u çliruan shumica e qyteteve të Kosovës, por ngjarje më e rëndësishme ishte çlirimi i Prishtinës më 21 korrik pa luftë. Atëherë në Prishtinë e në rrethin e saj, ishin grumbulluar rreth 40.000 kryengritës me shumë krerë shqiptarë nga viset e ndryshme, të cilët pritnin përgjigje pozitive për kërkesat e parashtruara, përndryshe do të vazhdonin kryengritjen drejt Ferizajt, Kaçanikut dhe Shkupit. Po në këtë kohë rreth 1.500 kryengritës të mbledhur në Gjilan nën udhëheqjen e Idriz Seferit u dhanë urdhër karakollëve të fshatrave të Karadaku si të Seferet Bellanocit etj. që t'i dorëzonin armët, ndërsa fshatrat e rrethinës së Shkupit i porositën që të përgatitnin ushqim për kryengritësit. Këto fakte në Shkup u interpretuan si masa paraprake për sulmin mbi Shkupin.⁴

Më 20 korrik paria e Karadaku i dërgon një telegram Stambollit nënshkruar nga Idriz Seferi, ku kundërshtuan ashpër politikën e dhunës së xhonturqve dhe kërkuan t'i jepej fund asaj dhe të plotësoheshin kërkesat e kryengritësve. Po nga kjo krahinë iu dërguan telegrame parlamentarëve shqiptarë, nga të cilët kërkonin të ndërhynin ndaj qeverisë dhe ta shfrytëzonin tribunën e parlamentit për t'u dhënë fund përndjekjeve të shqiptarëve dhe për t'i plotësuar kërkesat e tyre. Këto telegrame u lexuan edhe në mitingjet që u mbajtën në disa qytete të Kosovës.

Pas çlirimit të Prishtinës, forcat kryengritëse të kazasë së Gjilanit dhe të trevës së Karadaku u përqendruan në Ferizaj dhe u çliruan atë (30 korrik), si dhe në afërsi të Kaçanikut për të ndërmarrë sulme për çlirimin e tij. Këtu ishin vendosur rreth 2.000 veta, nën drejtimin e Idriz Seferit dhe udhëheqësve lokalë. Edhe Sait Hoxha këtu kishte sjellë rreth 2.200 veta nga rrethin e Shkupit dhe e Kumanovës, sidomos nga malësitë. Këtu kishin ardhur më 22 korrik edhe 1.500 kryengritës të udhëhequr nga

³ „Politika „Beograd,Nr.22.5,6.7.1912.Zekiria Cana,Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912,Prishtinë,1979,f.242.„Liri e Shqipërisë„,Sofje,Nr.50,24 korrik 1912.Dr.Ramiz Abdyli,Presheva dhe viset për rreth në kryengritjen antiosmane dhe në Luftën Ballkanike,në„Jena„Bujanoc,janar-shkurt 1993,f.11.B.Hrabak,punim i përm.,f.273-274.Naim Halimi,Lëvizja Kombëtare Shqiptare në trevën e Karadaku 1908-1912,Kumanovë,2001,f.222-225.

⁴ Historia e Shqipërisë II, Tiranë, 1984, f.476. „Vardar„Shkup, Nr.52, 8/21.7.1912. DASSIP, PP, Prishtinë, 1/14.7.1912. Zeqirija Idrizi, Treva e pollogut në Lëvizjen kombëtare Shqiptare 1899-1912,Tetovë, 2007, f.230-237.

Mehme Pashë Deralla dhe pritej të vinin shumë të tjerë nga Dibra, Luma dhe Mirdita. Ky përqendrim i kryengritësve i zonave të Karadakut u bë kryesisht për të mësyre Shkupin, por sulmi mbi Shkupin u shty për një kohë. Më parë kryengritësit çliruan trevën e Karadakut, me qytetet Gjilanin, Bujanocin, Preshevën dhe Kumanovën.⁵

Pas çlirimit të këtyre qendrave të trevës së Karadakut si dhe grumbullimit të rreth 50.000 kryengritësve në Prishtinë, e pastaj kalimit të tyre në Ferizaj, në vendin tradicional të kuvendeve shqiptare, sepse qeveria osmane nuk iu përgjigj kërkesave të kryengritësve në Prishtinë, e as atyre në Ferizaj të njohura si Memorandumi i Ferizajt të hartuara nga Hasan Prishtina, ushtria dhe administrata osmane në Shkup u gjet në një situatë tepër të vështirë. Përderisa qeveria osmane nuk u përgjigj kërkesave të shqiptarëve, i zvarriste ato, kryengritësit shqiptarë të Kosovës e të Karadakut dhe të viseve të tjera përreth përgatiteshin për ta sulmuar Shkupin, qytetin kryesor të trevës së Karadakut dhe kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës.

Ndërkaq, edhe komanda e trupave osmane, sado që ushtria ishte duke u shthurur, mori masa për mbrojtjen e Shkupit, u hapën llogore rreth tij, u përforcua artileria, e cila i drejtoi grykat e topave drejt Kaçanikut. Oficerët shfaqën gatishmërinë për të mos lejuar shpërndarjen e parlamentit dhe për t'u rezistuar kryengritësve, qoftë në kundërshtim edhe me urdhrat e Stambollit. Në fund të korrikut komanda osmane kishte në Kosovë gjithsej 35 batalione, të cilët sidomos kuadri i oficerëve ishte në gatishmëri luftarake. Por te administrata osmane në Shkup në përgjithësi qëndronte një lloj nervozizmi. Njësitet e policisë patrullonin pa ndalur, ndërsa Zeki Pasha, ushtrues i detyrës së komandantit të truparmatës së vilajetit të Kosovës, i siguronte qytetarët se nuk do ta lejonte depërtimin e kryengritësve shqiptarë në Shkup, duke sjellë përforsime të mëdha ushtarake.⁶

Megjithatë, asgjë nuk mund t'i ndalonte kryengritësit në luftën për çlirimin e Shkupit. Meqenëse qeveria osmane vonoi përgjigjen ndaj 14 kërkesave të shqiptarëve, udhëheqësit e kryengritjes vendosën të sulmonin Shkupin. Qysh më 5 gusht hynë në Shkup 100 kryengritës me tren nga Ferizaj. Por kërcënimi më i madh qytetit i vinte nga forcat kryengritëse prej 1.000 vetash nga Bujanoci, që pritnin urdhrin e Hasan Prishtinës. Po aq kryengritës pritnin edhe në malësinë e Kumanovës në fshatin Burim (Izvor), të udhëhequr nga prijësit e kësaj ane Kadri Hasani i Burimit, Sheh Strima, Selim Çausi, Bylbyl Efendia etj. për të marshuar drejt Shkupit. Rreth 1.000 të tjerë pritnin në fshatrat Goshicë, Malinë e Brezë. Lajmin për të depërtuar drejt Shkupit e pritnin edhe kryengritësit e tubuar në Gjilan, Ferizaj, Kaçanik, dhe ata që më herët kishin ardhur e ishin vendosur në malësinë e Preshevës, Kumanovës dhe të Shkupit. Pas çlirimit të trevës së

⁵ DASSIP, PP, P, Prishtinë, 12/29.7.1912, N-S, 1028; Prishtinë, 8/21.7.1912, Nr.1006. B.Hrabak, punim i përm., f. 290-300. „Politika,, Beograd, 19.7/1.8.1912. „Gllas Naroda,, Nr. 31. Shkup, 18/31.7.11912. „Politika,, Beograd, 20.7/2.8.1912. Y. Cana, punim i përm., f. 252. Niko Koleci, Kryengritja e përgjithshme shqiptare kundër sundimit turk në vitin 1912, Tiranë 1962, f.75.

⁶ Z. Cana punim i përm. f. 267-277. B. Hrabak, punim i përm. 315-316. DASSIP, PP, Shkup, 6/13.8.1912. DASSIP, PP, Shkup, 17/30.7.1912. Nr. 4379; Shkup, 20, 7/2.8.1912, Nr. 4433; Shkup, 19/1.8.1912, Nr. 1364. „Vardar,, 19/7/1.8.1912, Nr. 59. Z. Cana, punim i përm. f. 268-269. Hasan Prishtina, Një shkurtim kujtımesh mbi kryengritjen shqiptare të vitit 1912, Shkodër, 1921, f. 25-30.

Karadaku pothuaj të gjithë kryengritësit u hodhën në Shkup të armatosur me pushkë e revole (allti të Karadaku) të llojeve të ndryshme.

Mësymjen e kryengritësve drejt Shkupit me gëzim të madh po e prisnin shqiptarët, ndërsa sllavët nuk e kundërshtuan, epse kishin besim në disiplinën e tyre, dhe shpresonin se nëse shpërndahet parlamenti do ta qetësonte situatën.

Autoritetet osmane edhe pse morën masa për mbrojtjen e qytetit, grupe kryengritësish shqiptarë hynin në Shkup çdo ditë, nga të gjitha anët, e sidomos pas 9 gushtit, kur mbaroi afati i përmbushjes së kërkesave të dërguara nga Ferizaj. Edhe përpjekjet e Ibrahim Pashës për t'i ndalur kryengritësit me anë të mashtrimeve nuk japin rezultate. Marshimi i kryengritësve drejt Shkupit kryesisht u bë rrugëve tokësore të Karadaku, Grykës së Kaçanikut dhe nëpërmjet hekurudhës Mitrovicë-Shkup dhe Ristoc-Bujanoc-Preshevë-Kumanovë-Shkup. Më 10 e 11 gusht hynë në Shkup çeta kryengritësish nga Mitrovica, Karadaku i Shkupit dhe 320 veta të udhëhequr nga Bajram Deklani, Zefi i Vogël dhe Hysen Beu. Hyrja e tyre u prit me këngë, valle e muzikë. Së bashku me kryengritësit festonin e luanin valle edhe udhëheqësit siç ishte rasti me Bajram Deklanin, ndërsa Sait Hoxha ish-deputeti i parlamentit osman "mbante flamurin kombëtar në dorë". Në mbrëmje të 11 gushtit u mor vendimi për të kaluar në Shkup të gjithë kryengritësit që gjendeshin në Ferizaj, ndërsa rreth 6.000 kryengritës të tjerë mbesin në rrafshin e Dukagjinit, në Sanxhak dhe Jeni Pazar, për ta ruajtur kufirin verior nga sulmi eventual nëse ndodhte nga Mali i Zi apo Serbia. Më 12 gusht në Shkup hynë rreth 500 kryengritës nga Vushtria, 1.200 të tjerë nga Prishtina, me tren të mallrave, dhe 500 nga Gjilani. Më 13 gusht hynë në Shkup rreth 2.500 kryengritës të udhëhequr nga Isa Boletini, të armatosur, ndërsa më 14 gusht grupi i Bajram Currit dhe Idriz Seferit pasdite vonë hyri në Shkup me 6.000 kryengritës, në mesin e të cilëve kishte shumë kryengritës edhe masivi malor i Karadaku. Depërtimi i kryengritësve në Shkup, nga Ferizaj, Kumanova e vise e tjera shqiptare vazhdoi edhe më 15 e 16 gusht. Deri më 16 gusht 1912 në Shkup u grumbulluan mbi 35.000 kryengritës shqiptarë, duke mos i llogaritur këtu edhe 2.000 të tjerë nga vetë qyteti i Shkupit.⁷ Shumica e kryengritësve u vendosën në qytet, ndërsa pjesa tjetër jashtë qytetit në rrethinat e tij, në familjet shqiptare. Në mesin e kryengritësve, sipas vëzhguesve të huaj, u gjetën edhe shumë oficerë shqiptarë, që kishin dezertuar dhe ishin veshur me veshje kombëtare, e cila edhe më shumë e kishte zbuluar pamjen e kryengritësve. Kryengritësit shtinë në dorë Postë-Telegrafin dhe vendosën rendin e qetësinë duke u bërë zotë të situatës. Valiu i Kosovës e njoftonte Stambollin se ishte i pafuqishëm t'i ndalonte kryengritësit. Marrja e Shkupit nga kryengritësit e

⁷ Bogomil Hrabak, punim i përm.f.318.DASSIP,PP,Prishtinë,30.7/12.8.1912.Zekirija Cana,punim i përm.f.270.DASSIP,PP,Shkup,2/15.8.1912,nr.1464.,Vardar,,2/15.8.1912,Nr.2.DASSIP,PP, Prishtinë, 2/15.8.1912,NS-1195.,Vardar,,Shkup,2/15.8.1912,Nr.59, 2/15 gusht 1912,5/18.8.1912, Nr.60.,Drita,,Nr.81, Manastir,16 gusht 1912.,Shkupi,,Nr.31, Shkup,16 korrik 1912.Dr.Ramiz Abdyli,Në 86 vjetorin e çlirimit të Shkupit nga kryengritësit shqiptarë "Fakti", Shkup,12-13 gusht 1998. „Politika,, Nr. 3068, Beograd,2.8.1912; Nr. 3069, 3.8.1912. „Liri e Shqipërisë „Nr.52,11 gusht 1912. Shih edhe deklaratën e Nazim Fazliut nga f. Burim(Izvor) dhënë nautorit në Kumanovë,më 19.5.1988. Shih po ashtu deklaratën e Zejnulla Hasanit- haxhi Xunit,nga f.Gllazhdë plak 80 vjeçarë dhënë autorit në Shkup,më 12.5.1982.

paralizoi të gjithë administratën civile dhe ushtarake jo vetëm në qytet, por në gjithë vilajetin e Kosovës. Në rastin e çlirimit të Shkupit, Bajram Curri urdhëroi të lirohen të gjithë të burgosurit. Si u urdhërua ashtu edhe u veprua, u liruan rreth 1.000 të burgosur kryesisht shqiptarë, shumica prej të cilëve iu bashkuan kryengritësve pasi u furnizuan me armë nga thyerja e depove të ushtrisë osmane. Në qytet patrullonin ditë e natë kryengritësit shqiptarë duke marrë masa të rrepta disiplinore ndaj keqbërësve. Gazeta “Liri e Shqipërisë” shkruante se ato ditë kryengritësit silleshin shumë mirë me vendësit dhe me butësi me krishterët. Kryengritësit shqiptarë ndonëse e çliruan Shkupin dhe vendosën rregullin e qetësinë e tyre, bënë një gabim të madh sepse administratën osmane nuk e zëvendësuan me atë shqiptare. Gazeta “Liri e Shqipërisë” “vinte re se hyrja e kryengritësve në Shkup u bë me mend e me taktikë që habiti botën”, por sipas saj ata bënë një gabim: sikurse këtu, edhe kudo ku hynë, duhej të kishin marrë gjithë fuqinë në duart e tyre dhe të ngrinin qeverinë e hëpërhëshme (të përkohshme), dhe se nuk mjaftonte të hysh vetëm në qytet, të lirosh të burgosurit dhe hyqymetin t’ua lësh sundimtarëve të parë.⁸

Çlirimi i Shkupit nga kryengritësit shqiptarë ndonëse nuk qe një fitore e plotë, sepse kryengritësit vetëm e çliruan qytetin e nuk e morën pushtetin në duart e tyre, përsëri ishte një sukses i madh i cili u prit me gëzim kudo nga shqiptarët. Përderisa shqiptarët u gëzuan me këto suksese, u shqetësuan pa masë shtetet ballkanike me aleatët e tyre Rusinë dhe Francën në krye, sepse sukcesi i plotë i shqiptarëve do t’i hidhte në erë planet e tyre.

Franca dhe Serbia pasi kishin marrë mësim të mjaftueshme nga Rusia, e përshpejtuan punën në Aleancën Ballkanike për luftë kundër Perandorisë Osmane nëse ajo i pranonte kërkesat për autonomi të shqiptarëve. Kërkesat e shqiptarëve në heshtje i pranonte vetëm Austro-Hungaria. Ajo në fakt paraqiti një plan momental para Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane për decentralizimin e pushtetit osman në Ballkan nga i cili do të ruhej paqja, popujt e Ballkanit do të fitonin më shumë të drejta, ndërsa Perandoria Osmane do ta ruante sundimin në këtë pjesë evropiane të perandorisë. Madje Vjena mendonte se do të ishte edhe më mirë sikur Porta të emëronte një ministër shqiptar pa portofol ose një inspektor të përgjithshëm për vilajetet shqiptare, siç ishte rasti në Bosnjë e Hercegovinë, mirëpo ky propozim nuk pëlqej nga shtetet ballkanike dhe aleatët e tyre Rusia e Franca, e as nga qeveria osmane e ngarkuar me paragjykime panosmane dhe shoviniste.⁹

Me fjalë të tjera, shqiptarët dhe tokat e tyre ishin bërë objekt konflikti të Fuqive të Mëdha në Ballkan. Përderisa Austro-Hungaria, Gjermania, Italia dhe Anglia ishin

⁸ Prof.Dr. Ramiz Abdyl, Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912, II, Prishtinë, 2004, f.366-373., Liri e Shqipërisë., Nr.52, Sofje, 11.8.1912., Vardar., Nr.60, Shkup, 5.8.1912., Politika., Nr.3070, Beograd, 4.8.1912. Eqrem Bej Vlora, Kujtime I, Tiranë, 2001, f.290-291., Drita., nr.81, Manastir, 16 gusht 1912.

⁹ Xheladin Shala, Mardhënjet shqiptaro-serbe 1912-1918, Prishtinë, 1995, f.25-30, 32-35. Z.Cana, vep. e përm., f.271-275. Stefanaq Pollo, Lufta e popullit hqiptar për çlirim kombëtar dhe shpallja e pavarësisë më 28 nëntor 1912, Tiranë, 1962, f.60-70. Stefanaq Pollo, Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Tiranë, 1962, f.65-78. Prof.Dr.Ramiz Abdyl, vepër e përm., f.378-380., Gllas naroda., Nr.36, Shkup, 4/17.8.1912. Historia e Shqipërisë III, 11984, f.482. Gazmend Shpuza, Përmasat e kryengritjeve të mëdha shqiptare të viteve 19110-1912, në „Gjurmime albanologjike”, Nr.23, Prishtinë, 1995, f.122. HHHSt, A, PA, A, Shkup, 1 shtator 1912, Nr.105.

dakord që shqiptarëve t'u njihej autonomia në tokat e tyre, e me këtë të ndalohej depërtimi i Rusisë në Ballkan dhe në Detin Adriatik ku rrezikoheshin interesat e tyre, Rusia e Franca ishin kundër, tokat e shqiptarëve donin t'i pushtonin dhe t'ua ndanin Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë, nëpërmjet të cilëve do të dilnin në Detin Adriatik, ku do t'i mbronin tregjet dhe interesat e tjera që i kishin. Perandoria Osmane nuk dëshironte t'ua njihte autonominë shqiptarëve sepse frikësohej që të mos e humbte sundimin mbi shqiptarët në Ballkan dhe në pjesën europiane të Perandorisë. Megjithatë, çlirimi i pjesës më të madhe të vilajetit të Kosovës dhe kryeqytetit të saj Shkupit, paraqet një shqetësim të madh për qeverinë osmane. E vetëdijshme për rrezikun që i kërcënohej nga shtetet ballkanike, Aleanca Ballkanike, qeveria osmane e cila kishte hyrë në bisedime me udhëheqësit e kryengritjes në Shkup, u detyrua të përfundonte sa më parë bisedimet me drejtuesit shqiptarë, që do të mundësonte tërheqjen e tyre nga Shkupi, dhe të shmangej rreziku për depërtimin e kryengritësve drejt Selanikut e Stambollit, për të cilin kryengritësit kishin paralajmëruar më parë. Meqenëse Ibrahim Pasha i autorizuar nga qeveria osmane nuk arriti t'i largonte nga Shkupi me premtime të rreme kryengritësit, u detyrua të zhvillonte bisedime tri ditë me radhë (16-18 gusht 1912) me udhëheqësit e kryengritjes në Bashkinë e qytetit dhe në shtëpinë e Nexhip Dragës. Mbledhjen e hapi Ibrahim Pasha, ndërsa në emër të shqiptarëve Hasan Prishtina i paraqiti edhe një herë 14 kërkesat e formuluar në Ferizaj. Gjatë bisedave pati mospajtime dhe kundërshtime të ashpra, sepse pala osmane kërkonte që t'i ngushtonte sa më shumë kërkesat e shqiptarëve, ndërsa pala shqiptare kërkonte të realizohen të gjitha. Më 18 gusht, Ibrahim Pasha thërriti krerët shqiptarë të kryengritjes të shkonin në konakun e tij për t'i njoftuar me urdhrin që kishte marrë nga sulltan Mehmet Reshati V, për miratimin e kërkesave të parashtruara. Krerëve të kryengritjes të shkuar në konak me në krye Hasan Prishtinën iu komunikua se u ishin pranuar 12 nga 14 kërkesat e shtruara, domethënë përpos çështjes së hedhjes në gjyq të kabineteve të regjimit xhonturk, i cili mbetej në kompetencë të parlamentit të ri, ndërsa kërkesa tjetër, armatimi i shqiptarëve, do të bëhej më vonë. Hasan Prishtina duke pasur parasysh konstelacionin e forcave politike që mbretëronin në Ballkan dhe më gjerë, në emër të delegacionit shqiptar pranoi marrëveshjen dhe e deklaroi kryengritjen të përfunduar. Në mbrëmje Hasan Prishtina organizoi një mbledhje me udhëheqësit e kryengritjes për të pranuar marrëveshjen e ofruar, dhe, pasi të gjithë udhëheqësit u pajtuan, vendosën të largoheshin nga qyteti, Shkupi. Tërheqja e kryengritësve filloi nga dita e nesërme 19 gusht dhe brenda disa ditëve të gjithë kryengritësit u larguan nga Shkupi me një disiplinë shembullore. Kështu, Shkupi edhe pse u çlirua nga kryengritësit shqiptarë, nuk arriti ta shpallte Autonominë dhe Pavarësinë e Shqipërisë në gusht të vitit 1912. Nikollë Ivanaj, veprimtar dhe publicist i kësaj kohe, do të vlerësonte se “triumfi i kryengritësve në qendrën e Vilajetit të Kosovës, në Shkup, shënoi një faqe të lavdishme në historinë e popullit shqiptar(...) por vetëm Lufta Ballkanike u bë shkak që kjo nder e famë t'i mbetet Vlorës e jo

Kosovës”, Shkupit. Zhvillimet e mëtutjeshme të ngjarjeve vërtetuan se ai kishte pasur të drejtë.¹⁰

Me shpërndarjen e forcave kryengritëse nga Shkupi, synohej që të merreshin masa në çdo anë të tokave shqiptare për mbrojtjen e tërësisë së tyre territoriale. Në çdo kaza kryengritësit formuan komisionet apo këshillat shqiptare, të cilat ishin organe të pushtetit të shqiptarëve për të mbajtur rendin dhe qetësinë, për të lidhur besën dhe për t’u përgatitur në luftë kundër armikut të ri Serbisë, e cila po u trokiste në derë shqiptarëve. Për këtë qëllim këshilla u formuan pothuajse në tërë trevën e Karadikut, në Shkup, Kumanovë, Preshevë, Bujanoc, Gjilan, Ferizaj e Kaçanik, nën udhëheqjen e prijësit kryesor të kësaj treve Idriz Seferi. Në Gjilan, theksonte shtypi i kohës, pyetej Idriz Seferi e jo administrata osmane. Shqiptarët po përpiqeshin kudo edhe në trevën e Karadaku të përfitonin nga ato lëshime që parashikoheshin në marrëveshjen shqiptaro-turke në Shkup, për të vendosur pushtetin e tyre në trevat shqiptare dhe për të siguruar kështu vetëqeverisjen dhe mundësinë e mbrojtjes së tyre nga sulmi i jashtëm që po përgatitej nga Serbia. Është koha pra kur shqiptarëve po u trokiste në derë Lufta Ballkanike e përgatitur gjatë kohë nga fqinjët për t’i pushtuar tokat e tyre. Pra, shqetësimet e atdhetarëve shqiptarë për t’u tërhequr nga Shkupi dhe për t’i mbrojtur tokat e tyre nuk qenë të pabaza, sepse pa kaluar as dy muaj nga përfundimi i kryengritjes së vitit 1912 dhe çlirimi i Shkupit, Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia filluan luftën ballkanike, e cila pati pasoja fatale për kombin shqiptar.

Ndonëse kryengritja e vitit 1912 përfundoi me çlirimin e të gjitha qyteteve të Kosovës, kuptohet këtu edhe të trevës së Karadikut, nuk çoi në formimin e një Shteti autonom kombëtar shqiptar me kufij të përcaktuar dhe të njohur nga Perandoria Osmane dhe nga faktorët ndërkombëtarë. Ky përfundim nuk i përgjigjej aspak zhvillimit ngadhënjimtar të kryengritjes dhe pati rrjedhoja tepër të rënda për atdheun dhe kombin shqiptar. Kështu, fillimi i Luftës Ballkanike, në tetor të vitit 1912, i gjeti shqiptarët të paorganizuar në shtetin e tyre kombëtar dhe në përbërje të një Perandorie osmane të shthurur politikisht dhe ushtarakisht, të rrënuar ekonomikisht dhe të shndërruar në një vegël në duart e Fuqive të Mëdha. Në një kohë të tillë shqiptarët u gjetën të pambrojtur si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë të ndërkombëtar, të vetmuar e në mëshirën e fatit, dhe në këtë gjendje e vazhduan luftën për liri.¹¹

¹⁰ Zef Prela, Problemi shqiptarë dhe politika austro-hungareze(1878-1912).Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Tiranë,1962,f.185-90.,Politka,,Nr.3064,Beograd,30.8.1912;Nr.3071,5.9.1912; Nr.74,8.8.192; Nr.76,10.8.1912 AQSH,F.35,1912 d.26,f.1-10,15-18. „Liri e Shqipërisë,,Nr.53,16 gusht 1912.,,Shkupi,,Nr.32,Shkup,30 gusht 1912.Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj,Tiranë,1963,d.1,f.24.Luigj Gurakuqi,Vepra,3,Prishtinë,1988,f.184-186.Niko Koleci,vepër e përm.f.85-95.,,Vardar,,Nr.60,Shkup,5.8.1912.Nikoll Ivanaj,Historia e Shqipërisë së re-vuajtje dhe veprimet e mija,I,Tiranë,1943,f.12.Ramiz Abdyli,Në 86 vjetorin e çlirimit të Shkupit,,Fakti,,Shkup,14 gusht 1998.

¹¹ Z.Cana,punim i përm. f.275-2285.Gazmend Shpuza,punim i përm.,f.120-125. DASSIP, PP, Prishtinë,27.8/9.9.1912;7/30.9.1912;Prishtinë,17/30.9.1912.,,Vardar,,Shkup,2/15.9.1912,nr.68.,,Vardar,,Shkup,20.9/3.10.1912,Nr.73.,,Politika,,Beograd,18/31.9.1912.,,Vardar,,Shkup,19.8/11.9.1912,Nr.67.,,Vardar,,Shkup,16/29.8.1912,Nr.63.,,Politika,,Beograd,5/18.9.1912,B.Hrabak,punim i përm.,355, HHHSt,A,PA,A,Shkup,1 shtator 1912,Nr.105.Hollësisht për këtë shih:Thoma Murzaku,Politika e

Serbia prej kohësh kishte përgatitur planin e Luftës Ballkanike, sipas të cilit ushtria e saj duhej të arrinte “deri në Detin e Bardhë (Egje) dhe në Detin Adriatik, ku i konsideronte kufijtë e saj natyror”. Po ashtu ishin përcaktuar edhe veprimet konkrete ushtarake për pushtimin e tokave shqiptare nga Llapi e Kumanova deri në Elbasan e Durrës. Për realizimin e këtij qëllimi ajo hodhi në luftë 350.000 ushtarë të pajisur me armët më moderne të kohës, me 230 mitralezë dhe 544 topa. Në kudër të kësaj ushtrie ishte paraparë që Armata e parë të sulmonte në drejtimin Moravë-Vardar, Shkup, ndërsa Armata e tretë në drejtim të Kosovës, në Prokuplje-Prishtinë, Shkup. Po ashtu ishte planifikuar nga Komanda serbe që me një sulm të paplanifikuar dhe ende pa u bërë mobilizimi i ushtrisë turke, ushtria serbe të përparonte në drejtim të Kumanovës, Prishtinës Mitrovicës dhe Novi Pazarit për të hyrë thellë në jug e për të pushtuar pastaj Shqipërinë perëndimore, duke zhvilluar luftime në drejtimin Prishtinë-Lumë-Mirditë-Lezhë-Durrës dhe Kumanovë-Manastir-Strugë-Elbasan-Durrës. Në këtë mënyrë Serbia planifikonte të pushtonte pjesën më të madhe të Shqipërisë. Para një armiku të ri e të fuqishëm udhëheqësit e popullit shqiptar: Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Idriz Seferi, Bedri Pejani, Sali Gjuka e shumë të tjerë u gjetën në një pozitë mjaft të vështirë për fatin e popullit dhe të atdheut, dhe në këto momente e zgjodhën rrugën më të vështirë, por më të drejtë, t’u qëndronin me forcat e tyre njerëzore pushtuesve ballkanas dhe të luftonin njëherazi për çlirimin kombëtar, për t’u veçuar nga Perandoria Osmane, për të mos marrë mbi vete pasojat tragjike të luftës dhe për të dalë prej saj, me shtetin e tyre kombëtar e të pavarur në kufijtë e tij etnikë.

Posa u mor vesh se lufta ishte duke filluar, u dha kushtimi për mbrojtjen e atdheut nga agresorët serbë. Kudo filloi grumbullimi i vullnetarëve, që shkuan në kufi për mbrojtjen e vendit nga ushtria serbe. Edhe në këtë periudhë të vështirë të historisë së shqiptarëve, qytetet e trevës së Karadakut u bënë qendra të organizimit të qëndrësës popullore kundër pushtuesve serbë dhe ballkanas në përgjithësi. Pikërisht në Shkup në kryeqendrën e vilajetit të Kosovës dhe në qytetin kryesor të kësaj treve u mbajt më 14 tetor 1912 një mbledhje me personalitetet kryesore të vendit e nën kryesinë e Nexhip Dragës, në prezencë të Sali Gjukës, Nexhip Dragës e mjaft të tjerëve nga treva e Karadakut. Në mbledhje u theksua se Perandoria Osmane do ta humbte luftën nga Aleanca ballkanike dhe se shqiptarët do të veçohen prej saj. Ata vendosën që në emër të kombit shqiptar t’u paraqesin Fuqive të Mëdha një Deklaratë se populli shqiptar do t’i kapë armët për të luftuar jo për ta forcuar Perandorinë osmane në Ballkan, por për t’i dalë zot tërësisë tokësore dhe lirisë së Shqipërisë. Deklarata iu paraqit konsujve të huaj në Shkup, më 16 tetor 1912. Në mbledhje po ashtu u vendos që të formohet një komision i cili do të bënte përgatitjet për mbajtjen e një Kuvendi kombëtar i cili do të vendoste për fatin e atdheut në këto çaste të vështira. Orientimi i atdhetarëve shqiptarë në Shkup u përgjigjej plotësisht kërkesave të Lëvizje Kombëtare Shqiptare, të shpallte pavarësinë nga P. Osmane, asnjësinë e Shqipërisë në Luftën Ballkanike,

Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë Luftës ballkanike 1912-1913, Tiranë 1987, f.70-80. Xheladin Shala, Lidhja e Aleancës ballkanike dhe shqiptarët, në „Fjala”, Prishtinë, shtator, 1991.

vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur vendin pa lejuar copëtimin e saj nga fqinjët etj.

Serbia ende pa i shpallur luftë P. Osmane, filloi konfliktet e armatosura në kufij, në rrethet kufitare të trevës së Karadakut si në atë të Kumanovës, Preshevës e Bujanocit. Më 15 tetor trupat serbe mësynë rajonin e Vranjës, ndërsa tri ditë pas u hodh në sulm e gjithë ushtria prej 286.000 vetash. Armata e parë dhe e dytë morën mësymjen në drejtimin Nish-Manastir-Elbasan dhe Nish-Manastir-Selanik. Armata osmane nuk kishte bërë përgatitjet e duhura dhe raporti i forcave ishte 4 me 1 në favor të armatës serbe. Shqiptarëve, që iu ishin premtuar armët për mbrojtjen e vendit, iu dhanë fare pak. Në këto momente shqiptarët u lanë pa armë, në mëshirën e fatit. Pavarësisht nga mosbesimi i tyre ndaj qeverisë së Stambollit, shqiptarët në shumë raste u treguan të gatshëm të merrnin armët, por për të mbrojtur atdheun e tyre e jo P. Osmane.¹²

Me organizimin e forcave vullnetare shqiptare në zonën e Karadakut u mor Idriz Seferi. Pas largimit nga Shkupi, në mesin e tetorit u hodh në Gjilan dhe aty te Kulla e Sahatit mbajti një mbledhje me krerët popullor të kësaj ane, ku u vendos të mobilizohen vullnetarë shqiptarë për të luftuar kundër Serbisë. Shtypi shkruante në ato ditë se Idriz Seferi arriti t'i grumbullonte 6.000 luftëtarë të cilët u hodhën në kufirin me Serbinë, në Sfirçë e Velegllavë, ku së bashku me forcat e vendit luftuan me forcat serbe. Përkundër heroizmit të madh të vullnetarëve shqiptarë, forcat serbe falë epërsisë numerike dhe armatimit e thyen qëndresën dhe arrijnë afër Bujanocit. Gjatë këtyre veprimeve serbët disa herë u detyruan të largohen nga pozicionet, duke lënë 26 të vrarë dhe 113 të plagosur. Një qëndresë e ashpër serbëve iu bë nga kryengritësit edhe në Bujanoc, por mungesa e municionit dhe epërsia numerike e serbëve i detyroi shqiptarët të tërhiqeshin në Tërnoc e në Rohovicë të Preshevës dhe në qendra tjera. Qëndresë e ashpër iu bë agresorëve dhe në Grykën e Konçulit. Pas kësaj qëndrese, ushtria serbe e pushtoi Gjilanin më 24 tetor.

Pas pushtimit të Gjilanit, serbët iu vërsulën trevës së Karadakut, të cilët kishin si objektiv të parë pushtimin e Ferizajt, Kumanovës dhe Shkupit, për të vazhduar pastaj drejt jugut dhe pjesës perëndimore të Shqipërisë. Për ta realizuar këtë qëllim, komanda serbe urdhëroi Armatën e tretë që të hidhte njësitet e saj në marshim drejt Kumanovës dhe Shkupit. Ferizaj u mbrojt nga ushtria serbe thujse vetëm nga shqiptarët, sepse ushtria osmane (turke) u tërhoq nga andej para konfliktit. Mehmet Deralla shkruante se në luftën e Ferizajt serbët lanë 100 të vrarë. Serbet arritën suksese në këto luftime vetëm në sajë të përdorimit të artillerisë së rëndë dhe e pushtuan qytetin më 25 tetor. Forcat shqiptare u tërhoqën drejt Kaçanikut.

Beteja më e madhe e trevës së Karadakut ishte ajo e Kumanovës (23-24 tetor), që u zhvillua në hapësirën afër saj pranë fshatrave Lojan, Karabiçan, Nikulan dhe Stezovcë, në lartësinë Zebërnjak, ku më vonë Serbia (1938) ka ngritur përmendore

¹² B.Ratkoviç, Prvi Ballkanski rat i Serbia, Beograd, 1975, f.360-380. Sh. Braha, Idriz Seferi, Tiranë, 1981, f.180-190. Th. Murzaka, punim i përm. f.110-115. Historia e Shqipërisë, II, Tiranë, 1984, Akte të Rindjes Kombëtare Shqiptare, Tiranë, 1978, d.169, f.255-260. HHSt, A, PA, A, Shkup, 18 tetor 1912, Nr.118. A. Puto, Pavarsia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha, Tiranë, 1968, f.100-105. Sh. Braha, Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844-1990, Tiranë, 1992, f.135-140.

në kujtim të kësaj ngjarjeje. Në anën e serbëve u hodhën forcat e Armatës së parë 90.000 luftëtarë, ndërsa Armata osmane e Vardarit kishte 50.000 luftëtarë. Në radhët e ushtrisë osmane kishte edhe shumë vullnetarë nga Kumanova e rrethi i saj si dhe nga Presheva e Gjilani. Ushtria serbe kishte pothuajse dy herë më shumë ushtarë, pastaj në çastin e fillimit të luftës serbët kishin zënë pozicionet më të mira. Ushtria Osmane nuk zuri pozicione të përshtatshme për luftë, nuk ishte e përgatitur, i mungonte ushqimi, disiplina etj. Ahmet Hamdi, pjesëmarrës i këtyre ngjarjeve, shkruante se komanda turke (osmane) gaboi kur zgjodhi këtë qendër për t'u mbrojtur nga sulmet serbe, sepse Kumanova nuk ofronte kushte të nevojshme ushtarako-strategjike për mbrojtje. Përkundër kësaj, për komandën serbe ky vend ishte i rëndësishëm dhe i përshtatshëm sepse nëpërmjet Kumanovës ajo shihte t'i nxirrte forcat e saj nga Vranja në Shkup për të vazhduar pushtimet më tej në drejtim të jugut dhe bregdetit shqiptar. Në ditën e parë të betejës (23 tetor), ushtria osmane, edhe pse ishte në epërsi ushtarake, nuk arriti t'i zbrapsë forcat serbe, ndërsa në ditën e dytë (24 gusht) ushtria serbe kaloi në epërsi dhe ushtria osmane u thye përfundimisht.

Të dhënat dokumentare dëshmojnë se në betejën e Kumanovës luftuan me trimëri të rrallë më shumë se 4.000 vullnetarë shqiptarë. Ndonëse u tradhtuan nga komanda osmane, këta arritën të gozhdonin forcat serbe gjatë gjithë vijës së frontit dhe shumica e tyre duke luftuar heroikisht ranë trimërisht në fushën e luftës në mbrojtje të trojeve të tyre amtare, stërgjyshore. Falë epërsisë numerike dhe në armatime të ushtrisë serbe dhe shturjes së ushtrisë osmane, serbët mund të thyenin edhe këtë vijë të frontit duke hapur rrugën drejt Shkupit dhe Manastirit. Më 26 tetor forcat e Armatës së parë serbe e pushtuan Shkupin, pa luftë. Mbeturinat e ushtrisë osmane të shthurura përfundimisht, u larguan në panik drejt jugut, drejt bregdetit të Egeut. Me pushtimin e Shkupit përfundoi faza e parë e Luftës ballkanike. Periudha e dytë ishte ajo e luftës për pushtimin e territoreve shqiptare në pjesën perëndimore të vilajetit të Kosovës, në vilajetin e Manastirit, të Shkodrës dhe të Janinës.¹³

Si në betejën e Kumanovës, ashtu edhe në luftërat tjera të trevës së Karadakut, shqiptarët luftuan me trimëri të madhe për ta mbrojtur atdheun e tyre, tokën e vetë amtare, duke u lënë të vetëm para agresorëve serbë. Me qëndresën që u bëri pushtuesve serbë në tetor të vitit 1912, popullsia e trevës së Karadakut dhe e mbarë të vilajetit të Kosovës, mbrojtë jo vetëm trojet e saj të lindjes, por mbarë Shqipërinë. Në luftimet që u zhvilluan në Karadak, në rrethinë dhe në qytetin e Gjilanit, në Ferizaj, në betejën e Kumanovës dhe në rrethet e Shkupit e kudo shqiptarët e kësaj treve, edhe pse nuk arritën të ndalin përfundimisht ushtrinë e

¹³ HHSt,A,PA,A,Shkup,8 tetor 1912,Nr.67.Shih edhe kujtimet e kapitenit Ahmet Hamdi për Luftën Ballkanike dhe shqiptarët.Si duhet të jetë shteti shqiptar,Orhanie,1920.Cituar sipas „Gjurmime albanologjike„,Serija historike,Prishtinë,Nr.15,1985,f.315.Xh. Shala, Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1912-1918, Prishtinë,1990, f.54-55.B.Ratkoviq,punim i përm.,f.333467,809.,„Politika„,Beograd, 13 tetor 1912.,Vardar,,Shkup,Nr.79,26 tetor 1912.Pasha Zeqir,Kujtimet e mija për Luftën Ballkanike,përkthim,AIH,Tiranë,d.A-IV,89,f.5.Çakmak Fevzi,Kujtime nga Lufta Ballkanike.Nga libri;Si u humb Rumelia Perendimore.Përkthim,AIH,Tiranë,d.AIH,A,IV,30,f.44-45.,„Liri e Shqipërisë„,Nr.59,Sofje,23 vjeshtë e dytë,1912.Boucancille,La guerre Ballkanique 1912-1913,Paris,1914,f.105.

agresorëve serbë, i shkaktuan asaj humbje të konsiderueshme dhe ia ngadalësuan marshimin drejt Shqipërisë perëndimore dhe bregdetare. Kështu shqiptarët e Karadakut dhanë një kontribut tjetër të çmuar, u dhanë mundësi dhe kohë atdhetarëve shqiptarë, të kryesuar nga Ismail Qemali, të përgatisnin e të mbledhnin Kuvendin e Vlorës dhe të shpallnin Pavarësinë e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912. Kosova dhe treva e saj e Karadakut, ndonëse qenë në kushte të pushtimit serb, u përfaqësuan nga Sali Gjuka, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica dhe Durmish Presheva. Kështu edhe treva e Karadakut, ndonëse në skaj të botës shqiptare, dha një kontribut të çmueshëm në ngritjen e Flamurit dhe në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

ZEQIRJA IDRIZI
FAHREDIN SHABANI

KONTRIBUTI I TAJAR BEJ TETOVËS PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE SHQIPTARE

Përpyekjet e qarqeve politike shqiptare për të siguruar aleatë në grupin e shteteve evropiane dhe të atyre ballkanike nuk dhanë fryt, kur edhe përçarjet për një aleancë me lëvizjen bullgare-maqedone (vërhoviste) nuk gjetën mbështetje në Sofje. Udhëheqësit e kryengritjes u përpoqën të shfrytëzonin, jo pa sukses, luftën politike për pushtet ndërmjet xhonturqve e kundërshtarëve të tyre politikë. Kjo nuk ishte e lehtë të arrihej dhe përbënte një çështje mjaft delikate, sepse mbarte pasoja komprometuese, të rrezikshme për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.¹

Komitetet shqiptare zhvilluan midis ushtarëve dhe sidomos midis oficerëve të trupave osmane një agjitacion të dendur kundër Komitetit “Bashkim e Përparim”. Në këto kushte nisi bashkëpunimi me shoqëritë e fshehta, që vepronin në radhët e ushtrisë osmane dhe që drejtoheshin nga “Grupi i oficerëve shpëtimtarë” (“Halasçar zabitan gurubu”), si dhe me partinë opozitare “Hyrriet ve ittilaf” (“Liri dhe Marrëveshje”). Në Rumeli pothuajse të gjithë oficerët shqiptarë ishin pjesëtarë ose simpatizantë të “Grupit të oficerëve shpëtimtarë”.² Në gjysmën e qershorit në garnizonet ushtarake të Manastirit u përhap një trakt i cili mbante emrin “Partia për Shpëtimin e Atdheut”, në të cilin parashtröheshin kërkesat programatike për përmbymbjen e qeverisë, shpartallimin e komitetit xhonturk, dhe depolitizimin e ushtrisë.³

Kryengritja shqiptare ndikoi nga ana e saj, në çorientimin e paralizimin e ushtrisë, që u shoqërua me dezertimin e ushtarëve dhe të oficerëve, madje edhe me revoltat e tyre kundër qeverisë xhonturke. Më 21 qershor të vitit 1912 një grup oficerësh e ushtarësh (8 oficer dhe 140 ushtarë), të batalionit të parë të regjimentit të 49-të, të këmbësorisë, të udhëhequr nga oficeri shqiptar Tajar Tetova (Deralla Z.I.), i njohur

¹ Historia e Popullit Shqiptar II, Tiranë, 2002, f.473.

² Po aty

³ AIHT, Vj-22-17-1761, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, Nr. 67, dt. 29 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

për ndihmesën e madhe që kishte dhënë në fitoren e Revolucionit Xhonturk (1908), Në raportin e ambasadorit austro-hungarez, Kral thuhet: Se Tajar bej Tetova ka qenë i shquar qysh më parë në çështjen nacionale dhe se për rebelizëm kishte nxitur kryesisht tanë bashkatdhetarët e tij, në veprimtarinë e tij që kishte qëllime nacionale.⁴ Së bashku me Tajar Tetovën dolën në mal edhe oficerë të tjerë shqiptarë, si Xhelal Preveza, Kasem Kolonja, Melek Kolonja (Frashri), Ahmet Bejtaga (Kavaja) e të tjerë.⁵ Figura qendrore e lëvizjes së oficerëve, Tajar bej Tetova do të bëhet objekt raportesh, analizash e shkrimesh të përfaqësuesve diplomatikë dhe në faqet e shtypit të kohës, por edhe në opinionin e brendshëm. Lidhur me këtë figurë do të shprehen mendime të ndryshme lidhur me rolin dhe përcaktimet e tij. Në dokumentet Bullgare thuhet se më 8 korrik 1912 “Agjitacioni i krerëve shqiptarë të ngritur, për të tërhequr oficerët dhe ushtarët shqiptarë të lëvizjes vazhdon. Po këtë natë, nga garnizoni i këtushëm kanë ikur tre oficerë dhe pesëdhjetë ushtarë shqiptarë. Kjo ngjarje ka shkaktuar një alarm të madh në qarqet zyrtare”.⁶

Oficerët dhe ushtarët e ikur janë nga tabori i parë i regjimentit 4të, i vendosur në kamp në fshatrat Bistricë dhe Zllokuqan afër qytetit (Manastir). Një nga oficerët të ikur është i njohuri kapiten Tajar Beu,⁷ përkrahës i “Marrëveshjes Liberale”, i cili ka qenë i ngarkuar me detyrën t’i zbulojë “Klubi i Itilafçive” në qytet.

Për ikjen nga ushtria turke është vendosur në një mbledhje, të cilën oficerët në fjalë e kanë mbajtur një ditë përpara, në hotelin “Liria”.⁸ Ushtarët e ikur, duke u nisur janë përshëndetur shumë përzemërsisht me shokët e tyre nga tabori, të cilët kanë dhënë fjalën, se nuk do t’i ndjekin.

Këto agjitacione midis shqiptarëve në ushtri, sipas konsullit bullgar bëhen nga emisarë të Lëvizjes Shqiptare. Ajo që është enigmatike, se ata gjejnë përkrahjen edhe te partia e re “ Hefizi vatan” (Shpëtimtarët e Atdheut), e përbërë kryesisht nga ushtarakë disidentë të Komitetit “Itihade ve Tereki”, e cila ka dhënë për detyrë dështimin e partisë “Itihade ve Tereki” bashkë me kabinetin.⁹ Lëvizja e oficerëve, sikurse edhe partitë politike dhe grupet e tjera opozitare në krye me partinë “Liri e marrëveshje” (Itihat ve terakki), ishin të interesuara të bashkëpunonin me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, që nga shpërthimi i kryengritjes së armatosur, për ta shfrytëzuar atë për qëllimet e tyre programore. Burimet që kemi arritur t’i konsultojmë provojnë se dalja në shesh ose fuqizimi i Lëvizjes së oficerëve ndodhi në kohën kur kryengritja e armatosur në vilajetin e Kosovës dhe në vilajetet tjera

⁴ AIHT, Vj-22-2-290, Raport i konsullit austro-hungarez nga Selaniku mbi Dezertimin e oficerëve ,dt. 25 qershor 1912, Kral Nr.101, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

⁵ Historia e Popullit Shqiptar II, Tiranë, 2002, f.474; AIH, Vj-22-2-290, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, No 60, Halla,dt. 25 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

⁶ AIHT, Korespondencë No 6, Raporte, Letra, Telegrame të shifruara nga Konsullata tregtare në Selanik, Shkup, Bitola, ambasada në Stamboll të dërguara të gjithë ambasadave jashtë shtetit.

⁷ AIHT, Rraport i konsullit Bullgar në Manastir No 388, 10 qershor 1912, dërguar Zotit Iv. EV. Geshev, Kryeministër dhe Ministër i punëve të Jashtme dhe kulteve në Sofje; Reshat Nexhipi, Shtypja dhe rezistenca e shqiptare në Maqedoni nëpër shekuj, Manastir,1996,f.269.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty

tashmë kishin shënuar suksese të konsiderueshme dhe kishte mbështetjen e pjesës dërmuese të shoqërisë shqiptare. Kryengritja shqiptare po gjente mbështetjen edhe të ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë, që kishin filluar t'i bashkoheshin kryengritjes së armatosur më parë. Dervish Hima, njëri nga drejtuesit kryesorë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në Vilajetin e Manastirit dhe të Janinës, thotë se me iniciativën e Komitetit të “Shoqërisë së Zezë” dhe të drejtuesve të Lëvizjes ushtarake, u organizua një takim në Stamboll, me 28 shkurt 1912. Në këtë takim, sipas tij morën pjesë Tajar Beu nga Garnizoni i Manastirit dhe Tahsin Beu nga Garnizoni i Edrenesë. Këta ishin dërguar nga disa shokë të tyre të grupit të Lëvizjes. Në takimin e fshehtë të Stambollit oficerët shprehën pakënaqësinë, në emër të shumë shokëve dhe ushtarëve ndaj despotizmit të Shefqet Mahmut Pashës, Ministrit të Luftës, që kishte bërë gjatë ekspeditës në Shqipëri. Po këtë ditë, gjithnjë sipas Dervish Himës, u arrit marrëveshje midis përfaqësuesve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe Lëvizjes Ushtarake, për aksione të përbashkëta, me synim rrëzimin e kabinetit xhonturk, shpërndarjen e parlamentit dhe organizimin e zgjedhjeve të reja.¹⁰ Më tepër burime provojnë se drejtues të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare përmes Lëvizjes ushtarake synonin jetësimin e kërkesave programatike të parashtruara prej kohësh. Ishte interesi i dyanshëm i dy lëvizjeve, për bashkëpunim dhe bashkëveprim kundër regjimit xhonturk. Në këtë kuadër nuk do të zgjidhej rastësisht Manastiri si qendër ndërlidhëse e këtyre dy lëvizjeve, dhe do të bëhej sipas një plani dhe strategjie të paramenduar mirë. Kjo u bë për arsye, se ky qytet përbënte kryeqendrën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Shqipërinë e mesme dhe jugore, i cili do të shndërrohet njëkohësisht në qendër kryesore të Lëvizjes ushtarake, ku kishte selinë Korparmata e VI, e ushtrisë osmane. Në gjysmën e qershorit në garnizonet ushtarake të Manastirit u përhap një pamflet që mbante emrin “Partia për Shpëtimin e atdheut”, në të cilin parashikoheshin kërkesat programatike për përmbysjen e Qeverisë, shpartallimin e Komitetit xhonturk dhe për depolitizimin e ushtrisë.¹¹

Tajar bej Tetova, kapiten në garnizonin e Tetovës, i cili kishte marrë pjesë aktive në revolucionin e Korrikut. Në viset shqiptare të Vilajetit të Manastirit,¹² do të vihej në krye të grupit të “Shpëtimtarëve të Atdheut” dhe protagonist kryesor i Lëvizjes në ushtri, i cili ishte atdhetar i shquar nga dera e Derallëve (Pashallarëve Tetovar). Ky që prej kohësh ishte i lidhur me krahun militant të oficerëve kundërshtarë, të politikës së komitetit “Bashkim e Përparim”, në krye me kolonel Sadik beu dhe Tahsin beun, ky i fundit personalitet me ndikim në qarqet e oficerëve të pakënaqur, të kryeqytetit të Perandorisë. Këta të dy ishin armiq të përbetuar të komitetit “Bashkim e Përparim”, kurse Tajar bej Tetova do të bëhet shtylla kryesore, e cila do të mbajë lidhjet kryesore midis Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe Lëvizjes

¹⁰ AIHT, Vj-22-6-644, D. Hima dhe çështja e dezertorëve oficer nga Manastiri, Janinë 21 korrik 1912; R. Abdyl, Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1911-1912, Libri 2, Prishtinë, 2004, f.269.

¹¹ AIHT, Vj-22-17-1761, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, nr.67, dt. 29 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë; Vj-22-2-294

¹² AIHT, (MPJ dhe e kulteve, Sofje), Raport i konsullit Bullgar në Manastir, 19 qershor 1912. Zotit Iv. Geshev, kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme dhe të Kulteve.

Ushtarake.¹³ Më 19 qershor 1912, konsulli bullgar njofton se Tajar beu, që dy ditë e këtej ka qenë me disa miq të tij në një fshat afër Korçës, ku ka pasur disa takime të fshehta me përparimtarë shqiptarë nga Korça, pastaj Tajari beu ka vazhduar për në Kolonjë, për të krijuar kontakte me udhëheqësit e atjeshëm të Lëvizjes.¹⁴ Menjëherë pas takimeve, të cilat Tajari i ka pasur me korçarë, ka ndodhur ikja e shumë patriotëve korçarë. Përveç shqiptarëve myslimanë me Lëvizjen janë bashkuar edhe shqiptarë krishterë, nga qarku i Korçës Pandeli Calis, Llambi Bibli, i cili ka marrë pjesë në Lëvizjen e vitit të kaluar, Themistokli Gërmenji dhe të tjerë.¹⁵ Tajar beu shpreson për një fitore të sigurt midis shqiptarëve të Kolonjës, ku ai ka pasur influencë, si aktivist i grushtit të korrikut, i cili i pari ka proklamuar Kushtetutën në këtë krahinë. Bashkë me këtë, për në Kolonjë janë nisur edhe bejlerët shqiptarë: Menduh beu Zavalani; Ferid beu dhe Qazim beu- dy të fundit nga familja e njohur Frashri. Ndërsa pjesa tjetër nga shokët e Tajar beut ndodhen në fshatrat malore të “Debërca”, Strugë.¹⁶

Konsulli austriak në Janinë, Bilinski njoftonte Vjenën se Tajar Tetova, D. Hima dhe nacionalistë të tjerë, synojnë të shfrytëzojnë gjendjen e krijuar për të organizuar edhe në Toskëri, një kryengritje të përgjithshme.¹⁷ Ndërsa Konsulli bullgar në Manastir bënte të ditur, se në gjysmën e qershorit ishte forcuar agjitacioni “ nga emisarët e Lëvizjes Shqiptare midis ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë për dezertimin e tyre dhe bashkimin me kryengritjen”.¹⁸ Tajar Beu në marrëveshje me Grupin e oficerëve të Manastirit dhe të qyteteve të tjera të Korparmatës VI, në gjysmën e qershorit do të vendosë të “fillojë aksionin e rebelimit”, kundër Qeverisë dhe Komitetit xhonturk. Nga kjo mund të konstatojmë, se tek Tajar beu dhe shokët e tij, të garnizonit të Manastirit ekzistonte një interesim i madh, për të bashkëpunuar me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Në prag të fillimit të aksionit, ai me disa oficerë ishte parë disa herë duke u takuar në hotelin “Liria” të Manastirit, pronë e vëllezërve Gërmenji.¹⁹ Ai në hotelin e përmendur, një ditë para arratisjes së tij në mal, ishte parë me pjesëtarë të LKSH-së.²⁰

Oficerët nga kompania e mitraljerëve-Tetovali Yuzbashi Tajar, toger Xhelal dhe një oficer i tretë, me 25 ushtarë, secili nga ata, duke marrë me vete nga dy pushkë-

¹³ Po aty; AIHT, Burime Vjeneze, Vj-22-20-1022, Raport i Konsullit Austro-hungarez me titull: Dezertimi i oficerëve dhe lidhja e tyre me Korpusin e gjashtë të Manastirit, Stamboll, 29 qershor 1912.

¹⁴ Po aty, Shtojcë sekrete No 421, ndaj numri-418, a-72-74.

¹⁵ Po aty, 418, a-72-74.

¹⁶ Po aty; AIH, Vj-22-17-1763

¹⁷ HHSt.A.PA.,A. Janinë, 21 korrik 1912, Ref. I, Cit. Sipas K. Prifti, Dervish Hima, Tiranë, 1993, f. 304-305.

¹⁸ AIHT, F. 176, op. 2 al 1317, Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimit të Bullgarisë, (Nenkol. T. Nedelkov), nr. 428, dt. 22 qershor 1912.

¹⁹ R. Abdyl, Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 dhe Lëvizjae..., Kosova 24/25.Prishtinë, 2003, f.89-90.

²⁰ AIHT, Raport i konsullit bullgar nga Manastiri nr. 388, dt. 10 (23) qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimit në Sofje.

mauzerë.²¹ Oficerët paraprakisht kanë marrë të gjitha vidhet e topave, dy mitraloz si dhe nëntë (9-të) ngarkesa me fishekë.²²

Të gjithë të ikurit kanë kaluar Drinin dhe kanë shkuar tek i quajhuri Mersim Dema²³, nga fshati Honesh, Malësia e Dibrës. Arratisja e Tajar Beut natën midis 21 dhe 22 qershorit e dha sinjalin për fillimin e rebelimit të tyre. Sipas konsullit austro-hungarez në Manastir, deri më 25 qershor u arratisën 25 oficerë dhe 469 ushtarë shqiptarë nga Korparmata VI e Manastirit.²⁴ Po në këtë kohë dezertuan 10 ushtarë nga garnizoni i Tetovës, të cilët iu bashkuan kryengritësve.²⁵ Sipas saj vihet në dukje, se procesi i dezertimit të oficerëve dhe ushtarëve shqiptarë, u shoqërua me dezertimin e nëpunësve shqiptarë të administratës osmane dhe bashkimin e tyre me kryengritësit shqiptarë.

Oficerët dhe ushtarët e dezertuar nga garnizoni i Korparmata VI, shkuan në tri drejtime: grupi i parë në drejtim të Malësisë së Dibrës.²⁶ Grupi i dytë në krye me Tajar bej Tetovën, shkoi në drejtim të Korçës, dhe grupi i tretë fillimisht i sistemuar në rrethinën e Resnjës, ku më pas kaloi në krahinën e Demirhisarit dhe Strugës, me synim bashkëpunimi me kryengritësit.²⁷ Mirëpo, deri në fillim të korrikut, dy herë dështoi ekspedita, për kapjen e Tajar bej Tetovës dhe oficerëve të tjerë, sepse njësitë e dërguara për këtë qëllim, nuk pranorin të hynin në luftë me ta.²⁸ Po ashtu, kanë dështuar edhe bisedimet e delegacionit qeveritar me Tajar Beun në përpjekje për ta bindur të hiqte dorë nga synimi i tij dhe të kthehej në njësitin e tij në Manastir.²⁹ Masa të rrepta për ndjekjen e dezertorëve, të cilët cilësoheshin si

²¹ AIHT, Raport i Konsullit Bullgar në Shkup No 528, Geshev, MPJK, Sofje, kopje e dërguar në Stamboll dhe Selanik.

²² Po aty.

²³ AIHT, Vj-22-2-290, Raport i konsullit austro-hungarez Halla nga Manastiri, No 60, dt. 25 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Më tej në raport thuhet: "Udhëheqës kryesor, i cili disponon me katër pesë mijë persona të armatosur".

²⁴ AIHT, Vj-22-2-287, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, nr. 120, dt. 25 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë; AIHT, F. 176, aop. 2, ae 1317, Raport i Konsullit bullgar nënkol. T. Nedkov, në manastir, No 428, dt. 22 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimit në Sofje.

²⁵ R. Abdyl, Kryengritja e Përgjithshme e vitit 1912 dhe Lëvizjae..., Kosova 24/25.Prishtinë, 2003, f.92.

²⁶ AIHT, Raport i konsullit bullgar nga Manastiri, nr.438, dt 25 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimit në Sofje; AIH, Vj-22-2-290, Raport i konsullit austro-hungarez Halla nga Manastiri, No 60, dt. 25 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Më tej thuhet: "Grupi i parë iu bashkua kryengritësve shqiptarë në homesh nën udhëhjen e Mersim agë Demës, i cili në këtë kohë po veoronte në viset e malësisë së Dibrës së Poshtme në krye të 4. 500 kryengritësve shqiptarë". Me rebelët e Dibrës janë bashkuar edhe fisnikët Dibranë Sadulla Strazimiri, Ismail Efendiu, Eqrem Cami, Shyqyri bej, Eliaz Pasha Zadea, Qamil Efendiu dhe Izet beu.

²⁷ Po aty, Në raportin e konsullit bullgar nga Manastiri, nr.438, dt 25 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimit në Sofje më tej thuhet: "Tajar beu vazhdon me sukses propagandën në Shqipërinë e Jugut në Vilajetin e Janinës, dhe se qeveria (Osmane Z.I) ndodhet para vështirësive të mëdha".

²⁸ Po aty.

²⁹ AIHT, Telegram i atashut ushtarak I P dhe M në Stamboll 27 qershor 1912, me titull: Lëvizja e Oficerëve në Manastir, Vj-22-6-681 ndër të tjera thuhet se :Lëvizja në Manastir vazhdon duke qenë thjesht shqiptare.; AIHT, F, 176, op. 2, ae 1317, Telegram i shifruar i konsullit bullgar nga Manastiri, nr. i daljes 431 dhe me numër regjistrimi 2228, dt. 23 qershor 1912 marë më 24 qershor 1912, në

tradhtarë të atdheut, kërkoi edhe Ministri i Luftës, Shefqet Mahmut Pasha, i cili dërgoi një telegram në të gjitha njësitë ushtarake, duke kërkuar që oficerët ta dënonin këtë akt të kolegëve të tyre. Sipas njoftimeve të konsujve bullgar dhe atyre austro-hungarez gati 70%, e oficerëve të Edrenesë mbështetën Lëvizjen, në radhët e oficerëve dhe ushtarëve të manastirit.³⁰ Konsulli austro-hungarez në Selanik pohonte, se kapiten Tajar bej Tetova, ka qenë shquar qysh më parë në çështje nacionale dhe se për “rebelizëm kishte nxitur tërë bashkatdhetarët e tij”, dhe se veprimtaria e tij kishte qëllime nacionale.³¹ Prej kohësh ekzistonte një bashkëpunim midis “Shqiptarëve dhe Lidhjes së fshehtë” të oficerëve, dhe se Tajar bej Tetova ishte një atdhetar shqiptar.³² Mirëpo në letrën që la para se të arratisesh, kapiten Tajar bej Tetova, të cilën ua drejtonte shokëve të tij oficerë të garnizonit, u bë objekt diskutimesh, sepse ai me anë të kësaj kundërshtonte pavarësinë e Shqipërisë.³³ Tajar Beu këtë nuk e pranoi ta bënte me arsyetim që të mos komprometohej Lëvizja Ushtarake dhe për të mos dështuar objektivi i rrëzimit të Komitetit xhonturk, si fazë e parë për arritjen e synimeve programatike të LKSH-së.³⁴ Sipas saj mund të konkludojmë; se ky ishte taktizim i tij ndaj drejtuesve të tjerë të Lëvizjes së oficerëve, sepse ai sikurse një pjesë e oficerëve shqiptarë, ishte nxitur nga motivi kombëtar, për t’u rreshtuar në radhët e Lëvizjes Ushtarake.

telegramin Shtues me No 436 thuht: “Oficerë kanë deklaruar, se ata nuk mundë të bëjnë asnjë kompromis me këdo që të jetë, sepse shokët e tyre të ikur janë të vendosur të mos ndërpritet lufta, derisa nuk realizohen plotësisht të gjitha kërkesat e tyre”.

³⁰ AIHT, Raport i konsullit bullgar nga Andrinopoli, No 734, dt. 18 qershor 1912, sekret- Personalisht, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimit në Sofje; AIH, Vj-22-6-681, Ku më tej thuhet se: “Nuk egziston besim në trupat e korpusit të gjashtë, edhe në Kosovë operacioni ka ngelur për mosbesim, bile vetë inspektorati i ushtrisë në Selanik simpatizon dezertetë”.

³¹ AIHT, Vj-22-2-289, Raport i konsullit austro-hungarez Kral nga Selaniku, nr. 101, dt. 25 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

³² Po aty, Vj 22-2-294, Raport i konsullit austro-hungarez, Palavaçini, No 209, Dezertimi i 71 ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë nga Dibra, Përlepi dhe Manastiri përshkak të kryengritjes shqiptare, Jenikoj, 25 qershor 1912.

³³ AIHT, Raport i konsullit bullgar nga Manastiri, No 413, dt. 17 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Besimit në Sofje. Ndër të tjera në Letrën e Tajar bej Tetovës thuhet: “*Të nderuar shokë ushtarakë: Hapet fjalë, se unë dhe shokët e mi, bijtë e ushtrisë, kemi ndjekur qëllime personale dhe se disa njerëz po përpiqen të krijojnë përçarje në ushtri. Beto hem në emrin e shejtë të Zotit, se ne gjithmonë mallkojmë ata, që mbajnë brenda vehtes këtë mendim dhe do të lutesha të gjithë miqtë e mi ushtarakë dhe ata nga ana e tyre, gjithmonë të mallkojnë njerëzit e tillë dhe të mos durojnë mes tyre. Sot Atëdheu jonë kërcënohet. Ata që ndjekin qëllime personale dhe të tjera, veç se duhet të ngjallin zemërimin e Zotit mbi vete, duhet të dëbohen dhe përzihen nga bijtë e dashur të këtij vendit. Qëllimi i të gjithë neve është i njëjtë- shpëtimi i Atëdheut dhe lumturi për popullin. Ja përse të gjithë vllëzërit tanë të respektuar, të solidarizuar dhe të bashkuar, duke respektuar komandantët e tyre, duhet të veprojnë, pa haruar njëkohësisht dhe armiqtë përreth. Këte ne presim nga dashuria dhe bujaria e tyre. Haxhi Ali, i cili për grindje personale ka vvarë mikun e vet dhe në këte mënyrë ka nxitur opinionin shoqëror, ashtu dhe ata q’i gjajnë, ne lutemi që të gjithë shokët tanë të mos durojnë njerëz të tillë në ushtri, ashtu siç ndodhi këtu.*

Dërgojmë konsideratat tona të gjithë shokëve dhe lutemi Zotit për shpëtimin e Atëdheut tonë. (firmosur) TAJAR.

³⁴ AIHT, Vj-22-2-289, Raport i konsullit austro-hungarez nga Selaniku, nr. 101, dt. 25 qershor 1912, dërgar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë.

Njohësit e mirë të Tajar bej Tetovës pohojnë, se ai mbi të gjitha ishte atdhetar shqiptar. Njëri ndër ta është: Eqrem bej Vlora, i cili pohon se Tajar Beu ishte për një jetë të mëvetëshme, të shqiptarëve në kuadër të Perandorisë Osmane.³⁵ Ndonëse dështoi arritja e marrëveshjes, së plotë midis komiteteve shqiptare në një anë, dhe Lëvizjes Ushtarake dhe opozitës parlamentare, në anën tjetër, rreth programit të përbashkët, sepse kjo e fundit refuzonte kërkesën për autonominë e Shqipërisë.³⁶ Dalja në skenë e kësaj lëvizjeje përbënte një ndihmesë, për Kryengritjen shqiptare në një fazë të caktuar. Dezertimi i kapitenit Tajar bej Tetovës, bashkë me oficerët e tjerë dhe ushtarët me shumicë shqiptarë. Sipas burimeve diplomatike të kohës,³⁷ përbënte një ngjarje me rëndësi për Lëvizjen kryengritëse, në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut. Në shtimin e radhëve të kryengritësve, do të shprehet edhe deklarata e kapiten Tajar bej Tetovës, në të cilën thuhet "Në qoftë se Lëvizja Ushtarake do të dështonte, oficerët shqiptarë për arsye kombëtare do të vazhdojnë, të bëjnë kundërshtime (luftë) dhe do të organizojnë kryengritjen e përgjithshme". Në të njëjtën kohë, oficerët u dërgonin letra (bënin thirrje) kryepleqve të katundeve, që popullsia të bashkohej me ta.³⁸ Lëvizja ushtarake i dha Lëvizjes Kombëtare shqiptare në Shqipërinë e Jugut, një nxitje të mëtejshme.³⁹ E frikësuar nga masivizimi i Lëvizjes kryengritëse, qeveria osmane ndërmoi masa për shuarjen e saj, duke emëruar Xhavit Pashën që të ndjek dezertorët dhe të shtyp Kryengritjen, në Shqipërinë e Mesme dhe Jugore. Për mizoritë e tij Gjenerali Xhavit Pasha ishte i njohur gjatë ekspeditës së vitit 1909, detyra e tij ishte ndjekja e ushtarakëve dhe kryengritësve shqiptarë.⁴⁰ Në raportin e konsullit bullgar, po ashtu raportohet se njësitet nga Rumelia nuk pranin të hynin në luftë, kundër oficerëve dhe ushtarëve të "rebeluar" në vend të tyre u sollën forca të reja nga Azia e Vogël.⁴¹ Njëkohësisht mësojmë se edhe përpjekjet e gjeneralit osman (Xhavit Pasha), për ta bindë Tajar bej Tetovën, që të kthehet në Manastir

³⁵ Më tej thuhet: Kapiten Tajar bej Tetova ishte djali i spahi (pra i shtresës së fisnikërisë fshatare) Xhaferrit, e ëma rridhte nga dera e Derrallëve, Shtëpi e njohur kjo me ndikim të madh në Kalkandele (Tetovë Z.I). Shokët e tij në këtë grusht ushtarak ishin krejt shqiptar: nipi i tij Tahsin Deralla, kapiten Mymtazi nga Manastiri, toger Nuredini nga Dibra,, toger Xhelali nga Perveza, togerët Qazim dhe Ismaili nga Kolonja, toger Meleku nga Frashëri dhe të tjerë. Bashkë me ta edhe 150 ushtarë, këta oficerë të rinj, që po therorizoheshin për të mirën e atdhet të tyre, Shqipërisë, duheshin admiruar. Eqrem bej Vlora, Kujtime, 1885-1925, Tiranë, 2003, f. 265.

³⁶ Z. Cana, Lëvizja Kombëtare Shqip..., f. 235.

³⁷ Me kapiten Tajar bej Tetovën u arratisën 25 oficerë dhe 469 ushtarë shqiptarë, prej tyre 5 oficer dhe 180 ushtarë ishin nga Manastiri, nga Perlepi 5 oficer dhe 15 ushtarë, nga Resnja 7 oficer dhe 21 ushtarë, nga Ohri 3 oficer dhe 25 ushtarë, nga Dibra 5 oficer dhe 150 ushtarë, Kosova 10 ushtarak, Korça 28 ushtarë, Luma 40 ushtarë. (AIH, Vj-22-2-290, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, No 60, Halla, dt. 25 qershor 1912, dërguar Ministrisë së punëve të Jashtme në Vjenë).

³⁸ AIHT, Vj-22-1-112, Raport i konsullit austro-hungarez, Bilinski, nga Janina, No 43, dt. 15 korrik 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ AIHT, F. 176, op. 2, ae 1317, Sekrete, Raport i konsullit bullgar nga Manastiri, No 460, dt. 3 korrik 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të besimit në Sofje.

⁴¹ Krah. F. 176, op. 2, ae 1317, Raport i konsullit bullgar nga Selaniku, nr 525 shtojcë e raportit 522, dt. 18 qershor 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimit në Sofje; AIHT, Vj -22-7-758, Pergatitja e kryengritjes në Tepelenë, Telegram i konsullit austro-hungarez Bilinski, No 14, nga Janina, 2 korrik 1912.

dështuan, por edhe i dërguari special i tij kapiten Hamza Beu , nuk ia doli ta bindë prijësin e oficerëve dhe ushtarëve të “rebeluar” të kthehej në Manastir, edhe përkundër premtimit se ishte i amnistuar. Përpyekja dështoi sipas Hamza Beut, i cili duke folur në emër të Tajar Beut tha: se lëvizja e tyre është shkaktuar nga politika, e partisë në pushtet “Itthade ve Tereki”, që s’mer parasysh asgjë, në saj të cilës vendi është hedhur në prova të tmerrshme të reja; se lufta e tyre është e lartë, patriotike dhe se ata nuk do të tërhiqen, derisa nuk do të shkojnë në largimin e të gjitha atyre shkaqeve, të cilët kanë krijuar situatën e sotme pa rrugëdalje. Lufta jonë, ka vazhduar Hamza Efendi, shprehet Tajar bej Tetova, është më vete dhe është jashtë çdo lloj ndikimi nga jashtë. Aq më pak ajo mund të jetë e inspiruar nga drejtuesit e Lëvizjes Shqiptare, kur ne, në mënyrë më energjike kemi dënuar separatizmin e tyre politik, dhe në qoftë se disa projekte të saj i vendosin në kontakt me këtë lëvizje, kjo rrjedh nga fakti, se dhe në rastin e parë dhe në të dytin, objekti i pakënaqësisë është partia në pushtet”Itthade ve Tereki”. Këto janë të vetmet pika, të cilat afrojnë luftën tonë me nacionalistët shqiptarë”, ka përfunduar Hamza Efendi.⁴² Nga ky takim mund të konkludojmë se; gjithë kjo erdh si rrjedhojë e ndikimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në Lëvizjen e oficerëve dhe të ushtrisë. Ndërkohë kryengritja e armatosur në të tri vilajetet gjatë korrikut, mori përmasa të kryengritjes së përgjithshme, e cila do të rezultojë me çlirimin e disa viseve të vilajetit të Kosovës. Ndërkaq, nga vilajeti i Kosovës në raportin e datës 5 korrik 1912, Fadil Pasha nga Mitrovica lajmëronte për mosbindjen e trupave dhe refuzimin e tyre të bëjnë ndjekje të mëtejshme kundër arnautëve (shqiptarëve). Po kështu, u veprua në Shkup dhe në Gjakovë. Ai kërkonte me urgjencë zëvendësimin e tyre, me forca tjera nga Anadoli.⁴³

Në gjysmën e korrikut 1912, vazhdoi aktiviteti i veprimtarëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe aksionet e çetave kryengritëse, në bashkëpunim me Tajar bej Tetovën dhe oficerët e tjerë, për organizimin e Kryengritjes së përgjithshme në Vilajetin e Janinës. Në këtë kohë një delegacion i oficerëve, në krye me Tajar bej Tetovën po qëndronte në Frashër, në Teqenë e Baba Abedinit, në përpjekje për të përfutur popullatën, për lëvizje nga autoriteti i tij prej atdhetari. Numri i ushtarëve në fillim nga 220 u rrit në 550, me ardhjen e Sali Butkës me 60 persona, si dhe të disa prijësve të tjerë.⁴⁴ Tajar bej Tetova më 4 gusht 1912, me forcat e tij do t’i afrohej Elbasanit dhe me anë të një telegrami i është kërcënuar Vezirit të Madh, duke kërkuar shpërndarjen e parlamentit.⁴⁵

Ndërkohë me këmbënguljen e drejtuesve të Kryengritjes, në krye me Hasan Prishtinën, më 5 gusht, do të pasojë dekreti perandorak për shpërndarjen e

⁴² AIHT, F. 176, op. 2, ae 1317, Raport i konsullit bullgar nga Manastiri, Kopje nga T.SH. 6/VII/ 912, No i përgjithshëm të daljes 1112, T.A. 2342, 2345, 10 korrik 1912.

⁴³ Refuzimi i oficerëve të Vilajetit të Kosovës, në Shkup dhe në Mitrovicë për të Luftuar kundër kryengritësve. Vj-22-3-343, Raport i konsullit austro-hungarez nga Selaniku, 10 korrik 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

⁴⁴ AIHT, Vj-22-1-112, Raport i konsullit austro-hungarez nga Janina, No 43, dt. 15 korrik 1912, dërguar ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

⁴⁵ AIHT, Vj- 22-1 19, Raport i konsullit austro-hungarez nga Selaniku, No 119, dt. 5 gusht 1912

parlamentit.⁴⁶ Pas përfundimit të bisedimeve shqiptaro-osmane dhe arritjes së marrëveshjes, për aprovimin e 12 nga 14 kërkesat e shtruara të delegacionit shqiptar dhe hyrja në fuqi e dekretit për amnisti, krahas shpërndarjes së kryengritësve nëpër shtëpitë e tyre.⁴⁷ U mirëprit edhe nga oficerët dhe ushtarët e arratisur, të cilët u kthyen nëpër kazermat e tyre. Tajar bej Tetova me 4 oficerë të lartë dhe 35 nënoficerë, shkuan në Manastir.⁴⁸ Ndërsa Konsulli bullgar nga Manastiri informon, se Tajar bej Tetova më 20 gusht 1912, në hotelin “Liria” ka bërë deklaratë, se ai del jashtë radhëve të Lidhjes Ushtarake “Hevzi Vatan”, ku me rrëzimin e ish kabinetit dhe me shpërndarjen e dhomës “Ittihadxhije”, thotë: “kam përfunduar misionin dhe i dorëzohem plotësisht, t’i shërbejë kauzës Kombëtare Shqiptare”.⁴⁹ Më tej vazhdon raporti, se Tajar bej Tetova përgatitet të niset për Tetovë, qytetin e lindjes së tij.⁵⁰

Siç del nga mjaft dokumente, letra e letërkëmbime, që i përkasin pranverës së vitit 1913, e sidomos muajit maj, Tajar bej Tetova i përkushtohet me këmbëngulje kësaj pune të madhe, ai u gjet në komisionin e veçantë që e propozoi Vehbi Dibra, dhe u dërgua në Dibër e Mat, për organizimin e pushtetit lokal në zonat, që ishin çliruar nga serbët.⁵¹ Në mes tjerash kërkohej që Dibra dhe krahina e Matit, të lidhen me Qeverinë e Përkohshme sa më shpejt.⁵²

Po ashtu Tajar bej Tetovën e përmend Tafil Boletini më 21.01.1916, si të internuar në Podgoricë dhe shton: Duke shkuar rrugës, pamë se prej shtëpisë së Sokol Bacit, ku kishin qenë vendosur një grup shqiptarë të internuar, doli kapiten Tajar Tetova. Mbasi u përqaftua tha: “Shyqyr që u poqëm. Kur ju pamë, shumë u gëzuam, se kemi qenë në merak për juve, qysh kur ju ndanë prej nesh”. I them turqisht: “Këta po na thonë, do të na marrin me veti për Itali. “jo, more, shpëtuam. Çfarë Italie, - thotë. Austriakët kanë nxënë Taraboshin, kanë kaluar Bunën e kanë dalë në Bushat. Këta s’kanë nga të shkojnë as vetë. Kanë vendos të dorëzohen brenda 2-3 ditësh.

Kapitenët Tajar bej Tetova e Ibrahim Prishtina nga shtëpia e Sokol Bacit vrapojnë e i thonë “Jonuz, ndal, çdo andej” Jonuzi, dëgjova se i kanë zënë pritën Isa Boletinit,

⁴⁶ AIHT, Vj-22-18-18877, Rënia e qeverisë- marshimi i Shqiptarëve drejt Shkupit, raport i konsullit austro-hungarez nga Ferizaj, 6 gusht 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

⁴⁷ Vj-22-20-2024, Raport i konsullit austro-hungarez Heimroth-Bertholdi nga Shkupi, no 60, 21 gusht 1912.

⁴⁸ Vj-22-68, “Jehona e pranimit të kërkesave të H. Prishtinës në Manastir dhe në Sanxhakun e Manastirit”, Raport i konsullit austro-hungarez Halla nga Manastiri, No 103, dt. 24 gusht 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

⁴⁹ AIHT, F. 176, op. 2, ae 1317, Raport i konsullit bullgar nga Manastiri, No 628 shtojcë, Ndaj No 618, dt 24 gusht 1912, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimit në Sofje, Më tej thuhet: Në këtë mbledhje kanë diskutuar për çështjen e amnestisë si dhe është marrë vendimi, që një pjesë e bashkëatdhetarëve të tyre të ngritur, të mbeten në vendet e tyre derisa nuk do të merren të gjitha provat nga pala turke, për zbatimin serioz të reformave. Ndërsa Mersim Mema, drejtuesi themelor i Lëvizjes në Shqipërinë e Mesme, i cili aktualisht ndodhet në krye të 300 vetëve, në Martanesh dhe krerët shqipatr Sali Butka dhe Ali Farkami u përcaktuan të rinë me njerëzit e tyre nëpër male dhe të presin zhvillimin e ngjarjeve.

⁵⁰ Po aty

⁵¹ Qazim Xhelili, Vehbi Dibra personalitet dhe veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare, Tiranë, 1998, f. 112.

⁵² Po aty.

te ura prandaj do të kaloj ndërsa Xhandarët këta të dy, me dibçika pushke i futin në një shpij dhe u lënë një roje në derë. Më 23.01.1916, malazezët vranë Isa Boletinin dhe shtatë të tjerë. Ndërsa në varrim, më 25.01.1916 morën pjesë të gjithë shqiptarët e internuar në Podgoricë.⁵³

Për kontributin e Tajar bej Tetovës flet edhe vjersha e poshtëshënuar të cilën ia ka thurur Sali Butka në shenjë respekti ndaj tij:⁵⁴

Mynxyrë e madhe

Ç'mënxyrë e madhe që na helmoi!

Na la Tajari na shkretoi.

Oh, trimi urtë, oh shkoi për jetë,

Qani o shokë, se na la shkretë.

Vdiq punëtori, shkoi punëmbari,

Trimi vërtetë s'vjen si Tajari.

Qani, vajtoni, o shqiptarë,

Me helm në zemër për atdhetarë.

Krahu i djathtë i kombësisë,

Na la për jetë dielën e zisë.

⁵³ E Para pushkë nga malazezët ka qenë e Pero Buriçit nga Vasoviçi. Ndërsa mbas vrasjes, Mehmet Pashë Deralla është takuar me Llabud Gojniçin, të cilin e kishte njoft qysh në kohën e Turkisë, si konsull në Shkup, kur ishte aty komandant gjandarmërie, duke çfaqë habinë e tij e kishte pyetë: "Ku është pa të vriten të internuarit"? Gojniç: "Veprat e tij kundër nesh e kanë pasë provokue egërsimin në atë shkallë sa që me përfundue në këtë mënyrë tragjike. Që edhe neve na dhimsen ata patriotë trima, profesorë e oficerë. Cit sipas Tafil Boletinit, Pranë Isa Boletinit, Kujtime 1 (1892-1916), Tetovë, 1996, f. 207-211.

⁵⁴ R. Nexhipi, v.c. f. 270.

QERIM DALIPI

KONSOLIDIMI DHE ZGJERIMI TERRITORIAL I SHTETIT TË BALSHAJVE (1360-1385)

Abstrakt. Familja bujare e Balshajve i zgjeroi relativisht shpejt zotërimet e saj feudale në Arbërinë Veriore dhe në Zetë. Kjo ishte si rezultat i sundimit të përbashkët të tre vëllezërve Balshaj, si dhe i aleancave politike që ata lidhën me feudalët përreth, me çka pushteti i tyre u zgjeruar edhe përmes lidhjeve vasale. Përkundër rrethanave të këtuja të favorshme, Balshajt u ballafaquan me shumë vështirësi në përpjekjet e tyre për t'u ngritur në sundimtarë të pavarur. Megjithatë, ata ia dolën mbanë dhe në fund të viteve 60 të shek. XIV edhe formalisht u shkëputën nga pushteti suprem i perandorit serb Uroshit V dhe madje braktisën ritin ortodoks dhe përqafuan katolicizmin.

Lulëzimin më të madh shteti i Balshajve e arriti gjatë viteve 70 të shek. XIV, atëherë kur u zgjerua dukshëm në aspektin territorial. Në kuadër të tij hynë edhe Arbëria Jugperëndimore dhe ajo Juglindore (Kosturi), Kosova, Trebinja, Konavla dhe Draçevica. Këto tri të fundit, aty nga fundi i viteve të sipërpërmendura, u shkëputën nga pushteti i Balshajve. Megjithatë ky zhvillim negativ nuk i zbrapsi Balshajt nga rruga e nisur për zgjerimin territorial të shtetit të tyre. Ata u bënë zotër edhe të Arbërisë së Mesme, duke krijuar në këtë mënyrë shtetin më të madh mesjetar arbëror deri në atë kohë. Ky sukses i madh nuk pati kohë të konsolidohej, ngase rreziku osman ishte bërë i paevitueshëm. Rrjedhimisht, pas disfatës në Savër (1385), zotërimet e Balshajve u ngushtuan në një territor të ngushtë, ku bënë pjesë: Shkodra, Drishti, Ulqini dhe Tivari.

Paqja e arritur nën tryshninë venedikase, në fund të 1369-ës ose në fillim të 1370-ës, në raport me Republikën e Shën Markut, në fakt ishte përsëritje e episodit të marsit të vitit 1369, i cili qe përmbyllur përmes rrugës paqësore. E gjithë kjo për zotërinjtë arbërorë do të thoshte dritë e gjelbër për të marrë edhe një herë pëlqimin e Republikës së Venedikut për të mbajtur anije të armatosura në det, të cilat më vonë do t'i përdornin patjetër kundër Kotorrit. Në këtë drejtim, Gjergji I Balsha, përballë paqes së arritur, nuk hoqi dorë nga qëllimet e tij. Kështu, në fillim të shkurtit të vitit 1370, në Venedik ndodhej ambasadori i tij, i cili informoi Sinjorinë se tregtarët e

saj mund të tregtonin lirshëm në krahinat e zotërisë së tij. Njëkohësisht Venedikut iu propozua të dërgonte konsullin e tij te Gjergji I¹. Përmes kushteve të këtitilla të favorshme, pa dyshim se zotëriu arbëror përpiqej të thyente hamendjen e Republikës përballë interesave të saj tregtare, dhe ta tërhiqte atë në favor të qëllimit të tij të projektuar. Dhe me të vërtetë, pa kaluar shumë kohë, në mars të atij viti, Gjergji I, përmes ambasadorit të tij, i kërkonte leje Sinjorisë që anijet e tij të lundronin të armatosura në det. Senati venedikas, më 7 mars, e miratoi kërkesën e parashtruar, por me kusht që anijet e armatosura të Gjergjit I të përdorshin vetëm kundër armiqve të tij, respektivisht të mos i sulmonin anijet e tregtarëve venedikas dhe të tregtarëve të tjerë. Njëkohësisht Senati vendosi që zotëriu i përmendur të mos i shqetësonte kotorrasit, të cilët e respektonin paqen e arritur². Nga kjo që u tha, nuk është vështirë të konstatohet se Republika e Shën Markut nuk hiqte dorë nga qëndrimi i saj i mëhershëm për çështjen e Kotorrit. Lëshimet e kufizuara ndaj Balshajve, pa dyshim se ishin me karakter formal. Në fakt, Republika përmes tyre synonte t'i mbante zotërinjtë arbërorë në anën e saj, me qëllim që mos i rrezikonte privilegjet e sipërpërmendura tregtare.

Në vjeshtë të vitit 1370, ushtria e Nikollë Altomanoviçit depërtoi në territorin raguzan. Ekspedita u karakterizua me shkatërrime dhe plaçkitje, si dhe me shumë vrasje e internime të popullsisë. Njëkohësisht, dëme të mëdha pësoi edhe tregtia raguzane që zhvillohej përmes tokës. E njëjta gjendje ekzistonte edhe në pranverë të vitit 1371. Në maj të atij viti, Raguzat u kundërpërgjigj me dërgimin e një anijeje lufte në gjirin e Grykës së Kotorrit. Ajo duhej të sulmonte njerëzit e Nikollës, të cilët do t'i takonte në det. Pikërisht, gjatë këtij konflikti (1370-1371), qyteti i Kotorrit kaloi nën pushtetin hungarez³, me ç'rast u fundosën synimet e Balshajve për marrjen e tij. Nga ana tjetër, nga ky moment, për zotërinjtë arbërorë sfidë kryesore mbetej Nikollë Altomanoviçi, i cili edhe më tej ishte në luftë kundër aleates së tyre, Raguzës. Në fakt, ky feudal lehtë mund t'i vinte në rrezik edhe kundërshtarët e tij në jug. Me sa duket, duke pasur parasysh këtë rrethanë të mundshme, Balshajt vendosën të hynin në konflikt. Ata me këtë veprim, përveç që i dilnin në ndihmë Raguzës, më në fund edhe mund të çliroheshin nga rreziku i zotëriut të përmendur. Në këtë drejtim, në qershor të vitit 1371, bujari i Gjergjit I Balshës, Andrea Pashtroviç, e informonte komunën e Raguzës se zotëriu i tij Gjergji I, sundimtari Vukashin dhe djali i këtij të fundit Marko, me ushtritë e tyre qëndronin në fushën pranë Shkodrës. Ata planifikonin një sulm ndaj feudalit Nikollës, në Onogosht ose në ndonjë vend tjetër, aty ku do ta gjenin. Njëkohësisht, bujari i përmendur u bëri thirrje raguzanëve t'i përgatisnin anijet e tyre, të cilat do të transportonin ushtrinë e Gjergjit I për në vendin e Nikollë Altomanoviçit. Me gjasë, anijet do të duhej të lundronin nga gjiri i Grykës së Kotorrit drejt Konavllës dhe Draçevicës. Më së voni deri më 26 qershor të atij viti, raguzanët dërguan një përfaqësues tek Adrea me detyrë që të informohej nga afër se cilën ditë anijet raguzane duhej të ishin gati për të bërë transportimin. Njëkohësisht, i dërguari

¹ A. Alb., II, nr. 264, f. 61; AAV, I/1, nr. 223, f. 204-205.

² A. Alb., II, nr. 266, f. 61; AAV, I/1, nr. 225, f. 206.

³ M. Динић, *pun. i cit.*, f. 15-18; V. Foretić, *Povjest Dubrovnika do 1808. Pprvi dio: Od osnutka do 1526*, Zagreb, 1980, f. 154-155.

raguzan duhej t'i kërkonte Gjergjit I që ta ndërpriste armiqësinë ndaj Kotorrit, me të cilin raguzanët, për shkak të mbretit hungarez, nuk dëshironin të kishin kurrfarë ngatërresash. Ai, po ashtu duhej të mësonte se cilët zotërinj arbërorë do të ishin me Gjergjin I dhe çfarë ushtrie kishin ata me veti, sa ishte e fuqishme ushtria që duhej të shkonte përmes "rrugës së sipërme" (domethënë nga Shkodra në Onogosht), dhe kur ata mund të niseshin. Megjithatë, çdo gjë mbeti në letër. Vukashini u detyrua të largohet nga Shkodra, duke i shkuar në ndihmë vëllait të tij, Gjon Ugleshës, krahinat e të cilit rrezikoheshin nga osmanët⁴. Rrjedhimisht, pas rënies së Vukashinit në betejën e Maricës (26 shtator 1371), Balshajt, nga zotërimet e këtij ish-aleati morën qytetin e Prizrenit (1372)⁵. Me këtë rast, popullsia (arbërore – Q. D.) e këtij qyteti e priti Gjergjin I Balshën me entuziazëm të madh, sa që Balshajt u cilësuan me epitelin "çlirimtarë"⁶. Më pas, Gjergji I u nda nga motra e Vukashinit dhe u martua me Teodorën, vejane e bujarit malazez Zharko⁷.

Vëllai më i madh Strazimir Balsha, me sa duket, vdiq në vitin 1372, në Prizren, ku edhe qe varrosur⁸, ndërsa Gjergji I Balsha (1372-1378) gjatë atij viti u bë zot i qytetit të Pejës⁹. Në atë kohë, ose në vitet që pasuan, pushteti i Balshajve u shtri edhe më thellë në Kosovë. Rrjedhimisht, Gjergji I Balsha ngriti pikën doganore në Kriva Rrekë, pranë Novobërdës, në juglindje të Prishtinës. Në funksion të fuqizimit të pushtetit të tij, ai u imponoi tregtarëve raguzanë pagesën e taksës doganore në Kriva Rrekë dhe në Dejë¹⁰.

Ndërkohë, Balshajt arritën edhe suksese të tjera drejt rritjes së principatës së tyre në një shtet të fuqishëm feudal. Rrjedhimisht, aty nga vitet 1370-1371, ata u bënë sundimtarë të Arbërisë Jugperëndimore, respektivisht të Vlorës, të Kaninës dhe të Beratit. Edhe pse në burimet e shkruara mungojnë informacionet rreth mënyrës së zgjerimit të pushtetit të tyre në këto vise, studiuesit janë të mendimit se ky proces ishte rezultat i martesës së Balshës II me Komitën* (Komnenën)¹¹. Në fakt, duket

⁴ К. Лиречек, *Српски цар Урош, краљ Вукашин и Дубровчани*, f. 374-377.

⁵ По ату, f. 378; S. Gorčević, *Geschichte von Montenegro und Albanien*, Gotha, 1914, f. 52; P. Михалчић, v. c., f. 169.

⁶ G. Gelcich, v. c., f. 84, 86; P. Bogdani, *Kosova ...*, f. 116.

⁷ М. Орбин, v. c., f. 64. Gjergji I Balsha nga martesa me Milicën (Oliverën) kishte vetëm një vajzë – Jelisavetën, ndërsa nga martesa me Teodorën, kishte djalin Konstantinin dhe katër vajza: Jelisavetën, Goisavën, Evdokinë, Jellën. Konsiderohet se kishte dhe një djalë jashtëmartesor me emrin Gjergj (P. Imami, *Srbi i Arbanasi kroz vekove*, Beograd, 2000, f. 27).

⁸ P. Imami, v. c., f. 27.

⁹ *Историја српског народа*, II, Београд, 1982, f. 14; P. Bogdani, *Kosova ...*, f. 115; L. Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, Prishtinë, 1997, f. 50.

¹⁰ *Monumenta serbica*, nr. CLXXXIII, f. 193; *Законски споменици*, nr. LVIII, f. 196; *Burime të zgjedhura*, nr. 112, f. 186.

* Те Мауро Орбини, Komita përmendet me emrin Kanina (M. Орбин, v. c., f. 71).

¹¹ Gjon Muzaka thekson se Komita ishte e bija e Andreas II Muzakës, e cila u martua me Balshën II (*Мемоарите на Иван и Константина Музаци*, отъ А. Шоповъ, Периодическо списание на българското книжно дружество, год XV, София, 1904, f. 126-127; Gj. Muzaka, v. c., f. 39). Një pjesë e studiuesve e pranon si të besueshëm pikërisht këtë informacion (П. Бартл, v. c., f. 31; P. Imami, v. c., f. 27-28; *Historia e popullit shqiptar*, I, f. 302; L. Malltezi, *Himara dhe qëndresa kundërosmane në shek. XV*, në: "Himara në shekuj", Tiranë, 2006, f. 99; etj. Ndërsa, pjesa tjetër e studiuesve konsideron se Komnena ishte e bija e princit bullgar të Beratit dhe të Vlorës, Gjon Komnen Asenit (И. Руварац, v. c., f. 118; К. Јиречек, *Vlora në mesjetë*, në: "Vëzhgime iliro-

se, pushteti i Balshajve në Arbërinë Jugperëndimore u vendos që nga viti 1370. Ky qëndrim mund të mbështetet në letrën e papës Urbani V (1362-1370) të 25 gushtit të atij viti. Përmes saj, ai u rekomandoi Balshajve pesë peshkopët e porsaemëruar, të cilët duhej t'i udhëhiqnin dioqezat në disa nga viset që ndodheshin nën pushtetin e tyre. Midis këtyre peshkopëve ndodhej edhe peshkopi i Vlorës¹², fakt që nënkupton se ky qytet që atëherë ishte nën pushtetin e Balshajve.

Pavarësisht se Balshajt u përkrahën nga bujaria, ata, në Vlorë, megjithatë u ballafaquan me rezistencën e shtresave të caktuara të popullsisë, të cilat në radhë të parë ndoshta ishin zejtarë dhe tregtarë të lidhur me Venedikun, duke kyçur këtu edhe tregtarët venedikas. Cilat ishin shkaqet që i detyruan ata t'i kundërshtonin Balshajt, mund vetëm të supozohet. Nga një dokument venedikas, të muajt mars të vitit 1372, mësohet se kapiteni i detit Adriatik, sipas urdhrit të Republikës, duhej të shkonte te Gjergji I Balsha „*sundimtar i Vlorës, i Buduës dhe i viseve të tjera*“ (*Juram de Balsce dominum Avalonae et aliorum locorum*) dhe t'i kërkonte atij kompensimin për dëmin e shkaktuar ndaj venedikasve¹³ domethënë tregtarëve venedikas. Kjo urdhëresë të çon në supozimin se kryengritja që shpërtheu pikërisht gjatë atij viti ishte si pasojë e dëmit të shkaktuar nga pushteti i Balshajve ndaj tregtarëve të Republikës, por edhe ndaj atyre të cilët bashkëpunonin me to. Rrjedhimisht, mund të supozohet se Balshajt nuk i respektonin privilegjet e tregtarëve venedikas, rrethanë e cila goditi edhe zejtarët dhe tregtarët vendas, të cilët nga bashkëpunimi me ata përfitonin mirë materialisht.

Disa banorë të qytetit të Vlorës, në pranverë të vitit 1372, u rebeluan* kundër pushtetit të Balshajve dhe u larguan e u vendosën në ishullin e vogël të Sazanit përballë qytetit. Mirëpo, për fatin e tyre u përkujdes Republika e Venedikut. Më 5 korrik 1372, Senati venedikas i shkroi një letër kapitenit të detit Adriatik, përmes së cilës e porosiste që t'u propozonte kryengritësve të shpërnguleshin në Koron dhe në Modon*. Nëse ata do të pajtoheshin me këtë propozim, atëherë kapiteni duhej të

shqiptarë”, përpiluem prej L. Thallóczy-t, përkëthyer në shqip nga M. Merlika - Kruja, Shkodër, 2004, f. 135; P. Михальчић, v. c., f. 190; *Историја Црне Горе*, II/2, f. 29; М. Антоновић, *Област Валоне и Канине под српском влашћу (1343-1417)*, *Зборник Филозофског факултета*, серија А: историјске науке, Београд, 1994, f. 152; Dh. Shuteriqi, Arianitët – Zotërimet, *Studime për epokën e Skënderbeut*, II, Tiranë, 1989, f.110; etj. Kristo Frashëri e prezanton Komnenën si bijë të Aleksandrit (K. Frashëri, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu – jeta dhe vepra 1405-1468*), Tiranë, 2002, f. 31), i cili ishte vëllai ose djali, ose së paku farefis i Gjon Komnen Asenit (M. Антоновић, *pun. i cit.*, f. 152; И. Руварац, v. c., f. 118; P. Михальчић, v. c., f. 127; K. Jireček, *Vlora në mesjetë*, f. 135; A. Ducellier, *La façade ...*, f. 488). Në të vërtetë studiuesi francez A. Dyselje, duke iu referuar veprës së M. Orbinit, ku ekziston shprehja “la figliuola del despoto di Belgrado”, konstaton se bëhet fjalë për vajzën e despotit të Beratit, Gjon Komnenin, prej nga vjen emri Komnena (A. Ducellier, *La façade ...*, f. 488 dhe shën. 122 në f. 610; I njëjti, *Note sur l'île de Sazan (Saseno) du XIII^e au XV^e siècles*, në: “L'Albanie entre Byzance et Venise, X^e-XV^e siècles”, London, 1987, f. 19, shën. 15).

¹² *A. Alb.*, II, nr. 270, f. 62.

¹³ *Po aty*, nr. 288, f. 67.

* Në qershor të vitit 1372 dy komandantë të flotës së kryengritësve dhe një bashkëqytetar i tyre shtinë në dorë dy anije të vogla të një detari raguzan dhe sekuestruan armë dhe disa mallra të tjera (*AAV*, I/1, nr. 264, f. 236).

* Kështjellat e Koronit dhe të Modonit në Peloponez ndodheshin nën sundimin venedikas (*Historia e popullit shqiptar*, I, f. 458).

organizonte transportimin e tyre. Ndërsa, në qoftë se kryengritësit nuk do të pajtoheshin, atëherë, porosiste Senati, ata nën mbrojtjen venedikase do të mund të qëndronin me familjet dhe pasurinë e tyre në Sazan. Nëse aty do të ndërtonin kështjellë, thuhet më tej në vendimin e Senatit, ata do të liroheshin nga tatimet për katër vite. Më pas, ata do të ngarkoheshin me tatime dhe angari. Ndërkohë, Senati obligohej të dërgonte ushtrinë për mbrojtjen e ishullit, por në çdo rast banorët e tij do të duhej të jepnin betimin e besnikërisë ndaj Venedikut. Kryengritësit zgjodhën të qëndronin në ishull dhe pranuan kushtin e fundit të Republikës domethënë besnikërinë venedikase, ndërsa Senati aty nga fundi i gushtit të atij viti vendosi t'u dërgonte ndihmë në ushqime dhe armë. Kështu, gjatë disa viteve në vijim, ishulli i Sazanit shërbeu si bazë e flotës venedikase në detin Adriatik. Nga fundi i muajt gusht të vitit 1377, kapiteni i flotës Donato Troni i shkruante Senatit pikërisht nga ky ishull¹⁴.

Republika e Venedikut e shfrytëzoi kryengritjen e përmendur si mjet presioni ndaj Balshajve. Në nëntor të vitit 1372, Senati venedikas iu përgjigj të dërguarve të Gjergjit I Balshës se sundimtari i tyre duhej t'i kompensonte dëmet e shkaktuara ndaj qytetarëve venedikas dhe t'ua kthente atyre borxhet, dhe tek pastaj do të jepej përgjigja për çështjen e Sazanit. Ambasadori i Gjergjit I premtoi se çështja e dëmshpërblimit do të zgjidhej, por nga ky premtim nuk doli asgjë. Rrjedhimisht, Senati, aty nga mesi i marsit të vitit 1373, deklaroi se Gjergji I nuk i kthente borxhet e përmendura, prandaj urdhërohej kapiteni i flotës së detit Adriatik të përpiqej të kompensonte dëmet dhe pagesën e borxheve, të cilat gjithsej arrinin 9 000 dukate. Nëse këtë detyrë ai nuk mund ta arrinte përmes rrugës paqësore, atëherë atë duhej ta realizonte me përdorimin e forcës, duke konfiskuar pasurinë e të nënshtruarve të Gjergjit I. Megjithatë, ky vendim i Senatit nuk u vu në jetë¹⁵.

Nga ana tjetër, Balshajt, ndërkohë, arritën një sukses tjetër të rëndësishëm në funksion të zgjerimit territorial të shtetit të tyre. Ata u bënë zotër të një pjese të viseve juglindore arbërore, duke marrë qytetin e Kosturit*, që ndodhej nën pushtetin e zotit feudal Marko. Sipas Mauro Orbinit, i cili këtë ngjarje e vendos pas rënies të Vukashinit në betejën e Maricës (1371), Balsha II e pushtoi qytetin me pëlqimin e Helenës, atëherë kur bashkëshorti i saj Markoja nuk ndodhej aty¹⁶. Mirëpo, në një burim tjetër historik thuhet krejtësisht diç tjetër mbi këtë ngjarje. Sipas tij, Andrea II Muzaka feudalit të përmendur ia mori Kosturin me luftë¹⁷. Në një situatë të këtillë informacionesh kundërtëse, patjetër se duhet bërë përpjekje

¹⁴ A. Alb., II, nr. 293, 299, f. 68, 70; AAV, I/1, nr. 236, 237, 264, f. 212-214, 236; A. Ducellier, *La façade ...*, f. 488; I njëjti, *Note sur l'île de Sazan ...*, f. 19-20; M. Антоновић, *pun. i cit.*, f. 161.

¹⁵ A. Ducellier, *La façade ...*, f. 488-489; M. Антоновић, *pun. i cit.*, f. 162-163.

* Kosturi në dokumentet e gjysmës së dytë të shek. XIV përfshihet brenda konceptit Arbëri "*Castoria de partibus Albanie*" (B. Kreki), *Dubrovnik (Raguse) et la Levant au moyen âge*, Paris, 1961, f. 229).

¹⁶ Balsha II e mori Kosturin në dorëzim nga Helena, duke e mashtruar atë se për këtë shërbim do t'i ofronte kurorën martesore (M. Орбин, *v. c.*, f. 68).

¹⁷ *Мемоарите на Иван и Константина Музаки*, f. 126-127; Gj. Muzaka, *v. c.*, f. 29; B. Б. Грозданова, *Прилог кон Охридската ковница од XIV век*, Историја, VII/1, Скопје, 1971, f. 201; J. Белчовски, *Охридската архиепископија (од основањето до паѓањето на Македонија под турска власт)*, Скопје, 1997, f. 394).

për ndriçimin e problematikës së përmendur, por gjithnjë duke pretenduar të mundshmen. Rrjedhimisht, në fillim të viteve 70 të shek. XIV, Balshajt u bënë zotër edhe të qytetit të Beratit¹⁸, i cili ishte pjesë përbërëse e zotërimeve feudale të Andreas II Muzakës, sundimi i të cilit shtrihej në krahinën e Myzeqesë dhe më gjerë¹⁹, gjë që nënkupton se Muzakajt kishin rënë nën pushtetin e Balshajve. Me fjalë të tjera, përmendja e të sipërpërmendurve për sundimtarë të Kosturit, sipas burimeve të cekura, dhe paraqitja e mëvonshme si zotër të tij e djemve të Andrea II Muzakës, Stoja dhe Teodori (1383/4)²⁰, do të thotë se Balshajt i kishin lënë Muzakajt të qeverisnin me këtë qytet, por si vasalë të tyre.

Në fillim të vitit 1372, Gjergji I Balsha dhe Karl Topia, me sa duket, po trazonin në vazhdimësi Durrësin, i cili ndodhej nën sundimin e anzhuinëve të Napolit. Për t'i bërë ballë këtij rreziku, konti i Durrësit, Ludevigu i Navarës, u tregua tepër energjik. Ai u përpoq të përgatiste një ekspeditë ndëshkuese kundër sundimtarëve arbërorë. Po ashtu, konti anzhuin planifikonte t'i zinte ata rob, përndryshe armiq të moçëm të tij, për të cilët premtonte një çmim prej 1.000 dukatesh ari për secilin. Pavarësisht se një gjë e tillë nuk u realizua²¹, as sundimtarët arbërorë nuk e arritën qëllimin e projektuar. Prandaj ishte e natyrshme që Balshajt të merreshin me sfidat e tjera të radhës. Në këtë drejtim, Gjergji I Balsha, në pranverë të vitit 1373, papritmas u pajtua me kundërshtarin e tij Nikollë Altomanoviçin. Afrimi midis tyre, me gjasë, u realizua me iniciativën e diplomacisë venedikase. Në të vërtetë, në maj të vitit 1373, raguzanët* e lajmëronin mbretin hungarez se Republika e Venedikut përpiqej, përmes përfaqësuesit të saj, të tërhiqte Balshajt dhe Nikollë Altomanoviçin në luftë kundër Hungarisë. Si kompensim për këtë, ajo u premtonte atyre dhënie e qyteteve që kishin pranuar pushtetin hungarez: Kotorri dhe Durrësi (për Gjergjin I) dhe gadishullin e Peleshacit, në veriperëndim të Raguzës, (për Nikollën)²². Megjithatë, këto plane nuk u vunë në jetë.

Nikollë Altomanoviçi, i cili ndërmerre sulme ushtarake kundër banit boshnjak Tvërtko dhe princit serb Lazar, sfidoi këta sundimtarë të lidhin aleancë kundër tij. Kështu, në vjeshtë të vitit 1373, aleatët i shkaktuan Nikollës disfatë të rëndë, ku vetë ai qe verbuar. Fituesit i ndanë zotërimet e tij feudale midis veti. Por, nga situata e krijuar përfitime nxori edhe Gjergji I Balsha, i cili pushtoi një pjesë të territorit të feudalit të mposhtur. Pra, ai u bë zot i Trebinjës, Konavlës dhe Draçevicës²³, të cilat shtriheshin midis Grykës së Kotorrit dhe Raguzës.

Pushteti mbi Trebinjën, Konavlën dhe Draçevicën i solli Gjergjit I Balshës edhe të drejtën e shfrytëzimit të tributit të Shën Dhimitrit, të cilin raguzanët prej kohësh e

¹⁸ M. Орбин, v. c., f. 67.

¹⁹ Gj. Muzaka, v. c., f. 29.

²⁰ Г. Суботић, *Манастир Богородице Месонисиотисе*, Зборник радова Византолошког института, XXVI, Београд, 1987, f. 160-161; Ц. Грозданов, *Охридското судно сликарство од XIV век*, Охрид, 1980, f. 20, shën. 123).

²¹ A. Alb., II, nr. 286, f. 66-67; M. Shufaj, v. c., f. 109, 129; A. Ducellier, *La façade ...*, f. 480.

* Paqja midis Raguzës dhe Nikollë Altomanoviçit u arrit në pranverë të vitit 1372 (M. Динић, *pun. i cit.*, f. 20).

²² A. Alb., II, nr. 312, f. 72; *Писма и унутсва Дубровачке Републике*, књ. I, објавио Ј. Тадић, Београд, 1935, nr. 261, f. 274.

²³ M. Орбин, v. c., f. 59-61.

kishin lidhur me atë që sundonte me territoret përreth Raguzës. Pas vdekjes së perandorit serb Uroshit V, tributin në fjalë, për një kohë të shkurtër, e pat marrë Nikollë Altomanoviçi, dhe më pas ai i kaloi Gjergjit I²⁴. Ky sundimtar, gjatë qëndrimit në Raguzë, në nëntor të vitit 1373, në emër të vet, të vëllait të tij, Balshës II, dhe të nipit, Gjergjit II Balshës (djalë i Strazimirit)*, i lëshoi një dokument Republikës së Raguzës. Përmes tij ai betohej se do të ruante miqësinë e vjetër me raguzanët, dhe se, në rast nevojë, do të ndihmonte dhe qytetin e tyre. Sundimtari arbëror, më tej, u garantonte tregtarëve raguzanë tregti të lirë në vendin e tij, duke premtuar se nëse ata do të pësonin ndonjë dëm, atëherë fajtorët do t'ia dorëzonte Raguzës ose do t'i kompensonte vetë dëmet. Ai, po ashtu i lironte ata nga pagesa e taksave doganore, por u tregua tepër syçelë për të ardhurat e tributit të sipërpërmendur, duke kërkuar pagesën e tyre²⁵.

Me zgjerimin e pushtetit të Balshajve në veriperëndim deri në afërsi të Raguzës, në verilindje deri në juglindje të Prishtinës, si dhe në Arbërinë Jugperëndimore dhe atë Juglindore (Kosturi), vëllezërit Gjergji I dhe Balsha II tanimë qëndronin në krye të një shteti të fuqishëm feudal. Si i tillë, ky shtet, posedonte vulën, stemën²⁶, monedhat²⁷, pikat doganore²⁸ dhe, siç dihet, ambasadorët që vizitonin disa nga qendrat e shteteve të kohës. Në këtë rast duhet shtuar edhe faktin se Balsha II mbante titullin “mbret”²⁹. Prandaj, te njerëzit e rëndomtë, nuk mungoi shprehja që pushteti i tyre të shihej nga prizma e krenarisë, respektivisht e traditës historike, prirje kjo e njohur në mesjetë. Kështu, sundimtarët e përmendur, në epitafin e Glavnicës (Ballshit) të vitit 1373, përmenden si „zotërinj shumë të lartë të Serbisë, Romanisë (Bizantit – Q. D.) dhe gjithë Arbërisë”³⁰.

²⁴ *Историја Црне Горе*, II/2, f. 31. Tributi i Shën Dhimitrit në të vërtetë ishte çmimi për tregtinë e lirë të raguzanëve dhe për paqen në kufi. Raguza këtë tribut vjetor ia paguante Gjergjit I Balshës derisa ky sundimtar e pati pushtetin mbi Trebinjën, Konavllën dhe Draçevicën (1373-1377). Marrëdhëniet midis tyre ishin miqësore dhe të dyja palët ishin të kënaqura (V. Foretić, v. c., f. 155-156).

* Sipas njoftimeve të Gjon Muzakës, Strazimiri ishte i martuar me vajzën e bujarit arbëror Progon Dukagjini, Irenën, me të cilën pati djalin Gjergjin (Gj. Muzaka, v. c., f. 58).

²⁵ *Monumenta serbica*, nr. CLXXIII, f. 183-184; *Законски споменици*, nr. LV, f. 192. *Burime të zgjedhura*, nr. 111, f. 185.

²⁶ Balshajt shërbeheshin me vulë të stemës sundimtare të tyre, në të cilën paraqitej koka e ujkut (S. Antoljak, *Shkencat ndihmëse të historisë*, Prishtinë, 1972, f. 177, 186).

²⁷ Balshajt si familje sundimtare farkëtuan monedha. Kështu Gjergji I Balsha farkëtoi pesë lloje monedhash me mbishkrim sllav. Këtu mund të përmenden edhe dy lloje monedhash bakri, të cilat mund të lidhen me Gjergjin I, dhe janë me mbishkrime latine (monedha e Tivarit me germën e madhe **G** – dhe mbishkrimi **eorgius** në njëërën anë, dhe germa e madhe **A** – dhe mbishkrimi **ntivar** në anën tjetër; dhe monedha e Shkodrës me germën e madhe **G** në njëërën anë, dhe mburoja-emblema e këtij qyteti në anën tjetër. Balsha II faktoi vetëm një lloj monedhe (të qytetit të Shkodrës me emrin e tij), ndërsa Gjergji II Balsha dy lloje, nga të cilat njëra lidhet me Shkodrën, por në të është edhe emri i tij. Monedhat e Balshës II dhe të Gjergjit II janë me mbishkrime latine (С. Димитријевић, *Новац кнеза Лазара у односу на новац других обласних господара*, О кнезу Лазару, Научни скуп у Крушевцу /1971/, Београд, 1975, f. 189-190, 196, 199, 206).

²⁸ *Monumenta serbica*, nr. CLXI, f. 177; *A. Alb.*, II, nr. 235, f. 53-54.

²⁹ *Мемоарите на Иван и Константина Музаки*, f. 126-127; Gj. Muzaka, v. c., f. 39

³⁰ *Burime të zgjedhura*, nr. 124, f. 194; Th. Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, përgatitur për shtyp nga Dega e Botimeve të Akademisë së Shkencave të RSH-së, Tiranë, 1998, nr. 90, f. 84-85.

Në pranverë të vitit 1375, përfaqësuesit e kishës bizantine dhe të asaj serbe arritën marrëveshje pajtuese në Prizren³¹, i cili, siç është thënë më lartë, ndodhej nën sundimin e Balshajve. Moskundërshtimi i Gjergjit I ndaj aktit të këtillë, mendojmë se mund të interpretohet si respekt ndaj kishës ortodokse, nga e cila vëllezërit Balshaj ishin larguar vetëm përpara disa vitesh. Njëkohësisht, ky moskundërshtim mund të nënkuptohet edhe si kontribut i rëndësishëm drejt tolerancës midis ortodoksizmit dhe katolicizmit, sepse pikërisht atë vit përmendet edhe ipeshkvi i Prizrenit, Gjoni³². Mirëpo, mbi të gjitha, me sa duket, përmes aktit të përmendur, Gjergji I synonte të kishte nën ndikimin e tij Patrikanën e Pejës (ndodhej në kuadër të zotërimeve të tij), ashtu siç i kishte nën ndikim edhe ipeshkvitë katolike, që nga viti 1370³³. Në kuadër të këtij këndvështrimi konsiderojmë se mund të shihet edhe kuvendi kishtar, i thirrur, nga sundimtarët Gjergji I dhe Lazari, në fillim të tetorit të vitit 1375, në Pejë, për zgjedhjen e patriarkut të ri të kishës serbe. Kuvendi u përcoll me kundërthënie, të cilat, siç thekson studiuesi M. Purkoviç, ishin rezultat të asaj se: “A do të ishte kandidati i ri njeri i princit Lazar, apo njeri i Balshajve”. Megjithatë, kundërthëniet qenë kapërcyer me zgjidhje kompromisi. Patrik u zgjodh asketi bullgar Efremi³⁴. Mirëpo, meqë në kuvend morën pjesë edhe dy përfaqësues të patrikanës së Kostandinopojës, Matheu dhe Marku³⁵, atëherë mund të supozohet se kompromisi i përmendur qe arritur edhe nën ndikimin e tyre.

Nga ana tjetër, marrëdhëniet midis Balshajve dhe Republikës së Shën Markut edhe më tej mbeteshin të rënduara për shkak të çështjes së dëmshpërblimit të vitit 1372. Kështu, më 13 mars 1376, Senati venedikas thujse përsëriti urdhëresën e marsit të vitit 1373, por vetëm me pak ndryshime. Kësaj radhe theksohej se konfiskimi duhej bërë ndaj Gjergjit I dhe vëllait të tij, sundimtar i Vlorës. S’ka dyshim se edhe ky vendim mbeti në letër, ndërsa situata u acarua edhe më shumë kur në fillim të vitit 1376 disa banorë të Vlorës vranë dy tregtarë venedikas. Senati venedikas e akuzoi Balshën II se me urdhër të tij u qe marrë i gjithë malli tregtarëve të vranë, në vlerë prej 5 000 dukatesh. Përveç këtij rasti, tregtarëve venedikas iu imponua edhe pagesa e doganës. Prandaj, Senati urdhëronte kapitenin e detit Adriatik të shkonte në Vlorë, të takohej me Balshën II dhe mëkëmbësit e tij dhe t’u kërkonte atyre dënimin e fajtorëve, kompensimin e dëmit dhe heqjen e doganës³⁶. Se si qe epilogu i këtij kontesti, në mungesë të të dhënave burimore, mund vetëm të supozohet.

Gjergji I Balsha dhe bani boshnjak Tvërtko, me ndërmjetësimin e raguzanëve, u takuan në Lokrum për t’i zgjidhur kundërthëniet midis tyre. Gjergji I, sipas Mauro Orbinit, dëshironte ta shfrytëzonte takimin për të zënë rob Tvërtkon, por në këtë hap të ndërmarrë u pengua nga raguzanët. Si rezultat i këtij incidenti dështoi arritja

³¹ M. Пурковић, *Српски патријарси средњега века*, Гласник Скопског научног друштва, књига XV-XVI/9-10, Скопље, 1936, f. 309-310; *Историја српског народа*, II, f. 13.

³² A. Alb., II, nr. 326, f. 76; M. Shuflaj, v. c., f. 203; G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup- Prizren nëpër shekuj*, Ferizaj, 1992, f. 98. Ipeshkvia e Prizrenit gjatë shek. XIV-XV ishte sufragat e ipeshkvisë së Kotorrit (Z. Mirdita, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren – Zagreb, 1998, f. 168).

³³ Papa Urbani V, midis 9 dhe 25 gushtit 1370, emëroi peshkopët e Vlorës, të Pultit, të Lezhës, të Arbanonit dhe të Sardit, të cilët ua rekomandoi vëllezërve Balshaj (M. Антоновић, *pun. i cit.*, f. 160).

³⁴ M. Пурковић, *pun. i cit.*, f. 310.

³⁵ *Историја српског народа*, II, f. 14.

³⁶ A. Ducellier, *La façade ...*, f. 488-489; M. Антоновић, *pun. i cit.*, f. 162-163.

e marrëveshjes së pritur³⁷, ndërsa marrëdhëniet midis tyre u acaruan skajshmërisht. Kështu, në janar ose në gjysmën e parë të shkurtit të vitit 1377, në Trebinjë, në Konavle dhe në Draçevicë shpërtheu kryengritje kundër pushtetit të Balshajve, e cila qe nxitur nga njerëzit e banit Tvërtko. Për rrjedhojë këto vise u shkëputën nga shteti i Balshajve dhe hynë në kuadër të shtetit boshnjak, i cili tani u zgjerua deri në afërsi të Kotorrit. Gjergji I nuk u pajtua me këtë rrethanë negative dhe u kundërpërgjigj përmes organizimit të një ekspedite kundër zotërimeve të banit boshnjak në Hum. I shoqëruar nga aleati i tij, Kal Topia, në krye të ushtrisë prej 10 000 vetash, Gjergji I, në tetor të atij viti, përmes Onogoshtit, arriti deri në Nevesinjë. Por më shumë nuk arriti të bëjë. U kthye prej andej me plaçkë të madhe lufte³⁸.

Më 13 janar 1378*, Gjergji I Balsha vdiq në Shkodër, ndërsa pushtetin e trashëgoi i vëllai, Balsha II (1378-1385). Ky sundimtar, për sa i përket politikës së brendshme, ndërmori masa të duhura për përqendrimin e të gjithë pushtetit në duart e veta. Në këtë kuadër, ai arrestoi nipin e tij Gjergjin II Balshën në kështjellën e Durrësit, për shkak të “mosdëgjueshmërisë” dhe nga frika se do të mund të qeveriste me Zetën³⁹. Mund të supozohet se ky internim u bë para datës 24 prill 1385, kur tashmë Balsha II ishte bërë sundimtar i këtij qyteti⁴⁰, respektivisht në periudhën kohore 1382-1385⁴¹. Një masë tjetër e ndërmarrë ishte ajo e mbushjes së arkës shtetërore, gjë që garantonte fuqinë e shtetit. Kështu, në nëntor të vitit 1379, Balsha II konfirmoi vendimin e mëparshëm të Gjergjit I për pagesën e taksës doganore, 2 dinarë për thes, nga tregtarët raguzanë në Dejë dhe në Kriva Rrekë⁴².

Lufta detare midis Venedikut dhe Xhenovës (1378-1381), për shkak të ujdhesës së Tenedosit, u përhap shpejt edhe në ujërat e detit Adriatik. Në gusht të vitit 1378, venedikasit u bënë zotër të Kotorrit, por nuk mundën ta mbanin atë për një kohë të gjatë. Në qershor të vitit 1379, ky qytet përsëri u ndodh nën pushtetin hungarez. Gjatë këtij konflikti, edhe pse Balsha II konsiderohej si aleat raguzan dhe hungarez, ai kishte lidhje me Republikën e Venedikut, duke mbajtur në oborrin e tij tregtarin venedikas Filip Barelin. Ky tregtar i fuqishëm, në fakt kryente funksionin e *protovestiarit* (ministër i financave), nga i cili kryezoti i përmendur merrte hua në të holla, ndërsa kur nuk mund t'i kthente borxhin, e kompensonte atë përmes dhënies së pronave tokësore⁴³.

³⁷ M. Орбин, v. c., f. 69-70.

³⁸ *Ро ату*, f. 70; М. Динић, *рп. и сит.*, f. 35-37; *Историја Црне Горе*, II/2, f. 34-35.

* Gjergji I Balsha vdiq më 13 janar 1378 dhe jo siç thotë Mauro Orbini më 13 janar 1379 (P. Михаљчић, v. c., f. 206).

³⁹ M. Орбин, v. c., f. 70-71; *Историја Црне Горе*, II/2, f. 37.

⁴⁰ *Монумента сербика*, nr. СХСII, f. 202; *Законски споменици*, nr. LX, f. 197-198; *A. Alb.*, II, nr. 388, f. 93.

⁴¹ Çështja e kalimit të Durrësit nën sundimin e Balshajve nuk është precizuar deri në fund. Disa studiues këtë ngjarje e vendosin në vitin 1382 (K. Frashëri, v. c., f. 36; P. Bogdani, *Kosova ...*, f. 119); të tjerë në vitin 1383 (П. Баргл, v. c., f. 31; *Historia e popullit shqiptar*, I, f. 304); si dhe disa të tjerë më 1385 (*Историја Црне Горе*, II/2, f. 47; *Историја српског народа*, II, f. 28).

⁴² *Монумента сербика*, nr. CLXXXIII, f. 193; *Законски споменици*, nr. LVIII, f. 196; *Burime të zgjedhura*, nr. 112, f. 186.

⁴³ *Историја Црне Горе*, II/2, f. 37-39, 46.

Kur në afërsi të Ulqinit filloi patrullimin një anije xhenoveze (1380), për t'i penguar anijet venedikase të furnizoheshin në këtë qytet, Balsha II u lejoi ulqinakëve ta sulmonin dhe ta konfiskonin atë. Kjo ngjarje e detyroi flotën xhenoveze të përgatitej për ndërmarrjen e veprimeve ushtarake kundër Ulqinit. Raguzat, edhe pse ishte në gjendje lufte me Republikën e Venedikut, për t'i ruajtur interesat e tregtarëve të saj në shtetin e Balshajve, ndërhyri pranë Balshës II, duke kërkuar çlirimin e anijes xhenoveze. Meqë kjo nuk i shkoi për dore, shteti dalmatin u bëri thirrje xhenovezve të mos e sulmonin Ulqinin dhe njerëzit e Balshajve⁴⁴.

Gjendja e tendosur, si më sipër, patjetër se ishte si pasojë e zemërimit të Balshës II ndaj xhenovezëve dhe zarasve, të cilët kishin zënë dhe ndaluar disa varka të njerëzve të tij në rrugë për në Raguzë. Raguzanët theksonin se thuajse ishin nën rrethim për shkak të veprimit të tillë të xhenovezëve dhe të zarasve, dhe se ishte rrezikuar edhe furnizimi i qytetit me prodhime nga ana e territoreve të Balshës II. Madje, sipas tyre, ky kryezot në mënyrë tendencioze konsideronte se Raguzat dhe Zarat ishin nën pushtetin e një sundimtari (domethënë të mbretit hungarez – Q. D.). Rrjedhimisht, raguzanët frikoheshin se ai si “njeri i paarsyeshëm” do të mund t'u hakmerrej dhe të kërkonte dëmshpërblim për dëmin e pësuar të njerëzve të tij. Mirëpo, marrëdhëniet midis tyre disi u rregulluan dhe ishin të mira deri në momentin kur Balsha II filloi sulmet ndaj Kotorrit, kur përsëri u acaruan⁴⁵.

Mbreti boshnjak Tvërtko*, i cili nuk posedonte asnjë liman në detin Adriatik, në pranverë të vitit 1382, i vuri themelet e një kështjelle në afërsi të lumit të vogël Sutorin, në hyrje të Grykës së Kotorrit. Kështjella duhej të mbronte tregun, të cilin këtu e themeloi Tvrtkoja. Dalja e këtij të fundit në Grykën e Kotorrit, pa dyshim se sfidonte sundimtarin arbëror. Prandaj, për t'iu kundërvënë politikës së këtillë pushtuese, që rrezikonte posaçërisht qytetin e Kotorrit, Balsha II, pas vdekjes të mbretit anzhuin të Hungarisë, Ludovikut I (11 shtator 1382), tashmë në fillim të vjeshtës të atij viti, nxitoi dhe e vuri qytetin nën rrethim. Aty nga gjysma e muajit tetor, kotorrasit kërkuan ndërhyrjen e raguzanëve pranë Balshës II. Këta të fundit u shprehën pozitivisht rreth kësaj çështjeje, por nuk arritën ndonjë rezultat. Rrethimi vazhdoi edhe në fillim të vitit 1383 dhe në këtë drejtim u dallua kështjellari i Buduës, Nikollë Sakati, i cili i sulmonte dhe i konfiskonte varkat raguzane që lundronin drejt Kotorrit⁴⁶.

Për ta larguar rrezikun boshnjak, Balsha II, siç duket, ndërmori ekspeditë kundër mbretit Tvërtko. Kështu në shtator të vitit 1383, gjendja në territorin midis Grykës së Kotorrit dhe Raguzës, domethënë në Trebinjë dhe në Konavllë, ishte shumë e tendosur. Mbreti boshnjak dërgoi një ushtri prej 2 000 vetash, e cila përzuri ushtritë e Balshës II nga krahinat e përmendura, mirëpo lufta për Kotorrin nuk përfundoi⁴⁷. Në pranverë të vitit 1384, Kotorri përsëri ishte i rrethuar nga sundimtari arbëror. Raguzanët edhe një herë u premtuan kotorrasve se do të dërgonin një përfaqësi

⁴⁴ P. Bogdani, *Lufta e Principatës së Balshajve ...*, f. 53-54.

⁴⁵ *Историја Црне Горе*, II/2, f. 45-46.

* Tvërtko u shpall perandor më 26 tetor 1377.

⁴⁶ *По ату*, f. 41-42; С. Ђирковић, *Историја средњовековне босанске државе*, Београд, 1964, f. 151; P. Bogdani, *Lufta e Principatës së Balshajve ...*, f. 57.

⁴⁷ Д. Динић-Кнежевић, *Дубровник и Угарска у средњем веку*, Нови Сад, 1986, f. 43.

diplomatiqe pranë Balshës II për të mbajtur anën e tyre. Mirëpo, edhe në këtë rast nuk pati rezultat. Duket se qyteti, aty nga fundi i korrikut të atij viti, iu dorëzua boshnjakëve, ndërsa mbretëresha hungareze Maria, pushtetin boshnjak mbi këtë qytet e vërtetoi gjatë periudhës nga fundi i marsit e deri para gushtit të vitit 1385⁴⁸. Kalimi i Kotorrit nën pushtetin boshnjak, me gjasë, u kundërshtua ashpër nga Balsha II. Forcat e tij ushtarake madje luftuan kundër ushtrisë së mbretit boshnjak, por rrjedha e luftimeve nuk është e njohur. Dihet vetëm se Tvërtkoja para 5 tetorit 1385 dërgoi dy përfaqësues në Venedik, të cilët kërkuan ndërmjetësimin venedikas për arritjen e paqes me sundimtarin arbëror. Senati venedikas, më 5 tetor, u shpreh pozitivisht për kërkesën e parashtruar, sepse, përveç luftës, siç është thënë në përgjigjen për mbretin boshnjak, më tepër dëme u shkaktonte qytetarëve venedikas, të cilët ndodheshin në viset e sundimtarëve që ishin në konflikt⁴⁹. Megjithatë, misioni ndërmjetësues i Republikës së Venedikut, me sa duket, nuk u realizua.

Nga ana tjetër, ndërkohë Balsha II kishte arritur një sukses të rëndësishëm. Ai tashmë, më 24 prill 1385, i kishte shtuar emrit të tij edhe titullin e “*dukës së Durrësit*” (*douka Dra~ki*)⁵⁰. Në këtë mënyrë zotërimet veriore dhe ato jugore të Balshajve u lidhën midis tyre me një vazhdimësi territoriale, pra me viset e Arbërisë së Mesme, duke krijuar në këtë mënyrë shtetin më të madh mesjetar arbëror deri në atë kohë. Pushteti suprem i Balshajve, në fakt, duhet të jetë shtrirë edhe në një pjesë të viseve të sotme të Maqedonisë Perëndimore. Është fjala Ohrin me rrethinë, që siç dihet, pas vitit 1380, ishte nën sundimin e princit të Arbit, Karl Topisë⁵¹. Pra ky i fundit, logjikisht u ndodh nën pushtetin suprem të Balshës II, i cili, me sa duket, në funksion të këtij realiteti të ri, edhe një herë ua vërtetoi tregtarëve raguzanë të gjitha privilegjet, të cilat qysh më herët ua kishte dhënë vëllai i tij Gjergji I dhe ai vetë⁵².

Këto suksese të Balshajve shpejt ranë nën hijen e rrezikut osman, që trokiste në derë. Rrjedhimisht, në dhjetëditëshin e parë të gushtit të vitit 1385, Balsha II, përmes ambasadorit të tij, njoftonte Republikën e Venedikut se osmanët sulmonin e shkretonin atdheun e tij për çdo ditë. Prandaj, nëse nuk do t'i jepej ndihma sa më shpejt, zotërimet e tij do të shpartalloheshin⁵³. Mirëpo, Republika u tregua e shurdhër ndaj shqetësimeve të paraqitura.

Mosveprimin e Republikës së Shën Markut kundrejt kërkesave të Balshës II duhet parë në kontekst të disa faktorëve, të cilët ndikonin në mënyrën e veprimit të saj në politikën e jashtme. Në këtë kuadër, pas dhënies fund të luftës hungarezo-venedikase (1356-1358), me paqen e Zarës (18 shkurt 1358), Republika hoqi dorë

⁴⁸ *Историја Црне Горе*, II/2, f. 43; С. Ђирковић, *Историја средњовековне босанске државе*, f. 151; P. Bogdani, *Lufta e Principatës së Balshajve ...*, f. 57.

⁴⁹ P. Ђук, v. c., f. 91; *AAV*, I/2, nr. 305, f. 19-20.

⁵⁰ *Monumenta serbica*, nr. CXCII, f. 202; *Законски споменици*, nr. LX, f. 197.

⁵¹ Përshkrimi i cili hedh dritë për sundimin e Karl Topisë në Ohër është shkruar në margjinat e një buletini grek të Gjon Lestiqnikut të kryepeshkopatës së Ohrit, si koncept i letres të igumenit të manastirit të Klimentit, Gjevrasiu. Në këtë dorëshkrim Karli përmendet si *ktitor* i manastirit të përmendur dhe *sundimtar* i viseve perëndimore dhe të bregdetit (Ц. Грозданов, v. c., f. 20-21).

⁵² *Monumenta serbica*, nr. CXCII, f. 202-203; *Законски споменици*, nr. LX, f. 197-198; *Burime të zgjedhura*, nr. 113, f. 186-187.

⁵³ *AAV*, I/2, nr. 300, f. 13; *A. Alb.*, II, nr. 389, f. 93.

nga qytetet që zotëronte në bregun lindor të detit Adriatik (Zarë, Shibenik, Split, Raguzë etj.), në favor të Hungarisë. Madje asaj i ndalohej të shtrinte pushtimet e saj në Dalmaci nga Kuarneri deri në Durrës⁵⁴. Këto vendime u konfirmuan edhe nga paqja e Torinos (1381), e cila i dha fund konfliktit midis Venedikut dhe Gjenovës (1378-1381), ku në anën e kësaj të fundit ishin Hungaria, duka i Austrisë, zoti i Padovës dhe një numër sundimtarësh të vegjël italianë. Megjithatë, Venedikut iu njoh sovraniteti mbi detin Adriatik, përkundër pretendimeve të Hungarisë, e cila u kënaq me një dëmshpërblim vjetor prej 7 000 dukatesh. Në rrethana të këtylla, Republikës i mbetej vetëm të respektonte marrëveshjet e përmendura, parim që, ajo, si fuqi tregtare, e zbatonte, gjithnjë në funksion të ruajtjes të së drejtës tregtare në të gjithë Lindjen. Prandaj, përzierja e saj në zhvillimet e bregut lindor të detit Adriatik, do të binte ndesh me marrëveshjet e arritura. Veç kësaj, kishte edhe faktorë të tjerë. Pas vdekjes së mbretit anzhuin të Hungarisë, Ludovikut të Madh (1382), vëmendja e Republikës Detare u orientua në trazirat që përfshinë fronin hungarez, duke nxjerrë përfitime. Pas vrasjes së mbretit anzhuin të Napolit, Karlit III në trazirat hungareze (shkurt 1386), Republika po atë vit u mori anzhuinëve ishullin e Korfuzit. Njëkohësisht, ajo pamundësoi pretendimin e Anzhuinëve të Napolit mbi fronin hungarez dhe ndihmoi Sigismundin e Luksemburgut, të birin e perandorit Karli IV*, të merrte fronin e Mbretërisë së Hungarisë (1387)⁵⁵. Të gjitha këto zhvillime dhe “besnikëria venedikase” ndaj marrëveshjeve të sipërpërmendura, veçse e largonin përkohësisht vëmendjen e Republikës për zhvillimet në shtetin e Balshajve, në momentin më të vështirë të ekzistencës së tij. Politika e sipërpërmendur e Republikës Detare e la Balshën II të vetmuar përballë rrezikut osman. Në mungesë burimesh historike, zakonisht rënia e Kosturit dhe e Ohrit nën sundimin osman lidhet me ekspeditën ushtarake osmane të vitit 1385⁵⁶. Rrjedhimisht ushtria osmane prej 5 000 vetash*, duke shkretuar viset nëpër të cilat

⁵⁴ V. Foretić, v. c., f. 131, 136; L. Malltezi, *Përprjekjet dhe synimet e Venedikut për pushtimin e Durrësit (1386-1392)*, në: “Studime për epokën e Skënderbeut”, II, Tiranë, 1989, f. 126.

* Karli IV i Luksemburgut (1316-1358) nga viti 1346 ishte mbret i Çekisë. Meqë ishte në marrëdhënie të mira me papën, u kurorëzua mbret i Lombardisë dhe më pas perandor i Perandorisë së Shenjtë Romake-Gjermane (1355) (*Enciklopedijski leksikon – Istorija*, Beograd, 1970, f. 319).

⁵⁵ O. J. Schmit, *Das venezianische...*, f. 41-42, 218; I njëjti, *Arbëria...*, f. 43-44, 217-218

⁵⁶ A. Стојановски, *Градовите на Македонија од крајот на XIV до XVII век*, Скопје, 1981, f. 16-17.

* Humanisti shqiptar M. Barleci njofton se ushtria osmane, në krye me *Hieurenezin* (Evrenozit – Q. D.), numëronte 40 000 veta (M. Barleci, v. c., f. 36). Konsiderojmë se ky numër është i stërmadhuar, prandaj si më realë duket numri prej 5 000 ushtarësh që e thotë: M. Орбин, v. c., f. 70-71. Ndërsa sa i përket Evrenozit, disa studiues mbrojnë qëndrimin se megjithatë bëhet fjalë për bejlerbeun e Rumelisë Timurtash Pashën (K. Biçoku, *Skënderbeu dhe Shqipëria në kohën e tij*, Tiranë, 2005, f. 50; *Historia e popullit shqiptar*, I, 374). Gjithashtu nuk mund të përjashtohet edhe mundësia që Timurtash Pasha, që komandonte gjithë ushtrinë (në Rumeli – Q. D.), të ketë dërguar në Savër vetëm një pjesë të forcave të veta, duke i vënë nën komandën e Evrenozit (S. Pulaha, *Luftërat shqiptaro-turke në veprat e kronistëve dhe historianëve osmanë të shekujve XV-XVII*, Studime për epokën e Skënderbeut, III, Tiranë, 1989, f. 404), apo të kenë marrë pjesë që të dy. Studiues të tjerë konsiderojnë se forcat osmane komandoheshin nga Hajredin Pasha (G. Gelcich, v. c., f. 134; K. Лиречек, *Историја Срба*, II, f. 83; A. Buda, *Lufta e popullit shqiptar kundër pushtimit turk*, Shkrime historike, 3, përgatiti dhe redakti T. Haxhimihali, Tiranë, 2002, f. 228; Xhufi P., *Dilemat e Arbërit - Një studim mbi Shqipërinë e shek.*

kalonte arriti deri pranë Beratit. Balsha II, pasi u njoftua për këtë inkursion, përkundër faktit se bashkëpunëtorët e tij feudalë e këshilluan që t'i ikte konfrontimit me ushtrinë osmane deri sa të mblidhte një ushtri më të madhe, me nxitim dhe pa përgatitjen e duhur vetëm me 1 000 kalorës, marshoi nga Durrësi, dhe i doli përpara armikut. Beteja u zhvillua më 18 shtator 1385, në veri të Beratit, në fushën e Savrës pranë Lushnjës. Balsha II përballë ushtrisë shumë më të fuqishme osmane, tregoi një heroizëm të vërtetë. Ai madje për pak nuk ia doli t'u rezistonte osmanëve. Si rezultat i luftimeve të përgjakshme, u vranë shumë ushtarë nga të dyja palët. Në mesin e tyre qe edhe vetë Balsha II, kokën e të cilit osmanët e morën me veti si trofe lufte. Njëkohësisht shumë ushtarë të sundimtarit të vranë përfunduan në robërinë osmane⁵⁷.

Disfata në Savër tronditi rëndë shtetin e Balshajve. Nga trangu i tij u shkëputën zotërimet e Arbërisë Jugore, të Arbërisë së Mesme dhe të Kosovës⁵⁸. Gjendja u bë e paqëndrueshme edhe në zotërimet e mbetura në veri, në krye të të cilave u vu nipi i Balshës II, respektivisht djali i Strazimir Balshës, Gjergji II Balsha (1385-1403). Nga pushteti i tij, të parët u shkëputën vëllezërit Sakati-Zaharia, ndërsa Dukagjinët u pavarësuan në Zadrimë dhe në Lezhë. Midis Durrësit dhe Drinit (ose më saktësisht midis Rrëshenit dhe Lezhës – Q. D.) në mënyrë të pavarur qeverisnin Jonimët. Në Zetën e Epërme u pavarësuan Cërnojeviçët, të cilët mbështeteshin nga fqinjët e tyre, zotërinjtë boshnjakë dhe mbreti Tvërtko. Zotërimet feudale të Cërnojeviçëve përfshinin masivin malor mbi Grykën e Kotorrit dhe Buduës, një fshat në Tejbunë (Oblik) dhe dy fshatra në rrethin e Shkodrës (Samarishi dhe Grisha), si dhe disa fshatra në Zetën e Epërme, në kufij me Bosnjën⁵⁹. Për rrjedhojë zotërimet e Balshajve u rruhdën në një zonë të ngushtë që përfshinte Shkodrën, Drishtin, Ulqinin dhe Tivarin⁶⁰, ndërsa Gjergji II hyri nën vasalitetin osman⁶¹.

XI-XVI, Tiranë, 2006, f. 320). Në këtë rast po përmendim se Evrenoz Beu ishte komandant i forcave kufitare në Ballkan, kurse Hajredin Pasha vezir (K. Frashëri, v. c., f. 38).

⁵⁷ М. Орбин, v. c., f. 70-71; М. Барлеци, v. c., f. 36; *Историја Црне Горе*, II/2, f. 48.

⁵⁸ P. Bogdani, *Prirjet drejt bashkimit shtetëror të trojeve shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XIV dhe në fillim të shek. XV*, në: "Studime për epokën e Skënderbeut", III, Tiranë, 1989, f. 11. Gjerësisht për pushtetin e Balshajve në Kosovë deri në vitin 1385 shih: P. Bogdani, *Kosova ...*, f. 109-121.

⁵⁹ М. Орбин, v. c., f. 71-72; *Историја Црне Горе*, II/2, f. 50.

⁶⁰ L. Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas (1392-1478)*, Tiranë, 1988, f. 53.

⁶¹ М. Орбин, v. c., f. 72.

FAUZI SKENDERI

**DISA VEÇORI GJEOGRAFIKE TË
VENDBANIMEVE RURALE NË TREVAT
SHQIPTARE NË MAQEDONI**

Hyrje

Në Maqedoni dhe në hapësirën shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore kanë ndodhur transformime të mëdha në aspektin socio-ekonomik të mjedisit rural për shkak të zhvillimit jo të njëjtë ekonomik në tërë vendin, si pasojë e një politike diskriminuese ndaj trevave shqiptare të pushtetit sllavo-komunist maqedonas gjatë kësaj periudhe. Për rrjedhojë, kjo ka lënë gjurmë në planin e zhvillimit dhe transformimit të zonave rurale. Duke pasur parasysh dallimet që ka bërë pushteti qendror maqedonas në aspektin e zhvillimit më të shpejtë të hapësirave të populluara kryesisht me popullsi sllave, kjo ka ndikuar në përshpejtimin e egzodit të fshatrave sllavo-maqedonase drejt qendrave urbane, duke lënë pasojë socio-ekonomike për fshatrat e zbrazura në zonat kodrinore malore të vendit. Nga ana tjetër, është lënë pas dore zhvillimi ekonomik i trevave shqiptare, e kjo ka ndikuar në ngadalësimin e egzodit të popullsisë shqiptare nga zonat rurale, të cilat sot me të vërtetë paraqesin zona më kompakte rurale në vend, edhe pse ato në dy dekadat e fundit kanë filluar të preken nga “erozioni” i emigracionit ekonomik të shqiptarëve të këtushëm në botën e jashtme. Si do që të jetë ky kontribut i vogël shkencor paraqet ndoshta qasjen e pare nga një studiues shqiptar i këtushëm sa i përket zhvillimit dhe transformimit të zonave rurale shqiptare në Maqedoni, përkatësisht të vendbanimeve rurale në te.

Në vazhdim të këtij punimi do të bëhet fjalë për veçoritë e përgjithshme të vendbanimeve rurale, përhapjen gjeografike të fshatrave, përhapjen e fshatrave në varësi të relievit, përhapjen e fshatrave në varësi të akseve të rëndësishme rrugore, përhapjen e fshatrave në varësi të qendrave urbane, dhe përhapjen e vendbanimeve rurale sipas komunave.

Karakteristikat e përgjithshme të vendbanimeve rurale


Vendbanimet rurale në trevat shqiptare në Maqedoni kanë përjetuar transformime të mëdha ekonomiko-shoqërore, sidomos gjatë gjysmë shekullit të kaluar. Si rezultat i kushteve të ndryshme natyrore, historike dhe social-ekonomike, në hapësirën shqiptare në Maqedoni janë formuar tipa të ndryshëm të vendbanimesh rurale, të cilët dallojnë nga pozita, madhësia, pamja (fizionomia), funksionet etj. Ato paraqesin një mozaik të vërtetë, me ndryshim të shpejtë, veçanërisht pas vitit 1990, kur disa fshatra të zonave të thella malore filluan të shpopullohen me ritme të shpejta, të tjerë, me pozitë dhe kushte më të përshtatshme se të parët, mbeten thuajse të pandryshuar dhe, disa të tjerë, pranë rrugëve të rëndësishme të komunikacionit dhe qendrave urbane, njohën rritje të popullsisë dhe të sipërfaqes, zhvillim të ekonomisë, infrastrukturës etj. Fshatrat përbëjnë njësi të veçanta administrative, popullsia e të cilëve merret kryesisht me ekonomi bujqësore. Vendbanimet rurale kanë mënyrën e tyre të jetës dhe të funksionimit, organizimin e tyre, institucionet “qeverisëse”, arsimore, kulturore etj. Pra, fshatrat nuk janë thjesht vendbanime në hapësirën rurale, por edhe organizma administrative, social-kulturore dhe ekonomike, që zhvillohet në kohë dhe hapësirë. Krahasuar me vendbanimet urbane, ato rurale ndryshojnë më ngadalë, sepse vetë popullsia (më patriarkale se ajo urbane) është e prirur ta pranojë më vështirë të renë (ndryshimin) në të gjitha aspektet e jetës e të veprimtarisë social-kulturore dhe ekonomike. Kjo është arsyeja pse në fshat ruhen më gjatë marrëdhëniet, traditat, zakonet, doket, shprehitë e punës etj. Por, edhe në këtë aspekt ka dallime midis fshatrave të izoluara malore dhe atyre pranë qendrave urbane. Këto të fundit i pranojnë ndryshimet (urbanizuese dhe modernizuese) më shpejt dhe më me pak “dhimbje”. Gjithsesi, fshati i sotëm nuk mund të konsiderohet më si antipod i qytetit. Përkundrazi, ai po bëhet çdo ditë e më shumë vendbanim i prodhuesve bujqësorë dhe jobujqësorë. Deri më tani studiumit të vendbanimeve rurale në hapësirën shqiptare në Maqedoni i është kushtuar shumë pak vëmendje, megjithëse njohja e ecurisë së proceseve historike, social-kulturore, ekonomike dhe mjedisore të tyre ka rëndësi shumë të madhe për hartimin e strategjive dhe të politikave të organizimit hapësinor, rregullimit dhe zhvillimit rural etj. Interes të veçantë në aspektin gjeografik paraqesin koha, kushtet dhe faktorët që kanë ndikuar në formimin e fshatrave dhe evolucionit të tyre demografik e hapësinor. Si kudo tjetër, edhe në hapësirën shqiptare në Maqedoni, në formimin dhe zhvillimin e fshatrave kanë ndikuar një seri faktorësh, si: relievi, pasuritë ujore, kushtet historike, social-ekonomike, mundësitë për komunikim etj. Në hapësirën shqiptare në Maqedoni gjenden 720 fshatra ose 48,1 % të 1.644 fshatrave të Maqedonisë. Në shkallë vendi, një fshati i takojnë 15,3 km², ndërsa në hapësirën shqiptare 15,4 km². Largësia mesatare në mes fshatrave në shkallë vendi është 15 km, ndërsa në HSHM (hapësira shqiptare në Maqedoni) 12 km.

Përhapja gjeografike e fshatrave*Tabela . Numri, dendësia për 100 km² dhe sipërfaqja mesatare e çdo fshati.*

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja në km ²	Numri i fshatrave	Fshatra për 100 km ²	Sipërfaqja mesatare e territorit që i takon çdo fshati
1.	Maqedonia	25.713	1.644	6,4	15,3 km ²
2.	H. Shqiptare	12.382	790	6,5	15,4 km ²

Burimi: *ESRM (Të dhënat i përpunoi autori).*

Në shkallë vendi, në çdo 100 km² gjenden 6,4 fshatra, ndërsa në hapësirën shqiptare 6,5 fshatra. Largësia mesatare në mes vendbanimeve fshatare në shkallë vendi është 15 km, ndërsa në hapësirën shqiptare rreth 12 km¹.



Harta 1. Përhapja gjeografike e vendbanimeve fshatare në Hapësirën Shqiptare në Maqedoni*

* A. Pushka: Kosova dhe vazhdimsia etnike shqiptare (Atlas), Prishtinë, 1999.

Përhapja e fshatrave në varësi të relievit

Rol të rëndësishëm në përhapjen gjeografike të fshatrave kanë faktorët natyrorë, veçanërisht relievi. Zakonisht më të pëlqyeshme për ndërtimin e vendbanimeve janë rrëzat e maleve dhe kodrave, si dhe shpatet e buta të tyre, me qëllim që të mund të shfrytëzohen mundësitë që krijon fusha për veprimtari bujqësore dhe mali për blegtori e pylltari. Siç është përmendur më lart, fshatrat më të mëdha të hapësirës shqiptare në Maqedoni gjenden pikërisht në rrëzën lindore të Sharrit, midis Tetovës dhe Gostivarit.

Përhapja e vendbanimeve rurale ndryshon në varësi të formave të relievit. Pjesa më e madhe e fshatrave janë përqendruar në territoret më të rrafshëta. Numri i fshatrave dhe dendësia e tyre në këto territore paraqitet si vijon:

Në *Pellagoni* ndodhen 291 fshatra ose 36,8 % të vendbanimet rurale të hapësirës shqiptare, me dendësi mesatare 8,8 fshatra për 100 km².

Në *fushëgropën e Pollogut* gjenden 177 fshatra ose 22,5 % të numrit vendbanimeve rurale të hapësirës shqiptare, me dendësi mesatare 7,3 fshatra në 100 km².

Në *fushëgropën e Kërçovës (Uskanës)* (rrjedhja e sipërme e lumit Ilirida) gjenden 132 fshatra ose 16,8 % të vendbanimeve rurale të hapësirës shqiptare, me dendësi mesatare 6,5 fshatra në 100 km².

Në *fushëgropën e Shkupit* ka 122 fshatra ose 15,5 % të numrit të fshatrave të hapësirës shqiptare, me dendësi mesatare 6,5 fshatra për 100 km².

Në *fushëgropën e Ohrit dhe Strugës* janë përqendruara 101 vendbanime rurale ose 12,8 % e numrit të fshatrave në hapësirën në studim, me dendësi mesatare 6,4 vendbanime në çdo 100 km².

Fshatrat në hapësirën shqiptare në Maqedoni janë të pranishme në të gjitha tipat e relievit, kështu që ata dallohen nga lartësia mbi nivelin e detit dhe nga morfologjia e territorit. Ky element i pozitës së fshatrave është tregues i rëndësishëm i mundësive të tyre për komunikim me qendrat komunale dhe qytetet, për ushtrimin e veprimtarive jobujqësore dhe shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këto të fundit, si: administrative, shëndetësore, arsimore, kulturore etj. Gjithashtu, ky element mundëson shkallë të ndryshme të intensitetit të veprimtarive bujqësore dhe të procesit të urbanizimit. Në varësi të relievit, vendbanimet rurale klasifikohen në: fushore (në terren të rrafshët), kodrinore dhe malore. Në hapësirën shqiptare mbizotërojnë *fshatrat fushore*, të cilat përbëjnë rreth 50 % të vendbanimeve rurale. Kjo kategori e vendbanimeve gjendet në fushëgropa, gropa dhe lugina. Kështu, 320 të tilla gjenden në fushëgropën e Shkupit, Pollogut dhe Pellagonisë; 51 në rajonin e Ohrit dhe Strugës, dhe 23 në atë të Prespës. *Fshatrat kodrinore* janë gjithsej 274 ose rreth 50 % e vendbanimeve rurale të hapësirës shqiptare. *Fshatrat malore* përbëjnë rreth 17 % e vendbanimeve rurale të hapësirës shqiptare. Vetëm në rajonin e Pollogut gjenden 52 fshatra të kësaj kategorie. Si në shkallë vendi (42,4 %), ashtu edhe në hapësirën shqiptare (47,2 %) mbizotërojnë fshatrat e ndërtuara në terrene të rrafshëta, ku kushtet për veprimtari ekonomike janë më të përshtatshme, ndërsa fshatrat malore po shkojnë drejt shuarjes (zhdukjes), si rezultat i largimit të popullsisë, për shkak të kushteve të vështira për jetesë.

Tabela 2. Klasifikimi i fshatrave sipas formave të relievit (viti 2002)

Nr	Tipi i fshatrave	Republika e Maqedonisë		Hapësira Shqiptare	
		Numri i fshatrave	%	Numri i fshatrave	%
1.	Fushore	683	42.4	340	47.2
2.	Kodrinore	632	39.2	260	36.1
3.	Malore	295	18.4	120	16.7

Burimi: *Si te pasqyra e mëparshme*

Dallimin midis fshatrave shqiptare dhe atyre sllave në aspektin e lartësisë mbi nivelin e detit duket në rastin e malësisë së Tetovës, ku fshatrat me popullsi shqiptare janë në numër të madh dhe me shumë banorë. Të tillë janë: Bozovca me 1.012 banorë, Brodeci (553 banorë), Vica (381 banorë), Veshalla (1.054 banorë), Gajrja (802 banorë), Pallçishti i Epërm (1.166 banorë), Xherma (991 banorë), Llaca (268 banorë), Lisjani (814 banorë), Rakoveci (828 banorë), Sellca e Keqe (308 banorë), Shipkovicica (2.571 banorë), si dhe Jellovjani (719 banorë) e Urviçi (811 banorë). Në të njëjtën lartësi mbi nivelin e detit dhe në të njëjtat forma të relievit, fshatrat sllave kanë shumë më pak banorë. Të tillë janë: Brezna me 2 banorë, Barbari 7, Jedoarca 11, Setola me 7, Jelloshniku -, Otuja² -. Me gjithë përpjekjet e shumta të pushteti maqedonas për t'i mbajtur “gjallë” fshatrat sllave, nëpërmjet rregullimit të infrastrukturës dhe investimeve për zhvillimin e bujqësisë dhe të sektorëve jobujqësorë, tashmë këto fshatra mund të konsiderohen të shpopulluar. Interesimin e pushtetit maqedonas për të mos lejuar shpopullimin e fshatrave me popullsi maqedonase në hapësirën shqiptare e tregon edhe formimi i komunës rurale të Stravinës (në jug të Manastirit) me gjithsej 10 fshatra, 323 banorë dhe vetëm 26 banorë në qendrën e komunës (Stravinë). Fshatrat e tjerë të kësaj komune janë: Burniku me 8 banorë, Budimirci 42 banorë, Gradmanci 112 banorë, Grunishti 3 banorë, Zoviçi 55 banorë, Iveni 7 banorë, Makova 98 banorë, Rapeshi 74 banorë dhe Orel 26 banorë. Po kështu, në veriperëndim të Strugës është formuar komuna e Vevçanit, vetëm me një fshat të banuar nga maqedonas.

Tabela 3. Shpërndarja e fshatrave sipas lartësisë mbi nivelin e detit (viti 2002)

Nr.	Lartësia e fshatrave	Republika e Maqedonisë		Hapësira Shqiptare	
		Nr. i fshatrave	Në %	Nr. i fshatrave	Në %
1.	Deri 300 m	212	13.2	66	9.2
2.	301–500 m	306	19.1	130	18.1
3.	501–800 m	665	41.3	342	47.5
4.	801–1000 m	260	16.1	103	14.3
5.	Mbi 1000 m	167	10.3	79	10.9

Burimi: *ESRM (Të dhënat i përpunoi autori).*

Hapësira shqiptare në Maqedoni karakterizohet nga përqendrimi i vogël i fshatrave (vetëm 9,2 % e numrit të fshatrave) në lartësitë nën 300 m dhe nga përqendrim i madh i tyre (47,5 %) në lartësitë 501-800 metra. Gjithsesi, pjesa më e madhe e fshatrave (73,5 % në shkallë vendi dhe 75 % në hapësirën shqiptare) shtrihen në lartësitë deri në 800 metra. Kjo tregon se kushtet më të mira për jetesë gjenden pikërisht deri në këtë lartësi.

Një klasifikim më përgjithësues i vendbanimeve rurale, bazuar në lartësinë mbi nivelin e detit, do t'i ndante ata në tri grupe:

deri 500 metra,

501-1000 metra.

mbi 1000 metra.

Tabela 4. Kategorizimi i vendbanimeve rurale sipas lartësisë mbi nivelin e detit (vitin 2002)

Nr	Lartësia mbi nivelin e detit	Maqedonia		Hapësira shqiptare	
		Numri i fshatrave	%	Numri i fshatrave	%
1.	Deri në 500 m.	516	31.4	172	21.8
2.	501–1000 m.	949	57.8	529	66.9
3.	Mbi 1000 m.	179	10.8	89	11.3
	Gjithsej	1644	100.0	790	100.0

Burimi: *Si te tabela e mëparshme.*

Nga të dhënat e mësipërme del se vendbanimet rurale në hapësirën shqiptare gjenden në lartësi mesatare më të mëdha se ato të Maqedonisë në tërësi. Këto dallime hipsometrike të vendbanimeve rurale shpjegohen me faktin se hapësira shqiptare ka lartësi më të madhe mbidetare se mesatarja në shkallë vendi dhe se pjesa lindore e juglindore e Maqedonisë.

Shpërndarja e fshatrave sipas lartësisë në hapësirën shqiptare paraqitet si vijon: deri në lartësinë 500 metra ndodhen 60 fshatra të fushëgropës së Shkupit dhe 63 fshatra të rajonit të Velesit;

në lartësinë mbidetare 501-1000 metra ndodhen 279 fshatra në Pellagoni dhe 167 fshatra në rajonin e Pollogut;

në lartësinë mbi 1000 metra ndodhen 18 fshatra përreth Pollogut (pjesa malore), nga dy fshatra në komunën e Strugës dhe të Dibrës dhe një në komunën e Ohrit. Kjo kategori fshatrash ka prirje të zvogëlohet për shkak të largimit të popullsisë drejt qendrave urbane ose fshatrave më të ulëta³.

Përhapja e fshatrave në varësi të akteve të rëndësishme rrugore

Rol të rëndësishëm në përhapjen dhe zhvillimin e fshatrave ka *prania e rrugëve kryesore*. Vendbanimet rurale, ekzistenca e të cilave lidhet me rrugët kryesore, janë dy kategorish:

fshatra që ndodhen në akset (në të dy anët) e rrugëve,

fshatra që gjenden deri në largësinë 3 km nga rrugët kryesore.

Në kategorinë e parë bëjnë pjesë 100 fshatra që gjenden në rreth 1000 km rrugë kryesore të hapësirën shqiptare në Maqedonisë, d.m.th. mesatarisht një fshat në çdo 10 km rrugë. Kështu, në 210 km të rrugës: Shkup-Tetovë-Gostivar-Dibër-Strugë-Ohër gjenden 16 fshatra ose një në çdo 15 km. Nga të dhënat del se numri i fshatrave në aksin kryesor të hapësirës shqiptare është relativisht i vogël. Kjo shpjegohet me faktin se një pjesë e këtij aksi (25 km) është superstradë e ndërtuar vonë (v. 1996) ndërsa pjesa tjetër kalon kryesisht në lugina malore pak të populluara.

Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë 200 vendbanime rurale ose një numër dy herë më i madh se në kategorinë e parë. Të tilla në rrugën: Shkup-Tetovë-Gostivar-Dibër-Ohër-Strugë janë rreth 80 vendbanime rurale, ndërsa në rrugën Ohër-Manastir janë 24 të tillë.⁴

Përhapja e fshatrave në varësi të qendrave urbane

Në hapësirën shqiptare (Maqedonia Perëndimore) numri i fshatrave që i takon çdo qendër urbane është dukshëm më i madh se në Maqedoninë Lindore. Për këtë tregues dallohet sidomos rajoni i Pellagonisë, ku secilës prej tre qendra urbane (Manastiri, Prilepi dhe Bregasi) i takojnë mesatarisht nga 97 vendbanime rurale. Në vend të dytë renditet rajoni i Pollogut, ku secilës prej dy qendrave urbane (Tetova dhe Gostivari) i takojnë mesatarisht nga 89 vendbanime fshatare etj. Por, procesi i boshatisjes dhe i shuarjes së vendbanimeve rurale, që po zhvillohet me intensitet të lartë, do të ndikojë në zvogëlimin e numrit të fshatrave në të ardhmen. Aktualisht, ky proces është më intensiv në Maqedoninë Lindore se në atë Perëndimore (shqiptare). Interes paraqet edhe analiza e vendbanimeve rurale që gjenden brenda *një unaze me rreze 5 km* nga qendrat urbane. Të tilla përreth Shkupit janë 28 fshatra, përreth Tetovës 14, përreth Gostivarit 12, përreth Kumanovës 13, përreth Ohrit 10, përreth Dibrës 10, përreth Manastirit 9, përreth Strugës 8, përreth Resnjës dhe Krushevës (Bregasit) nga 7, përreth Kërçovës (Uskanës) dhe Prilepit 6, përreth Velesit 3.⁵

Përhapja e vendbanimeve rurale sipas komunave

Përhapja e vendbanimeve rurale sipas komunave (Ndarja administrative e vitit 1996) nuk është e njëjtë. Nga njëra anë, në varësi të relievit e të sipërfaqes, nga ana tjetër në varësi të interesave politiko-elektorale të qarqeve drejtuese të Maqedonisë, disa komuna kanë numër të madh fshatrash, disa më të vogël.

Tabela 5. Klasifikimi i komunave sipas numrit të fshatrave (v.2002)

Nr.	Numri limit i fshatrave	Numri i komunave në Maqedoni	Nr. i fshatrave gjithsej	Nr. komunave në hapësirën Shqiptare	Nr. I fshatrave gjithsej
1.	deri 50 fshatra	20	562	3	66
2.	50-100 fshatra	9	626	6	357
3.	mbi 100 fshatra	4	456	4	367

Burimi: ESRM (Të dhënat i përpunoi autori)

Në varësi të numrit të fshatrave (të dhëna të vitit 2002), komunat në hapësirën shqiptare në Maqedonisë klasifikohen në tri kategori:

me mbi 100 fshatra: 4 komuna,

me 50 deri në 100 fshatra: 6 komuna,

me më pak se 50 fshatra: 3 komuna⁶.

Literatura:

- Skenderi, F.(2005) Popullsia dhe vendbanimet shqiptare në Maqedoni, Kumanovë.
 Skenderi, F.(2000) Popullsia e Pollogut të Poshtëm, Shkup.
 Selmani, A.(2005) Popullsia e Maqedonisë, Shkup.
 Skenderi, F.(1999) Vështrimi socio-gjeografik i vendbanimeve urbane në Hapësirën Shqiptare në Maqedoni, Tiranë.
 Skenderi, F.(1999) Hapësira gjeografike shqiptare në Maqedoni dhe integrimi i saj në gjithëhapësirën shqiptare në Ballkan, Tiranë.
 Селмани, А.(1986) Некои социо-географски карактеристики на селските населби во општина Дебар, Скопје.
 Лаçi, S. (1999) Shqiptarët e Maqedonisë, Tiranë.
 Pushka, A.(1997) Kosova dhe vazhdimia etnike shqiptare/Kosova and its ethnic albanian continuity, Prishtinë,
 Панов, М.(1996) Општините во Македонија, Скопје.
 Панов, М.(1967) Географија на СР Македонија, Скопје.
 Панов, М.(1998) Енциклопедија на селата во Македонија, Скопје.

SADIK KRASNIQI

ZHVILLIMI I MUZEOLOGJISË NË KOSOVË

Interesimet e para në fushën e Muzeologjisë në Kosovë

Kosova për shkak të pozitës gjeografike dhe strategjike ka qenë një nga udhëkryqet e Evropës, e cila lidhte Lindjen me Perëndimin. Për shkak të interesave të Fuqive të Mëdha të kohës gjithmonë ka qenë arenë e shumë ngjarjeve historike, të cilat i tejkalojnë suazat kombëtare. Për këtë arsye trashëgimia e saj kulturore është shkatërruar, plaçkitur dhe tjetërsuar në masë të madhe. Një numër i vogël i thesareve që kanë mbijetuar, sot gjenden në institucionet kulturo-muzeale qendrore dhe lokale në Kosovë, kurse një pjesë tjetër e tyre ende ruhen në popull. E kaluara historike tregon më së miri për ndikimet e kulturave të ndryshme që interferuan në kulturën tonë. Me plot të drejtë mund të pohojmë se në këtë trevë u shtresua një thesar i madh shumëkulturore, duke filluar që nga preilirët, ilirët-dardanët, romakët, sllavët, e deri te osmanët (turqit). Të gjithë sundimtarët e popullit shqiptar në përgjithësi e të Kosovës në veçanti (si romakët, bizantinët, osmanët dhe sllavët) lanë gjurmë të mëdha në traditën kulturore. Thesaret e para muzeale janë krijuar, ruajtur dhe zhvilluar prej kohëve më të hershme dhe kanë evoluar në mënyra dhe forma të ndryshme deri te kohët e sotme. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë se ruajtësit (Trezorimi) më të mirë të thesarit muzeor në Kosovë ishin: objektet e kultit, kishat dhe manastiret e hershme paleokristiane-mesjetare, xhamitë, teqetë, tyrbet, por edhe nga familjet feudale. Eksponatet me vlera të larta muzeale që ruheshin me fanatizëm nga dashuria për të parët ishin: gjësendet e ndryshme personale të familjes, armë dhe relikte të tjera me karakter fetar dhe laik. Krahas popujve evropianë, edhe ne kemi treguar një interesim të veçantë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Tradita jonë në këtë fushë tregon se shumë monumente sot hyjnë në radhën e realizimeve më me vlera të qytetërimit dhe kulturës evropiane e botërore.¹ Kosova posedon një thesar të çmueshëm duke filluar që nga koleksionet e kishave, manastireve mesjetare siç janë: Manastiri i Deçanit, Patriarkana e Pejës,

¹ Mr. Tefik Morina, Rruga e zhvillimit dhe perspektiva e muzeve të Kosovës, "Buletini i Muzeut të Kosovës, nr. XII", Prishtinë, 1974, fq. 216-217.

Graçanicës, etj. Thesari i Manastirit të Deçanit është një ndër më të pasurit dhe më të ruajturit në raport me kishat dhe manastiret e tjera, përjashtim bën vetëm Manastiri i Hilandarit në Malin e Shenjtë. Koleksionet ndër më kryesoret janë: gjësende prej metaleve fisnike, dorëshkrime të rralla, koleksioni i pasur kryqesh, që i takojnë shek. XIV, koleksioni i gotave prej 15 sosh të gjitha prej argjendi, ndër to më e bukura është gota e mitropolitit të Novobërdës që i është dhuruar Deçanit më 1593.

Koleksioni i pasur me qemer dhe pafta të shek. XVII, XVIII, XIX, koleksioni i panagjive, në të cilin një vëmendje e posaçme i kushtohet panagjisë së mitropolitit të Vuçitërnës, Nikiforit, i shek. XVI, koleksioni i kandilave, që përbëhet prej 100 sosh, punuar prej argjendi, që i takojnë shek. XVII, XVIII, XIX. Nga Koleksioni i ikonave të shekujve XVI-XVII, më kryesoret ndër to janë: ikonat biografi të Stefan Deçanit, dhe ikona më e bukur e Shën Mëria e Pelagonisë me Krishtin në prehër; nga punimet e drurit ndër më kryesori është sarkofagu me drugdhendje, i derdhur me argjend, që i takon shek. XIV. Ndërsa dy sarkofagë e tjerë të gdhendur gjatë shek. XIX janë punime të mjeshtërve dibranë, etj.

Thesaret e Manastirit të Graçanicës kryesisht përbëheshin nga këto koleksione: ikonat dhe librat dorëshkrimore, ku veçohet ikona e Krishtit, gjykatësit të tmerrshëm, dhe ikona e evangjelistit Lukë e shek. XVI. Dorëshkrime gjithsej 17 sosh, 20 fragmente të librave të shkruara me dorë të shekujve XIV-XVI, etj. Thesare të pasura kishte edhe Patriarkana e Pejës, por ngjarjet e kohës së Luftës Austro-Turke (1683-1689) ishin tragjike edhe për koleksionet e pasura të kësaj kishë. Turqit nën udhëheqjen e Jegen Pashës më 1688 gjetën pasurinë e këtij thesari të fshehur në një kube të Graçanicës dhe të tërin e morën me vete. Patriarkana e Pejës shquhej me koleksionin e ikonave, koleksionin e metaleve fisnike të përbërë prej disa kryqeve të punuar në shek. XVII-XIX. Në këtë kuadër, një rrallësi interesante paraqet klisheja e këtij thesari me drugdhendje, të cilin e punoi Haxhi Ruvim Neshkoviqi, arkimandriti i Manastirit të Bogovatës i vitit 1797.² Sundimi turk në fund të shek. XV shkaktoi ndryshime të mëdha në Ballkan, duke përfshirë këtu dhe Shqipërinë e Kosovën. Me këtë rast ndikimi i kulturës osmane u vërejt shumë si në zakone, arkitekturë, kostume, sidomos nëpër ato vende që e përqaftuan islamin. Që nga kjo periudhë në Kosovë është ruajtur një numër i madh përmendoresh dhe objektesh me arkitekturë osmane siç janë: xhamitë, tyrbet, teqetë, hamamet, urat, etj. Shumë prej këtyre objekteve në brendësi përmbajnë koleksione të ndryshme muzeale kryesisht të ritit fetar mysliman. Xhamia e Mehmet Pashës në Prizren, përkatësisht biblioteka e saj posedon pasurinë më të madhe të vlerave kulturo-muzeale të dorëshkrimeve të vjetra islame në Kosovë. Koleksionet e dorëshkrimeve islame të kësaj xhamie përmbajnë mbi dy mijë ekzemplarë, në të ruhet edhe një ekzemplar i Kuranit i shkruar në vitin 1312, që konsiderohet më i vjetri i dorëshkrimeve në të. Në këtë Kuran ekzistojnë shënime në gjuhën arabe, që flasin edhe për Sinan Pashën, i cili ka lënë në testament disa shënime në vitin 1589 për Xhaminë e Mehmet Pashës në Prizren. Disa dorëshkrime të kësaj biblioteke hyjnë në radhën e kryeveprave të kaligrafisë arabe dhe të artit

² Mr. Tefik Morina, pun. i cit., f. 223-228.

dekorativ oriental. Ekzistojnë disa vepra interesante me karakter shkencor si nga historia, matematika, filozofia, medicina, astronomia, etj. Aty gjendet edhe kopja e KANONIT të autorit më të njohur nga medicina arabe Arcenë (Ibni Sinaid). Koleksione të dorëshkrimeve islame janë ruajtur edhe nëpër disa xhami të tjera në Kosovë, si në Xhaminë e Hadumit në Gjakovë, në këshillin e Vakëfit në Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, etj. Koleksionet e tyrbeve në Kosovë janë: Tyrbja e Muratit më kryesorja që posedon një koleksion të çmueshëm si në dorëshkrime, armë të ftohta, etj. Të gjitha këto koleksione u shkatërruan dhe u plaçkitën nga ushtria bullgare gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në Tyrben e Gazimestanit (Bajraktari) ekzistonte një koleksion i varfër, por edhe ky u dëmtua në masë të madhe. Disa prej tyre janë: mbulesa, qilima, kandila, shandanë, fragmente kuranore, etj. Koleksionet e teqeve në Kosovë kryesisht përbëhen nga dorëshkrime islame të vjetra sidomos nga tarikati i dervishëve, gjësende të ndryshme, armë dhe punime nga tekstili. Ekziston dhe ruhet fondi i punimeve të Haxhi Ymer Lufti Paçarrizit (1896-1929) nga Prizreni, i cili në shkrimet e veta përfaqësonte idetë socialiste dhe e përkrahu Revolucionin Socialist të Tetorit. Në Teqenë Melamie të Rahovecit ka punuar dhe i ka ruajtur veprat e veta Sheh Hilmi Maliqi (1865-1928), që konsiderohet prijësi i poezisë shqiptare, së bashku edhe me Shaip Zhurnaxhiu (1884-1951). Koleksione librash, por edhe vegla fetare, armë e tjera ka pasur gjithandej në Prizren, Rahovec, Gjakovë, Pejë, Gjilan, etj.³

Koleksionet e para private muzeore të Kosovës

Koleksionet private, si kudo tjetër nëpër botë, edhe në vendin tonë janë të paraqitura për herë të parë tek pushtetarët, feudalët e pasur, që në një mënyrë apo tjetër e mbanin pushtetin në duart e veta. Krahas këtyre kategorive ka pasur edhe koleksione të tjera që ruheshin nëpër familje të rëndomta. Këta të fundit koleksionet i ruanin më shumë nga dashuria për të afërmit se sa nga vlerat muzeale që mund të kishin ato. Në përgjithësi nëpër këto koleksione ruheshin eksponate me vlera si: gjësende personale të personaliteteve të njohura të vendit, armët e ndryshme, rrobat, shënime dhe dokumente të ndryshme të shkruara në kontekstin kohor. Koleksionet muzeore për herë të parë u shfaqën në gjysmën e dytë të shek XVIII. Gjatë kësaj kohe ato u mblodhën me vetëdije me qëllim të ruajtjes dhe ekspozimit të tyre para mysafirëve të familjes, si dhe para vizitorëve të tjerë të shoqërisë, që kryesisht ishin “shkallë e lartë”.

Koleksioni i parë muzeor në Kosovë ishte muzeu i familjes Xhinolli në Prishtinë. Populli i asaj kohe e quante “Kulla Antike”. Muzeu i familjes së bejlerëve (të pasurit, feudalët) Xhinolli me origjinë shqiptare ishte i artikuluar si institucioni kulturo-historik më interesanti i cili iu ngjasonte oborreve feudale evropiane. Pjesëtarët e familjes Xhinolli ishin: Maliq Pasha, Jashar Pasha, Fuad Begu etj., të cilët në këtë muze ekspozonin eksponate me karakter nga historia dhe etnologjia: armë të vjetra si jatagan, shpata-kordha, pushkë, pancirë dhe pajisje të tjera ushtarake (në mesin e këtyre relikteve ishte edhe xhelatina, me të cilën xhelati i

³ Po aty, f. 229-236

Jashar Pashës priste koka. Aty kishte edhe ekspozite nga etnologjia me përbërje nga tekstili, që ishin shtrojat e ndryshme.

Me pushtimin e Kosovës nga forcat serbe në Luftën e Parë Ballkanike, ky muze plaçkitet dhe tërësisht u shkatërrua në vitin 1912.⁴ Përveç këtij muzeu kanë ekzistuar edhe disa të tjerë siç janë: Koleksioni i rëndësishëm i familjes Bashota në Prizren i shek. XIX, i cili mori formën e muzeut dhe u hap për vizitorë në vitin 1974, pastaj koleksionet e familjes feudale shqiptare të Begollve në Pejë, të familjes së Dragalijve në Mitrovicë, etj.⁵

Koleksioni muzeor i Dimitrie Paramendiçit në Prishtinë konsiderohej të ishte vazhdimësi e dytë muzeore në Kosovë, themeluar nga Dimitrie Paramendiçi, me profesion piktor-skulptor, akademik nga Prishtina, i lindur me 25.10.1911. Ai në vitin 1936 hapi ekspozitën me 80 punime artistike, kryesisht skulptura dhe piktura. Hapjen e kësaj ekspozite publicistika gazetareske beogradase e përshkruan me këto fjalë: “Në Prishtinë u hap Muzeu”. Kjo ekspozitë e Paramendiçit hedh përpjekjet e para të hapjes së Muzeut të Artit Bashkëkohor. Ndërkaq, dy vjet më vonë përmendet muzeu popullor “Kosova”, në të cilin u inkorporua muzeu i mëhershëm i artit bashkëkohor. Nga kjo bazë muzeore më vonë do të formohej Muzeu Krahinor i vitit 1949. Koleksionet e këtij muzeu ishin kryesisht me karakter nga etnografia dhe numizmatika. Koleksionet në fjalë të quajtura Muzeu i Artit Bashkëkohor dhe Muzeu Popullor u shkatërruan gjatë kohës së LNÇ-së (1941-1945). Pas përfundimit të luftës, Paramendiçi vazhdoi punën në mbledhjen e materialeve muzeore, sidomos në krijimtarinë artistike në pikturë dhe skulpturë.

Në vitin 1956 Paramendiçi hapi në shtëpinë e vet Galerinë Artistike, e njohur me emrin “Bozhurja e Kosovës”. Të gjitha veprat e tij kryesisht kishin për motivim Kosovën dhe qytetin e lindjes Prishtinën, prandaj e quajti galerinë e tij “Bozhurja e Kosovës”.

Përpjekjet e Paramendiçit rreth themelimit të një muzeu të Artit Bashkëkohor nuk u realizuan edhe sot. Ai galerinë artistike të hapur në shtëpinë e vet më vonë ia dhuroi qytetit. Me këtë rast është me rëndësi të potencohet fakti se koleksionet e Paramendiçit mbartnin në vete elemente të Muzeut Krahinor të Kosovës e Metohisë të themeluar më vonë.⁶

Muzeu i Kosovës

Institucioni i parë muzeor në Kosovë u themelua në vitin 1949, disa vjet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Ishte i pari i tipit kompleks në territorin e Kosovës, i cili merret me punën e tij profesionale dhe shkencore me hulumtimin, grumbullimin, ruajtjen, prezantimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore-historike të lëvizshme që nga antikiteti e deri në ditët e sotme. Muzeu në fjalë veprimtarinë e vet e filloi me koleksionin e vogël etnografik, ndërkaq më vonë u

⁴ Kadri Halimi, Mbi rolin dhe perspektivat e muzeumeve në Kosovë, “Përparimi”, nr. 1-2, Prishtinë, 1955, f. 55-56.

⁵ Mumin Zeqiri, Udhëheqës i Sektorit të Etnologjisë në Muzeun e Kosovës, të dhënat i dha me 20.12.2011, Prishtinë.

⁶ Mr. Tefik Morina, pun. i cit., f. 239-240

shndërrua në një muze shumëdimensional, që përparonte dita-ditës, duke mbledhur materiale të ndryshme me karakter nga historia, etnologjia, natyra dhe vazhdoi edhe në gjurmimin e gjetjeve arkeologjike.⁷ Në vitin 1951 Muzeu i Kosovës filloi gjurmimet arkeologjike në Artanë (Novobërdë), me ç'rast nga materialet e gjetura arkeologjike u krijua një fond i mirë, i cili mbi këtë bazë po këtë vit organizoi dhe e hapë ekspozitën e parë për publikun, që shënon edhe zyrtarisht veprimtarinë e saj muzeore. Muzeu i Kosovës krahas punës që bënte në fushën e etnologjisë dhe arkeologjisë, po në këtë vit (1951) themeloi edhe Sektorin e Natyrës, bibliotekën, fotolaboratorin dhe punëtorinë zdrukthëtare- preparuese, etj. Sektorin e Natyrës prej vitit 1951 e deri në vitin 1965 shënoi arritje të mira, duke u shkëputur kështu nga Muzeu i Kosovës dhe u shndërrua në Muzeun e Natyrës.

Krahas punës hulumtuese, mbrojtëse dhe prezantuese, gjatë vitit 1956 Muzeu filloi edhe me veprimtarinë shkencore, me botimin edhe të Revistës shkencore “Buletini i Muzeut të Kosovës dhe Metohisë”. Në këtë libër përmbledhës kryesisht botoheshin punime shkencore nga fusha e etnologjisë, arkeologjisë, natyrës dhe historisë së Kosovës në kontekstin muzeor.⁸ Ndërkaq, në tetor të vitit 1959, ky Muze themeloi edhe Seksionin e lëvizjes punëtore dhe të LNÇ-së, së cilës iu kushtua vëmendje e madhe nga pushteti komunist. Madje këtë kaptinë e konsideronin si periudha e lindjes, zhvillimit dhe të ndërtimit të ideologjisë komuniste. Në vitin 1962 Sektorin e ndërtimit socialist, lëvizjes punëtore, u shndërrua në Muzeun e Revolucionit Popullor të Kosovës. Prej 1 janarit të vitit 1963, u bë integrimi i Muzeut Krahinor të Kosovës e të Metohisë, Muzeut Natyror të Kosovës e të Metohisë dhe Muzeut të Revolucionit të Kosovës e të Metohisë. Që prej integritit të tyre Muzeu punon si një institucion unik muzeor me karakter krahinor, me ndryshimin e vetëm që pati kur u themelua Seksioni i mesjetës në vitin 1969, dhe pikërisht në vitin 1970 Muzeu u shpall “Muze amë” në territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.⁹ Muzeu i Kosovës pas luftës fillon punën më datën 6 shtator 1999 dhe vijon edhe me tej në cilësinë e institucionit kryesor të trashëgimisë muzeale në Kosovë.

Sektorin e Arkeologjisë

Me hapjen e Muzeut të Kosovës, krahas seksioneve të tjera, në vitin 1951 u hap edhe Sektorin e Arkeologjisë, i cili bëri një serë gjurmimesh arkeologjike, p.sh. gjurmimet në Artanë (Novobërdë) gjatë viteve 1952-1955. Ndërmjet viteve 1955-1966 hulumtime janë bërë në lokalitetin e quajtur Tjerrtorja afër Prishtinës, si dhe në vendbanimet e periudhës romake si Ulpiana, Municipiumi D.D. etj. Ndërsa prej vitit 1974 fillojnë të merren me gjurmime arkeologjike edhe shqiptarët nga Kosova. Kështu, pas këtyre viteve interesimi u shtua edhe më shumë gjë që çoi në zbulimin e trashëgimisë sonë kulturore- arkeologjike që nga periudha e neolitit deri në

⁷ Vasilije Kozarac, Muzeumi i Kosovës-Metohisë, “Glasnik Muzeja Kosova i Metohije”, Prishtina, 1956.

⁸ Po aty

⁹ Mr. Tefik Morina, pun. i cit., f. 243.

mesjetë.¹⁰Fondet e arkeologjisë në Muzeun e Kosovës posedojnë këto koleksione: neolit, eneolit, hekur, antike, mesjetë. Ndërkaq, fondet e përgjithshme të koleksioneve të arkeologjisë në Muze ende nuk dihen saktësisht, për shkak se inventarizimi i materialit arkeologjik nuk është përfunduar për shkak të demtimëve të luftës. Po ashtu ende nuk dihet numri definitiv i materialit sipas periudhave dhe kategorive. Megjithatë, numri i përgjithshëm i objekteve të arkeologjisë të inventarizuara deri më tani është 2000.¹¹Ndërkaq, nëse i referohemi numrit të përgjithshëm të fondeve të arkeologjisë të vitit 1956, të botuara në Buletinin e Muzeut të Kosovës, nga një punim shkencor i Emil Çerskovit del se janë 5000 fragmente dhe objekte.¹²Ndërsa në vitin 1974 sipas disa shënimeve shkencore-muzeale të Mr. Tefik Morinës, numri i përgjithshëm i koleksioneve arkeologjike arrin në 15707 objekte.¹³Në Sektorin e Arkeologjisë në Muzeun e Kosovës reliket arkeologjike janë të kategorizuara sipas materialit, funksionit dhe formave, duke formuar grupe dhe nëngrupe që u përkasin periudhave të caktuara p.sh. prej guri: vegla pune, armë (sëpata, majë shigjete, brisqe, etj.), prej balte të pjekur: objekte kulti (figurë, altar, etj.), objekte utilitare (enë, pesha tezgjahu, etj.), prej metali: armë (shpata maje heshte, etj.), stoli (unaza, bylyzykë, qafore, fibula, etj.), monedha, prej qelqi: enë tualeti, etj.¹⁴ Disa nga eksponatet më karakteristike të Sektorit të Arkeologjisë janë: Periudha neolitike (koha e gurit të ri, 6000-3500 p.e.re)-Hyjnesha në Fron e zbuluar në Prishtinë, figurë neolitike e zbuluar në Varosh-Ferizaj, figurinë neolitike (kentaur) nga Fafosi-Mitrovicë, figurinë neolitike antropomorfë, kapak prosopomorf.Periudha e metaleve, epoka e eneolitit (bakri), epoka e bronzit dhe epoka e hekurit (3500-IV p.e.)- enë eneolitike zbuluar në Hisar-Therandë, dy urna të periudhës së bronzit të vonë zbuluar në Bërnice të Poshtme, si dhe një urnë e periudhës së hershme të hekurit zbuluar në Bardh të Madh (ish- Bellaçevci), stoli argjendi zbuluar në Banjë të Pejës, etj.¹⁵

Spektori i Etnologjisë-Etnografi

Spektori i Etnologjisë në Muzeun e Kosovës veprimtarinë e vet e filloi që nga vitit 1951, duke shënuar rezultate të kënaqshme.¹⁶ Spektori i Etnologjisë në Muzeun e Kosovës disponon me këtë fond të përgjithshëm të koleksioneve siç janë:
2059 ekzemplarë tekstile
691 ekzemplarë stoli

¹⁰ Po aty

¹¹ Mr.Tomor Krastrati, Kustos profesional i arkeologjisë në Sektorin e Arkeologjisë në kuadër të Muzeut të Kosovës, të dhënat i dha me datën 18.01.2012, Prishtinë.

¹² E. Cerskov, Zbirke Muzeja Kosove i Metohije, "Glasnik Muzeja Kosova i Metohija", Knj.I, Prishtina, 1956, f. 377.

¹³ Mr.Tefik Morina, pun. i cit., f. 249.

¹⁴ Mr.Tomor Krastrati, Kustos profesional i arkeologjisë në Sektorin e Arkeologjisë në kuadër të Muzeut të Kosovës, të dhënat i dha me datën 18.01.2012, Prishtinë.

¹⁵ Fletëpalosje, Informator arkeologjik, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë.

¹⁶ Mumin Zeqiri, Çështje etnologjie në Muzeun e Kosovës, "Studime muzeologjike", Tiranë, 2003, f. 73-76.

401 ekzemplarë poçari, prodhime argjilore

737 ekzemplarë metale

695 ekzemplarë prodhime druri¹⁷

Nga këto të dhëna shihet qartë se Sektori i Etnologjisë evidentoi dhe gjeti në Muze gjithsej 4583 ekzemplarë. Meqë Muzeu i Kosovës posedon listat e tërë materialit etnologjik para luftës, ku janë të regjistruara dhe të specifikuara gjithsej 7290 ekzemplarë relikte të këtij sektori, nga kjo që u pa më lart argumentohet se një numër i madh i eksponateve të etnologjisë janë grabitur nga serbët gjatë luftës.¹⁸ Në kompleksin e Emin Gjikut është hapur për vizitorë ekspozita e përhershme që përmban kryesisht eksponate nga etnokultura autoktone duke përfshirë kombinatorikën qytetare dhe atë fshatare. Në mesin e eksponateve janë: armët e ndryshme (karajfilja shqiptare, kaçatura, huta), veshje të ndryshme nga viset e Kosovës dhe më gjerë për meshkuj dhe femra (veshja e Rugovës, e Drenicës, e Hasit, e Anamoravës, e Llapit-Gollakut, etj.), shtroje të ndryshme (qilima dhe zburime të tjera nga vendi), vegla dore (veku, çekërku, makina e dorës, etj.), armë të ftohta (thika, shpata, etj.), vegla amvisërie e vegla bujqësore, etj.¹⁹

Sektori i Historisë

Kosova gjatë historisë ka qenë arenë luftërash të përgjakshme, në të cilën janë zhvilluar ngjarje të bujshme shekullore ndërmjet vendasve (shqiptarëve) dhe regjimeve të ndryshme okupuese që nga antikiteti e deri në fundshekullin XX. Prandaj për këto arsye edhe trashëgimia e saj kulturore-historike është shkatërruar, plaçkitur dhe falsifikuar në masë të madhe. Pas Luftës së Dytë Botërore, pikërisht atëherë kur zuri fill themelimi i institucioneve muzeore në Kosovë, një numër shumë i vogël i eksponateve u vendosën në Muzeun e Kosovës. Ndërsa eksponatet e mirëfillta me vlera kombëtare dhe muzeologjike u ruajtën edhe më tej në popull. Kjo vinte nga shkaku se Kosova edhe në rrethana të reja (1945-1999) ishte e kontrolluar (okupuar) nga serbo-jugosllavët dhe për këto arsye substanca kombëtare shqiptare në të gjitha dimensionet e saj u pengua, e këtë fat e përjetoi edhe lënda muzeale.²⁰ Veprimtaria muzeale e Sektorit të Historisë që nga paslufta e deri më sot, përgjatë 12 vjetëve të punës së tij, ka evidentuar rezultate të mëdha në hulumtimin, grumbullimin, ruajtjen, përpunimin, sistematizimin, prezantimin dhe publikimin e thesareve muzeale të historisë materiale që për një kohë të gjatë u munguan muzeve në Kosovë.²¹ Koleksionet e këtij fondi janë gjithësejt rreth 20 mijë eksponate që nga mesjeta e deri te lufta për çlirimin e Kosovës. Në mesin e materialeve muzeore janë : armët, uniformat, fotografitë, dokumentet, xhirimet

¹⁷ Imrane Veliu, Dokumentariste në Sektorin e Etnologjisë në Muzeun e Kosovës, të dhënat i dha me 09.12.2011, Prishtinë.

¹⁸ Mumin Zeqiri, Udheheqës i Sektorit të Etnologjisë në Muzeun e Kosovës, të dhënat i dha me 20.12.2011, Prishtinë.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Dr. Riza Sadiku, Këshilltar profesional në Sektorin e Historisë të Muzeut të Kosovës, të dhënat i dha me 25.02.2012, Prishtinë

²¹ Po aty

filmike, revista, gazeta të kohës për segmentin e UÇK-së, dhunës, eksodit dhe bashkësisë ndërkombëtare NATO-së.²² Ekspozitat më karakteristike që posedon ky sektor janë: armët e ftohta të shek. XV deri në shek. XVIII me origjinë osmane, armët e zjarrit, prodhim shqiptar, siç janë: karajfilja shqiptare e shek. XIX, kostume kombëtare shqiptare të rajonit të Rugovës, Drenicës, xhamadani i Isa Boletinit, palltoja e heroit Shaban Jashari, motori i komandantit Adem Jashari, çiftin e heroit Hamëz Jashari, armët artizanale të UÇK-së, disa pushkë automatike të dëshmorëve të kombit, disa sosh uniforma të dëshmorëve të UÇK-së, flamujt, uniforma ushtarake e komandantit të NATO-së Vesli Klark, rrobat e presidentit amerikan Bill Klinton, xhaketa e ish-ambasadorit amerikan Viliam Voker, sheshiri i sekretares së shtetit Amerikan Ollbrajt, interieri i Presidencës së Republikës së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, Deklarata origjinale e Shpalljes së Pavarësisë të Republikës së Kosovës në letërën me material papirus, etj.²³

Sektori i Natyrës

Deri në vitet e para të pasluftës në Kosovë Sektori i Natyrës ka qenë i vendosur në kompleksin e quajtur “Emin Gjiku”, ku ekzistonin katër shtëpi të vjetra jo shumë të mëdha, në të cilat ndodhej thesari muzeologjik i Sektorit të Natyrës.

Në kuadër të këtyre koleksioneve ekzistonin ekspozite, p.sh. nga Zoologjia ishin 850 ekzemplarë, nga entomologjia 27 ekzemplarë, peshq 11, amfibe 20, reptilë 577, shpezë 20, ve të shpezëve të ndryshme 36, gjitarë 49, skelete të ndryshme të gjitarëve, nga botanika ekzistonin 222 specie bimësh. Koleksionet e përgjithshme muzeore të Sektorit të Natyrës janë gjithsej 1812 sosh dhe paraqesin një material shumë të vlefshëm, sepse dokumentojnë shumëllojshmërinë e formave jetësore nga botanika dhe zoologjia

Të gjitha këto ishin të ekspozuara mirë në një ekspozitë të përhershme, ndërsa prej vitit 2002 janë vendosur në depot e muzeut.²⁴

Disa nga koleksionet me karakteristike të Florës dhe Faunës në Kosovë janë: nga flora spermatophyta (faroret), pinophyta (farëzhveshurat), magnoliophyta (farëveshurat), magnoliatae (dythelboret), pteridophyta (fieroret), forsythia europaea, tulipa scardica, aristolochia merxmuller, aster albanicus, linum flavum, moltkea doerfleri, paeonia decora, etj. Nga fauna janë: ariu i murrmë (ursus arctos linn), dhelpra (vulpes vulpes), pulegra (tetrao urogallus), dhia e egër (rupicapra rupicapra linn), rrëqebulli (lynx lynx linn), ujku (canis lupus), dreni (cervus elaphus), macja egër (felis silvestris), shqiponja e malit (aquila chrysaetos l.), etj.²⁵

²² Raport pune në terren i veprimtarisë hulumtuese rreth grumbullimit të thesareve muzeale në Sektorin e Historisë, Prishtinë, 2012.

²³ Mr. Sadik Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit të Historisë në Muzeun e Kosovës, të dhënat i dha më 15.02.2012, Prishtinë.

²⁴ Dr. Safet Nishefci, Udhëheqës i Sektorit të Natyrës në Muzeun e Kosovës, të dhënat i dha më 25.11.2011, Prishtinë.

²⁵ Po aty

Sektori i Artit

Krahas sektorëve të tjerë, në Muzeun e Kosovës ka funksionuar edhe Sektori i Artit, i cili kryesisht i ka plotësuar resorët si: arkeologjinë, etnologjinë, historinë dhe natyrën me vepra artistike nga piktura, skulptura, grafika dhe grafikonet.²⁶

Koleksionet e punuara nga artistët e Sektorit të Artit dhe që janë vjelë jashtë muzeut arrin numrin rreth 100 ekzemplarë, ndër ato më karakteristike janë: skulptura “Portret plaku”, statuja e punuar me gips që paraqet skulpturën e mbretëreshës dardane, skulptura e dëshmorit të kombit Sali Çeku, piktura me motivacion nga natyra që quhet “Peizazhe natyrore”, pikturë e madhe muri me pamje nga luftërat e luftëtarëve shqiptarë në krye me heroin Skënderbeu, piktura me motivacion etnologjik, sofa shqiptare, piktura-vizatim mjaft interesante e quajtur “Shqiptari i gozhduar me drapër dhe çekan”, etj.²⁷

Krahas Muzeut të Kosovës ekzistojnë edhe një serë muzesh tjerë të profileve të ndryshëm në Kosovë në rang nacional, regjional, komunal e deri të koleksionet individuale private.

Në perspektivë rrjeti i muzeve të Kosovë synon të ecë në hapë me trendet e muzeologjisë bashkëkohore.²⁸

²⁶ Prof.Mr.doc. Fatmir Hoxha, Bashëpunor i lartë profesional (skulptor dhe piktor) në Muzeun e Revolucionit të Kosovës në Prishtinë, të dhënat i dha me 24.02.2012, Prishtinë.

²⁷ Po aty.

²⁸ Mr. Sadik Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit të Historisë në Muzeun e Kosovës, të dhënat i dha më 15.02.2012, Prishtinë.

Identitete ballkanike

MONIKA SHOSHORI STAFA**“GJUHA E TJETRIT” SI KRITER MENDËSIE**

Dy dekada më parë në Perëndim, e ardhmja e Ballkanit shprehej në një fjalë të vetme: Ballkan-Babel! Ballkani i mosmarrëveshjes dhe i dialogut të prerë. Ballkani i gjuhës së refuzuar të tjetrit. Ballkani ku njerëzit shpallen tradhtarë pse vizitojnë kryeqytetin e fqinjit dhe të shitur nëse flasin gjuhën e tij. Ballkani ku përkthehet edhe letërsia e bulevardëve, por shkrimtari i vendit fqinj mbetet i ndaluar. Pak gjë ka ndryshuar nga ajo kohë. Gazetarët e rinj të Europës, që udhëtojnë nëpër vendet e paintegruara për të hetuar stereotipat e vjetra të përfllimit të tjetrit, nuk e përdorin më shprehjen Ballkan-Babel, që të sjell ndërmend mallkimin biblik të ndarjes së gjuhëve, por diçka të ngjashme: Babel-Caffe, Caffe-Babel. Ky është përfytyrimi i sotëm europian për Ballkanin e frikshëm, ku gjuha e tjetrit është më kufi se kufiri.

Kush e ka provuar të udhëtojë jo sot, por muaj më parë, në zonën “me status të ndërmjetëm” të Mitrovicës, do të ketë vërejtur se shqiptarë e serbë e flasin shumë mirë gjuhën e njëri-tjetrit, sidomos po që punë tregtie apo veprimesh të fshehta, por në prani të të tretëve nuk e pranojnë. “Është e vështirë nëse do të tentosh të flasësh në gjuhën e tjetrit thjesht për t’u marrë vesh, domethënë pa një arsye shtrënguese. Nga shqiptarët kjo quhet provokim, sidomos pas plagëve të luftës kjo është e pamundur”, shprehet një koleg yni që e ka provuar “regjimin e kufirit të gjuhës”.

Në përfytyrimin e sotëm europian fundi i diskriminimit shënjohej kur përfundon vëmendja ndaj ndryshimit. Për aq kohë sa mjedisi shoqëror nuk është indiferent ndaj ndryshimit: etnik, racor, kulturor, gjuhësor, fetar, gjinor, të flasësh për mosdiskriminim është thjesht mashtrim ose vetëmashtrim. A mund të jetë dhe ky, tejkalimi i vëmendjes ndaj ndryshimit, një kriter shtesë mbi “12 pikat”, për të mundësuar hapjen e portave europiane për Shqipërinë? Nëse do të ishte vërtet dhe një kriter i tillë, atëherë vendi përpara ka një rrugë të vështirë. 250 mijë kuqezinj alarmojnë prej muajsh çintegrimin e popullit shqiptar për shkak të vetëdeklarimit etnik dhe fetar. Po sikur pyetja europiane për tejkalimin e ndryshimit të shtrohej jo për etnicitetin dhe besimin, por dhe për gjuhën?

“Gjuha e tjetrit” si kriter mendësie: europiane apo ballkanase - s’është një fabrikim gazetaresk. Nuk ka kaluar një vit prej kohës kur një mësuese në Athinë u përjashtua nga rendi i mësuesisë pse kishte gjykuar t’u lejonte fëmijëve shqiptarë të lindur prej prindërisht emigrantë të mësonin në orë shtesë gjuhën e tyre amtare. Një nxënësi tjetër, më i miri i shkollës, nuk iu lejua të ngrinte flamurin e shtetit fqinj, siç ia

njihte ligji, për shkak se fliste gjuhën e tjetrit. Atë gjuhë që iu ndalua qysh më 1945 shqiptarëve banues të Çamërisë që mbetën atje. Por le të mos rendisim më fakte të tilla, të përditshme e të përnatshme në edicionet e lajmeve. Kush ka provuar të udhëtoj në shtetet e fqinjëve të afërm, do të ketë vënë re pa dyshim dhunimin e emrave të vendeve në tabelat e qarkullimit rrugor. Sigurisht, emrat në gjuhën e tjetrit. Shqiptarët shuajnë me bojë të zezë “Vladimir”, “Djakovo” e “Bitola” dhe tjetri, pa e zgjatur, bën të njëjtën gjë me emrat në gjuhën shqipe. Dhe kështu “lufta e gjuhëve” vazhdon në heshtje luftën e ftohtë, fjalën e urrejtjes, refuzimin e tjetrit, diskriminimin e padhunshëm të atij që është ndryshe. Dhe kjo është “lufta e tabelave”, që sa herë e kemi njoftuar edhe për Himarën e fshatrat e Bregdetit, anakronike e ballkanike njëherësh: ti hiq e unë vur, ti e do greqisht por unë e thyej dhe e kthej në shqip se zot jam unë! Në Europë, me tabela ku shtyhet tutje gjuha e tjetrit?! Pak e vështirë për ta menduar! Dhe vetëm një hap duhet për ta vështirësuar edhe më pengesën: A nuk u shqetësua tej mase Tirana jonë kur Presidenti rumun Basescu, në përgjigje të thirrjes së autoriteteve të vendit për ta njohur Kosovën, kërkoi menjëherë status minoriteti për arumunët e Shqipërisë? Pastaj doemos gjërat ndërlikohen më tej. Se popullsi dygjuhëshe dhe pakica kulturore ka në çdo vend ballkanas. Kosovës, shtetit më të ri të rajonit, autoritetet europiane i kërkuan të shënjojë në flamur gjashtë yje, sepse, sipas tyre, gjashtë janë popullsitë etnike banuese atje. “Supi i njërit nën sqetull të tjetrit” - kjo është historia e Ballkanit, ku njeriu, nëse e kthen gjuhën në kufi, mund ta ishullzojë menjëherë vetveten. Sllavët mund të gdhihen poliglotë, se dinë gjuhën e njëri-tjetrit, ashtu si grekë e turq - tani vonë dhe shqiptarëve po u vjen mbarë të flasin për shqip e kosovarisht!

Po, “djalli” ka hyrë dhe brenda gjuhës. Ju shqiptarët e Shqipërisë së vjetër hiç patriotë nuk ini, qortojnë me dëshpërim pushuesit nga Kosova: si i mbani këto emra: Çorovodë, Novoselë, Gollobordë, Selcë? Na po i ndërrojmë, se janë emra të shkijeve. Ua kemi hequr emrat serbë qyteteve e fshatrave e i kemi quajtur shqip: Artanë, Besianë, Therandë. Një urdhër patriotësh të rinj në shtetin e vjetër, përkundrazi, demonin sllav të fshehur në gjuhën e emrave të vendeve sikur nuk e vënë re. Por demoni tjetër, me emrin e fqinjit të jugut, ngre me vrull dallgë zemërimi: Pse liturgjia në kisha bëhet greqisht dhe pse kreu i kishës bizantine nuk është shqiptar? Pse shqiptarët emigrantë ndërrojnë emrat dhe - mos qoftë e thënë - edhe kombësinë? Pse qeveria lejon me lehtësi shkollat greke në vend pa i siguruar për fatin e shqipes në Greqi? Dhe kjo nuk është një gjë e re. Kur shefi i dikurshëm i Kremlinit, Nikita Hrushov, vizitoi Shqipërinë dhe tha se në Korçë kishte dëgjuar të flitej greqisht, qindra faqe letrash e shkresash, artikujsh e polemikash, u shkruan prej udhëheqjes më të lartë të shtetit shqiptar për ta shkukur nga mendjet e njerëzve idenë se kjo mund të kishte qenë e vërtetë.

Por, pa shkuar pas në histori, a nuk do të mjaftonte koka e kthyer prapa e qytetarit të zakonshëm shqiptar kur veshi i zë gjuhën e fqinjit, sidomos të fqinjit verior? Tërë vëmendje ndaj gjuhës së tjetrit, ja ku një dallim shumë i thjeshtë dhe gjenetik u bë menjëherë shenjë vëmendjeje, njësoj si vëmendja e pionierëve vigjilentë në qytetet kufitare dikur. Le të imagjinojmë ç’mund të ndodhte në Zvicrën e afërme, ku më pak se 100 mijë romenë vendës kanë të drejtën e barazisë gjuhësore me frëngjishten, gjermanishten dhe italishten, nëse instinkti i “kokës prapa” do të ishte

si i shqiptarëve, apo më saktë si i ballkanasve? Atëherë askush nuk do të ishte i saktë në orare si orët proverbiale zvicerane! Frika prej gjuhës së tjetrit, sidomos frika se gjuha e tjetrit e folur brenda vendit mund të kthehet në një faktor dezintegrues, është një prej shenjave që nuk përfshiheshin në 12 pikat për të testuar, njësoj si një lakmus lëndën kimike, se si po ndryshon Shqipëria, jo ajo politike, por Shqipëria në mendësi.

Në Ballkan ende mbijetojnë hijet e “luftës së gjuhëve”. Në shtëpi nuk flasin shqip! Flasin “nashkoj”! Ku ka shqiptarë me këtë mbiemër? E flasin mirë shqipen se e kanë mësuar në shkollë! Jo, jo, atje shqipja është gjuhë e parë, greqishtja është e dyta! Ç’thua, si mund të jetë greqishtja e dyta?! Le të thonë si të duan studiuesit, greqishtja është e para. Këto janë vetëm copëza të përditshme bisedash të qytetarëve shqiptarë kur gjykojnë tjetrin. “Lufta e gjuhëve” kthehet edhe në retrospektivë: me serbishten nuk kemi punë se është e vonë, por kush ka lindur më parë, shqipja apo greqishtja? Dhe hierarkia mes njerëzve shpesh përcaktohet nga “gjuha e shtëpisë”, “gjuha e dytë”. Dhe prej këndej menjëherë lind paniku për shthurjen e kombit.

Popullsitë dygjuhëshe kanë një status të posaçëm. Në Shqipëri bëhet humor me shprehjen “*jam pakicë*”, që në një farë mënyre do të thotë dhe “jam privilegj”. Pastaj fillon lufta për “gjuhën e zemrës” dhe “gjuhën e bukës”, thënë më qartë për gjuhën e dashur dhe gjuhën e urrejtur. “Pronari im kërkon emra ortodoksë dhe unë ia jap. Unë kërkoj punë e para dhe ai m’i jep”, pohon një mërgimtar i ri shqiptar me indiferencë të plotë. Këtu fillon blerja e gjuhës, e emrit, e identitetit, dhe menjëherë dhe lufta për parësi. Dhe ky është problem me gjuhën e fqinjit, se me gjuhë të tjera, qoftë dhe kinezisht, je i nderuar. Mirëpo kur fqinji thotë “po”, dhe fqinji mund të marrë vendimin edhe prej qëndrimit ndaj “gjuhës së tjetrit”, atëherë udha europiane mund të jetë më e lehtë. Por si mund të verifikohet vullneti i fqinjit para se të thotë “po”. Ose, më saktë, çfarë mund të kenë raportuar në Bruksel ministrat Lambrinidis dhe Fratini? Meqë një term për fobinë ndaj gjuhës së tjetrit nuk ekziston, siç ekziston ksenofobia apo etnofobia, sepse testi i mendësisë së integritetit për popujt e Ballkanit është krejt i ri, mund të përdornim shprehjen “refuzim gjuhësor”. Shqiptarët e Kosovës qortojnë qeverinë pse RTK-ja ka edicion lajmesh serbisht. Në të Tiranës më të vëmendshëm jemi ndaj tjetrit në jug. Sigurisht që emisarët e Europës së Bashkuar nuk kanë bërë teste gjuhësie në Tiranë. Por testet mund të bëhen shumë thjesht duke këshilluar në distancë katalogët online të Bibliotekës Kombëtare. Cilët shkrimtarë nobelistë ose të mirënjohur të Ballkanit janë përkthyer në shqip? Përveçse në periudhën jugosllave në Kosovë, Ivo Andrić jo, sepse ishte antishqiptar në elaboratet e tij. M. Krleža, Danilo Kiš, Meša Selimović, edhe në janë përkthyer, janë futur në shqip si vjedhurazi, pa bujë, të mos e marrë vesh shtypi, të mos na thonë filoserbë, të mos na shpallin të shitur. Një shkrimtar i njohur shqiptar pati qenë shprehur afro tri dekada më parë se ndërgjegjja shqiptare do të shprehte një shkallë bashkëkohore emancipimi nëse do të shkruhej një libër për një shkrimtar serb. Që nuk është shkruar ende. Pak më me fat ka qenë letërsia greke, edhe ajo kryesisht në kohën kur grekë e shqiptarë ishin “dy popuj miq”. Sidomos poetët u përkthyen në shqip: Janis Ricos, Kostantinos Kavafis, Tasos Livadhitis, sigurisht dhe Zorba greku e Kapedan Mihali të Nikos Kazantzakis. Kur

krahason se ç'nderim kishte për shqiptarët nobelisti tjetër grek Jorgos Seferis, ndër të tjera edhe konsull i Athinës në Korçë në periudhën mbretërore; dhe ç'provokim ngjalli një konsull tjetër këtë vit, pikërisht me gjuhën e tjetrit - shihni shkrimet në varret e të parëve për të ditur çfarë jeni - dëshpërimisht del pyetja: a po bëhet Ballkani më europian apo më tribal? Të dish gjuhën e tjetrit, atij që historikisht është quajtur i kundërti, është një privilegj. Një gazetare e re e klubit të europeistëve të rinj ballkanas, reportazhin e saj e niste me fjalinë: "U befasova pak kur vërejtja se bashkëbiseduesi im shqiptar e dinte gjuhën time". Në sociologjinë e sotme europiane është shtuar një term i ri. Është në gjuhën e tjetrit, në gjuhën e fqinjëve jugorë, si shumë terma të shkencës, dhe ka për qëllim pikërisht dëbimin e djallit prej gjuhës së demonizuar. Quhet empatia dhe është një ndjenjë njerëzore dashamirësie dhe mirësie ndaj tjetrit, por jo aq sa simpatia, megjithëse me të njëjtën prejardhje me të. Simpatia është një ndjenjë e drejtuar së jashtmi ndaj tjetrit, kurse empatia është ta shohësh tjetrin brenda vetes, të shohësh veten te tjetri, ta mendosh individin si një pasqyrë për të parë vetveten, sepse, siç shkruante shumë shekuj më parë poeti i famshëm pers Saadiu, "Si gishtat e dorës njerëzit janë / Të Hyjit janë Lindja dhe Perëndimi". Nuk ka racizëm gjuhësor në botën e shqiptarëve. Mund të ketë në letërsi ironi me karakter shqiptarë që "gjuhën e tjetrit" e kanë parë si çështje karriere. Por vetëm kaq. Gjuha shqipe e provon më së miri këtë. Ka në këtë gjuhë edhe fjalë të kinezishtes, edhe fjalë të hebraishtes, edhe të gjuhëve të tjera më të largëta e më të afërta. Dhe nëse refuzimi gjuhësor si shenja e fundme e Ballkan-Babelit shfaqet e rishfaqet në hapësirën rajonale, kjo nuk është "lakmusi" i vetëm i verifikimit të ndryshimit. "Çdo vend ka Mitrovicën e vet", deklaroi rreth dy muaj më parë kryetari i qeverisë së Kosovës. Ashtu siç kishin Alzas Lorenën, Franca dhe Gjermania. Ashtu siç kanë Komarnon, Çekia dhe Hungaria. Ashtu siç kanë "Srpska Republika-n" serbë e boshnjakë. Sepse popuj homogjenë në botën e sotme nuk ka - dhe ata që e shënjojnë në Kushtetutë thjesht shënjojnë një premtim. Por popujt e lirë nuk i tremben gjuhës së tjetrit. Regjisori i filmit "Spanglish" këtë na thotë: jo gjuha, por mosnjohja e kulturave, mund të jetë problemi i asaj dukurie që sot rëndom quhet "incom" - moskomunikim.

Në antikitetin helen kishte grekë dhe barbarë dhe barbarët nuk ishin popuj inferiorë, por popuj që flisnin një gjuhë të ndryshme nga greqishtja. Kur gjermanë e sllavë njohën për herë të parë njëri-tjetrin, të parët e quajtën veten "deutsch", të kuptueshëm; por tjetri i quajti "nemci", të pagojë. Ashtu ka ndodhur dhe me shqiptarët: heronjtë e tyre legjendarë nuk e quajnë veten as arbër as shqiptarë, thjesht thonë se i folën njëri-tjetrit "në gjuhë të vet". Kur Bullgaria u bë anëtare e bashkësisë europiane, menjëherë kërkoi që monedha euro të kishte dhe versionin e saj me shkrimin cirilik sllav. Në aulat e konferencave të Bashkimit Europian doemos ka dy greqishte: një të Athinës e një të Qipros; dy gjermanishte: një të Berlinit e një të Austrisë; çekisht e sllovakisht - megjithëse deri dy dekada më parë ishin e njëjta gjuhë. Sepse popujt mendojnë se gjuha e tyre ka lindur e para, se Zoti vetë i tha me gojë urdhëresat e veta në gjuhën e tyre, dhe ky është etnocentrizëm. Veçse kur etnocentrizmi kthehet në fanatizëm, qoftë dhe në fanatizëm gjuhësor, atëherë rruga drejt europeizmit ngushtohet dhe "12 pikave" burokratike mund t'u shtohen të tjera që zakonisht quhen "kushte të pashkruara".

EDA DERHEMI**ZAMAN, DERMAN, BALLKAN, MOR AMAN!**

“*Njat'zaman t'asaj furie*” është një këngë qytetare shkodrane që, në versionin tim, e këndon me shumë elegancë Inva Mula shoqëruar nga kuarteti i harqeve Gaudi. Më duhej të prezantoja në radion publike të qytetit tim një cikël të muzikës shqiptare ku kisha përfshirë edhe këtë këngë, dhe s'dija ç'do të thoshte fjala ‘zaman’. Kënga më pëlqente shumë, ndaj nuk doja ta lija jashtë prezantimit. Por nëse e futja, duhej t'i përktheja titullin. Më polli bela e madhe për dy ditë. E kisha dëgjuar fjalën ‘zaman’, por s'kish Zot të më kujtonte ç'qe tamam. Sillja nëpër mend gjithë shprehjet e nonës sime kryqebardhë që e kish gjuhën të mbushur me turqizma, po mazallah se e gjeja kund ‘zamanin’ në inventarin llafe-none ruajtur me aq dashuri në kujtesë. Shkova të pyes një shok grek nga Kreta që e ka zyrën afër meje, me shpresë se ai, si ballkanas, mund ta dinte. Nikos u mendua, por më tha se nuk e kish dëgjuar këtë fjalë. Më sugjeroi t'i shkruaja një mikut tonë të përbashkët turk, Erkanit, që mua më pat dalë nga mendja. U shkruajta në të njëjtën kohë edhe Erkanit që jetonte në qytetin tim, edhe P.L. në Tiranë. Erkanin e pyeta nëse fjala ekzistonte sot në turqisht apo jo, dhe se ç'kuptim kishte po qe se ekzistonte. I thashë edhe se besoj se ime gjyshe e përdorte, por unë e kisha harruar. Të nesërmen mora përgjigje nga nga P.L., që kam frikë se di çdo histori deri në tre shekuj të shkuar për gjithçka të kënduar e të këndueshme shqiptare. Ky më sqaroi se ‘zaman’ i thoshin ‘kohës’, dhe më tregoi edhe historinë e mrekullueshme të autorit të këngës, që qenkësh Hila i Files nga Shkodra, e që ishte ahengxhi dhe bejtexhi i talentuar, por që pas një grindjeje me nallbanian e lagjes, u arratis në Virpazar të Malit të Zi, sepse bashkë me mikun e vet, në grindje e sipër vranë dy shoqërues të nallbanit. Arratisja zgjati më fort se pritej, dhe malli për të dashurën që e pat lënë në Shkodër, e bëri Hilën e Files të krijonte këtë këngë për motin e shkuar të furisë së dashurisë së vet, “zamanin e asaj furie”. Historia e pazakontë e atij zamani më jep një ngasje të fortë që ndonjë ditë ta shkruaj jetën e Hilës, sido që, qartësisht, furia e dashurisë gjatë së cilës unë besoj se edhe njerëzit e rëndomtë mund të bëjnë mrekullira, duhet t'i qe fikur Hilës muhaxhir e hallexhi kur shkroi këngën.

Sidoqoftë, sot nuk shkruaj as për Hilën dhe as për zamanin në vetvete, por për një marrëdhënie të veçantë që ne shqiptarët kemi me turqizmat. A. Vehbiu këto muajt e fundit i është kthyer disa herë përdorimit të turqizmeve të shqipes, duke theksuar se përdorimi i tyre jo veç nuk i prish punë shqipes, por e pasuron atë. Gomari sigurisht që çalon nga veshë të tjerë. Ai jep edhe një mori shembujsh që dëftojnë se turqizmat shpesh nuk janë thjesht paralele leksikore që përsërisin fjalët tona, por sinonime me vlera të veçanta shprehëse që të ngjashmet joturke nuk i bartin dhe, në fakt, rrinë kaq mirë në gjuhë pikërisht për këtë arsye. Në fakt, nën çarçafin ksenofob të purizmit anti-turk, që herë-herë merr ngjyrën blu të europianëve safi, herë pamjen shumëngjyrëshe të modernëve të çartur, fshihen pasiguritë e një grupi që di mirë se ka halle, por nga t'ia nisë e si ta tjerë problemin, nuk e di. Ndaj, tani u bie mizave ose turqizmeve. Pa dyshim, në këtë proces nuk mungojnë bastisjet manipuluese politike të idesë që, si mospërdorimit ashtu edhe përdorimit të turqizmeve, gjejnë rrugë e marifete t'i japin ngjyrimet patriotike e t'i shndërrojnë në makina vota-nxjerrëse. Por ajo që vura re teksa rreksha të gjeja fjalën time lozonjare 'zaman' që më luante vazhdimisht syrin, është se nuk jemi veç ne që kemi këto pasiguri kulturore lidhur me turqishten, por është një sëmundje e gjithë Ballkanëve, madje edhe e Turqisë, jashtë, por po aq edhe brenda Ballkanit.

Miqte e mi që pyeta, me përgjigjet që më dhanë për fjalën 'zaman', dëshmuar se turqizmat shihen padrejtësisht si fjalë nga të cilat duhet të distancohemi, jo veç ndër shqiptarë, por edhe në Greqi është po kjo mesele. Kur pyeta Nikon grek, besoj se sinqerisht më tha që nuk e dinte. Pas disa orësh në korridor takova Marinën, një tjetër greke që jep pragmatikën në Departamentin e Gjuhësisë. I thashë se para pak kisha folur me Nikos-in për fjalën "zaman", dhe e pyeta nëse ajo e kish dëgjuar në greqisht dhe a ia dinte kuptimin. Marina në fakt u mor fare pak me kuptimin 'kohë' të fjalës, që tha se përdorej paq në greqisht, dhe u përqendrua tek çështja se pse Niko paskësh thënë që nuk e dinte fjalën 'zaman'. Pra ajo ishte e bindur se Niko "kish thënë" që nuk e dinte, dhe as e diskutoi se mundet që vërtet të mos e dinte fjalën. Me sa duket Marina mendonte se Niko kish sëmundjen ballkanase të të distancuarit nga turqishtja për arsye kompleksuale të së shkuarës. E nëse ka një sëmundje të tillë, a nuk duhet të ishte ajo pikërisht greke?! Kur u ktheva në shtëpi pashë se miku im turk, Erkani, më kish shkruar një email për fjalën 'zaman'. Më thoshte tekstualisht kaq: " E dashur Eda. Pa dyshim që fjala ekziston sot në turqisht. 'Zaman' do të thotë 'kohë', siç e di fare mirë edhe ti." Në fillim thashë se mos përgjigja e irrituar e Erkanit ishte thjesht një keqpërdorim prej tij i anglishtes si gjuhë e huaj, që mund të dilte jo tamam ashtu siç donte shkruesi. Por Erkani flet një anglishte shumë të mirë dhe është tip që s'e kam parë kurrë as të irritohet e as të ironizojë. E rilexova dhe kuptova se Erkani vuan nga e njëjta sëmundje si edhe ne: kompleksi se të tjerët kanë kompleksin e të menduarit se ne kemi kompleksin që të tjerët kanë kompleksin se ne kemi kompleksin...Pra ai zinxhiri kompleks i kompleksit ballkanas, si edhe turk, që na lidh të gjithëve dhe nga i cili mund të çlirohemi vetëm nëse nuk paragjykojmë më tjetrin si përdorues apo mospërdorues të turqizmeve. Marina kujtoi se Nikos-i fshehu njohjen e fjalës 'zaman' që të dukej sa më jo-turk, pra më i civilizuar dhe europian, dhe njëlloj Erkani mendoi se unë e dija fjalën dhe, për arsye të ndryshme (?), po shtiresha sikur nuk e dija. Të them të

drejtën, nisa të mendoj se kjo ideja e idesë së idesë ishte shumë ngatërrestare, ndaj vendosa ta pres këtu muhabetin e të mos e ndjek më tutje. I kam takuar tre miqtë e mi pas atij komunikimi dhe kemi kaluar për bukuri, duke mos e përmendur hiç atë punën e ‘zamanit’. Ndoshta e kemi harruar siç dimë të harrojmë ne ballkanasit. M’u kujtua kushëriri im i mirë dhe i zgjuar që, një herë, pasi kish lexuar një shkrim timin, më tha se i pëlqente shkrimi, por s’i pëlqente që përdorja turqizma. Sikur s’kemi fjalë shqip për to! I thashë se turqizmat në fakt *janë* fjalë shqip, dhe unë jam krenare për to, dhe s’lë njeri që të m’i heqë nga gjuha e të më varfërojë shprehjen. Pse nuk e kanë problem anglishtfolësit faktin që anglishtja është ndër gjuhët me sasi më të madhe fjalësh të huazuara? Një muhabet të ngjashëm, veç disi më të hershëm, qëlloi që bëra me një shok gjuhëtar, A.M., që ndërton një databazë të shqipes duke vjelë leksik, frazeologji dhe struktura nga shtypi, dhe duke ia nënshtruar këto më pas programeve kompjuterike. Edhe ai më tha se kish vjelë disa nga shkrimet e mia, sepse përdorja turqizma. Shpesh, për natyrën dhe frymën e shkrimeve të mia, turqizmat janë ilaç si gjylaxh (edhe kjo një fjalë pe të nonës sime), që i vijnë mirë për shtat ironisë, shakasë e lodrave; por unë jam e sigurt për shqipen qelibar e gjithë lëng që përdor, ndaj fakti që veçohet një shkrim i imi për përdorim turqizmesh, besoj se dëshmon faktin tjetër që atë klasë ne e kemi veçuar disi më fort se klasa të tjera fjalësh të huazuara, (e Zoti na faltë në mos paçim të tilla me bollëk!); ai grup na prek më shumë, e kemi politizuar më fort, na djeg e na kruhet veçanërisht, sido që të gjitha llojet e huazimeve na bezdisin dhe do vdisnim të lumtur po të vërtetonim se jemi ne kërthiza e qytetërimit perëndimor, sado larg qytetërimit e të pahonepsur prej tij qofshim sot. Por ç’i do llafet! Kjo është koha dhe ora e Ballkanit, zamani ynë polifonik kulturor, ekonomik e politik. Ndoshta zaman tjetër më i mirë na pret. S’thonë kot në Ballkan: “Ditë e re, nafakë e vjetër”.

Recensione

NJË VEPËR STUDIMORE ME VLERA PËR GJUHËN E XOXËS

(Dr. Bukurie Mustafa, Gjuha e romanit “LUMI I VDEKUR” të Jakov Xoxës, Institutit të Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup, 2011)

Libri GJUHA E ROMANIT “LUMI I VDEKUR” të JAKOV XOXËS i dr. Bukurie Mustafës, botim i Institutit të Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup (2011), është një studim monografik për gjuhën e një shkrimtari nga më të veçantit të letërsisë shqiptare, i cili ka ditur jo vetëm të shkruajë artistikisht, por dhe të krijojë gjuhë.

Është thënë sa hera se Jakov Xoxa është njëri prej shkrimtarëve më të talentuar dhe më të shquar të letërsisë shqiptare, njohës i mrekullueshëm i gjuhës popullore shqipe, që ka tërhequr vazhdimisht dhe vëmendjen e studiuesve të gjuhës. Sipas fjalëve të atyre që janë marrë me këtë punë, fondi i tij leksikor kap afro 10-12 mijë fjalë. Kjo e bën këtë shkrimtar jo vetëm mjeshtër të përdorimit artistik të fjalës shqipe, por dhe krijues të shumë neologjizmave.

Në këtë kuptim, gjuha e veprës së Xoxës afrohet me Fjalorin e një Shekspiri, i cili sipas disa studiuesve të tij ka pasur 15000 fjalë. Apo Miltoni, i cili ka përdorur prej 7000 deri 8000 fjalë.

Për gjuhën e këtij “Shekspiri” a “Miltoni” të letërsisë shqipe janë shkruar studime e disertacione edhe nga studiues të tjerë, siç është për shembull “Gjuha e Jakov Xoxës - veçori leksiko-semantike dhe stilistike” e Shefkije Islamajt (2000), porse studimi në fjalë i koleges sonë Dr. Bukurie Mustafa fokusohet veçanërisht dhe imtësisht në gjuhën e romanit të tij “Lumi i vdekur”, një vepër artistike e një individualiteti të fuqishëm dhe të papërsëritshëm në letërsinë shqiptare, që shquhet për gjuhë e stil të veçantë. Për veçantitë e këtij romani, ja çfarë thotë vetë autori shprehimisht:

“Desha të shkruaj një roman jo sikur lexuesin iks ose epsilon ta kem larg, jo, desha të shkruaj sikur lexuesin ta kem para meje, gjatë çdo radhe, sikur të hyj në bisedë me të, sikur t’ia tregoj jo letrës, por lexuesit me mend në kokë, që duke lexuar, do të kundërshtojë, të flasë, të thotë ki mendjen, mos gënje! E desha romanin tim që të jetë sa më realist, se realizmi në art është gjithçka për mua”.

Me këtë vepër të saj, për gjuhën e një shkrimtari kaq kompleks, që nuk ka qenë e lehtë për t’u realizuar në përmasat e tilla të një monografie, autorja dr. Bukurije Mustafa dëshmon këmbënguljen e studiueses së zellshme dhe përsëritshme në vrojtuese në trajtimin e problemeve në fushën e gjuhës së letërsisë, duke i rrokur ato në një pamje tërësore në të gjitha dimensionet: në fonetikë, morfologji, fjalëformim, leksik, stilistikë.

Librit i prin një Parathënie, Rezymeja në anglisht, dhe është strukturuar në disa kapituj kryesorë:

- I. GJUHA E LIGJËRIMIT LETRAR
- II. MJETET SHPREHËSE GRAMATIKORE
- III. FJALËFORMIMI
- IV. FUSHA KUPTIMORE E FJALËS
- V. SHITESIMI I LEKSIKUT SIPAS BURIMIT
- VI. FIGURAT (TROPET) GJUHËSORE

Në këto makrostruktura, romani “Lumi i vdekur” vështrohet në rrafshin semantik e leksikor, por edhe vlerat stilistike që bartin fjalët, ngjyrimet e ndryshme emocionale, kuptimet e figurshme, si dhe frazeologjizmat popullore. Trajtohen dhe analizohen kategoritë kryesore morfologjike: emrat, mbiemrat, foljet, përemrat, ndajfoljet etj.; ndërtimet, funksionet, kuptimet leksikore që shprehin ato, por edhe ngjyrimet emocionale e subjektive të këtyre njësive. Shënjoheft aftësitë fjalëformuese të fjalëve, vlerat sintagmatike, që do të thotë aftësia e lidhjes së fjalës me fjalë të tjera, vlerat paradigmatiske etj. Fjala nuk analizohet si e vetme, por analizohen edhe funksionet emërtuese të saj, fjalët e përngjitura e të përbëra, mënyrat e ndërtimit (parashtesor, prapashtesor e nyjëtimi), me përdorim mbiemëror, foljor apo ndajfoljor.

Sipas vëzhgimeve të Dr. Bukurie Mustafës, “Vlerat gjuhësore të romanit “Lumi i Vdekur” të Jakov Xoxës flasin për një fond të pasur leksikor (letrar e popullor, vetjak e të huazuar etj.), gramatiske, semantik (të shitesimit historik, arkaik etj.). Por vlera gjuhësore e ligjërit letrar e të shprehjes artistike, shtrihet edhe në rrafshin stilistik (fonostilistikë, morfostilistikë, sintaksostilistikë, leksikostilistikë, semantostilistikë).

Me analizat e argumentuara, me dijet gjuhësore dhe me korrektësinë e studiueses serioze, autorja dr. Bukurie Mustafa ka arritur të përimitojë tema gjuhësore me interes. Ky është një studim i dalluar që rrok në tërësi gjuhën e një shkrimtari, me stil të qartë në shtrimin e problemeve, me trajtimin koherent të përmbajtjeve gjuhësore, me shembujt e shumtë që ilustrojnë një numër trajtesash që lidhen me gjuhën e Xoxës. Si i tillë, libri që kemi në dorë do të tërheqë vëmendjen e studentëve dhe të studiuesve të gjuhës, si dhe të gjithë atyre që interesohen për problemet letrare në përgjithësi.

Libri paraqet një tërësi me përmbajtje të strukturuar qartë, të lidhur konceptualisht dhe të formësuar metodologjikisht. Larmia dhe gjerësia tematike nuk e cenon as profesionalizmin, as argumentimin dhe as trajtimin shkencor. Thënë shkurt, libri na shfaqet shumë kërkues në fushën e studimeve në problematikën e gjuhës së shkrimtarit.

Autorja e këtij studimi monografik, për të arritur në rezultate të dëshirueshme dhe të pranueshme, ka shfrytëzuar një literaturë të gjerë, dhe mendimet e veta i mbështet edhe në atë se çfarë kanë thënë të tjerët përpara saj për gjuhën e Xoxës dhe për shqipën përgjithësisht në aspektin teorik (si p.sh. studiuesit Rexhep Qosja, Xhevat Lloshi, Jani Thomai, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Shefkije Islamaj etj.), pohimet e të cilëve i citon me korrektësi dhe në vendin e duhur.

Për rezultatet e arritura, si dhe për metodologjinë e saj që ka ndjekur, vepra e Dr. Bukurie Mustafës do të jetë një libër që lexohet këndshëm, një mjet i mirë pune për studiuesit, dhe do t'u shërbejë atyre që do të merren me gjuhën e shkrimtarit e të shkrimtarisë, si një model a gjedhe, një fushë kjo jo shumë e lëvruar ndër ne.

Për arsyet që u thanë më sipër, si njëri nga recensuesit e kësaj vepre, unë i propozoja Institutit të Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve në Maqedoni që dorëshkrimin me titull GJUHA E ROMANIT "LUMI I VDEKUR" të JAKOV XOXËS, të autores dr. Bukurije Mustafa, ta vinte në planin e botimeve të veta, duke qenë i bindur se ai i sjell pasurim kësaj veprimtarie.

Qemal Murati

MARRËDHËNIET SHQIPTARE-MAQEDONASE - KONTEKSTI I ENCIKLOPEDIË

Enciklopedia e ndarjes (Marrëdhëniet shqiptare-maqedonase - konteksti i Enciklopedisë së Maqedonase). *Kumtesa të Tribunës shkencore të organizuar nga Instituti Albshkenca, mbajtur në Prishtinë, më 7. 10. 2009.* Botoi Instituti Albshkenca, Prishtinë, 2010, f. 124)

Vëllimit i prin kumtesa e Akademik *Rexhep Qosjes, Paragjykimet e vjetra në kushte të reja.* Profesor Qosja, i cili tri dekadat e fundit ka shkruar shumë për dhunën maqedonase mbi shqiptarët, në të vërtetë dhunën policore dhe ushtarake, dhunën e organizuar institucionale dhe joinstitucionale, dhunën politike dhe psikologjike, dhunën gjuhësore dhe kulturore, dhunën për gjithçka dhe për asgjë, kësaj radhe sjell një sintezë të historisë së kësaj dhune dhe paradigmën serbe të saj. Shkolla maqedonase, përkujton Profesor Qosja, është dije e shkollës serbe për shqiptarët dhe historinë e tyre, është shkollë e paragjykimeve ndaj shqiptarëve, historisë së tyre, gjuhës, kulturës dhe sidomos pranisë së tyre në hapësirën e sotme shqiptare në Maqedoni, të cilën më parë se sa ta sistemojnë në Enciklopedinë maqedonase e kanë shprehur në artikuj publicistikë në shtypin ditor, e shkencor, në konferenca e botime të veçanta etj. Dhe, më parë se sa akademikët maqedonas këtë po e bëjnë dhe e kanë bërë po në këto përmasa, akademikët serbë, e madje edhe akademikë e Akademi të tjera ballkanike e evropiane, për të cilat ne dimë shumë pak apo nuk dimë asgjë. Kjo është arsyeja pse shqetësimi ynë, për botimet enciklopedike serbe, greke dhe madje evropiane do të duhej të ishte më i madh, për vet faktin se ndikimi i tyre në shkencën ndërkombëtare është shumë herë më i madh dhe shumë herë i besueshëm se ai i enciklopedisë maqedonase.

Por, vazhdon Profesor Qosja "Harrohet të theksohet se ky i ashtuquajtimi imazh i padëshiruar nuk është pasojë vetëm e sjelljeve të vetjeve dhe grupeve të përmendura, por pak a shumë edhe e përfytyrimeve të krijuara për ne më përpara në enciklopeditë, në doracakët e ndryshëm, në tekstet historike, publicistike, letrare në gjuhë të tjera, ballkanike dhe evropiane, në të cilat trajtohet edhe problematika shqiptare. Në shkencën tonë, në krijimtarinë tonë intelektuale nuk është bërë ose, është bërë shumë, shumë pak, për mposhtjen, përgënjeshttrimin, zhvlerësimin e atyre përfytyrimeve, domethënë të atyre gabimeve, shtrembërimeve, paragjykimeve për shqiptarët në veprat në të cilat trajtohet edhe problematika shqiptare", përfundon Qosja, duke kujtuar dhe duke radhitur gjithë ato vepra dhe sinteza të mëdha shkencore që i kanë popujt shtetëformues dhe popujt modern, e që shqiptarët ende vazhdojnë të mos i kenë.

Prof. dr. *Shefki Sejdiu*, në studimin e tij *Paradigma, formë sistemore (argumentimi apo edhe përgënjeshtrimi) në trajtime shkencore*, ka trajtuar një nga problemet më me ndikim në gjithë historinë e studimeve albanologjike të studiuesve serbë e maqedonas në dy shekujt e fundit. Fjala është për sintagmën *zbritje nga malet*, përmes së cilës Akademia maqedonase përpiket ta mohojë autoktoninë e (proto)shqiptarëve në ultësira dhe në lokalitete urbane të Maqedonisë. Pra, shkruan

profesor Sejdiu "*autoktonia* e banorëve shqiptarë të kësaj hapësire përmes kësaj *sintagme* është vënë në sprovë, duke harruar se (*jo*)*autoktonia* e banorëve të hapësirave të ndryshme të mbarë globit tokësor (janë) është dukuri universale, probleme komplekse e edhe koncepte relative, ku nënkuptohet edhe *kronologjia* që përmban edhe konceptin *rend në kohë* dhe të tjerë faktorë e rrethana që janë në raporte kauzaliteti".

Çështjes në fjalë Prof. Sejdiu i është qasur nga aspekti semantik dhe në mënyrë interdisiplinare, ndërsa më tej, sidomos në pjesën e dytë çështja është kundruar nga aspekti antropologjik e tipologjik. Pjesët vijuese të këtij studimi i janë kushtuar konkordancave, por edhe dallimeve kundërvënëse në fushë të onomastikës me përqendrim të veçantë tek gjinia e gjenerikut të emrave të lumenjve, cilësi kjo dalluese e gjuhës shqipe edhe kundërvënëse në raport me gjuhët sllave. Vëmendje të veçantë u është kushtuar disa çështjeve të domenit të fonologjisë diakronike, përkatësisht evoluimit të fërkimores (frikativit) /s/ në /sh/ në protoshqipe. Këto fërkimore u kanë shërbyer shumë gjuhëtarëve që nga Skoku, Bariqi e Çabeji, t'i trajtojnë etimologjitë e disa toponimeve (ojkonime e oronime) si tek seria *Naissus*, *Scupi*, *Astibos*, *Lychnidus*, *Scardus*, të cilat në saje të ligjeve fonetike të shqipes kanë evoluar në të sotmet (forma): Nish, Shkup, Shtip, Ohër dhe Sharr.

Ky fenomen evolutiv ka bërë që protoshqipja të dallojë nga greqishtja, latinishtja dhe prasllavishtja dhe të ndihmojë në diskutimin rreth autoktonisë së elementit etnik shqiptar në këto hapësira dhe lokalitete urbane. Kalimi i fërkimores alveolare /s/ në /sh/ u ka shërbyer shumë gjuhëtarëve të huaj e të vendit ta shikojnë në sistem zinxhirin ojkonomik *Nish – Shkup – Shtip – Sharr*, që rrjedhin nga trajtat *Naissus – Scupi – Astibos – Scardus*, ku fërkimorja alveolare /s/, sipas mendimit të Skokut, Bariqit e Çabejit ka evoluar në fërkimore alveolare qiellëzore /sh/ vetëm mbi bazë të ligjeve fonetike të shqipes".

Në analizën e tij *Enciklopedia e AMSHA-së dhe ardhmëria politike e Maqedonisë*, Prof. dr. *Agim Vinca*, nxit një orientim pragmatik të shqiptarëve ndaj Maqedonisë së tashme dhe politikës së saj. "Botimi i *Enciklopedisë maqedonase* (Makedonska enciklopedija), vepër e Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve (AMSHA), shkruan Profesor Vinca, është një rast i mirë për rishikimin e marrëdhënieve shqiptaro-maqedonase dhe, pse jo, edhe të vetë ardhmërisë së Maqedonisë si shtet". Akademikët maqedonas ka disa vjet që po e nxisin këtë veprim, madje nga opsioni për federalizmin e Maqedonisë deri te ndarja e saj. Në vazhdim Profesor Vinca kujton të ashtuquajturin "plani i Efremovit", në të cilin, gjatë kohës së luftës së UÇK-së, veç tjerash ai propozonte edhe një Miri të Berlinit mes etnitetit shqiptar dhe atij maqedonas.

Për shkak se projektin e tij në vend se ta kundërshtonin shqiptarët me një kundërprojekt e kundërshtuan ndërkombëtarët, madje duke e shkarkuar autorin e tij edhe nga kryetari i akademisë, vetëm disa vjet më vonë, ja po ky institucion doli me projektin e ri *Enciklopedinë maqedonase*, kundër të cilës po reagojmë të gjithë, kryesisht politikisht, por asnjë institucion me ndonjë projekt shkencor. Studiuesit maqedonas bëjnë atë që deri më tash kemi lexuar në shtypin e verdhë, për nocione, data historike, personalitete dhe më në fund edhe për identitetin historik, gjuhësor, kulturor e etno-psikologjik shqiptar, marrëdhënieve shqiptaro-maqedonase, duke u

mohuar të gjitha këto shqiptarëve, ndërsa investojnë shumë në përdorimin e saj për nevoja të formimit të identitetit kombëtar. Derisa në njërin anë ata përvetësojnë shumë nga historia e antikitetit grek e shqiptar, në anën tjetër punojnë shumë dhe qëllimshëm, jo vetëm kundër historisë së antikitetit dhe asaj të mesjetës, po edhe historisë moderne shqiptare.

Kjo është arsyeja pse Profesor Vinca, krahas reagimit kundër *Enciklopedisë maqedonase* ngre zërin edhe kundër qëndrimit indiferent të dy Akademive shqiptare në Prishtinë dhe në Tiranë "ne shqiptarët jemi i vetmi popull në Ballkan që nuk ka ende enciklopedi të vetën nacionale - Enciklopedi shqiptare. Kemi dy akademi të shkencave, një në Tiranë e një në Prishtinë dhe po flitet, me këtë rast, edhe për formimin e së tretës - të një akademie shqiptare të shkencave në Maqedoni; kemi një numër të madh universitetesh, publike e private, andej e këndej kufirit a kufijve dhe një numër edhe më të madh njerëzish me grada shkencore, doktorë e magjistër të shkencave, e edhe akademikë, por ja që nuk kemi enciklopedi kombëtare, ashtu siç nuk kemi as libra për të qenë të historisë (opinionit shqiptar këto ditë u ballafaqua me një tekst skandaloz të historisë për shkollat e mesme të botuar në Tiranë), e as një histori të plotë shkencore të letërsisë sonë kombëtare prej fillimeve e deri më sot". Analizën e tij Profesor Vinca e mbyll edhe me nivelin e ulët shkencor të *Fjalorit enciklopedik shqiptar*, dhe me mungesën e botimeve të rëndësishme shqipe në gjuhë të huaja.

Prof. asc. dr. *Iljaz Rexhës*, në studimin e tij evidencues dhe krahasues *Vendbanimet dhe popullsia albane gjatë mesjetës në hapësirën e Maqedonisë së sotme (sipas burimeve sllave dhe osmane)*, sjell një mal të dhënash për gjendjen e popullsisë shqiptare jo vetëm në përfundim të Maqedonisë së sotme po edhe në Qendër e në Lindje të saj.

Mbështetur në rezultatet e gjertanishme të shkollës së studimeve historiko-gjuhësore jo vetëm shqiptare, po edhe asaj evropiane: *Alojz Benac, Aleksandër Stipçeviç, Radoslav Katiçiq, Fanula Papazoglu, Alain Dyciller, Konstantin Jireček, Milan Shuflaj, Skënder Anamali, Muzafer Korkut* etj., Profesor Rexha ka vendosur kufijtë gjuhësor dhe etnografik të vendbanimeve dhe autoktonisë së shqiptarëve thellë në lindje të Maqedonisë: *Scupin* - Shkupin, *Bilassora* (Velezi) dhe *Astibosi* (Shtipi), Nishit (Naisus) etj. për ta hapur çështjen më tej jo vetëm në hapësirën e sotme të Maqedonisë po edhe në zonën kontinentale të Ballkanit përgjithësisht. Në këtë rrjedhë Profesor Rexha i bën një sintezë të plotë gjendjes së sotme të dijes jo vetëm gjuhësore po edhe historike e gjeografike për shtrirjen e paraardhësve të shqiptarëve në Ballkan gjatë antikitetit dhe mesjetës.

Autoktonia e popullsisë albane në Ballkan, shkruan Profesor Rexha, është dëshmuar nga studiues të huaj dhe ata vendës edhe përmes toponimeve, oronimeve dhe hidronimeve parasllave që kanë marr formën nëpërmjet të gjuhës shqipe: *Naissus-Nish, Scupi-Shkupi, Astibos -Shtip, Scardus-Sharr, Ulpiana-Lypian, Scodra-Shkodër, Lissus-Lesh-Lezhë, Drivastum-Drisht, Drinus-Drin, Scumbus - Shkumbin, Barbana - Buna* etj. Duke u bazuar në këto dhëna të toponimisë antike linguistët e shquar si austriaku Norbert Jokl, gjermani Gustav Waigand, dhe Henrik Bariç kanë përkrahur tezën se ishte pikërisht Dardania, e përcaktuar si zonë ndër të tjera nga emra si Nish-Shkup-Shtip, që përbënte një vatër të popullsisë së lashtë

albane. Një fakt tjetër që ishte konstatuar, sipas dëshmimeve toponimike, nga linguisti i njohur holandez N. Van Wejk, se në mesjetën e hershme, popullsia serbe ishte e ndarë nga ajo bullgare, prej një popullsie josllave, që shpjegohet me praninë e popullsisë albane". Mirëpo, vazhdon studiuesi ynë "gjatë sundimit mesjetar serb edhe me më shumë intensitet vazhdon sllavizimi i emërtimeve të vendbanimeve në hapësirën e Ballkanit, ku përfshihej edhe Dardania. Kështu që gjatë mesjetës, në hapësirën e Arbërisë mesjetare, Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë së sotme, deri përtej Selanikut të Greqisë u bë edhe sllavizimi i toponimisë parasllave, siç shihet nga dokumentet dhe burimet shkrimore mesjetare: nga *Alpes Albanicae* në *Prokletije Planina*, nga *Durrahium – Durrës* në trajtën sllave *Draç*, nga *Shkodra* në *Skadar*, nga *Ulkinon -Ulkos* në *Ulcinj*, nga *Doclea* në *Zeta*, nga *krahina Palabardhi* në *Belopavliç Zhupa*, nga *Buna* në *Bojana*, nga *Bardusi* në *Belosh*, nga *Bardoniq-Beliç*, *Bardosan-Lipovac*, nga *Guri Kuq-Crveni Kamen*, nga *Gurizi* në *Kamenica*, nga *Ujmir* në *Dobra Voda*, nga *Scupi-Shkupi* në *Skopje*, nga *Bardovci-Gjorgje Petrov*, nga *Bardarios* në *Vardar*, nga *Kumanova* në *Nagoriç*, nga *Bilassora* në *Veles*, nga *Dibra* në *Debar*, nga *Thessalonikis* në *Solun*, nga *Byzantion-Kostantinopolis* në *Carigrad*, nga *Filipolis* në *Plovdiv* etj".

Në pjesën më të madhe të studimit të tij mjaft të vëllimshëm paraqitet inventari shumë i pasur i toponimisë, antroponimisë dhe sidomos patronimisë së albanëve në Perëndim dhe në Verilindje të Maqedonisë gjatë Mesjetës, të vjelë nga dokumentet e Arkivave turke të shekujve XV-XVI. Fjala është për toponime të ndryshuara gjatë shekujve të Perandorisë Osmane dhe gjatë mesjetës bizantine, si dhe për patronimin etnike të shqiptarëve të lidhur qoftë edhe vetëm me patronimin etnonimik arbëror, si: *Petro Arbanas*, *Dimitri Arbanas*, *Nikolla Arbanas*, *Bogdan Arbanas*, *Bogoslav Arbanas*, *Milosh Arbanas*, *Gjuro Arbanas*, *Mihajl Arbanas*, *Todor Arnaut*, *Andreja Arnaut*, *Lazar Arnaut* apo *Jusuf Arnaut* ose *Hamza Arnavut* etj.

Një grup pseudoshkencëtarësh sllavë të Maqedonisë në krye me Riste Blazhevskin, përfundon Profesor Rexha, kohët e fundit po pretendojnë dhe po mundohen t'i mohojnë faktet historike dhe argumentet shkencore, e sidomos burimet arkivore dhe defterët zyrtarë kadastralë të administratës osmane të shekullit XV të pranuar nga studiuesit vendas dhe të huaj, për praninë e popullsisë albane në mesjetë, pra, para shekullit XVI në tërë hapësirën e Maqedonisë së sotme. Ky grup, mjerisht po shërbehet me tezën e falsifikuar dhe të shpikur nga kuzhina e arsenalit propagandistik të historiografisë nacional-shoviniste serbe, e cila qysh para katër dekadash është ç'vlerësuar dhe demantuar, me zbulimin e gjetjeve të reja arkeologjike dhe dokumenteve të reja arkivore e sidomos të atyre të proveniencës osmane - turke. (...) Shteti njënacional i Maqedonisë së sotme është jetëshkurtër dhe jostabil, ndërsa, shteti qytetar dhe multietnik i Maqedonisë me të drejta të barabarta politike, gjuhësore dhe kulturore për të gjitha nacionalitetet e saj, pa dallim etnie dhe feje, ka perspektivë reale dhe jetë të gjatë.

Studimi i Prof. dr. Qemal Muratit, *Enciklopedia maqedonase – një botim i mbushur me frymë thellësisht joshkencore*, është një shembull i mirë i diskutimit të Enciklopedisë nga pozita e referimeve të zërave të saj. Në të vërtetë fjala është për një sintezë të leximit të saj metodologjikisht kritike dhe hulumtuese njëkohësisht. Pas një hyrjeje kritike për veprën si ide dhe si projekt me porosi paraprakisht

politike dhe vetëm pastaj shkencore e kulturore, i cili nuk i bën nder as vetë maqedonasve. Prandaj autorët e saj dhe sidomos Akademia maqedonase u detyrua ta largojnë nga shpërndarja, pasi në fillim pati reagime nga institucione shqiptare e të huaja²⁶¹. Mjafton të shihet vlerësimi, diskutimi kritik dhe sintetik, që i ka bërë zërit *Shqiptarët në Maqedoni*, për të parë dy anë të kontekstit: zëri enciklopedik për shqiptarët në Maqedoni të akademikëve maqedonas, në të cilin, që në fillim janë dhënë edhe këto të pavërteta: “*Shqiptarët në Maqedoni - bashkësia më e madhe etnike, pjesë e popullit shqiptar që i banon viset perëndimore të Gadishullit ballkanik. Te popujt e tjerë të Ballkanit njihen dhe si Arbanasi, Arnauti ose Šiptari (Planinci). Për nga religjioni, kryesisht janë të konfesionit mysliman. Selitja (ardhja) e tyre në Maqedoni vihet re kryesisht pas shek. XVI, pasi ishin islamizuar. Imigrimi i tyre ka pasur intensitet më të madh në gjysmën e dytë të shek. XVIII, kur feudalët shqiptarë vepronin për mëvetësinë nga pushteti qendror dhe zgjerimin e sundimit të tyre në Maqedoni. Ali Pasha Janina (nga fundi i shek. XVIII) e zgjeroi pushtetin e tij edhe në viset jugperëndimore të Maqedonisë, me çka në fakt filloi dhe imigrimi i shqiptarëve. Atëherë imigruan nga një ose më shumë familje në rreth 30 fshatra. Të gjitha ato erdhën nga Shqipëria Veriore dhe i takonin fisit Gegë. Në Tetovë, Gostivar dhe në vende të tjera erdhën pashallarë gjysmë të pavarur me prejardhje shqiptare, që i nxitën imigrimet. U përdorën bandat kaçake të cilat e terrorizuan popullsinë maqedonase dhe e detyruan të shpërngulet. Në shtëpitë dhe fshatrat maqedonase u vendosën familje shqiptare. Numri i tyre deri në fillim të shek. XIX arrinte rreth 20. 000 frymë (banorë)”. Autori ynë vazhdon më tej me të dhëna për të ashtuquajturat katër periudha të emigrimeve shqiptare nga Shqipëria kryesisht Veriore, si dhe përgjigjën metodologjike dhe parimisht shkencore të tij, një model që do të mund të aplikohet edhe me zëra të tjerë të kësaj Enciklopedie, duke ju kujtuar autorëve të saj se më parë se sa të merreshin me emigrimin e shqiptarëve në Maqedoni do të duhej të merreshin me shpërnguljen e shqiptarëve nga Maqedonia në Turqi, se më parë se sa të merreshin me prezantimin e numrit të rrejtshëm shqiptarë në periudha historike, për të cilat më së paku kanë të dhëna akademikët maqedonas, do të duhej të merreshin me prezantimin e numrit të saktë të shqiptarëve të sotëm në ish-Jugosllavi.*

Një vend të veçantë Murati ua kushtin referencave që autori i tekstit për shqiptarët Stojan Kiselinovski ka përdorur. Në këtë studim nuk është vështirë të kuptohet se si qëllimi e mund arsyen në mënyrën. Vendin e studiuesve, linguistëve më të mirë të shkollës evropiane dhe gjuhëtarët që kanë shënuar majat e studimeve albanologjike: Franc Bopp, Gustav Meyer, Holger Pedersen, Norbert Jokl, Franjo

²⁶¹ Si kundërpërgjigje ndaj “*Enciklopedisë maqedonase*”, dolën dhe dy botime në gjuhën shqipe: “*Maqedonia Shqiptare*” (2009), nga bashkautorët Nijazi Muhamedi dhe Bardhyl Zaimi, dhe një botim tjetër “*Çmenduria e Akademisë – Enciklopedia – Reagime, përmbledhje shkrimesh*” (2009), edicion i gazetës “Koha”, me reagime mjaft emocionale nga autorë të ndryshëm. Nga qarqet akademike një reagim të fortë “*Enciklopedisë maqedonase*” i ka bërë historiani i njohur nga Tirana Kristo Frashëri.

Mikloshiq, Vaclav Cimohovski, Radoslav Katiçiq, Eric Hamp, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Idriz Ajeti etj., e zënë pseudoshkencëtarë serbë e maqedonas, Jovan Trifunoski, Stojan Kiselinovski, Dr Miloš Konstatinov, e madje dhe ndonjë renegat shqiptar si Kapllan Buroviç etj.

Një vend të veçantë dhe gjerësisht të shtruar me dokumente e dëshmi të tjera të vjela nga ato, po edhe të komentuar me kujdes autori ua kushton toponimeve dhe mikrotoponime e ojkonimeve me paradigme etnonimin e mesjetës, të trajtave madje edhe sllave, si dhe patronimeve me bazë leksikore të shqipes mesjetare; simbiozës sllavo-shqiptare dhe koncepteve të Profesor Çabejt rreth kësaj teme; etnonimit maqedon në traditën shkencore shqiptare të shekullit XVIII dhe të fillimit të shekullit XIX. Duke iu referuar etnografëve e albanologëve nga radhët e arbëreshëve, Nikollë Keta, Gjergj Guxeta, Engjëll Mashi, autori kujton se ata patën vënë re se termi *Maqedon* është përdorur në kuptimin “shqiptar i hershëm”, domethënë për të treguar popullsitë vendëse jo greke të Gadishullit Ballkanik.

Një vend të rëndësishëm autori i kushton etnonimit maqedon, përkatësisht trajtave të sotme të tij (kruesisht të shekullit XX), si: *Makedonski sloveni (maqedonasit sllavë)*, *maqedonas sllavë* apo *sllavomaqedonas*, *maqedonas antikë e herë si sllavë*, “*grekë të sllavizuar*”, përkatësisht “*bullgarë të maqedonizuar*”, “*krijim artificial*” i *krijuar gjatë Luftës së Dytë Botërore*”, etj, të diskutuara nga studiues vendor, ballkanik dhe të huaj, për të konstatuar se *maqedonasit e sotëm, si popull dhe si gjuhë, janë vazhdues të sllavëve* sjellë e mbjellë prej dyndjeve të tyre në Ballkan (shek VI-VII pas Krishtit), dhe çdo përpjekje për të dëshmuar ndonjë traditë historike këtu, madje para shqiptarëve nuk është gjë tjetër veç se dhunim qesharak i historisë, sikur shprehej dikur historiani Kiril Ivanov.

Radhën e kumtesave e mbyll eseja e autorit të këtyre radhëve *Marrëdhëniet shqiptare - serbe - maqedone, ndërmjet kimit dhe ndëshkimit*. Në tekstin tonë kemi theksuar evidentuar pozitën e hapësirës maqedonase dhe të popullit maqedonas në rrethana të veçanta historike kur populli shqiptar po kalonte nga njëri shteg historik në kapërcylin tjetër, për tu ndalur më gjerësisht në 'kontributin e vonshëm' të akademikëve maqedonas në këtë rrjedhë, duke përfshirë edhe botimin e Enciklopedisë. Sinteza e këtyre 'kontributeve' është përdhur në disa rrafshë: Koncepti politik në vend të konceptit shkencor për prejardhjen e popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe; Koncepti ekstrashkencor për historinë e shqiptarëve në trojet e tyre etnike shqiptare sot nën Maqedoni, tezë e bartur drejtpërdrejt nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë; Përpjekja dhe përkrahja dhënë institucioneve shtetërore për eliminimin e gjurmëve kulturo - historike shqiptare në Maqedoninë Perëndimore; Satanizimi i antroponimeve etnike me bazë në leksikun shqiptar; Përrjashtimi i vlerave kulturore shqiptare të pranuar në universin kulturor kudo në botë; Veprimi i saj si një laborator i dikurshëm i Akademisë Mbretërore Serbe me qendër në Shkup etj". Sigurisht kontribute të tjera nuk mund të arrinte Akademia e cila ka një trashëgimi tipike të vendeve të ish-sistemit komunist dhe rezultate modeste shkencore, të cilat nuk paraqesin ndonjë rëndësi të veçantë për kërkimet shkencore shqiptare të kohës sonë; Akademia që në shumë aspekte ka përkrahur më parë dhe vazhdon të përkrahë edhe më tej ide, të cilat kanë shkaktuar luftëra dhe

gjenocid në Ballkanin e shqetësuar; dhe Akademia që ende nuk është liruar nga shtimungu i ngushtë nacional, me premisa ultraortodokse.

Në fund të këtij vëllim i është botuar *Deklarata e Institutit Alb-Shkenca*, Prishtinë-Tiranë-Shkup, shpërndarë menjëherë pas botimit të Enciklopedisë maqedonase.

Begzad Baliu

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

STUDIME ALBANOLOGJIKE

5

2012

*Kopertina
Imer Bajrami*

*Përpunimi kompjuterik
Besnik Emini*

*Shtypi
Shtypshkronja
"Focus Print" – Shkup*

Tirazhi

500 ekzemplarë

*Revista botohet me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës të
Republikës së Maqedonisë*

